**MBLEDHJA E DETYRIMEVE TATIMORE TE TATIMPADUESVE DELIKUENT  
(JO-DEKLARUESVE/NDALIM DEKLARUESIT)**

**PhD. Osman NEZIRI**

Administrata Tatimore e Kosoves

osmanneziri@gmail.com

**Abstrakt**

Shumica e kategorive te shoqërisë njerëzore merren me studimin ne fushën e politikave fiskale, me një arsye se gati e tërë popullata është e detyruar ne një forme apo forme tjetër te paguaj taksa te ndryshme. Praktikate e deritashme kane treguar se hartuesit e politikave fiskale shprehin pikëpamjen e synimeve te qeverisë e jo faktorët ekonomik ne periudhën fiskale apo fuqinë aktuale te taksapaguesve .

Se kush është përgjegjës per pagesën e këtyre taksave, dhe se kush duhet te merret me këtë çështje është hipoteza themelore e këtij punimi. Sipas statistikave qe sot ka Autoriteti Tatimor ne data bazën e saje mungojnë mbi 500 mijë deklarata te cilat përfshijnë një numër prej 33 mijë tatimpagues (te dhënat për vitin.2016).

Mbledhja e tatimeve delikuate, identifikimi i mos-deklaruesve dhe ndalim-deklaruesve dhe sigurimi i deklaratave të caktuara tatimore delikuate janë objektivat kyçe të një Autoriteti Tatimor Në mbledhjen e tatimeve delikuate dhe sigurimin e deklaratave tatimore delikuate, është me rëndësi të mbahet mend se këto përpjekje duhet të ndërmerren brenda një qëllimi përfundimtar të përmirësimit të përmbushjes vullnetare, jo vetëm për tatimpagues të veçantë të përfshirë në një rast, por për popullatën e Kosovës si tërësi. Mos-deklaruesit janë tatimpagues të cilët asnjëherë nuk kanë dorëzuar deklaratë; ndalim-deklaruesit janë tatimpaguesit të cilët kanë dorëzuar deklarata, por e kanë ndërprerë. Në secilin rast, fakti se tatimpaguesi nuk ka dorëzuar një deklaratë është shkak për shqetësim dhe duhet të përcillet nga Autoriteti Tatimor.



Varësisht nga rëndësia financiare e tatimpaguesit, në përgjithësi, një mos-deklarues do të ishte i një rreziku i më të lartë krahasuar me një ndalim-deklarues. Megjithatë, nëse një kompani e madhe dështon në dorëzimin e një deklarate, ai gjithashtu do të barte një rrezik të lartë.

Nga këto të dhëna mund të konkludojme se mundësia e rritjes së të hyrave për buxhetin e Kosovës nga luftimi i ekonomisë joformale është një burim i rëndësishëm por jo i vetëm.

**Fjalë kyçe:** *Ekonomia joformale tatimpaguesi, pagesat, ndalim deklarues-mos deklarues.*

## **HYRJE**

Mbledhja e tatimeve delikuate, identifikimi i mos-deklaruesve dhe ndalim-deklaruesve dhe sigurimi i deklaratave të caktuara tatimore delikuate janë objektivat kyçe të një Autoriteti Tatimor. Në mbledhjen e tatimeve delikuate dhe sigurimin e deklaratave tatimore delikuate, është me rëndësi të mbahet mend se këto përpjekje duhet të ndërmerren brenda një qëllimi përfundimtar të përmirësimit të përmbushjes vullnetare, jo vetëm për tatimpagues të veçantë të përfshirë në një rast, por për popullatën e Kosovës si tërësi.

Në vitet e fundit, Autoriteti Tatimor i Kosovës ka bërë progres të mirë në përmasimin e shërbimeve të saj ndaj tatimpaguesve dhe në aktivitetin e saj në mbledhjen e tatimeve por edhe në procesimin e deklaratave tatimore dhe aktualisht synon që me seriozitet të trajtojë tatimpaguesit që statusi i tyre është aktiv në sistem por nuk deklarojnë sipas kërkesave ligjore.

Sipas statistikave që sot ka Autoriteti Tatimor i Kosovës në databazën e saj, mungojnë mbi 500 mijë deklarata të cilat përfshijnë një numër prej 33 mijë tatimpagues (të dhënat për vitin.2016). Autoriteti Tatimor e ka të ditur këtë problem edhe me herët por ka qenë e nevojshme që brenda sistemeve funksionale të krijohen disa parakushte me qëllim që adresimi

i këtij problem te behet me sukses duke arritur objektiven kryesore – zvogëlimin në masën e pranueshme numrin e jo- deklaruesve.

Nga një analizë e bërë në vitin 2016, kanë dalë këto lloje të tatimpaguesve që figurojnë si jo-deklarues:

- Biznese të cilat janë çregjistruar madje kanë edhe çertifikatë të çregjistrimit nga ARBK ( Agjencini i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë) se kanë shuar veprimtarinë dhe akoma figurojnë në sistem si jo-deklarues.
- Biznese të cilat me gjase janë jo aktivë meqë nuk kanë mund të kontaktohen nga zyrtarët e zyrave regjionale por që nuk kanë kryer aktin formal të çregjistrimit dhe figurojnë në sistem si jo-deklarues.
- Bizneset të cilat kanë ndryshuar statusin e tyre juridik dhe deklarohen me numrin e ri fiskal ndërsa numri fiskal nga statusi i më hershem juridik nuk është mbyllur dhe vazhdon të figurojë si jo deklarues.
- Tatimpagues të cilët përkohësisht janë jo aktivë dhe për periudhën e jo aktivitetit ekonomik nuk dorëzojnë deklarata tatimore dhe nuk raportojë se janë jo aktive.
- Biznese të cilat realisht kanë aktivitetet ndertimore por të cilat nuk janë azhure në deklarimet e tyre apo arsye të tjera figurojnë si jo-deklarues.

Po ashtu është me rëndësi për Autoriteti Tatimor që:

-Identifikimi i tatimpaguesve delikuent përfshirë ndalim deklaruesit, jo deklaruesit dhe jo paguesit dhe paguesit me vonësë të tatimeve të bëhet me kohë;

-Krijimi i një procesi konsistent i cili përcjellë jo deklaruesit dhe jo paguesit në mënyrë automatike/elektronike.

### **INSPEKTIMI I DEKLARATAVE DELIKUENTE**

Autorizimi juridik për veprimet e mbledhjes së tatimeve, është i bazuar në Ligjin mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, Ligji Nr. 03/L-222. Bazuar në infrastrukturën ligjore që tash është e zbatueshme në Autoritetin Tatimor dhe ndikimin e ligjeve përkatëse në fuqi,

sot Kosova është në pozitë më të mirë për të zbatuar një seri të procedurave lidhur me Mbledhjen dhe Mbledhjen e sforcuar të tatimeve.

Ligji Tatimore parasheh që çdo person që i nënshtrohet ndonjë tatimi sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë do të dorëzojë në Autoriteti Tatimor një deklaratë të plotësuar sipas këtij ligji. Kur rrethanat të tregojnë se një person duhet të dorëzojë një deklaratë tatimore por nuk e ka bërë, Autoriteti Tatimor në bazë të Ligjit të sipërm do të ketë autorizim të kërkojë që personi të dorëzojë deklaratën tatimore.

Deklarata tatimore duhet të përmbajë numrin identifikues të tatimpaguesit (numrin fiskal), llogaritjen e detyrimeve tatimore dhe të gjitha informatat tjera që kërkohen me legjislacionin apo udhëzimet administrative të zbatueshme të nxjerra në pajtim me legjislacionin e tillë.

Një vlerësim i bazuar në Ligj do të bëhet sipas gjykimit të tij ose saj më të mirë dhe do të bazohet në të gjithë evidencën që ai ose ajo e ka në dispozicion sipas ligjit. Të gjitha tatimet duhet të vlerësohen brenda gjashtë viteve nga data e afatit për deklaram, apo nga data në të cilën është dorëzuar deklarata, cilado që lind e para.

### **MOS-DEKLARUESIT / NDALIM-DEKLARUESIT**

Mos-deklaruesit janë tatimpagues të cilët asnjëherë nuk kanë dorëzuar deklaratë; ndalim-deklaruesit janë tatimpaguesit të cilët kanë dorëzuar deklarata, por e kanë ndërprerë deklaramin. Në secilin rast, fakti se tatimpaguesi nuk ka dorëzuar një deklaratë është shkak për shqetësim dhe duhet të përcillet nga Autoriteti Tatimor.

Varësisht nga rëndësia financiare të tatimpaguesit, në përgjithësi, një mos-deklarues do të ishte i një rreziku i më të lartë krahasuar me një ndalim-deklarues. Megjithatë, nëse një kompani e madhe dështon në dorëzimin e një deklarate, ai gjithashtu do të barte një rrezik të lartë.

Mos-deklaruesit /ndalim-deklaruesit janë në masë të madhe të panjohur sa i përket ndikimit në të hyra. Një tatimpagues që dorëzon një deklaratë, qoftë e paguar, apo jo, së paku e bën me dije Administratën Tatimore se çfarë të hyrash priten nga ky parashtrim. Një

tatimpagues që nuk dorëzon një deklaratë mund të ketë borxh një shumë të madhe të të hyrave – një deklaratë e pa dorëzuar në thelb është një llogari delikuede që pritët të ndodhë. Si e tillë, sa më herët të jetë kontaktuar tatimpaguesi, është mundësia më e madhe për të mbledhur disa të hyra që nuk janë raportuar.

### **Procedurat:**

Të gjithë mbledhësit profesional si konsideratë kryesore duhet të kenë përmbushjen e plotës të obligimeve nga tatimpaguesi. Puna nuk mund të konsiderohet se është kryer plotësisht deri sa tatimpaguesi të mos ketë plotësuar të gjitha obligimet e deklaramit dhe pagesave vullnetarisht përbrenda kohës së paraparë. Ekzistojnë tri pjesë bazike të secilës punës të Mbledhësit tatimor:

1. Të sigurojë të gjitha deklaratat delikuede (kur tatimpaguesi ka ndërprerë dërgimin e deklaratave tatimore)
2. Të marrë pagesat delikuede (kur deklarata është dorëzuar nga tatimpaguesi apo kur deklarata ishte dorëzuar nga Administrata Tatimore pas një vlerësimi dhe kontrolli) – nëse pagesa është bërë më herët të sigurojë se është vendosur si duhet në llogarinë e tatimpaguesit për llojin dhe periudhën tatimore që synohet.
3. Të identifikojë dhe përfshijë të ardhurat nga ato burime që përpara nuk kanë paguar apo deklaruar (ekonomia e hirtë, “kontrabanda”).

Kompjuteri vazhdimisht do të monitorojë dhe identifikojë ata tatimpagues të cilët kanë dështuar të paguajnë tatimin apo të dorëzojnë deklaratën. Kompjuteri do të ketë tërë historinë e tatimpaguesit. Bazuar në këtë informatë inspektorët tatimor duhet të vazhdojnë të vizitojnë dhe ri-vizitojnë secilin tatimpagues i cili është vonë me pagesë apo me dorëzimin e deklaratave. Në të njëjtën kohë, inspektorët tatimor duhet të vazhdojnë me vizitat e edukimit të tatimpaguesit dhe vizitat për qëllime tjera.

Praktika ka treguar se ekzistojnë vetëm pesë mënyra për të plotësuar detyrimin tatimor. Këto pesë mënyra për të plotësuar një obligim janë të vërteta pavarësisht se a flasim për mbledhësin privat apo publik:

1. Mënyra e parë dhe më e mirë për të ri-paguar një obligim është të mblidhet shuma e tërësishme e detyrimit. Kjo mund të ndodhë menjëherë pas njoftimit të parë të

dërguar tatimpaguesit delikuent, apo derisa është e nevojshme të përdoren mjete tjera të mbledhjes. Shpesh tatimpaguesi thotë se ai nuk ka mundësi të kryejë pagës në e plotë edhe pse kemi zbuluar përmes një analize financiare se ai mundet. Në këto raste mbledhësi duhet të insistojë që të bëhet pagesa e tërësishme e obligimit. Kushtet e këqija financiare nuk nënkuptojnë se ai/ajo ka të drejtë të mos kryejë pagesën e tatimit.

2. Një mënyrë tjetër për të kryer ri pagesën e detyrimit tatimor është përmes një zgjatje të kohës, përgjithësisht për një kohë të shkurtër, për tatimpaguesin për pagesën e tatimit, veçanërisht në rastet kur shihet nga një analizë financiare se pagesa e tërësishme nuk është e mundur për t'u kryer menjëherë. Ky opsion zakonisht është në dispozicion për ato biznese me punë sezonale apo periodike, sikurse është bujqësia apo ndërtimi, si dhe ekziston mundësia për të zgjatur afatin e pagesës prej 30 – 90 ditë.
3. Mënyra e tretë për të riparuar një obligim si tërësi është përmes një marrëveshje për pagesë me këste, ndonjë herë e quajtur marrëveshje me këste. Kjo metodë është me e duhur për ato raste në të cilat analiza financiare tregon se kjo është e vetmja alternative e zbatueshme. Ndonëse kjo normalisht bëhet përmes pagesave të barabarta në këste për muaj të caktuar përbrenda periudhës së specifikuar, po ashtu është e mundshme të ndryshojnë shumat mujore apo të lejohen që për muaj të caktuar të mos ketë pagesë, bazuar në gjendjen e tatimpaguesit.
4. Mënyra e katërt për të plotësuar një obligim është përmes një përcaktimi që obligimi nuk mund të mblidhet për shkak se nuk mund të gjendet vendi i tatimpaguesit (bazuar në kërkimet e dokumenteve) apo për shkak se (bazuar në analizat financiare) nuk ka mundësi që obligimi të mund të paguhet. Në të dy rastet mbledhësi duhet të përcaktojë nëse ekziston mundësia të përmirësohet gjendja në të ardhmen. Në cilëndo gjendje, rasti i tatimpaguesit duhet të vendoset në dosjen pasive. Nëse në vonë zbulohen informata, rasti mund të ri-aktivizohet.
5. Mënyra e pestë dhe e fundit është se obligimi plotësohet përmes mbledhjes së sforcuar: urdhër-vjelja, konfiskimi, regjistrimi i barrës tatimore (hipotekës), duke kërkuar librat dhe regjistrimet, etj.

## **RASTET E TVSH-SË APO TATIMI I MBAJTUR NË BURIM/PENSIONET**

Procedurat e mëposhtme zbatohen vetëm në rastin e detyrimit për TVSH ( Tatimi mbi Vlerën e Shtuar) apo tatim të mbajtur në burim (përfshirë pensionet). Sistemi i TI-së (Teknologjia Informative) së Autoriteti Tatimor do të identifikojë të gjithë deklaruesit delikuent të TVSh-së brenda 5 ditëve pas afatit për dorëzimin e deklaratës. Në fazat fillestare të punës me rastet e mos-deklaruesve, TI do të përfshijë në listë vetëm ata tatimpagues të cilët kanë dorëzuar deklaratat, por nuk kanë dorëzuar një apo më shumë deklarata brenda 6 muajve të kaluar, apo tatimpaguesit e sapo regjistruar të cilët nuk kanë deklaruar. TI do të nxjerrë listën e atyre tatimpaguesve delikuent në dorëzimin e deklaratave të tyre sipas kriterëve të vëna për t'u kontaktuar nga Edukimi i Tatimpaguesve Qendra e Thirrjeve apo Mbledhja e Detyrueshme. Lista e tatimpaguesve delikuent në dorëzimin e deklaratave do të vihet në dispozicion në portalin SharePoint të intranetit të ATK-së.

Edukimi i tatimpaguesve është përgjegjës për kontaktet me bizneset e reja për të siguruar se informatat për regjistrimin e bizneseve të tyre janë të vlefshme dhe të sakta. Gjatë kontaktit, ata janë përgjegjës për të siguruar se tatimpaguesi është i informuar tërësisht lidhur me obligimet e deklarimit dhe pagimit. Mund të ketë tatimpagues i cili, për shkak të largësisë apo arsyeve tjera, nuk do të kontaktohet nga ATK kur të regjistrojnë bizneset e tyre të reja.

Kontrolla kryesisht është përgjegjës për kontrollimin e tatimpaguesve për të përcaktuar nëse ata kanë raportuar saktë transaksionet e tyre ekonomike (qarkullimin, të ardhurat, shpenzimet, mbajtjen në burim në paga, etj.). Gjatë kohës së kryerjes së kontrollës, ata janë përgjegjës për të siguruar se tatimpaguesi është aktual në të gjitha obligimet e deklarimit.

Mbledhja e sforcuar do të rishikojë listën e tatimpaguesve të cilët nuk kanë dorëzuar deklaratat me kohë, përveç deklaratave delikumente të TVSh-së, të cilat janë përgjegjësi e stafit të Kontrollit. Me qëllim që të arrihet shkallë më e lartë e përmbushjes, ata tatimpagues të cilët nuk kanë dorëzuar deklaratat për shumicën e periudhave më të fundit do të kontaktohen të parët (për shembull – një tatimpagues me mungesë deklarate për prill 2016 do të kontaktohet para një tatimpaguesi me një mungesë deklarate për qershor 2015). Tatimpaguesit të cilët nuk

kanë dorëzuar një deklaratë të mbajtjes në burim (përfshirë kontributet pensionale) do të kontaktohet para një tatimpaguesi i cili nuk ka dorëzuar një deklaratë për tatimin në të ardhurat.

Para kontaktimit të tatimpaguesit lidhur me një deklaratë delikuede, zyrtari i mbledhjes do të verifikojë në sistem për të përcaktuar gjendjen aktuale të përmbushjes të tatimpaguesit – a ka tatimpaguesi ndonjë borxh tatimor të papaguar, a ka deklaratat obligative që nuk janë dorëzuar, etj.

Zyrtari tatimor do të kontaktojë tatimpaguesin dhe do të përcaktojë shkaku e mosdorëzimit të deklaratës. Nëse deklarata nuk është dorëzuar, kërkoni që tatimpaguesi të dorëzojë deklaratën(at) brenda 10 ditëve. Gjatë kontaktit, merrni informatat bazike nga tatimpaguesi lidhur me qarkullimin e furnizimeve të tatueshme dhe mallrave tjera, totalit të eksporteve dhe importeve, blerjeve të blerjeve të tatueshme për secilën periudhë delikuede që është nën inspektim. Zyrtarët e mbledhjes duhet të ndërmarrin veprimet e nevojshme të sjellin tatimpaguesin në përmbushje të plotë me obligimet e deklarimit dhe pagesës.

Kur të vizitohet tatimpaguesi në lidhje me një deklaratë me gabim, duhet sqaruar arsyet pse deklarata nuk ka mundur të procedohet. Duhet verifikohet nëse tatimpaguesin ka dorëzuar deklaratë të përmirësuar:

Nëse ‘Po’: duhet siguruar një kopje të deklaratës së përmirësuar të tatimpaguesit, duhet verifikuar se a është përgatitur me korrektësi, dërgohet te procedimi i të dhënave për ta futur në sistem.

Nëse ‘Jo’: duhet përmirësuar të dhënat në deklaratë, nëse është mundur. Duhet bërë ndryshime tjera në të dhënat e deklaratës sipas nevojës dhe të dorëzohet deklaratën për procesim.

Me qëllim që të sigurohet se inspektimi i deklaratës delikuede është zgjidhur në tërësi, është shumë me rëndësi që të ketë mundësi të merret parasysht secili numër dokumenti që është vendosur në sistem. Përndryshe, sistemi do të vazhdojë t’i tregojë tatimpaguesit si mosdeklarues kur, në fakt, ata kanë dorëzuar deklaratat. Zyrtarët e mbledhjes duhet të jenë të vëmendshëm kur të merren me ato gabime apo deklarata të pa procesuara që të jenë në

gjendje të plotësojnë tërësisht të gjitha çështjet lidhur me deklaratat e paprocesuara apo deklaratat me gabime.

Kur tatimpaguesi të dorëzojë deklaratën në zyrën regjionale, inspektori do të llogarisë tatimin, ndëshkimin dhe interesin dhe t'i japë tatimpaguesit një njoftim me barkod me balancën obliguese. Tatimpaguesi do të këshillohet të kryejë pagesën në bankë. Nëse tatimpaguesi është i paaftë të kryejë pagesën e tatimit apo borxheve, mbledhësi do të sigurojë informata të duhura financiare dhe do të vendosë një marrëveshje me këste me tatimpaguesin.

Nëse tatimpaguesi nuk do të dorëzojë deklaratën brenda afatit të paraparë, mbledhësi do të përgatisë një referim për kontakt me stafin e kontrollit së regjionit. Referimi do të përfshijë informatat mbi veprimet e ndërmarra për të siguruar deklaratën, arsyet e tatimpaguesit për mosdorëzimin e deklaratës, dhe të gjitha informatat e siguruar për të ndihmuar kontrollin në përcaktimin e detyrimit tatimor.

## **PROCEDURAT, PAMUNDËSIA PËR TË GJETUR BORXHLIUN**

Do të ketë raste që përfshijnë tatimpaguesit të cilët nuk mund të gjenden në adresat e dhëna në dokumentet e tyre të regjistrimit apo adresën në dosjes e Autoriteti Tatimor. Në raste të tilla, do të jetë përgjegjësi e zyrtarit të mbledhjes të shterë të gjitha mundësitë e arsyeshme për të gjetur tatimpaguesin me qëllim që të sigurojë përmbushjen e plotë me kërkesat e ligjeve tatimore të Kosovës.

Tatimpaguesit aktivë duhet të mund të identifikohen nga tatimpaguesi joaktivë, që do të përmirësojë mundësinë për të monitoruar dhe ndjekur tatimpaguesit aktivë. Si rrjedhim, është me rëndësi të ndërmerren veprime të duhura për të identifikuar ata tatimpagues të cilët më nuk janë aktiv.

Nëse një tatimpagues nuk mund të gjendet në adresën e dhënë në sistem, inspektori i mbledhjes do të bëjë përpjekje për t gjetur tatimpaguesin. Disa burime informatash të mundshme përfshijnë:



- Nëse zyrtari i mbledhjes zbulon se tatimpaguesi mungon si rezultat i një kontakti në terren, përpara se të largohet nga terreni, të verifikohet me fqinjët për të parë nëse biznesi ka shkuar diku tjetër, nëse ka operuar ndonjë herë, kur i ka ndërprerë operacionet, sa punëtorë janë parë në biznes, kush ka qenë operatori kryesor i biznesit, çdo informatë tjetër që do t'ndihmonte në gjetjen e biznesit apo zyrtarëve të tij përgjegjës – nëse vendndodhja e biznesit është dhënë me qira apo është hapësirë e marrë me qira, a e dinë fqinjët kush është pronari.
- Vizitoni adresën e dhënë në sistem e cila është adresa e pronarit/zyrtarit kryesor të tatimpaguesit
- Kontaktoni personin i dhënë si kontabilist në dokumentet e regjistrimit të biznesit
- Rishikoni dokumentet në Agjencinë Për Regjistrimin e Bizneseve që ka në themeluar korporatën për të parë nëse individët tjerë janë emëruar, të cilët mund të ndihmojnë të gjemë korporatën
- Verifikoni me Komunën për të përcaktuar nëse informatat e dhëna nga tatimpaguesi në të njëjtën kohë të marrjes së një licencë të biznesit ka ndonjë informatë të dobishme apo nëse tatimpaguesi ka regjistruar një ndryshim në adresë.
- Verifikoni me zyrtarët e postës për të verifikuar nëse tatimpaguesi ka regjistruar ndonjë ndryshim në adresë apo nëse ata kanë ndonjë informatë të dobishme
- Verifikoni me kompanitë e komunaleve për të parë nëse ata kanë ndonjë informatë që do të ndihmojë në gjetjen e tatimpaguesit
- Verifikoni me policinë për të përcaktuar nëse ata kanë ndonjë informatë
- Verifikoni me kadastrën për të përcaktuar kush është pronari i pasurisë (nëse fqinjët nuk kanë mundur të japin ato informata) dhe siguroni adresën e pronarit
- Verifikoni me regjistrin e automjeteve për të përcaktuar nëse tatimpaguesi (apo zyrtari i tij kryesor) ka automjet dhe çfarë adresë është në regjistrimet e tyre
- Verifikoni me bankën që mban llogarinë bankare të biznesit sipas formularit të regjistrimit të biznesit.

## KONKLuzion

Një instrument me rëndësi vitale për kryerjen e punës në mënyrë të duhur është njohja e mjeteve dhe mundësive që janë në dispozicion gjatë kryerjes së detyrave. Mbledhja e sforcuar është një fushë komplekse për të cilën Zyrtari Tatimor i zakonshëm duhet të posedojë njohuri në disa fusha të ndryshme juridike. Nga ekzaminimet me lart shihet se me ligjin e Administratës Tatimore rriten kompetencat për përgjegjësit e shlyerjes së detyrimeve tatimore të prapambetura në krahasim me përgjegjësit që dalin me Ligjin për Shoqërinë Tregtare.

Baza parësore e sistemit tatimor të implementuar në Kosovë është se një tatimpagues obligimet e veta tatimore do t'i kryej në mënyrë vullnetare.

Besimi i publikut kërkon që ne të sigurojmë se të gjithë tatimpaguesit i dorëzojnë me përpikëri deklaratat e tyre dhe paguajnë shumën e duhur të tatimit, pavarësisht shumës që e kanë obligim.

Mundësia e tatimpaguesit që të dorëzojë me korrektësi një deklaratë të vetë-vlerësuar kërkon që tatimpaguesi të dijë rregullat për dorëzimin e deklaratave dhe pagesën e tatimeve. Zyrtarët tatimor janë përgjegjës për ofrimin e informatave atyre tatimpaguesve me të cilët bien në kontakt, të cilat përfshijnë:

1. shpjegime të qarta për obligimet e dorëzimit dhe pagesës
2. shpjegime të qarta se si të përmbushin ato obligime; dhe
3. shpjegime të qarta për pasojat në rast mos përmbushjes me obligimet e dorëzimit dhe pagesës.

Mos-deklaruesit /ndalim-deklaruesit janë në masë të madhe të panjohur sa i përket ndikimit në të hyra. Një tatimpagues që dorëzon një deklaratë, qoftë e paguar, apo jo, së paku e bën me dije administratën tatimore se çfarë të hyrash priten nga ky parashtrim. Një tatimpagues që nuk dorëzon një deklaratë mund të ketë borxh një shumë të madhe të të hyrave – një deklaratë e pa dorëzuar në thelb është një llogari delikuede që pritet të ndodhë. Si e tillë, sa më herët të jetë kontaktuar tatimpaguesi, është mundësia më e madhe për të mbledhur disa të hyra që nuk janë raportuar.

**Referenca:**

1. Ligjim Për Administraten Tatimore dhe Procedurat Nr. 03/L-222;
2. Ligji Për Tatimin Mbi Vleren e Shtuar Nr.05/L-37;
3. Ligji Për Tatimin Në Të Ardhura Personale Nr. 05/L-28;
4. Shënime nga interneti në websitein [www.google.com](http://www.google.com).

**MENAXHIMI DHE PERFORMANCA E BURIMEVE NJERZORE NE NIVEL  
LOKAL**

**Msc. Shkumbin LEKA**

Ministria e Transportit – Republika e Kosovës

majlo1977@hotmail.com

tel: +377 44 22 70 02

**Abstrakt**

Filluar prej një parimi kryesor të përcaktimit dhe efektivitetit të pritshmërive, është të sigurohet se rregullat dhe rregulloret janë të drejta, të arsyeshme, dhe të administruara me paañesi, pasi që mungesa e drejtësisë është njëri prej shkaqeve kryesore të pakënaqësive në vendin e punës. Pastaj të sigurohet menaxhimi i problemeve disiplinore që mund të jetë funksioni më pak i dëshiruar në procesin e menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Në organizatat në Kosovë ka shumë çështje që duhen marrë në konsideratë në dokumentimin dhe politikat mbi rëndësinë e emërimit të kreut administrativ në pozitat kyçe të një organizate (Y.Taejun & Sujae,2009).

Si përgjegjësi kryesore e funksionit të Burimeve Njerëzore brenda një organizate është të rekrutojë, përzgjedhë dhe zhvillojë personelin për t'i përmbushur nevojat dhe kërkesat e atij sektori. Pastaj për shkak të burimeve të kufizuara dhe nevojës për një hapësirë gjithnjë e më në rritje të ekspertizës, funksioni i personelit dhe funksionet buxhetore e financiare të organizatave duhet të renditen pranë njëra tjetrës për të thurë një rezultat.

Në kuadër të kësaj ecurie mund të tregohet rëndësia që kanë BNJ-re apo kapitali njeri, duke krijuar një ambient të favorshëm ekonomik, dhe duke adaptuar dizajnimin e praktikave të mira nga vendet e zhvilluara dhe me një eksperiencë të madhe dhe të gjatë, si dhe përdorimin e aplikimit në vendin tonë, pasi që këto vende kanë akumuluar përvojë të konsiderueshme me qëllim të reformimit të organizatave në shërbimet administrative publike.

**Fjalet kyçe:** *Drejtësia, Regulloret, Menaxhimi, Burimet njerzozor dhe Organizatat.*

## **HYRJE**

Në këtë studim do të trajtojmë disa aspekte të veçanta mbi Menaxhimin dhe Përformancën e Burimeve Njerëzore në nivel lokal, duke përdorur literaturë më të avancuar si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, krahasime të vendeve në zhvillim, vendeve të rajonit (vendeve në tranzicion), hulumtimin, përvojën dhe risitë ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të organizatave publike, me theks të veçantë në nivel lokal.

Rëndësia e këtij studimi është që ti shpalosim problematikat që punonjësit e organizatave që po ndeshën çdo ditë e më tepër, dhe të mundohemi ti shtjellojmë ato, duke dhënë shembuj mbi funksionimin e drejtë të organizatave të vendeve të tjera, si dhe aplikimin tek ne.

Gjatë punës studimore është bërë një analizë dhe është nxjerr rezultat, ku dhe janë dhënë mënyrat me të cilat BNJ-re mund të implementojnë dhe të kontribuojnë në menaxhimin e njohurive mbi funksionimin e një organizate të sukseshme.

Në punim janë paraqitur iniciativat e menaxhimit të dijes dhe barrierat për implementimin e talentit në organizata në Kosovë, ndikimin e proceseve të Burimeve Njerëzore (BNj), praktikave më të mira të ndarjes së diturisë në ndërmarrje, krijimin e kulturës në ndarjen e dijes etj.

Gjëja më e rëndësishme për organizatën është të krijojë kapitalin e duhur intelektual për të egzistuar dhe vazhduar suksese të mëtutjeshme, pasi që Burimet Njerëzore janë një nga shtyllat me prioritet shumë të lartë të një vendi dhe mund të jenë potenciali kryesor duke u

radhitur midis katër faktorëve kryesorë të prodhimit: si toka, fuqia punëtore, kapitali dhe kostot në shoqëri si për nga pesha, ashtu edhe për nga rëndësia (USAID, 2013).

Proceset kryesore të BNj-re si arsimimi i ndërmarrjes, menaxhimi i performancës dhe ngritja e kulturës, kanë rol kyç në zhvillimin e një organizate të bazuar në dije. Është shumë e rëndësishme të zhvillohet mekanizmi i komunikimit efektiv lidhur me sjelljen e punonjësve ndaj dijes, dhe të krijohet klima e besimit dhe e përkushtimit ashtu që të kyçen punëtorët në konceptin e njohurive më të gjëra në praktikë, pasi që praktikat dalluese të BNj-re ndihmojnë të krijohen kompetenca unike me të cilat diferencohen produktet dhe shërbimet, që si rezultat nxisin konkurrueshmërinë.

Në kontekstin për rolin dhe rëndësinë e BNj-re dhe për punëtorët e ditur të cilët krijojnë dije, ti motivojë dhe ti mbështesë ajo dije pastaj do të shpërndalet tek të tjerët

(C.Hefter ,1996).

**Dhe si përfundim** do të japim disa rekomandime mbi konstatimet tona që kanë të bëjnë me problematikën e shtjelluar në punimin përkatës.

## 1.1. PËRSHKRIMI I PROBLEMIT

Interesi i Autorit të këtij hulumtimi është në pajtim me tematikën e parashtruar dhe i shërben themelimit të njohurive të mia specifike qoftë atyre horizontale të bazuara në teoritë dhe praktikat e përgjithshme që flasin për Menaxhimin dhe Performancën e Burimeve Njerëzore, mundësitë dhe sfidat e tyre në tanzicion dhe atyre vertikale që nënkupton arritjen e njohurive praktike siç do të demonstrohen përmes paraqitjes së argumenteve hulumtuese (U.Eco,2006).

Në kohët e fundit, për njerëzit si burim thuhet se ata nuk janë vetëm një nga faktorët e prodhimit, por ata janë faktori më i rëndësishëm i prodhimit. Arsyet për këtë janë të shumta: zhvillimi i shpejtë i teknologjisë, ndryshimet ekonomike dhe demografike, zvogëlimi

i produktivitetit dhe tjetërsimi i punëtorëve e që sot shumë ndërmarrje, faktorin njeri e vendosin në planet e tyre afatgjata strategjike.

Problematika e përgjithshme e faktorit njerëzor në menaxhim trajtohet si sferë veçanërisht e rëndësishme, andaj përshkrimi i problemit të këtij projekti kërkimor është diagnostifikimi i gjendjes aktuale ekzistuese organizative, si struktura, problemet duke identifikuar njëkohësisht kërkesat e qytetarëve në organizata e posaqërisht ato në nivel lokal, si dhe avancimin e proceseve zhvillimore të trendëve pozitive në aspektin strategjik (S.Vellkova & Z.Zilatkovski,2010).

Gjendja e tanishme në institucionet administrative siç është inspektorati i punës dhe institucionet e tjera si juridike, e në përgjithësi gjykatat, u mungojnë kapacitetet që të mbikëqyrin implementimin e ligjeve dhe të ushtrojnë detyrat e tyre sipas kompetencave të tyre, për shkak të problemit me staf, përkrahjes financiare dhe pajisjeve adekuate, të cilat janë çështje thelbësore, po ashtu duhet të jenë më aktive në promovimin dhe monitorimin e respektimit të drejtave të punëtorëve, edhe pse ka pasur përparime të vogla në fushën të drejtave të punëtorëve në Kosovë, ende ka sfida të mëdha për t'u tejkaluar kjo gjendje. Kjo ndodh për shkak të kompleksitetit të ligjeve dhe legjislacionit në një anë dhe implementimit të dobët në anën tjetër (R.Kay & P.Banfield, 2011).

## **1.2. NEVOJA DHE JUSTIFIKIMI I STUDIMIT**

Filluar prej një parimi kryesor të përcaktimit dhe efektivitetit të pritshmërive, është të sigurohet se rregullat dhe rregulloret janë të drejta, të arsyeshme, dhe të administruara me paañesi, pasi që mungesa e drejtësisë është njëri prej shkaqeve kryesore të pakënaqësive në vendin e punës. Pastaj të sigurohet menaxhimi i problemeve disiplinore që mund të jetë funksioni më pak i dëshiruar në procesin e menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Në organizatat në Kosovë ka shumë çështje që duhen marrë në konsideratë në dokumentimin dhe politikat mbi rëndësinë e emërimit të kreut administrativ në pozitat kyçe të një organizate (Y.Taejun & Sujae,2009).

Si përgjegjësi kryesore e funksionit të Burimeve Njerëzore brenda një organizate është të

rekrutojë, përzgjedhë dhe zhvillojë personelin për t'i përmbushur nevojat dhe kërkesat e atij sektori. Pastaj për shkak të burimeve të kufizuara dhe nevojës për një hapësirë gjithnjë e më në rritje të ekspertizës, funksioni i personelit dhe funksionet buxhetore e financiare të organizatave duhet të renditen pranë njëra tjetrës për të thurë një rezultat.

Në kuadër të kësaj ecurie mund të tregohet rëndësia që kanë BNJ-re apo kapitali njeri, duke krijuar një ambient të favorshëm ekonomik, dhe duke adaptuar dizajnimin e praktikave të mira nga vendet e zhvilluara dhe me një eksperiencë të madhe dhe të gjatë, si dhe përdorimin e aplikimit në vendin tonë, pasi që këto vende kanë akumuluar përvojë të konsiderueshme me qëllim të reformimit të organizatave në shërbimet administrative publike (SHBSH, 2001).

Të ofrojmë shumë shembuj mbi programet dhe politikat e programeve të favorshme, qeveritare, të japim rekomandimet tona, për rëndësinë që kanë Burimet Njerëzore, pasi që në çdo organizatë menaxhimi i burimeve njerëzore është funksioni më i rëndësishëm, ndryshe nga burimet mekanike apo ato fizike, burimet e personelit shtojnë një element eksperience të pakrahasuar me burimet e tjera

### **1.3. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT**

Ky punim është mbështetur në përmushjen e disa qëllimeve dhe objektivave të cilat në vazhdimësi kërkojnë zgjidhje përmes Burimeve Njerëzore, si përmes, hulumtimeve, mbledhjes, strukturimit, analizimit të dhënave të mbledhura e pastaj të identifikohen vështirësitë, përparësitë dhe të metat e procesit të zhvillimit aktual në menaxhimin dhe performancën në organizatat e Kosovës në nivel lokal. Qëllimi është që të gjitha vështirësitë të adresohen në institucionet përkatëse dhe organizatat e tjera relevante të cilat shprehin vullnet për mbështetjen dhe aktiviteteve që mund ti kenë BNJ-re. Objektivat janë identifikuar në mënyrë sa më specifike, të matshme dhe të përcaktuara në kohë, që ndihmojnë në



përcaktimin më të lehtë të indikatorëve për vlerësim, përmes të cilëve maten efektet e studimit (P.Andrey & W. Patton,2009).

Objektivat kryesore të këtij studimi janë:

**1.** Krijimi një programi, duke dhënë bazat, modelet dhe idetë lidhur me mënyrën se si të menaxhohet drejt, si të fillohet dhe të zbatohet ky program i MBNJ-re në organizata e posaqërisht ato në nivel lokal ku mund të shërbej si një dhëzues në fushën e administrimit të personelit, që jep gjërat thelbësore të një organizate.

**2.** Bërja e një pyetësoi në sektorin publik për të evidentuar dhe kuptuar si realizohet vlerësimi formal dhe joformal i performancës dhe kuptuar problematikat që punonjësit që mund të ndeshen gjatë këtij procesi dhe pakënaqësitë e tyre në punë.

**3.** Sigurimi i një sistemi të drejtë, transparent dhe të barabartë për menaxhimin BNJ-re lidhur me emërimin, kategorizimin, vlerësimin dhe ecurinë e organizatës, Psh, si sistemi “benchmarking” si mjet metodologjik lidhur me udhëzimet për sistemin e analizimit të vendeve të punës: Ky model bazohet në ushtrimin krahasues të të gjitha pozitave me pozicionet tip (benchmark). Si mjet procedural, në kategorizimin e përgjithshëm të pozitave, pozitave si shembuj nga të gjitha gradat hierarkike vlerësohen dhe iu jepet një vlerë. E që në Kosovë ka mungesa të kategorizimit të përgjithshëm të pozitave, që do të thotë të një udhëzimi që do të përkufizonte karakteristikat kryesore të çdo grupi të pozitave të punës. i quajtur edhe katalog i punës në disa vende (FRIDOM ,2008).

**4.** Paraqitja e një sërë përfundimesh të punimit, duke dhënë disa shpjegime profesionale për çështjet e bëra objekt studimi në këtë punim.

Dhe së fundi, ky studim synon t'i përkufizojë dhe reduktoj disa probleme, duke dhënë shembuj nga më të ndyshmet se si mund të zbatohen ato etj.

## KONKLUZION

Varësisht nga rezultatet e hulumtimeve që do të jepen edhe konkludimet/përfundimet, Në kontekstin e një mjedisi kaq dinamik në të cilin funksionojnë organizatat publike në Kosovë dhe standardizimi i procedurave e bën shumë të vështirë mbijetesën e kjo aq më shumë ndjehet në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Ndaj rekomandohet që sektori publik të bashkëpunojë, të huazojë nga sektori privat në funksion të atyre cilësive kundrejt praktikave që janë të volitshme në të gjitha fushat, por më shumë në interesim të këtij studimi është huazimi i praktikave të përdorura në menaxhimin e burimeve njerëzore (I.Havolli, 2014).

Gjatë këtij studimi jemi munduar t'i precizojmë disa indikatorë të cilët mund të kenë ndikim në kualitetin e tranzicionit, mbi një platformë të tillë studimore mund të sintetizohen njohuri që mund të shërbejnë në njërin anë në përafrimin e fundit të tranzicionit e në anen tjetër mund të shërbej si model për vendet që mund të hyjnë në këto procese. Aplikimi i praktikave të mira duhet orientuar drejt individit pra drejt administratorit publik duke e vendosur atë në qendër të mekanizmit, dhe duke e trajtuar si një aset të çmuar, atëherë mund të arrihet suksesi i organizatave publike në vend. Përmes analizave dhe hulumtimeve, si në plan të përgjithshëm ashtu edhe për çdo rast veç e veç, të përcaktohen shkaqet të cilat çojnë deri te ngërçi në këtë sektor. Të nxirren rekomandimet për mënyrën e funksionimit sa më të suksesshëm, duke i eliminuar barrierat egzistuese të bëhet eliminimi i problemeve dhe sfidave, dhe të aplikohen përvojat të vendeve të tjera si model te ne.

## II. RISHIKIMI I LITERATURËS

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është një funksion bazë organizativ, që jep një kontribut të rëndësishëm në arritjen e objektivave jo vetëm në fushën e biznesit, por edhe në sferat e tjera

të aktivitetit njerëzor, po ashtu edhe vlerësimi i performacës së punonjësve është një nga funksionet më të rëndësishme (DAP, 2013).

Vlerësimi i performancës, ka për qëllim që në mënyrë të kujdesshme të maten rezultatet, cilësia e shërbimit që i ofrohet publikut, produktiviteti, eficienta, kënaqësia e klientëve për shërbimin e ofruar. Nëse procesi i vlerësimit kryhet mirë, ndihmon për një vendimarrje më të mirë, duke kaluar në *Menaxhimin e Performancës*

Punimi është mbështet në një grumbulltëdhënash citate të bazuar në informacionin cilësor të mbledhur, duke e shfrytëzuar literaturën më adekuate të botuara nga autorë të ndryshëm të huaj (ndërkombëtarë) dhe vendor, të cilën mund ta kemi në dispozicion, materiale të ndryshme angleze, manuale, broshura, website online, pastaj edhe direkt nga organizatat publike që operojnë në Kosovë dhe jashtë vendi, në përshtatjen e standardeve Ndërkombëtare të aplikueshme duke dhënë informatata sa më transparente.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore ka kaluar nëpër një proces të gjatë të zhvillimit deri sa ka arritur në statusin që ka fituar sot, si një nga funksionet më të rëndësishme të menaxhimit në një organizate (Koli & Llaci, 2005).

Një përkufizim i thjeshtë, por racional paraqitet si vijon: "Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është proces i tërheqjes, zhvillimit dhe mbajtjes së një force të talentuar dhe energjetike, për të mbështetur objektivat dhe strategjitë organizative" (J.Schermerhorn,2001,p,289)

Te menaxhmenti Strategjik-thonë se: "Qëllimi i matjes se performances se organizatës do të thotë krahasimi i rezultateve të pritura dhe të realizuara, hulumtohen devijimet nga planet, ku bëhet evaluimi individual i të arriturave, ekzaminohet progresi i deklaruar me atë aktual" (N.Mustafa 2005,f,12).

Si shembull i trajtimit të mirë të Ofrimit të Shërbimeve Publike mund të marrim shumë nga **libri "Menaxhimi i Organizatave Publike" të prof.** (A.Ceni 2013,f, 5/7).

I cili mund të jetë një udhërrëfyes i mirë për ofruesit e shërbimeve publike, menaxherët e organizatave publike, punonjësit, specialistët dhe politikanët për tu aftësuar, e sidomos problemet e mëdha në të cilat ballafaqohet si niveli lokal-komunat po ashtu edhe nivelet qendrore për çka bëjmë ligje jo të mira dhe të cilat bien ndesh me praktikën e menaxhimit

- *koncepti i klientit në shërbimet publike;*
- *Konceptimi i shërbimit me orientim klienti, pastaj*
- *raportet në mes qeverisë dhe përfituesve të shërbimeve publike.*

Pastaj lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e investimeve e që lidhet me konstatimin e rekomandimeve të cekura më lartë (A.Ceni 2013,f,10) në librin e tij: “Menaxhimi i Organizatave Publike” publike ka thënë: “ Programet ose projektet zënë një vend të rëndësishëm në jetën e organizatës. Drejtuesit duhet të sigurojnë monitorimin e programeve dhe të synojnë që objektivat dhe rezultatet e tyre të arrihen para kohe. Sistemet e monitorimit dhe të vlerësimit duhet të integrohen në programet dhe projektet e planifikimit”

## **2.1. HISTORIK I SHKURT I MENAXHIMIT TË BNJ-RE**

Ky studim argumenton teoritikisht dhe praktikisht metodën e mënyrave dhe mekanizmave që kanë të bëjnë me ndikimin e menaxhimit të performances organizative, pasi që menaxhimi i Burimeve Njerëzore mbetet një qështje shumë e mprehtë në organizatat në Kosovë e sidomos në ato publike, ku konsiderohen si avantazhi konkurrues dhe i rëndësishëm për organizatën. Të gjitha organizatat, te vogla apo të mëdha, private apo publike, të orientuara nga fitimi ose jo e pavarësisht nga fusha ku e ushtrojnë aktivitetin e tyre kanë një gjë të përbashket: nevojën për tu menaxhuar. Secila prej tyre, për arritjen e qëllimit final angazhon një sërë burimesh njerëzore, material dhe financiare.

Janë pikërisht menaxherët ata që procesin e punës e bashkojnë dhe kordinojnë këto burime të rralla për arritjen e objektivave organizative, që pranojnë rrezikun e marrin vendime në një mjedis dinamik ku ndërthuren e influencojnë një game e gjerë faktorësh ekonomik, social e teknik (I. Mazreku, 2010).

Zhvillimi i konceptit të menaxhmentit të Burimeve Njerëzore ka filluar të paraqitet qysh në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar. Termi Burime njerëzore prejardhjen e ka nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Beer & Tichy 1985). Ky termë u adaptua shpejt nga shumë organizata; i cili sjelli ndryshime rrënjësore në trajtimin e punonjësve duke maksimalizuar potencialin e tyre (N. Ismajli, 2012).

Termi “Menaxhimi i Burimeve Njerëzore” përdoret sot në vend të termit “Menaxhimi i Personelit” të përdorur në të kaluarën. Në thelb është e njëjta gjë, veçse termi i ri thekson, që punonjësit nuk janë thjeshtë një shpenzim por një burim i firmës ashtu sikurse janë kapitali apo pajisjet e tjera, madje burimi më i rëndësishëm i saj (I. Havolli 2014).

Në këtë studim, hulumtues do të diskutohen hipotezat, të cilat janë ngritur në hyrje dhe tani do të bëjmë rishikimin e literaturës dhe nxjerrjes së rezultateve nga të anketuarit ku do të dalim me opinione të ndryshme mbi menaxhimin dhe performancën BNJ-re në funksionimin e organizatave në Kosovë. Këto hipoteza janë të rëndësishme për të kuptuar rreth konceptit të menaxhimit të performancës në performancën e punonjësit.

Zhvillimi i konceptit të personelit, personeli i ndërmarrjes përfshinë të gjithë ata që ndërmarrja i punëson pa marrë parasysh përgaditjen e tyre profesionale, vendet e punës funksionet që përbëhen nga faktorë të mbrendshëm dhe të jashtëm. Në botën bashkohore ndërmarrjet operojnë në rrethinën dinamike, e cila është e ndikuar prej një numri të madh faktorësh. Si pjesë e ndërmarrjes, edhe burimet njerëzore i janë të ekspozuara këtyre ndryshimeve dhe faktorëve që ndikojnë në këto ndryshime. Faktorët e mbrendshëm dhe faktorët e jashtëm të cilët do të elaborojmë më poshtë secilën një nga një (I. Havolli, 2014).

## **2.2. PLANIFIKIMI I BNJ-RE NË ORGANIZATAT PUBLIKE NË NIVEL LOKAL**

Gjatë kësaj pune hulumtuese është vërtetuar se Planifikimi i Burimeve Njerëzore është hap i parë në menaxhimin e efektshëm të Burimeve Njerëzore, ku do të dalim me argumente konkrete për rolin dhe rëndësinë që ka planifikimi i BNJ-ve. Ai përfshinë parashikimin e nevojave të organizatës suaj për resurse njerëzore dhe planifikimin e hapave, të cilat organizata duhet t'i ndërmarrë për t'i përmbushur këto nevoja.

Planifikimi i resurseve njerëzore duhet të jetë ngusht i lidhur me objektivat strategjike dhe misionin e organizatës suaj.

Madje, edhe në rajonet në të cilat ka fuqi të mjaftueshme punëtore me arsimim të mirë, planifikimi i Burimeve Njerëzore paraqet një sfidë, për arsye se nevojat e organizates ndryshojnë vazhdimisht dhe ndonjëherë nuk janë konvergjente. Sfida është edhe më e madhe nëse rezervat e resurseve njerëzore për rekrutim janë të kufizuara, ose nëse njerëzit e ngarkuar me menaxhimin e këtyre resurseve nuk janë trajnuar që t'i parashikojnë nevojat e organizatës (Ch.Lusthaus 2005).

Planifikimi i burimeve njerëzore është procesi i identifikimit të nevojave të ardhshme për personel dhe i përcaktimit të strategjisë që duhet ndjekur për përmbushjen e këtij objekti. Planifikimi i Burimeve Njerëzore është mjaft i rëndësishëm sepse në fund të fundit, dështimi apo suksesi i biznesit varet mjaft nga përbërja, cilësitë dhe përpjekjet e stafit të organizatës (I. Havolli 2008).

**ORGANIZIMI DHE INOVACIONI I BIZNESIT****Msc. Nikson DAKA**

Universiteti Haxhi Zeka-Peje-Kosove

Departamenti: Administrim Biznesi

niksondaka@hotmail.com

**Vehbi RAMAJ**

International University of Struga

vehbiramaj@yahoo.com

**Abstrakt**

Termi i inovacionit dhe rëndësia e tij ne boten moderne është e njohur ne ditët e sotme dhe e hasim pothuajse ne gjdo hape te cilin ne bëjmë gjate jetës sonë.

Meqë inovacionin e njohim si term te globalizimit i cili ndërlidh rritjen, zhvillimin dhe produktivitetin e bizneseve, ne inovacionin e njohim edhe si katalizator te zhvillimit ekonomik sepse baza e ndërtimit te tij është biznesi i vogël dhe i mesëm. Por kush mund te krijoj inovacionin ta menaxhoj dhe organizoj atë? Ne ditët e sotme te konkurrencës perfekte jo-gjdo kush mund te krijoj risi, te rralle janë ata persona te cilët krijojnë ndryshime te një-pas njëshme, sidomos bizneset e vogla dhe te mesme te cilat detyrohen te shpikin risi qe te mbijetojnë ne treg. Por ajo qka i dallon bizneset e vogla nga format tjera te bizneseve ne inovacion është aftësia e fleksibilitetit i cili ju mundëson te përshtaten dhe adaptohen ndaj kërcënimeve te tregut. Kështu bizneset e vogla krijojnë bazën e inovacionit i cili shpesh here nuk vërehet për syrin tone! Pse nuk i vërejmë ne këto risi te bizneseve te vogla? Kjo ndodhe për shkak te barrierave dhe kufizimeve financiare te cilat ndeshen këto biznese e sidomos mungese se organizimit te mirëfillte dhe si te tilla shuhen duke bere qe këto risi te huazohen

nga bizneset e mesme dhe të mëdha të cilat i njohim me anë të produktit/shërbimit dhe marketingut si funksion të veçantë të njohjes.

Posedimi i dijes dhe inovacionit është një nga faktorët kyç në përcaktimin e suksesit të biznesit. Prandaj bizneset e mëdha krijojnë departamente, funksione të veçanta të kërkim zhvillimit dhe inovacionit, ku rekrutojnë dhe selekcionojnë të rinjë nga e gjithë bote në mënyre që të krijojnë risi në tregje.

Vetëm nëpërmes organizimit të inovacionit dhe kreativitetit bizneset arrijnë të funksionojnë në arenën e konkurrencës.

**Fjalët kyçe:** *Organizimi, inovacioni, barrierat, menaxhimi dhe ndërmarrësi.*

### **Metodologjia e përdorur**

Primary research (kërkim primar) – i cili është bazuar në të dhënat dhe informacionet e bizneseve të cilat ekzistojnë dhe i njohin inovacionet dhe organizimin e tyre. Burimi i këtij informacioni është kërkimi dhe strategjia e përshtatjes së bizneseve ndaj faktorëve të mjedisit dhe krijimit të inovacioneve.

Secondary research (kërkim dytësor) – i cili është përdorur për të studiuar konceptet teorike të organizimit dhe inovacioneve, për të kuptuar më mirë mënyrën se si funksionon organizimi i inovacioneve do të përdorim artikuj të shumtë shkencor, publikime dhe hulumtime rreth organizimit strategjik të inovacioneve.

Third research (pjesa e tretë) - është pjesë e cila bazohet në konkluzionet dhe rekomandimet të cilat si përfundim përfshijnë konkluzionin e caktuar për temën e lartë cekur.

### **HYRJE**

Termi inovacion vjen nga Latinishtja *innovare*, që do të thotë, më bë diçka të re”. Kuptimi i inovacionit në kohën e sotme nënkupton procesin e kthimit të ideve në mundësi të cilat krijojnë vlera përkonsumatorët dhe botën.

Termet inovacion dhe kreativitet shpesh përdoren për njëra tjetrën. Në kontekstin e menaxhimit të biznesit të vogël dhe ndërmarrësisë është e ndihmueshme të bëhet dallimi ndërmjet tyre. Kreativiteti është gjenerimi i ideve të reja, ndërsa inovacioni është shfrytëzimi i suksesshëm i ideve të reja.



Është e njohur që inovacioni luan një rol qendror në konkurrencën e kompanive dhe vendeve. Inovacioni kuptohet të jetë drejtuesi kryesor i produktivitetit. Inovacioni ndihmon bizneset të përmirësojnë mënyrën që produktet dhe shërbimet bëhen dhe dërgohen, apo të prezantohen tërësisht të reja.

Hulumtimet tregojnë që 12 për qind e qarkullimit të NVM të BE-së vjen nga produktet apo shërbimet e reja ose të përmirësuara dukshëm ( Komisioni Evropian, 2007). Të dhënat tregojnë se kompanitë inovuese mbajnë një performancë më të lartë dhe rriten më shpejtë se jo-inovatorët. Inovacioni është definuar gjerë si shfrytëzimi i suksesshëm i ideve – apo kthimi i ideve në produkte profitabile, procese, shërbime apo praktika biznesi. Me fjalë të tjera, një inovacion është komercializuar, ndërsa një shpikje nuk është.

## **ÇFARË ËSHTË INOVACIONI DHE ORGANIZIMI?**

Që nga koha e lindjes së organizimit si disiplinë e veçantë në fillimet e viteve të 900-ta teoria e organizimit ka evoluar duke ritrajtuar edhe funksionet e organizatës. Përgjatë gjithë kësaj historie të shkurtër të organizimit si funksion i veçantë i menaxhimit me ane të cilit funksionojnë bizneset janë krijuar dhe zhvilluar koncepte thelbësore mbi individët dhe organizatat e biznesit në lidhje me risitë, novacionet të cilat janë bërë në fushën e organizimit.

*Një përkufizim i gjere e përcakton teorinë e organizimit si ajo fushe qe merret me studimin e mënyrës se funksionimit te organizatës se edhe te lidhjeve te tyre me mjedisin.*

Nga ky përkufizim vërejmë se organizatat kanë ndryshuar shumë që nga periudha e hershme e tyre duke ri-strukturuar format e organizimit dhe stilet e menaxhereve, kjo përben inovacion në fushën e organizimit dhe menaxhimit.

Inovacioni është më shumë se sa thjesht një ide e mirë. Inovacioni nënkupton kthimin e ideve në koncepte të reja në diçka që do të krijojë vlerë. Vlera e krijuar mund të jetë komerciale, sociale apo organizative.

Inovacion është të bërit e gjërave të reja, ose të bërit e gjërave që pothuajse janë bërë me një rrugë të re... Inovacion është një proces me anë të cilit produkte dhe teknika të reja janë përhapur në sistemin ekonomik (**Schumpeter, 1947**)

### Ose komercializimi i parë i një ideje (**Fagerberg, 2004**)

Ose një inovacion është krijimi i një produkti të ri, ose i një produkti shumë të përmirësuar, ose një proces, ose një metodë e re organizimi në praktikën e një biznesi, si dhe një plan pune i organizimit ose i marrëdhënieve me jashtë. Inovacioni i biznesit ka të bëjë me krijimin dhe aplikimin me sukses të ideve të reja brenda organizatës. Kjo mund të jetë në formën e produktit apo shërbimit ose një seri e risive të vogla të tilla si gjetja e mënyrave më të mira ose efektive për të punuar dhe bërë gjërat më të dobishme.

## **INOVACIONET DHE BIZNESET**

Inovacioni është mekanizmi kryesor i rritjes ekonomike (Grossman dhe Helpman 1944). Inovacioni është një proces në baze të cilin bizneset avancojnë pozitën e tyre konkurruese në treg si dhe profitabilitetin përmes adaptimit të vazhdueshëm të produkteve të reja si dhe ideve të reja për të operuar në treg. Një numër i madh i studimeve lidhin inovacionet me performancën ekonomike të vendeve. Ekziston një konsensus i përgjithshëm se inovacionet bartin barrën kryesore të rritjes ekonomike të ekonomive nacionale. Dallimet e mëdha në literaturën ekonomike janë të lidhura me atë se cilat kategori të ndërmarrjeve bizneset e vogla dhe të mëdha janë bartëse të inovacioneve. Inovacionet kërkojnë resurse njerëzore si dhe kapital, gjë e cila favorizon bizneset e mëdha, sepse ato kanë më tepër potenciale të krijimit të inovacioneve. Në anën tjetër hulumtimet empirike tregojnë se bizneset e vogla janë më superiore në inovacione krahasuar me bizneset e mëdha. Mekanizmi kryesor i bizneseve të vogla është inovacioni nëse duan të mbijetojnë në treg, pra bizneset duhet të modifikojnë dhe krijojnë vazhdimisht risi duke përfshirë edhe procesin e punës dhe stilet menaxheriale. Shpesh herë veçoria e inovacioneve tek bizneset e vogla varet edhe nga industria të cilës i takojnë p.sh disa biznese janë më inovative në disa industri se bizneset e mëdha dhe e kundërta, pra fokusi i bizneseve të vogla zakonisht është tek ato industri të cilat kanë intensitet të ulët të kapitalit dhe investimeve.

Efektiviteti i bizneseve të vogla në kuptimin e inovacioneve llogaritet në baze të dy indikatorëve: së pari nëpërmes shpenzimeve për inovacione ku përfshihen shpenzimet për

kërkim dhe zhvillim, dhe se dyti inovacionet përpunëtorë. Ne ketë dy aspekte bizneset e vogla tregojnë efikasitet me të madhe se bizneset e mëdha.

Ekzistojnë dilema rreth superioritetit të këtyre kategorive të ndërmarrjeve në inovacione, andaj edhe hulumtime të mëtejme janë të nevojshme. Se pari nuk është e qarte se cila nga këto kategori të ndërmarrjes është më e suksesshme në inovacione të produktit i cili përfshinë dallimet fizike të produktit. Se dyti nuk është e qarte se cila kategori e biznesit është më e suksesshme në fazat e caktuara të inovacionit. Zakonisht fazat kryesore të inovacionit janë: Invencioni, zhvillimi, prodhimi, hyrja në treg dhe difuzioni. Besohet se bizneset e mëdha janë më të suksesshme në dy fazat para se për kërkohet përqendrim më i madh i kapitalit, ndërsa në fazat tjera supozohet se bizneset e vogla janë më të suksesshme sidomos në plasimin e tregut. Mirëpo duhet pasur parasysh që edhe plasimi kushton sidomos marketingu dhe funksionet e tij. Aspekti i tretë i pa definuar në këtë kontekst ka të bëjë me rëndësinë e inovacioneve pra kush bën inovacione radikale dhe kush inkrementale apo margjinalë. Inovacionet radikale – Inovacion që është shumë i ri dhe i ndryshëm prej solucionit paraprak. Ndërsa Inovacioni inkremental (minor) – Inovacion që bënë një ndryshim relativisht minor nga (ose modifikim të) praktikës ekzistuese. Sipas autoreve Acs dhe Audretsch (1987) mundësitë me të mëdha për bizneset e vogla janë në fillim të ciklit jetësor të produktit kur dizajni pëson ndryshime të shpeshta për shkak të evoluimit të produktit.

## **KONKLUZION**

Bizneset e vogla dhe të mesme ashtu edhe të mëdhatë kontribuojnë në procesin e inovimeve. Mirëpo superioriteti i këtyre kategorive varet nga industria të cilës i takojnë dhe nga faktorët e mjedisit të cilët përcaktojnë shpesh herë masën e inovacionit në biznes. Rëndësia e inovacioneve në nivelin kombëtar të biznesit është e veçantë, kjo dallohet me krijimin e produkteve dhe shërbimeve kreative. Edhe pse kompanitë e vogla kanë përparësi në aktivitetin inovativ, ato gjithashtu kanë edhe jo përparësi të cilat disa biznese i tejkalojnë bashkëveprim dhe bashkëpunim, por disa biznese ngecin dhe shihen si rezultat i mos dijes së menaxhimit dhe organizimit të inovacionit.

Inovacionet ne përgjithësi i referohen ndryshimeve te proceseve ose krijimit te proceseve efektive ne produkte dhe ide fitimprurëse. Për bizneset, kjo do të thotë zbatim i ideve të reja, duke krijuar produkte dinamike dhe përmirësim te shërbimeve ekzistuese.

Biznesi duke qenë inovativ nuk nënkupton vetëm shpikje. Inovacioni nënkupton edhe ndryshim te modelit te biznesit si dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve te mjedisit duke ofruar produkte apo shërbime më të mira.

Inovacionet në biznes duhet të jenë të definuara në strategjinë afatgjate të biznesit, duke krijuar një kulturë të inovacionit e cila ndërlihdh rrugën e te menduarit inovativ dhe zgjidhjen krijuese të problemeve. Inovacionet i rrisin gjasat e biznesit për te kapur fitimi dhe të krijojë procese sa më efikase të punës, performancës dhe produktivitetit.

#### **Referenca:**

1. M.Mustafa, E.Kutllovci, P.Gashi, B.Krasniqi. “Biznesi i vogël dhe i mesëm” prishtine 2006;
2. David Stokes: Small business managment(4 edition) thomson 2002”;
3. Paul Tiffany, Steven Peterson,Colin Barrov, “Buisines plans 2004”;
1. <http://www.monitor.al/inovacioni-arma-juaj-ne-sipermarrje/>;
2. <http://www.monitor.al/inovacioni-kerkimi-dhe-zhvillimi/>;
3. <http://www.euic.mk/be-ja-dhe-inovacioni.nspk>.

## **ROLI I KAPITALIT RISK DHE FONDIT TË KAPITALIT RISK NE PËRKRAHJEN E ZHVILLIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME**

**Doc.dr.Gzim SELIMI**

International University of Struga

[g.selimi@eust.edu.mk](mailto:g.selimi@eust.edu.mk)

### **Abstrakt**

Vëmendja e këtij punimi, para së gjithash, është në problemin global aktual i sipërmarrjeve për financimin e bizneseve dhe ideve të tyre biznesore. Nëpërmjet një analize do të tentojmë të sqarojmë nevojën e përdorimit të fondit të kapitalit rrisk në përkrahje apo nxitje të biznesit afarist. Përdorimi i këtij burimi alternative të financimit është vecanërisht i rëndësishëm kur kreditë bankare janë të shtrenjta apo në mungesë të bursës si burim i kapitalit për financimin e sipërmarrjeve. Sistemi i zhvilluar financiar jep më shumë mundësi për grumbullimin e kapitalit i cili është i nevojshëm për financimin e sipërmarrjeve. Në R.e Maqedonisë dhe në shtetet për rreth nesh, vazhdimisht ndëgjohej se një nga problemet më të theksuara është financimi i sipërmarrjeve. Kjo është e saktë, vecanërisht nëse e kemi parasysh se nuk ekzistojnë në masë të mjaftueshme të ashuquajturat “burimet alternative të financimit”. Pa një rrjet të zhvilluar të këtyre burimeve të financimit, pronarëve dhe menaxherëve të biznesit të vogël ju nevojitet një kohë shumë e gjatë për sigurimin e kapitalit dhe ta zgjedhin problemin për financimin e biznesit të tyre.

**Fjalë kyçe:** *Fondet, kapitali risk, biznes ëngjujt.*

### **HYRJE**

Një sistemi financiar i zhvilluar ofron mundësi më të madhe në grumbullimin e kapitalit të nevojshëm për sipërmarrjet. Në hapësirat tona shpesh ndëgjohej se problem më i madh paraqet financimi i sipërmarrjeve. Kjo kryesisht është e saktë, vecanërisht duke pasur parasysh se nuk ekzistojnë në nivele të mjaftueshme të ashtuquajturat burime “alternative” të financimit. Mos pasja e një rrjeti të zhvilluar të burimeve alternative të financimit, pronarëve dhe sipërmarrësve, u nevojitet shumë kohë të sigurojnë kapital dhe të zgjedhin problemin rreth financimit të biznesit të tyre.

Në kushtet e kreditimit të shtrejntë bankar, në mungesë të bursës si burim i kapitalit, është e qartë se lind nevoja që të zhvillohet lloj i veçantë i financimit të sipërmarrjeve. Një nga zgjidhjet e mundshme është tërheqja e financimit të fondeve të kapitalit risk.

**Kapitali risk** paraqet paratë që i investojnë individët (personat) e pasur ose investitorët institucional (fondet e kapitalit risk) tek kompanitë të cilat nuk kotojnë në bursë, në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre dhe e tëra kjo me qëllim të përfitimit sa më të madh nga investimi. Në tërë botën, kapitali risk gjithmonë është dëshmuar si nxitës dhe përkrahës i zhvillimit të sipërmarrjeve. Duke pranuar një nivel të latë rrishtu gjatë investimit të kapitalit të tyre në sipërmarrjet e reja apo ato që janë në themelimin, përgjatë të gjitha fazave të afarizmit të tyre, kapitali risk ka një rol shumë të rëndësishëm për sipërmarrësit me vision. Pa kapitalin risk, sipërmarrësit edhe me idetë të mira shpeshherë nuk do të kishin sukses që t’i realizonin ato ide në realitet, si shkak i moskuptimit të tyre nga ana e kreitorëve të zakonshëm, institucioneve financiare dhe bankave. E tëra kjo rrjedh nga kontaktet e ralla dhe të pamjaftueshme si dhe nga mosnjohja e vet procesit afarist.

## **1.DEFIMI I KAPITALIT RISK DHE FONDIT TË KAPITALIT RISK (FKR)**

Definicioni më i thjeshtë i kapitalit risk (ang. venture capital) është se ai paraqet kapitalin e individëve të pasur apo të institucioneve që investojnë mjetet, dijen dhe përvojën e tyre në sipërmarrjet e reja dhe të vogla që kanë potencial për një zhvillim dhe rritje të shpejtë. Në këtë mënyrë sipërmarrësit dhe pronarët e sipërmarrjeve të vogla i sigurojnë mjetet e nevojshme, ndërsa investitorët presin përfitime të mëdha vjetore nga investimet e tyre, si dhe rritjen e konsiderueshme të asaj pasurie brenda një periudhe të shkurtë kohore.

Pra, kapitali risk është kapital i siguar nga ana e investitorëve të kualifikuar për investime në sipërmarrje, të cilat zakonisht gjenden në fazat e hershme të themelimit dhe në industrinë me një zhvillim të shpejtë. Një investim i këtillë bartë një risk të lartë, por edhe mundësi për përfitime të mëdha. Kapitali risk është vendimtar dhe i rëndësishëm për financimin e kompanive të këtilla, pasi për shkak të riskut të ekspozuar, këto kompani, e kanë të kufizuar qasjen në tregun e kapitalit dhe tek kreditë bankare.

Kapitali risk bënë ndërmjetësim në mes kapitalit të tepërt në treg me kompanitë që kanë projekte dhe potencial të lartë të zhvillimit ekonomik, që nuk kanë qasje të drejtpërdrejta tek investitorët institucional sic janë: bursat, bankat, fondet e hapura investuese apo fondi pensional.

**Fondi i kapitalit risk** është fond i ndonjë shoqërie që formohet me qëllim që menaxhon me kapitalin i cili kryesisht dedikohet për investim afatshkurtë apo afatgjatë në kompanitë që zakonisht nuk **kotojnë** në bursë dhe kanë një potencial të lartë rritjeje. Kur thuhet fond i kapitalit risk mendohet për shoqërinë që menaxhon atë kapital. Fondi, mbledh kapital nga investitor të kualifikuar, të cilin kapital pastaj e investonë në sipërmarrje dhe projekte të përzgjedhura. Investitorët e kualifikuar mund të jenë individ të pasur ose investitorë institucional, sic është fondi pensional, shoqëritë e sigurimit dhe fonde tjera të specializuara. Disa fonde arrijnë të mbledhin shuma të ndryshme të kapitalit dhe blejnë pjesë të caktuara të kompanive, që pastaj pas disa viteve e shesin atë pjesë të blerë. FKR përfitojnë nga dallimi në mes vlerës së investuar dhe vlerës së shitur të asaj kompanie, e cila zakonisht shitet brenda 3 deri më 7 vite.

FKR, kapitalin, dituritë dhe përvojën e tyre zakonisht e investojnë në “start up” kompanitë, në nivel lokal, eventualisht edhe në nivel regjional. Janë të ralla investimet në projekte kombëtare apo ndërkombëtare. Ata janë shumë të kujdesshëm gjatë përzgjedhjes së projekteve për financim dhe zgjidhin një numër të vogël kompanish në krahasim me atë sa u ofrohen. Kapitalin të cilin e investojnë është shumëfish më i vogël nga ajo që e investojnë investitorët profesional.

## 2. KARAKTERISTIKAT E KAPITALIT RISK DHE FUSHAT E INVESTIMIT

Kapitali risk është opcion i përshtatshëm nëse dëshirohet të themelohet biznes i ri, të avancohet dhe zhvillohet biznesi ekzistues, të ndryshohet madhësia e sipërmarrjes, të ripozicionohet pjesëmarrja në treg, të futen produkte të reja në treg, të shfrytëzohet kreativiteti dhe inovacioni, etj. ..dhe në ndërkohë sipërmarrësi, respektivisht sipërmarrja nuk disponon kapital të nevojshëm që do ti mundësonte realizimin e planit, ndërsa bankat dhe institucionet tjera nuk janë të gatshme që t'i financojnë këto sipërmarrje.

Që të tërheqin kapitalin risk sipërmarrësit e kompanive të vogla dhe të mesme duhet të kenë projekte shumë atraktive dhe idetë e tyre afariste, investitorëve të mundshëm, duhet t'ua prezentojnë në mënyrë të sukseshme. Për shkak riskut të lartë investitorët kanë pritshmëri që për një afat të shkurtër kohor të realizojnë të ardhura të larta nga mjetet e investuara.

Qëllimi themelor i KR është që nëpërmjet strategjive të ndryshme dalëse, të krijojnë profit nga mjetet e investuara. Ky lloj i kapitalit nuk është i interesuar për posedimin e paketës kontrolluese, respektivisht të blerjes së kompanisë. Investohen para, duke e mbajtur të drejtën mbi kontrollin financiar, e ndihmon sipërmarrjen në ngritjen e nivelit të prodhimit, në zhvillimin dhe aplikimin teknik, në menaxhim, gjatë paraqitjes në treg dhe e tëra kjo me qëllim forcimin e sipërmarrjes dhe rritjes të vlerës së sajë në treg.

Në tërë botën KR është treguar si nxitës i zhvillimit dhe ka një rol të rëndësishëm për sipërmarrësit me vision. KR, ndër vite, është treguar shumë i suksesshëm në zhvillimin e SHBA-ës. BE si dhe SHBA-të kanë njohur rëndësinë e KR dhe në të ardhmen pritet rritja e ndikimit të tijë në tërë territorin e kontinentit evropian.

Në R. e Maqedonisë industria vendore me pronësi private dhe kapital risk është akoma e pazhvilluar, ndësa investitorët e jashtëm me kapital risk nuk kanë gjetur arsye të mjaftueshme që investimet e tyre ti drejtojnë kah R. e Maqedonisë. Edhe pse kapitali risk nuk është i zhvilluar, vitet e fundit ka një rritje të numrit të investimeve që kanë nevojë për këtë lloj të financimit.



### 3. EVOLUCIONI I KAPITALIT RISK DHE FONDIT TË KAPITALIT RISK

Që të kuptohet se ku gjinden sot fondet e kapitalit risk dhe cfarë zhvillimi i pret në të ardhmen, është e nevojshme që të njihemi me zhvillimin e deritanishëm. Duke filluar që nga themelimi i fondeve të para e deri më tani, industria e FKR ka ndryshuar varësisht ndryshimeve në tregjet botërore.

Kapitali risk ka filluar të zhvillohet në vitet e 20 dhe 30 të shek.XX në SHBA dhe Britaninë e Madhe, edhe pse ky aktivitet është mbështur kryesisht nga personat dhe familjet e pasura. Në vitin 1946 në SHBA themelohet Fondi i parë i KR me emrin Research and Development Corporation (ARD), i cili themelohet me grumbullimin e kapitalit nga investitorët institucional, universitetet dhe personave fizik. Gjatë afarizmit të sajë ARD ka investuar në shumë kompani që mbështeteshin në teknologji të lartë.

Që nga viti 1958 deri nga mesi i viteve të 70, në B.M. dhe SHBA janë aprovuar shumë ligje që e nxisin zhvillimin e industrisë së KR. Aplikohen rregulla të reja për investitorët institucional e vecanërisht për Fondet Pensionale. Po ashtu fillon edhe zhvillimi i klasterit “Silicon Valley” ku këto fonde e realizojnë potencialin e tyre të plotë dhe bashkëpunojnë me universitetet, institucionet shtetërore, me kompani dhe individ të ndryshëm.

Me ndihmën e KR krijohen disa nga kompanitë më të mëdha sic janë Apple Inc, Digital Equipment Corporation, Genetech, etj. Kriza e bursës në vitin 1987, e njohur si “E hëna e zezë”, e ngadalsoi aktivitetin e fondeve. Por, që nga mesi i viteve 1990 e deri në vitin 2000 është periudha e ekspansionit më të madh dhe më investimev i FKR në sektorin e teknologjisë së lartë. Por deri në vitin 2005 ka një zvogëlim të aktivitetit të FKR. Që nga 2005 aktiviteti i FKR rritet, duke iu falimenderuar kompanive të njohura, sic janë Skype, eBay, My Space, IPO, Google, Facebook, Tëitter, etj.

KR dhe FKR luajnw rol kuç në rritjen ekonomike dhe në krijimin e vedeve të reja të punës. Në periudhën nga viti 2000-2006 FKR kanë investuar më shumë se 270 miliardë euro në më shumë se 56 mijë sipërmarrjeje europiane. Në vitin 2007 janw investuar 68.5 miliarda

euro në sipërmarrje europiane. Në vitin 2005 KR ka hapur 6.5 milion vende pune, respektivisht më shumë se 3% nga popullata e aftë për punë në Europë<sup>1</sup>.

Gjithashtu i rëndësishëm është roli i KR në financimin aktivitetit në kërkim dhe zhvillim. Sipërmarrjet e financuara nga KR mesatarisht shpenzojnë 50.693 euro për një të punësuar në kërkim dhe zhvillim. Cdo i treti i punësuar në sipërmarrjet të financuara nga KR punon në kërkim dhe zhvillim. Në Europë mbi 25% të investitorëve në FKR janë nga fondet pensionale<sup>2</sup>.

#### **4. LLOJET E KAPITALIT RISK**

Kapitali risk në disa raste paraqet mundësinë e vetme të finansimit të ndërmarrësve me ide të mira, por që kanë mungesë parash. Sipërmarrësi gjatë investimit nuk fiton vetëm para por edhe partnerin afarist dhe si do të jetë ai varet nga përzgjedhja e kapitalit risk.

Ekzistojnë tre lloje të KR të cilat bashkërisht marrin pjesë në investime në aktivitete afariste:

1. Kapitali risk i korporatave
2. Ëngjëjt e biznesit
3. Kapitali risk regjional

##### **4.1. Kapitali risk i korporatave**

Kapitali risk i korporatave është karakteristik nga fakti se e përbëjnë kompani apo partneriti nga dy deri në dyzet persona profesional të cilët janë të specializuar në fusha të caktuara afariste. Kompania që të ketë mjete për investim, themelon fondin e kapitalit risk dhe kërkon investitorë të gatshëm që të investojnë mjete të konsiderueshme financiare.

Kapitali risk korporativ në bazë përbëhet nga fondi i ndonjë shoqërie tregtare ose partneritetit, kryesisht i dedikuar për investim afatmesëm dhe afatgjatë në sipërmarrjet që gjinden në nivelin fillestar ose mesatar të zhvillimit, por me potencial të lartë të rritjes. Kur

<sup>1</sup> <http://www.evca.eu/2012>

<sup>2</sup> Po aty

flitet për FKR, zakonisht mendohet për një shoqëri tregtare ose ortakëri e cila menaxhon me fondin, pasi fondi si i tillë nuk është person juridik dhe nuk mund të jetë bartës i të drejtave dhe detyrimeve.

## 4.2. Ëngjëjt e biznesit

Ëngjëjt e biznest janë të ashtuquajturit kapitali risk joformal. Bëhet fjalë për persona fizik të cilat kanë vlera të larta të pronës neto, të cilën e investojnë në kapitalin themeltar të sipërmarrjes. Sintagma kapitali risk joformal është i arsyeshëm për shkak se ato nuk janë persona juridik, nuk janë publikisht të ekspozuar dhe këtë aktivitet nuk e kanë veprimtari kryesore. Bëhet fjalë për individ të cilët me dëshirë do të investonin para në sipërmarrjet që ofrojnë prespektivë, me cka në mënyrë aktive do të ndihmojnë që këto sipërmarrje të kenë sukses në treg.

Ëngjëjt e biznesit janë individ që posedojnë sasi të mëdha të mjeteve financiare dhe kanë njohuri dhe përvojë afariste dhe dëshirojnë që t'i investojnë mjetet dhe dituritë e tyre në sipërmarrje të vogla me prespektivë për rritje dhe zhvillim.

Forma më e shpeshtë e investimit të ëngjijve të biznesit kryhet nëpërmjet këmbimit të investimit me pjesë në kapitalin aksionar. Kjo do të thotë se investitori, së bashku me sipërmarrësin, e ndanë riskun e projektit dhe shpeshherë mer pjesë në udhëheqjen operative të afizmit, zakonisht pa ndonjë formë të kompensimit plotwsues.

Kapitali i ëngjijve të biznesit është burim i përshtatshëm i financimit për disa arsye:

- nukka kthim të parave, për dallim nga kredia, lizingu, etj.
- përvec kapitalit mund të ofrojnë dije dhe përvojë në përkahje të zhvillimit të kompanisë,
- nëse kompania rritet dhe zhvillohet, mund të jetë burim për financimin e mëtejshëm financiar, për afarizëm financiar të qëndrueshëm si dhe për përparrimin e sistemit të afarizmit dhe menaxhimit të kompanisë.

Dallimi me kapitalin rrisht korporativ është se  ngjujt e biznesit n  projektet afariste nuk investojn  vet m p r shkak t  fitimit (profitit) por se n  t  gjejn  edhe disa k naq si t  tyre individuale. Sektor t n  t  cilat m  s  shumti investojn   ngj jt e biznesit jan : sektori i TI, internet, e-tregtia, soft eri dhe multimedia, n  industri, sh ndet si dhe bioteknologji.

### 4.3. Kapitali rrisht regjional

Financimi me kapital rrisht regjional ka p r q llim themelor angazhimin e potencialit t  gjithmbarsh m t  n j  regjioni t  caktuar, me cka do t  krijohet baza p r zvog limin e dallimeve regjionale. N p rmjet marrdh njeve t  partneritetit privato publik mobilizohen potencialet zhvillimore, duke e rritur nivelin e aft sive afariste t  sip rmar sve dhe sip rmarrjeve n  p rgjith si. Ekzistimi i fondit rrisht regjional ndikon q  kompanit  e regjionit t  caktuar, zhvillimin e tyre ta mb shtesin n  p rsosjen e pand rprer  tw tyre , me nxwnjen e nohurive t  reja q  t  jen  n  gjendje jo vet m t  konkurojn  p r mjete t  kapitalit rrisht por edhe ti fitojn .

## KONKLuzion

-FKR organizohen ne form  t  shoq rive komndite ose si shoq ri me p rgjegj si t  kufizuar (n se themelohen brenda SHBA-ve) ose si korporata (n se themelohen jashta teritorit t SHBA-ve. Kjo form  e organizimit mund son mospages n e tatimit nga ana e fondit por at  ta b jn  investitor t, k shtu q  tatimohen t  ardhurat e atyre;

-Fondi paguan dhe kompenson p r nxitje dhe p r menaxhim edhe ate deri sa investimet individuale nuk likuidohen, mund t  japin para hua p r blerjen e aktiv s nga kapitali i tij , kan  korelacion t  lart  me t  ardhurat nga tregu;

-Investitorwt zakonisht nuk i t rheqin investimet e tyre derisa aktiva t  mos likuidohet, q  ti largohen nevoj s q  ta mbojn  vler n e neto aktiv s t  p rputhje me tregun;

FKR , pa dyshim, n  t  ardhmen do t  ken  n j  rol t  r nd sish m n  tregjet financiare dhe nuk mund t  n nvler sohet forcimi i tyre dhe prezenca gjithn j  e m  e shpesht  e tyre n 

tregjet financiare. I mbijetuan të gjitha periudhat kritike, duke dalë nga disa prej tyre me përfitime shumë të larta.

Ajo që me siguri mund të thuhet për KR është se në të ardhmen ato do të bëjnë ndryshime në afarizmin e tyre. Pritet që fondet do të rriten, do të ofrojnë më shumë shërbime investitorëve të tyre me cka do të rritet konkurreca brenda industrisë. KR kanë një zhvillim të shpejtë dhe në të ardhmen do të shëndrohen në fonde shumë të rëndësishme investuese.

KR kanë ngelur të pa zhvilluara në R.e Maqedonisë si dhe në vendet e regjionit. Faktorët që kanë ndikuar në këtë gjendje janë: ekonomia e pazhvilluar regjionale, mungesa e aplikimit të një politike për investim nëpërmjet FKR, varshmëria e kompanive regjionale nga burime tjera financiare, pik së pari nga kreditë bankare, si dhe kultura e pazhvilluar për afarizëm aksionarë.

Për shkak përparësive që i ka KR duhet një angazhim më i theksuar për zhvillimin e tyre në vendin tonë. Me cka do të ndikonte në rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë në të gjitha fushat e saja. Për Maqedoninë, Shqipërin, Kosovën si dhe për vendet e rajonit më e mira do të ishte implementimi i përvojës europiane dhe asaj botërore në krijimin e kushteve dhe nxitjen e zhvillimit të FKR. Ky lloj i kapitalit do të ishte gjenerator i zhvillimit, i cili do të krijonte ambient tërësisht të ri afarist duke krijuar vende të reja të punës, përvojë menaxherike, njohuri strategjike dhe operative, standarde më të larta në lidhje me kontrollin e buxhetit dhe të financave. Kjo kompanive mund t'ju mundëson kotim të suksesshwm në bursë, me cka në përgjithësi do të zgjerohet hapësira për zhvillimin e tregut dhe përparimin e vendit.

### **Referenca:**

1. Biznesalbania: Libri i politikave të biznesit, Tiranë, 2013.
2. Burns A., Bush F., Marketing research, third edition, Prentice Hall inc, New Jersey.
3. Burns P.: Entrepreneurship and Small Business, Palgrave, New York, 2001.
4. B. Nanevski, V. Stojanova dhe A. Josifovska – “Zhvillimi i NVM dhe zvogëlimi i papunësisë në R. e Maqedonisë”, Fondacioni “Fridrih Ebert” – Shkup, v. 1997.
5. B. Shuklev – “Menaxhmenti i biznesit të vogël”, Fakulteti ekonomik, v. 2008

6. Challenge?, International Council from Small Business, Puerto Rico, 2002.
7. Cumming D.: Venture Capital- Investment Strategies, 2010.
8. Curan J.: "Smoll business research in Britan", London, 1984.
9. Discussion Paper on Entrepreneurship, Institute of Economics, 2005.
10. Deakins D, Freel: Entrepreneurship and smoll firms, McGraw hill, 2003.
11. David Storey,: "Understanding the Smoll Business Sector", London, 1994.
12. European Agency for Reconstruction, "Small Enterprise Development in Republic of Macedonia", 2007.
13. Fenn, G. W., Liang, N., Prowse, S. " The Private Equity Market" New York, 1997.
14. Gerald, B.A. i Margulis, J.B. "Angel Capital: How to Raise Early-Stage
15. Metrick A.: Venture Capital and Finance of Innovation, New York, 2007.
16. Marković, I.: Financiranje; Teorija i praska financiranja trgovačkih društava, Zagreb,2000.
17. N.Naik , V. Agarwa: Hedge Funds, Now Publisher, 2005.
18. I.Beraha: "Mala i sredna proizvedeca kako factor ekonomskog razvoja I smanjenja nezaposlenosti u Srbiji", Beograd, 2011.
  - I. Beraha i drugi: Finansiranje MSP, Beograd, 2012.
19. Hull J.: Risk Management and Financial Institution, Boston, 2010.
20. OECD – The Local Economic and Employment Development Programme, 1999.
21. OECD – Small and Medium Enterprise Outlook", Paris, 2002.
22. Pearce R., Bames S.: Raising Venture Capital, 2006.
23. Private Equity Financing“, 2005.
24. Radoslav Avlijas:Preduzetnistvo i menadzment malih i srednjih preduzeca, Bg.2008.
25. T. Fiti dhe V. H. Markovska – "Small Business Development and Privatization in R.M. Shkup, v. 1995.
26. T. Fiti dhe V. H. Markovska - "Sipërmarrje dhe menaxhment sipërmarrës", Fakulteti ekonomik, Shkup, v. 1994
27. USAID," Finansiranje rasta malih i srednjih preduzeca", Beograd, 2012.
28. Wet Feet,"Careers in Venture Capital, San Francisco, USA, 2005.
29. Zorica Maric, "Izvori financiranja", Beograd, 2012.

**LEGJISLACIONI TATIMOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË DHE  
KONTROLLI I GRUMBULLIMIT TË TATIMEVE**

**Msc. Abdulgafur SINANI**

International University of Struga

a.sinani@eust.edu.mk

**Abstrakt**

Legjislacioni tatimor në Republikën e Maqedonisë përbëhet nga një paketë ligjesh, rregulloresh dhe marrëveshje tatimore, të cilat paraqesin një përmbledhje të plotë të të gjitha llojeve, niveleve, procedurave, si dhe metodave dhe formave të kontrollit tatimor për taksat, tarifatat dhe tatimet që përfshinë sistemi tatimor në Republikën e Maqedonisë. Legjislacioni tatimor përmbajnë formulime të përgjithëshme dhe shpesh nuk mund të përshkruajnë e aq më tepër të parashikojnë rrethanat dhe kushtet e zbatimit të tyre. Interpretimi i ligjeve tatimore bëhet kryesisht nëpërmjet vendimeve, udhëzimeve e rregulloreve të nxjerra nga ekzekutivi. Interpretimi dhe aplikimi duhet të jetë në përputhje me ligjet tatimore dhe ligjet tjera përfshirë Kushtetutën.

Autoriteti që jep legjislacioni tatimor administratave tatimore për të bërë interpretime të legjislacionit tatimor është faktor kyç në efikasitetin e zbatimit të sistemit tatimor. Tarifatat e tatimeve përcaktohen lehtësisht me Ligj, mënyrat e përcaktimit apo llogaritjes së bazës tatimore dhe aq më tepër procedurat e grumbullimit dhe kontrollit, është e vështirë të përcaktohet me detaje në ligj. Kontrolli dhe grumbullimi i tatimeve në Republikën e Maqedonisë është i përcaktuar në bazë të dispozitave ligjore sepse, nuk ka tatime pa ligj, nuk ka tatime jashtë ligjit dhe kundër ligjit. Andaj edhe obliguesi tatimor është i njoftuar për të

gjitha elementet të cilat janë me rëndësi për shlyerjen e obligimit tatimor nëse ai meret me një atktivitet fitimprurës për të. Sot sistemi tatimor modern nuk mund të mendohet pa një administratë e cila është profesionalisht e aftë në përcaktimin e tatimit, të procedurave të kontrollit dhe grumbullimit. Për këtë arsye parimet administrative shtetërore janë në interes të përbashkët si për administratën tatimore ashtu edhe për obliguesin tatimor që kontrolli gjatë inspektimit të realizohet në suaza të ligjit për tatim dhe grumbullimi i tatimeve të jetë sipas normës dhe bazës së sajë tatimore.

**Fjalët kyçe:** *Legjislacioni tatimor, sistemi tatimor, kontrolli dhe grumbullimi i tatimeve nga obliguesi tatimor dhe inspektimi gjatë kontrollit për tatimpaguesit, roli i administratës tatimore dhe raporti me tatim paguesin.*

## **HYRJE**

Në këtë punim shkencorë do të bëhet një analizë të Legjislacionit tatimor në Republikën e Maqedonisë gjatë viteve 2010 – 2015, duke analizuar me kujdes të veçant se si kanë ndryshuar rezultatet e rritjes në sistemin fiskal.

Sistemi tatimor është shumë e të gjitha formave tatimore i cili në tërësinë e tij vepron brenda sistemit ekonomik, politik dhe shoqëror duke i përmbushur në përgjithësi objektivat fiskale, ekonomike, zhvillimore dhe shoqërore. Studimi i tatimit është i lidhur me rolin dhe funksionin e shtetit dhe kuptohet që tatimet janë format nga të cilat shteti fiton të hyrat, ku kuptohet që tatimi është mbledhja e mjeteve financiare për vetë shtetin dhe organet e tjera publike të cilat janë tepër të nevojshme për financimin e funksioneve të tyre ku veç tjerash ky është edhe qëllimi fiskal.

Në këtë punim si një pikë kryesore diskutimi e kam edhe legjislacionin tatimor në Republikën e Maqedonisë duke i përmendur të gjitha ligjet që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e kontrollit dhe grumbullimit të tatimeve edhe atë: Ligji i tatim fitimit, Ligji i tatimit mbi vlerën e shtuar, Ligji për tatimet në pronë dhe Ligji për tatim personal mbi të ardhurat. Kontrollin dhe grumbullimin e tatimeve i kam nxjerë edhe me rezultate në tabela duke patur parasaysh kontrollin e inspektimit nga Drejtoria e të hyrave publike në qytetin e Shkupit,



Manastirit, Tetovës, Shtipit dhe Kavadarit nga viti 2010 deri në vitin 2014. Gjithashtu përmendi se çfar rezultate pozitive sollën ndryshimet në tatimet e TVSH-së si ndryshoi lëvizja e standartit jetësor, shpenzimet kapitale dhe shpenzimet në agrokulturë, shëndetësi në periudhë dhjetëvjeçare nga viti 2005 deri në vitin 2015 në Republikën e Maqedonisë.

Gjatë gjithë hulumtimit që kam bërë në këtë punimin e shkencor do të shihni se si i kam të përmendura dhe sqaruar në mënyra më të zgjeruara për gjithë kapitujt me rradhë.

## 1. SISTEMI TATIMOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Sistemi tatimor i trashëguar nga monizmi në Republikën e Maqedonisë, edhe pse shumë më i avancuar se ai i shumë vendeve tipike socialiste, përsëri ishte larg objektivave të sistemeve moderne tatimore për përmbushjen e kërkesave të teorisë së re fiskale, nga shumë aspekte p.sh.: i efikasitetit, neutralitetit, drejtshmërisë, thjeshtësisë, dobishmërisë dhe transparencës.

Për këtë arsye në fillim të vitit 1992 u ndërtua “Koncepti për sistemin e ri tatimor të Republikës së Maqedonisë”. Duke pasur parasysh rrethanat e reja dhe kërkesat e sistemit të ri tatimor konform parimeve të lartpërmendura, si dhe njohuritë më të reja teorike dhe empirike për kahet e zhvillimit të sistemeve moderne tatimore në bazë të konceptioneve të krijuara, në vitin 1994 u bënë ndryshime esenciale në sistemin tatimor, si p.sh.:

- **Sistemi cedular i tatimeve** i përbërë prej shtatë llojeve të ndryshme të tatimeve në të ardhura, u zëvendësua me dy lloje të reja të tatimeve.
  - a) Në tatim personal në të ardhura dhe
  - b) Tatim në fitim
- Në aspekt të **tatimit të konsumit**, në fillim u mbajt sistemi i tatimit në qarkullim të mallrave dhe shërbimeve (deri në fillim të vitit 2000) kurse pas përgatitjeve të kryera, nga 1 prilli i vitit 2000, me sukses u aplikua TVSH-ja. Tatimi qarkullimit të pijeve alkoolike, derivateve të naftës dhe prodhimeve të duhanit, bëhet përmes akcizave që janë regulluar sipas standarteve evropiane.

- Në **tatimin e pasurisë**, pothuaj se u mbajtën zgjidhjet ekzistuese të tri formave të tatimit:
  - a) Tatimi në pasuri
  - b) Tatimi në trashëgimi dhe dhurata
  - c) Tatimi në qarkullim i pronave të pa luhatshme dhe të drejtave
- Në **sistemin e të ardhurave publike** edhe më tej u mbajtën vjeljet e doganës, taksave, të dhënave dhe kompensimeve komunale si dhe u krijua baza juridike për shfrytëzimin e borxhit publik në financimin publik.

**Sistemi i kontributeve dhe sigurimeve shoqërore** dhe më tej përbëhet prej kontributeve nga bruto rrogat dhe të ardhurave tjera të siguruesve për financimin e sigurimit pensional-invalidor, sigurimit shëndetsor dhe sigurimit në kohën e papunësisë.<sup>1</sup>

### **1.1. Llojet e tatimeve në Republikën e Maqedonisë**

Sistemet tatimore bashkëkohore mbështeten në shumë lloje tatimesh që ndryshe quhen sisteme plurale tatimore për dallim prej ish sistemeve që bazoheshin kryesisht në një lloj tatimi – monizmi tatimor. Në zgjedhjen e strukturës tatimore ndikojnë shumë faktor si: ekonomik, social, politik, etj që manifestohen në forma të ndryshme në vende të ndryshme. Prandaj në mes shteteve ekzistojnë ndryshime në strukturën tatimore, në disa sistemi tatimor mbështetet në tatimet e zhdrejta – në konsum kurse në disa tjera, përparësi u jepet tatimeve të drejtëpërdrejta – në të ardhura.

Sistemi tatimor aktual në Republikën e Maqedonisë sipas skemës së klasifikimit ndërkombëtar përbëhet :

#### **1. Tatimet në të ardhura**

- Tatimi personal në të ardhura
- Tatimi në fitim

#### **2. Tatimi në konsum**

- Tatimi i vlerës së shtuar (TVSH)

- Akcizat
- Doganat (Tatimet ndërkombëtare)

### **3. Tatimet në pasuri**

- Tatimi në pasuri
- Tatimi në trashëgimi dhe dhurata
- Tatimi në qarkullim të pronave të paluajtshme dhe të drejtave

### **4. Kontributet për sigurimet shoqërore**

Kontributet nga rrogat dhe të ardhurat tjera të siguruesve.

## **2. LEGJISLACIONI TATIMOR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË DHE KONTROLLI I GRUMBULLIMIT TË TATIMEVE**

Lënda e kësaj analize është legjislacioni tatimor në Republikën e Maqedonisë lëndë e rregullimit të saj, miratimit dhe ndryshimit. Po ashtu kjo analizë e shtjellon dhe çështjen e kontrollit dhe grumbullimit të tatimit në Drejtorinë për të hyra publike në Republikën e Maqedonisë nga viti 2010 – 2014.

### **1. Ligji i tatim fitimit**

1. Ligji i tatim fitimit është sjellë në vitin 1993 dhe së bashku me të gjithë plotësimet dhe ndryshimet është lëna jashtë fuqisë me miratimin e ligjit të ri në vitin 2014, por për nevojat e këtij hulumtimi do ta marrim parasysht. Në tekstin themelor të ligjit është paraparë se norma e tatim fitimit është proporcionale dhe paraqet 30%. Në ndryshimin e ligjit të shpallur në Gazetë zyrtare në Republikën e Maqedonisë nr. 71/96 norma e tatim fitimit ndryshon dhe paraqet 15%. Më vonë me ndryshimet nga viti 2006 norma e tatim fitimit sërish ndryshohet dhe paraqet 10%.

3. Ligji i Ri i tatim fitimit është shpallur në Gazetën zyrtare në Republikën e Maqedonisë nr. 112 nga 25.07.2014. Me këtë rregullohet mënyra e tatimit mbi fitim, shkalla sipas së cilës llogaritet tatim fitimi, obliguesit për pagesë të tatim fitimit, baza tatimore për llogaritje të tatim fitimit, afatet për pagesë të tatim fitimit, si dhe çështje tjera që janë me rëndësi për verifikimin dhe pagesën e tatimit mbi fitim. Konform ligjit, norma e tatim fitimit paraqet 10%. Ligji ka pësuar dy ndryshime në vitin 2015 dhe 2016.

## **2. Ligji i tatimit mbi vlerën e shtuar**

Ligji i TVSH-së është miratuar në vitin 1999. Me ligjin është futur dhe TVSH-ja dhe rregullohet llogaritja dhe pagesa e saj. Konform këtij ligji të parë themelor fjala është për tatimin e përgjithshëm të konsumit që llogaritet dhe paguhet në të gjitha fazat e prodhimit dhe tregtisë në tërë sektorin e shërbimit, përveç nëse ndryshe nuk është paraparë me ligj. Ligji i TVSH-së llogaritet me zbatimin e normës proporcionale të tatimit në bazë të tatimit bazë për tatim qarkullim të mallrave dhe shërbimeve dhe importit edhe atë :

- Sipas shkallës së përgjithshme të tatimit prej 19% dhe
- Sipas Normës tatimore të preferuar prej 5%.

Deri më sot ligji ka pësuar më tepër ndryshime dhe plotësime.

Me ndryshimin e ligjit në vitin 2003 ndryshohet norma e përgjithshme tatimore prej 19% në 18%.<sup>4</sup>

## **3. Ligji për tatimet në pronë**

Ligji është shpallur në Gazetë zyrtare në Republikën e Maqedonisë me datë 13.10.2004 dhe deri më tani ka kaluar në gjithsej dhjetë ndryshime dhe plotësime. Me ligjin rregullohet mënyrë e tatimit në llojet e tatimeve në pronë si vijon :

- Ligji në pronë
- Ligji për trashëgimi dhe dhuratë dhe

- Ligji për tatim të patundshmërisë.

Tatimi në pronë paguhet në pronë të palëvizshme, përveç për atë pronë që është e liruar nga pagesa e tatimit sipas ligjit. Normat e tatimit në pronë janë proporcionale dhe janë prej 0,10% deri 0,20%.

#### **4. Ligji për tatim personal mbi të ardhurat**

Ligji themeltar për tatim personal i të ardhurave (me ndryshim në vitin 2001 zëvendësohet me “tatim mbi të ardhurat”) është shpallur në Gazetë zyrtare në Republikën e Maqedonisë me datë 30.12.1993 dhe me të vendoset tatimi personal i të ardhurave dhe rreullohet mënyra e tatimit të ardhurave të qytetarëve. Tatimi personal i të ardhurave paguhet në vit nga neto të ardhurat nga të gjitha burimet, përveç nga të ardhurat që janë marrë nga tatimi me këtë ligj. Në nenin 12 nga ligji themeltar janë rregulluar normat e tatimit personal mbi të ardhurat. Normat janë progresive, kurse baza tatimore (paraqet të ardhurat për tatim sipas nenit 3 nga ky ligj, të zvogëluar për një të katërtën nga shuma e pagës mesatare të realizuar në Republikë).

##### **2.1. Kontrolli dhe grumbulimi i tatimeve**

Pagesa e tatimeve kryhet në mënyrë vullnetare, por DHP kryen dhe pagesë me detyrim të tatimeve. Paraqitja vullnetare e tatimeve dhe rritja e volumit të saj, është njëra nga strategjitë themelore zhvillimore të DHP. Ajo paraqet vetëdije të qytetarëve në rëndësinë e tatimeve në ndërtimin e shtetit dhe obliguesve tatimorë mirë të edukuar dhe të informuar për përmbushjen në kohë dhe saktë të detyrimeve tatimore të siguruara përmes shërbimeve cilësore të dhëna nga ana e DHP.

Nga tatimet e paguara sipas paraqitjeve bazike të përmendura prej 75% është Buxheti i Republikës së Maqedonisë, kurse shuma prej 25% janë të ardhurat e DHP.

##### **➤ Kontrolli dhe grumbullimi i tatimeve në vitin 2010**

Në vitin 2010 janë përpiluar 3,531 aktvendime për verifikimin e tatimeve në procedurë të kontrollit të inspektimit. Këtë vit janë kryer gjithsej 8,377 kontrolle, që paraqet zvogëlim për 19,17% në raport të numrit nga 10,364 kontrolle të kryera në vitin 2009.

Në vitin 2010 me zbatimin e kriteriumeve për rrezik gjatë përzgjedhjes së obliguesve tatimorë për kontrolle dhe metodat e tyre të kontrollit janë kryer kontrolle më të vogla, por numri më i madh i kontrolleve me parregullsi të vëretuar në raport me vitin 2009.<sup>7</sup>

**Tabela nr. 1**

<b>Tatime</b>	<b>DHP kontrolli i inspektimit 75%</b>
Shkup	239
Manastir	76
Tetovë	18
Shtip	61
Kavadar	36
DGDO	347
<b>Gjithsej</b>	<b>777</b>

➤ **Kontrolli dhe mbledhja e tatimeve në vitin 2011**

Neto të hyra nga tatimet (TF, TPA, TVSH) ..... 55,624

\*në neto-shumën janë kyçur dhe 75% nga tatimet e paguar nga procedura e kontrollit të inspektimit në shumë prej 519 milion denarë

Të hyra për DHP nga tatimet e sapozbuluara me kontroll të jashtëm ..... 173

\* 25% nga tatimet e paguara nga procedura e kontrollit të inspektimit

BRUTO TË HYRA NGA TATIMET (TF, TPA, TVSH) ..... 56,007

Përveç pagesës vullnetare të tatimev, DHP realizon dhe lloje tjeta të procedurave për pagesë administrative. 0,93% nga pagesa ka të bëjë me tatimet e posazbuluara në procedurë të kontrollit isnpektues.<sup>8</sup>

**Tabela nr. 2**

<b>Tatime</b>	<b>DHP kontrolli i inspektimit 75%</b>
Shkup	184.4
Manastir	59.1
Tetovë	28.2
Shtip	53.8
Kavadar	34
DGDO	159.5
<b>Gjithsej</b>	<b>519</b>

➤ **Kontrolli dhe mbledhja e tatimeve në vitin 2012**

**Tabela nr. 3**

<b>Tatime</b>	<b>DHP kontrolli i inspektimit 75%</b>
Shkup	148.9
Manastir	85.9
Tetovë	35.9
Shtip	59.1
Kavadar	24.8
DGDO	422.5
<b>Gjithsej</b>	<b>777.1</b>

Përveç pagesës vullnetare të tatimev, DHP realizon dhe lloje tjera të procedurave për pagesë administrative. 1,5% nga pagesa ka të bëjë me tatimet e posazbuluara në procerudë të kontrollit isnpektues.

➤ **Kontrolli dhe mbledhja e tatimeve në vitin 2013**

Gjithsej neto të hyra tatimore në vitin 2013 (TF, TPA, TVSH) .....  
54,509.17

\* të kyçura dhe 75% nga tatimet e paguar nga procedura e kontrollit të inspektimit në shumë prej 281 milion denarë

Të hyra për DHP nga tatimet e sapozbuluara me kontroll të jashtëm (25% nga gjithsej të pagura)

.....  
275,34

Nga llojet tjera procedura për pagesë administrative që i realizon DHP, përveç pagesës së paguar vullnetare, - 2,02 nga pagesa ka të bëjë me tatimet e sapo vërtetuara në procedurën e kontrollit të inspektimit. <sup>10</sup>

**Tabela nr. 4**

<b>Tatime</b>	<b>DHP kontrolli i inspektimit 75%</b>
Shkup	212.24
Manastir	125.49
Tetovë	69.39
Shtip	99.75
Kavadar	62.06
DGDO	532.44
<b>Gjithsej</b>	<b>1,101.36</b>

Në vitin 2013, janë paguar tatime të sapozbuluara në procedurë të kontrollit inspektues në shumë prej 1,101,364,474 denarë dhe të njëjtat për 6,3 përqind më të larta në raport të atyre të pashlyera në vitin 2012 (1,036,124,355 denarë).

**Tabela nr. 5**

<b>KONTROLLET E INSPEKTIMIT</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>
Kontrolli i tatimit të vlerës së shtuara	3,083	3,197
Kontrolli i tatim fitimit	687	588



Kontrolli i tatimit personal mbi të ardhurat	2,195	1,799
Kontrolli i tatimit ndalesë	21	12
Kontrolli i obliguesve tatimorë të paregjistruar	2	9
Kontrolli i lojave të fatit	185	92
Kontrolli i kompensimit të paguar për koncesione	72	53
Kontrolle në raporte afariste	335	307
Kontrolli i kushteve teknike-teknologjike për organizimin e lojave të fatit	487	526
Këqyrje në gjendje të rezervave	19	17
Kontrolle tjera	206	206
<b>Gjithsej</b>	<b>7,929</b>	<b>6,806</b>

➤ **Kontrolli dhe mbledhja e tatimeve në vitin 2014**

Përveç pagesës vullnetare të tatimev, DHP realizon dhe lloje tjeta të procedurave për pagesë administrative. 1,37% nga pagesa e tatimeve është kryer me shfrytëzimin e kërkesës së shmangies të një obliguesi tatimorë për mbulesë të debisë së obliguesit tjetër tatimorë., 063% është paguar përmes secionit, 1,21% është paguar me rirpogramimin e debisë tatimore, 1,78% nga pagesa ka të bëjë me tatimet e posazbuluara më procedurë të inspektimit për kontroll, 7,33% nga të hyrat tatimore që rezulton nga pagesa sipas paralajmërimeve për mospagesë në kohë të tatimeve që i paraprainë procesit të pagesës me dhunë.

**Tabela nr. 6**

<b>Tatime</b>	<b>DHP kontrolli i inspektimit 75%</b>
Shkup	219.2
Manastir	84.3
Tetovë	42.5

Shtip	107.8
Kavadar	25.6
DGDO	609.9
<b>Gjithsej</b>	<b>1,089.4</b>

Në vitin 2014, janë paguar tatime të sapozbuluara në procedurë të kontrollit inspektues në shumë prej 1,452,579,726 denarë dhe të njëjtat për 31,89 përqind më të larta në raport të atyre të pashlyera në vitin 2013 (1,101,364,474 denarë). <sup>11</sup>

**\* Tabela totale e tatimeve të mbledhura nga viti 2010 – 2014 në milion denarë.**

**Tabela nr. 7**

<b>TATIMET, DHP, Kontrollet e inspektimit 75%</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>
Shkup	239	184.4	148.9	212.24	219.2
Manastir	76	59.1	85.9	125.49	84.3
Tetovë	18	28.2	35.9	69.39	42.5
Shtip	61	53.8	59.1	99.75	107.8
Kavadar	36	34	24.8	62.06	25.6
DGDO	347	159.5	422.5	532.44	609.9
<b>Gjithësej</b>	<b>777</b>	<b>519</b>	<b>777.1</b>	<b>1,101.36</b>	<b>2,089.4</b>

*\*Burimi: Enti shtetërorë për statistika në Republikën e Maqedonisë.*

---

9. Raporti vjetor i Drejtorisë për të hyra publike (për vitin 2010) marrë nga faqja e internetit të DHP-së: [http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/0457/ISSN 1857-7121](http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/0457/ISSN%201857-7121) Raporti vjetor i DHP për 2010.

10. Raporti vjetor i Drejtorisë për të hyra publike (për vitin 2011) marrë nga faqja e internetit të DHP-së: [http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/0465/ISSN 1857-7121](http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/0465/ISSN%201857-7121) Raporti vjetor i DHP për 2011.

11. Raporti vjetor i Drejtorisë për të hyra publike (për vitin 2012) marrë nga faqja e internetit të DHP-së: [http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/0542/ISSN 1857-7121](http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/0542/ISSN%201857-7121) Raporti vjetor i DHP për 2012.

12. Raporti vjetor i Drejtorisë për të hyra publike (për vitin 2013) marrë nga faqja e internetit të DHP-së: [http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/0684/ISSN 1857-7121](http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/0684/ISSN%201857-7121) Raporti vjetor i DHP për 2013.

13. Raporti vjetor i Drejtorisë për të hyra publike (për vitin 2014) marrë nga faqja e internetit të DHP-së: [http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/0790/ISSN 1857-7121](http://www.ujp.gov.mk/files/attachment/0000/0790/ISSN%201857-7121) Raporti vjetor i DHP për 2014.

14. Mr.Abdulgafur Sinani “Zhvillimi i sistemit tatimor dhe politikës fiskale në Republikën e Maqedonisë 2005-2015”, Teza e Magjistraturës, Gostivar 2016

## **KONKLUZION**

Kontrolli tatimor dhe grumbullimi i tatimeve nga viti në vit ka ecur në përmisime pozitive duke mundësuar edhe zvogëlimin e normës së përgjithëshme tatimore prej 25% në 19% dhe sot në 18%, dhe norma tatimore e preferuar prej 5% që zbatohet në qarkullim dhe importe. Tatimet paguhen në vit nga neto të ardhurat nga të gjitha burimet, duke pasur parasyshë edhe natalitetin kontributet për tatimpagues që janë rritur. Un personalisht kam mundur të mbledh matriale në sajë të grumbullimit dhe kontrollit tatimor nga Drejtoria e të hyrave publike dhe Ministria e financave për qytetet në vijim: Shkup, Manastir, Tetovë, Shtip, dhe Kavadar ku kontrolli i inspektimit ka qenë 75% .

Nga viti 2010 deri në vitin 2014 në Republikën e Maqedonisë janë përpiluar 16.375 aktvendime për verifikimin e tatimeve në procedurë të kontrollit të inspektimit në pesë Drejtori regjionale të Drejtorisë së të hyrave publike, ku nga viti në viti rritja e kontrolleve të inspektimit ka ecur nga 2.3% deri në 4.7% të aktvendimeve për verifikimin e tatimeve në periudhë katër vjeçare. Në vitin 2014 në të gjitha Drejtoritë regjionale janë implementuar programe automatike për vërtetimin e të hyrave të realizuara dhe obliguesve tatimorë dhe të obliguesve tatimorë fizik në raste ku të njëjtit kanë paraqitur vlera identike të të hyrave duke ju ofruar edhe lehtësime tatimore dhe tatim të paguar në Fletparaqitjet e tyzre tatimore mbi vlera që i kanë paraqitur dhe pagesat e tyre në raportet vjetore për të ardhura të paguara. Me këtë metodë u janë thjeshtëzuar dhe lehtësuar procedura të vërtetimit të obligimeve dhe bartjes së aktvendimeve për tatim personal të të ardhurave në raste kur nuk janë në rrezik, dhe ku lejohen kapacitetet e punës me raste rreziku.

Në lidhje me standardin jetësor dhe Indeksin e shpenzimeve në Republikën e Maqedonisë kam marë statistika të sakta nga Enti statistikor i cili jep rezultatet duke matur standardin jetësor nëpërmjet indikatorëve Laeken të varfërisë, shpenzimeve në amvisëri si dhe përmes të dhënave për shfrytëzimin e kohës dhe baraspeshës mes punës dhe familjes. Me Anketën e konsumit në amvisëri grumbullohen të dhëna për mjetet mesatare në disponim sipas burimeve, lartësisë së përdorimit të mjeteve sipas qëllimit të shpenzimeve, sasisë së artikujve ushqimorë dhe të tjerë dedikuar për qëllime personale, si dhe të dhëna për furnizim të amvisërive me disa të mira shpenzimi. Kurse nga Anketa për shfrytëzimin e kohës fitohen të dhëna për atë se si e shfrytëzojnë qytetarët e rëndomtë kohën e tyre për aktivitete të detajuara, por poashtu kjo anketë paraqet burim të indikatorëve të rëndësishëm për krijimin e politikave në kohën e punës, pjesëmarrjen në rritje të grave në fuqinë e punës, mirëqenien e pozitës së personave të moshuar dhe në bazë të saj, për krijimin e disa aspekteve në politikën sociale që ka të bëjë me familjen dhe strukturën gjinore. Indikatorët Laeken për varfërinë janë të dhëna ndërkombëtare krahasuese, të bazuara në Anketën për të hyra dhe kushtet e jetesës që është realizuar sipas rekomandimeve të Unionit European. Burimi i llogarisë së varfërisë janë të hyrat kurse kufiri i varfërisë është definuar në 60% nga të hyrat mediale ekuivalente.

## REKOMANDIME

Si pikë të parë rekomandimi do të shtoja që të ju ofrohet lehtësim tatimor që të ndikoj në funksion të zhvillimit dhe përparimit tek prodhimitarët për lëndën e parë dhe tek investimet qofshin ato të vendit apo të huaja. Në qoftëse do të gëzonin një lehtësim tatimor prodhimitarët nga lënda e parë sigurisht që do të ndikonte në pozitivitet zhvillimi dhe përparimi, dhe sigurisht që sot vendi gjithashtu mund të ishte më tërheqëse edhe ndaj investimeve të huaja, duke ju patur një lehtësim tatimor.

Në lidhje me rritjen e kapacitetit fiskal dhe decentralizimit fiskal un do ti paraqes këto rekomandime:

- ❖ Të realizohen investime në forcim të bazës ekonomike duke ju mundësuar rrugëtim drejt një buxheti me vetëfinansim përmes mbështetjes së bizneseve dhe investimeve të huaja dhe të bëhet sigurimi i plotë i burimeve të volitshme financiare dhe të bëhet një garantim i pashëm në favor të investimeve të huaja.
- ❖ Të bëhet përshtatja e instrumenteve fiskale të vendeve të tranzicionit, të vendeve fqinje dhe atyre në zhvillim.
- ❖ Të mundësohet përcaktim i drejtë i ndarjes të të hyrave publike në mes pushtetit qendror dhe atijë loka dhe gjithashtu të mundësohen krijime të kushteve për autonomi të pushtetit lokal.

Rekomandim në lidhje me Evazionin fiskal dëshiroj të them që në eliminimin e ekonomisë joformale dhe futjes së sajë në rrjedha lokale do ti përmendi këto pika:

1. Të bëhet aprovimi dhe zbatimi i ligjeve nga fusha e ekonomisë.
2. Të mundësohet aftësi i plotë i operativës së kontrollit dhe dënimeve rigorozë për hikje nga obligimi tatimor.
3. Të mundësohet sigurimi i barazisë së plotë të detyruesve tatimorë dhe atyre dooganorë.

4. Të mundësohet sigurimi i infrastrukturës juridike për evidenca kontabël të cilat do të jenë konform standarteve.
5. Të bëhen pagesa dhe tatim të plotë për mallrat që importohen.

**Referenca:**

1. Prof.dr.Abdylmenaf Bexheti, Financat Publike Tetovë 2007.
2. Mr. Abdulgafur Sinani “Zhvillimi i sistemit tatimor dhe politikës fiskale në Republikën e Maqedonisë 2005-2015”, Teza e Magjistraturës, Gostivar 2016.
3. Ligji i tatim fitimit (Gazeta zyrtare nr.80/1993), e marur nga faqja e internetit të Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë.
4. Ligji për ndryshimin dhe shtimin e Ligjit për tatimin mbi fitimin, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.129 e datës 31.07.2015.
5. Ligji për tatimin personal mbi të ardhurat, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.80/93 e datës 30.12.1993.
6. Ligji për tatimet në pronë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.61/04 e datës 13.10.2004.
7. Raporti vjetor i DHP (për vitin 2010).
8. Raporti vjetor i DHP (për vitin 2011).
9. Raporti vjetor i DHP (për vitin 2012).
10. Raporti vjetor i DHP (për vitin 2013).
11. Raporti vjetor i DHP (për vitin 2014).

## SERVICE QUALITY AND CUSTOMER SATISFACTION

Msc.Iliriana RAJTA<sup>1</sup>

University of Tirana; Faculty of Social Sciences, Department of Psychology and Pedagogy",  
Tirana Al

ilirianarajta@gmail.com

### Abstrakt

Ky studim shqyrton lidhjen që ekziston ndërmjet cilësisë së perceptuar të shërbimit dhe kënaqësisë konsumatore, me fokus të veçantë te diferencat gjinore të klientëve pagamarrës të bankës Raiffeisen në Tiranë. Studimi ka një rëndësi të veçantë, pasi ky fenomen nuk është trajtuar gjerësisht nga pikëpamja e sjelljes së konsumatorit. Pjesa më e madhe e kontributit në këtë fushë është ofruar nga studentët dhe doktorantët e Fakultetit Ekonomik, megjithatë mesa është në dijeni studiuësja, hetimi i diferencave gjinore është anashkaluar.

Nga popullata e klientëve pagamarrës, me konvencienjë janë përzgjedhur klientët pagamarrës të bankës Raiffeisen. Pyetësorët janë administruar online. Në analizën finale u përfshinë 280 pyetësorë (N=280), nga të cilët 145 (51.8%) ishin femra dhe 135 (48.2%) ishin meshkuj. Nga analiza e të dhënave rezultoi që tri hipotezat e ngritura në fillim të studimit u vërtetuan. Kjo do të thotë që ekziston një marrëdhënie pozitive korrelacionale midis cilësisë së shërbimit dhe kënaqësisë konsumatore ku ( $r=0.76$ ,  $p<0.01$ ).

Analiza e variancës, ANOVA, tregoi se ekzistojnë diferenca gjinore statistikisht të rëndësishme ndërmjet meshkujve dhe femrave në perceptimin e cilësisë së shërbimit dhe në nivelin e kënaqësisë konsumatore, ku meshkujt e perceptonin cilësinë e shërbimit si më të

lartë sesa femrat si dhe rezultinin konsumatorë më të kënaqur. Studimi sugjeron se bankat duhet të mos neglizhojnë matjen e nivelit të cilësisë së perceptuar të shërbimit dhe kënaqësisë konsumatore për t'u njohur me mendimet dhe perceptimet e klientit, pasi ato kanë një impakt domethënës në suksesin dhe performancën e bankës.

**Fjalët kyçe:** *Cilësi shërbimi, kënaqësi konsumatore, diferenca gjinore, sektor bankar, Raiffeisen Bank.*

## **HYRJE**

Industritë e shërbimit po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në ekonomitë e vendeve të zhvilluara dhe në ekonomitë e vendeve në zhvillim, aq sa shekulli i XXI është konsideruar si shekulli i industrive të shërbimit. Në këtë industri, padyshim që bankat dhe sistemi bankar kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë ndikim madhor. Cilësia e shërbimit është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e shërbimeve bankare pasi siguron nivel të lartë të kënaqësisë së klientëve dhe për pasojë i sjell bankës avantazh brenda këtij mjedisi kaq kompetitiv (Ahmossawi, 2001). Për më tepër që cilësia e shërbimit ka impakt domethënës në suksesin dhe performancën e bankës (Mouawad; Kleiner 1996).

Kënaqësia e klientit, është e lidhur ngushtë me shërbimin që i ofrohet, pavarësisht se banka që zgjedh klienti për të operuar varet edhe nga vendndodhja e saj (Anderson 1976), (Laroche; Taylor 1988), (Thwaites; Vere 1995). Për organizatat e orientuara drejt prodhimit të shërbimeve ka qenë gjithnjë e rëndësishme të jenë në dijeni të perceptimeve të klientëve lidhur me cilësinë e eksperiencave të tyre gjatë marrjes së shërbimit. Ofrimi i shërbimit cilësor është esencial për të pasur klientë të kënaqur (Zeithaml, Bitner, & Gremler, 2006). Studimet e mëparshme sugjerojnë se gjinia ndikon në perceptimin e cilësisë së shërbimit në sajë të roleve gjinore, interpretimeve të ndryshme që gjinitë u bëjnë situatave gjatë ofrimit të shërbimit, diferencave në procesimin e informacionit, personalitetit dhe rëndësisë që u japin gjinitë aspekteve të caktuara të shërbimit Ato kanë treguar se femrat kanë tendencën ta vlerësojnë si më të varfër cilësinë e shërbimit, krahasuar me meshkujt.



**Hipotezat:**

1. **Hipoteza 1:** Ekziston një lidhje pozitive ndërmjet cilësisë së shërbimit dhe nivelit kënaqësisë konsumatore tek klientët bankës Raiffeisen.
2. **Hipoteza 2:** Ekzistojnë diferenca gjinore ndërmjet femrave dhe meshkujve në perceptimin e cilësisë së shërbimit.
3. **Hipoteza 3:** Ekzistojnë diferenca gjinore ndërmjet femrave dhe meshkujve në nivelin e kënaqësisë konsumatore.

**Qëllimi:**

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë lidhjen, që ekziston ndërmjet cilësisë së perceptuar të shërbimit dhe kënaqësisë konsumatore, tek klientët pagamarrës të bankës Raiffeisen, duke vënë theksin tek diferencat gjinore.

**Objektivat:**

1. Të masë nivelin e cilësisë së perceptuar të shërbimit tek klientët pagamarrës të bankës Raiffeisen.
2. Të masë nivelin e kënaqësisë konsumatore tek klientët pagamarrës të bankës Raiffeisen.
3. Të studiohet korrelacioni midis cilësisë së shërbimit dhe kënaqësisë konsumatore.
4. Të hetohen diferencat gjinore në raport me cilësinë e shërbimit dhe kënaqësinë konsumatore.
5. Të ofrohen ide mbi hartimin e strategjive të segmentimit të tregut bazuar mbi gjetjet e studimit.

**1. RISHIKIMI I LITERATURËS****1.1 Cilësia e shërbimit**

Ekzistojnë përkufizime të shumta të konceptit të cilësisë së shërbimit, dhënë nga nga autorë të ndryshëm në vite të ndryshme. Megjithatë Kotler (2003), e përcakton shërbimin si “një veprim ose një sjellje, që bazohet në një kontakt midis dy palëve, dhënësit dhe marrësit, të cilët shkëmbejnë një të mirë ose prodhim”. Mohamed & Shirley (2009) theksuan faktin se

bankat duhet t'i kushtojnë rëndësi cilësisë së shërbimeve të ofruara, pasi niveli i lartë i cilësisë së shërbimeve mund t'i ofrojë bankës epërsi të dukshme në konkurrencën brenda tregut bankar.

## **1. 2 Kënaqësia konsumatore**

Kënaqësia konsumatore është një fushë e eksploruar gjerësisht nga disa disiplina shkencore, megjithatë aktualisht ende nuk ekziston një konsensus në lidhje me përkufizimin e këtij koncepti (Giese dhe Cote, 2000; White dhe Yu, 2005).

Disa autorë i referohen kënaqësisë si një rezultat final, ndërsa të tjerë si një process. Autorë të caktuar e shikojnë kënaqësinë si një “gjendje konjitive” që vjen pas eksperiencës së konsumit. Ndërkohë, Ranaweera (2003) sugjeron se kënaqësia është një përgjigje emocionale e konsumatorit që pason eksperiencën e konsumit të një produkti apo shërbimi.

## **1. 3 Mbështetja teorike e hipotezave**

Kotler dhe Armstrong (2012) i referohen kënaqësisë si vlerësim pas blerjes të produktit a shërbimit të marrë duke shqyrtuar pritshmëritë e konsumatorit. Kërkuesit kanë qenë të ndarë në dy grupe për sa i takon lidhjes midis kënaqësisë dhe cilësisë së shërbimit. Disa prej tyre besojnë se cilësia e shërbimit ndikon në rritjen e kënaqësisë konsumatore ndërsa të tjerë mendojnë të kundërtën (Ting, 2004).

Studiuesit Lee dhe kolegët (2000); Gilbert dhe Veloutsou (2006); Sulieman (2011) dhe Buttle (1996) kanë konstatuar se ekziston një korrelacion pozitiv ndërmjet cilësisë së shërbimit dhe kënaqësisë konsumatore. Ata sugjerojnë se për të përfutur nivele të larta të kënaqësisë konsumatore duhet ofruar një shërbim cilësor nga ana e ofruesve të shërbimit. Ndaj mund të konkludojmë se me përmirësimin e cilësisë së shërbimit, rritet edhe probabiliteti i rritjes së kënaqësisë konsumatore.

## **1. 4 Diferencat gjinore dhe cilësia e shërbimit**

Shumë studime kanë testuar ndikimin e diferencave gjinore në pritshmëritë dhe perceptimet për cilësinë e shërbimit. Studimet kanë treguar se diferencat gjinore ekzistojnë jo vetëm në nivelin e përgjithshëm të cilësisë së shërbimit, por edhe në aspektet e caktuara të cilësisë së shërbimit, ku secila gjini thekson një apo tjetrin aspekt. Për shembull, Karatepe (2011) arriti në përfundimin se empatia është element më i rëndësishëm i shërbimit për femrat

sesa për meshkujt dhe se dimensionimi i besueshmërisë ka një ndikim më të fortë në kënaqësinë konsumatore tek femrat sesa tek meshkujt. Pak studime kanë treguar se nuk ka diferencë gjinore në vlerësimin e cilësisë së shërbimit, si psh: Ndhlovu dhe Senguder (2002) zbuluan rezultatin se perceptimi i cilësisë së shërbimit në hotele, ishte i njëjtë për të dyja gjinitë. Megjithatë shumica e punës kërkimore ka konfirmuar se ekzistojnë diferencë gjinore në perceptimin e cilësisë së shërbimit.

## **1.5 Diferencat gjinore dhe kënaqësia konsumatore**

Gjinia konsiderohet si një ndër parashikuesit më të rëndësishëm të shumë koncepteve të fushës së psikologjisë (Helgesen & Nettet, 2010). Implikimet e këtyre gjetjeve përfshijnë parashikimin se femrat priren të jenë kliente më të kënaqura se meshkujt, në rast se ofruesi i shërbimit i vë një rëndësi të veçantë komponentit të marrëdhënies afatgjatë me klientin. Autorë të tjerë si Adjei (2006) tregojnë se meshkujt dhe femrat ndryshojnë nga njëri-tjetri në qëndrimet dhe sjelljet që shfaqin kur blejnë produkte ose shërbime.

Pra, gjinia është parë si një faktor, që bën diferencën në kënaqësinë e konsumatorit. Për shembull, në një studim në fushën e shitjeve të makinave, Mittal dhe Kamakura (2001) konstatuan se femrat përjetonin nivele më të larta kënaqësie sesa meshkujt. Ndërsa Dimitriades (2006) ka konkluduar se se femrat rezultonin më pak të kënaqura krahasuar me meshkujt.

## **2. METODOLOGJIA**

### **2.1 Dizajni i kërkimit**

Studimi në fjalë ka natyrë joeksperimentale dhe është studim korrelacional, pasi qëllimi kryesor i tij është të hetojë marrëdhënien që ekziston midis cilësisë së shërbimit bankar dhe kënaqësisë konsumatore dhe studimin e diferencave gjinore në raport me CSH dhe KK.

### **2.2 Burimet e të dhënave**

Të dhënat janë mbledhur duke përdorur burimet parësore dhe dytësore. Të dhënat parësore janë mblidhur drejtpërdrejt nga respondentët nëpërmjet administrimit të dy

pyetësorëve; pyetësorit që mat nivelin e cilësisë së shërbimit dhe pyetësorit të kënaqësisë konsumatore. Si burime dytësore të dhënash kanë shërbyer literatura ekzistuese për cilësinë e shërbimit, kënaqësinë konsumatore dhe rezultatet punës kërkimore të mëparshme, libra, botimet e revistave të ndryshme shkencore etj.

### **2.3 Studimi pilot**

Instrumentat janë përkthyer nga anglishtja në shqip dhe anasjelltas duke përdorur procedurën e përkthimit të dyfishtë. Me qëllim kontrollin e disa prej parametrave të pyetësorëve si: kuptueshmëria, qartësia dhe vështirësia e pyetjeve të dy instrumentet janë pilotuar në një grup prej 20 studentësh të kursit të parë dhe të dytë të Psikologjisë Organizacionale, të cilët përmbushnin kushtin e të qenët klientë pagamarrës në një nga bankat e nivelit të dytë. Pas kësaj faze, ata u përjashtuan nga mundësia për t'u bërë pjesë e kampionit përfundimtar. Pyetësorët janë shpërndarë dorazi në fillim të orës së parë të mësimin dhe janë mbledhur në fund ditës.

Pas mbledhjes së pyetësorëve u realizua analiza e besueshmërisë së tyre, dhe u pa që vlera e alfës së Cronbach-ut për shkallët në total rezultoi të ishte përkatësisht ( $\alpha=0.85$ ) për Pyetësorin e Cilësisë së Shërbimit dhe ( $\alpha=0.87$ ) për pyetësorin e Kënaqësisë Konsumatore. Vlera të tilla të koeficientit alfa tregojnë një qëndrueshmëri të brendshme, e cila është mbi atë që konsiderohet si “e mirë” nga George dhe Mallery (2003).

### **2.4 Kampioni**

Në përzgjedhjen e klientëve është përdorur metoda e kampionimit të volitshëm. Kampioni i volitshëm është një ndër metodat e kampionimit jo me probabilitet, që konsiston në përzgjedhjen si subjekte të anëtarëve më lehtësisht të arritshëm të popullatës.

### **2.5 Mbledhja e të dhënave**

Mënyra e shpërndarjes ka së pyetësorëve ka qenë në formë elektronike. Kështu, pranë institucioneve të ndryshme pagamarrës ka patur nga një person kyç, i cili ka ndihmuar me shpërndarjen e pyetësorëve tek kolegët e tyre. Përgjithësisht respondentët janë kontaktuar nëpërmjet e-mailit personal dhe iu është dërguar linku i mëposhtëm (<https://www.surveymonkey.com/s/LWPMY9D>). Megjithatë pyetësorët janë shpërndarë edhe në rrjetet

sociale si: Facebook apo Twitter, por edhe nëpërmjet fjalës së gojës brenda një periudhe tri javore.

Kampioni me të cilën u filluan analizat ishte  $N=280$ . Në këtë kampion, 51.8% ( $n=145$ ) ishin femra dhe 48.2% ( $n=135$ ) ishin meshkuj. Moshë e pjesëmarrësve varioje nga 18 në mbi 50 vjeç. Statusi civil i respondentëve ishte si më poshtë: 65% ( $n=182$ ) ishin beqarë, 34.6% ishin të martuar ( $n=97$ ) dhe 0.4% ishin të ve ( $n=1$ ).

## 2.6 Instrumentet

Të dhënat primare janë mbledhur nëpërmjet aplikimit të dy pyetësorëve. Pyetësorët përmbajnë pyetje të strukturuar, që lidhen me variablat e studimit dhe që masin përkatësisht cilësinë e shërbimit dhe kënaqësinë konsumatore.

**Pyetësi i Cilësisë së Shërbimit Bankar** është hartuar nga (Reynoso & Moores, 1995). Ai përbëhet nga 22 pohime të shkallës Likert, 5-pikëshe 1= nuk jam aspak dakord 2= nuk jam dakord, 3= jam i/e pavendosur 4=jam dakord 5 = jam plotësisht dakord. Besueshmëria e brendshme e kësaj shkalle rezultoi të jetë  $\alpha=0.91$  ( $n=22$ ).

**Shkalla e kënaqësisë konsumatore** është krijuar nga Taylor dhe Baker (1994). Ajo përbëhet nga gjashtë pohime të shkallës Likert 5 pikëshe ku 1= nuk jam aspak dakord 2= nuk jam dakord, 3= jam i/e pavendosur 4=jam dakord 5 = jam plotësisht dakord. Gjatë analizës së të dhënave u gjet se vlera e qëndrueshmërisë së brendshme të Shkallës së Kënaqësisë Konsumatore është  $\alpha=0.9$  ku ( $n=6$ ). Kjo vlerë e koeficientit të alfës së Cronbach-ut tregon qëndrueshmëri të lartë të brendshme të pyetësorit. Ku për seclin pohim të fshirë, kemi një ulje thujse të pandjeshme të koeficientit alfa.

## 2.7 Aspektet etike

Gjatë mbledhjes së të dhënave i është kushtuar një vemendje e veçantë respektimit rigoroz të standarteve etike të studimit. Duke qenë se pyetësorët janë administruar online, një vemendje e veçantë i është kushtuar sigurimit të privatësisë së informacionit të ofruar gjatë plotësimit të pyetësorit. Paraprakisht është mundësuar çaktivizimi i opsionit të ruajtjes së IP për

kompjuterat nga ku do të plotësohej pyetëso. Eshte garantuar ruajtja e anonimatit dhe liria për t'u tërhequr nga studimi.

## 2.8 Limitet e studimit

Disa nga limitet e këtij studimi janë:

- **Kampionimi** - Rezultatet e këtij studimi nuk mund të përgjithësohen për të gjithë popullatën pasi mënyra e përzgjedhjes joprobabilitare të kampionit (kampioni i volitshëm) nuk lejon përgjithësim të rezultateve të përfitura përtej kampionit të marrë në studim. Ndaj rezultatet duhen parë me rezerva.
- **Mungesa e literaturës** në shqip dhe studimeve të mëparshme rreth lidhjes së këtyre dy variablave dhe ky boshllëk i madh në qasjen teorike dhe praktike ndaj variablave të studiuar ndihet në çdo fazë të kërkimit.
- **Instrumentet e përdorur** kanë rezultuar me një qëndrueshmëri të lartë të brendshme, megjithatë ato janë të pastandartizuar për kontekstin shqiptar.
- **Limite që lidhen me metodologjinë** - Ky studim ka qasje sasiore. Ndërthurja me metoda cilësore do të mundësonte një fotografim më të plotë të realitetit.

## 3. ANALIZA KORRELACIONALE DHE TESTIMI I HIPOTEZËS 1.

Lidhja që ekziston ndërmjet dy variablave është studiuar me anë të analizës së korrelacionit Pearson. Nga tabela rezulton që ekziston një lidhje statistikisht e rëndësishme dhe pozitive ndërmjet CSH dhe KK ku ( $r=0.76$ ,  $p<0.01$ ). Domethënë me rritjen e cilësisë së shërbimit rritet edhe kënaqësia konsumatore dhe anasjelltas. Bazuar arsyetimin e mësipërm vërtetohet **Hipoteza 1**.

### 3.1 Analiza e regresionit

Duke qenë se korrelacioni ishte statistikisht të rëndësishëm, u mendua e arsyeshme të realizohet dhe procedura e analizës së regresionit për të parë nëse cilësia e shërbimit mund të parashikohet nga kënaqësia konsumatore.

Me fjalë të tjera, variabli parashikues është kënaqësia konsumatore, ndërsa variabli i parashikuar është cilësia e shërbimit. Regresioni që u krye ishte regresion i thjeshtë linear.

Modeli	Koeficientët Pastandardizuar		Koeficienti Standardizuar	t	r <sup>2</sup>
	B	Gabimi standart	Beta		
<b>Kënaqësia konsumatore</b>	1.944	0.10	.761	19.42*	0.57

\*Korrelacioni është i rëndësishëm statistiki në nivelin 0.05.

$H_0 : \beta = 0$  (Kënaqësia konsumatore nuk është një parashikues i Cilësisë së Shërbimit).

$H_a : \beta \neq 0$  (Kënaqësia konsumatore është një parashikues i Cilësisë së Shërbimit).

Siç shihet edhe nga tabela ( $t=19.42$ ,  $p=0.00 < 0.05$ ) refuzohet hipoteza nul dhe pranohet hipoteza alternative që pohon se kënaqësia konsumatore mund të parashikojë cilësinë e shërbimit.

### 3.2 Analiza e regresionit dhe testimi i hipotezave 1 dhe 2

Për të hetuar diferencat gjinore në perceptimin e cilësisë së shërbimit u përdor procedura e analizës së variancës ANOVA. U vu re që kishte diferenca statistiki të rëndësishme ndërmjet mesatareve pikëve të femrave dhe meshkujve në pyetësinë e cilësisë së shërbimit ku,  $F(1, 277) = 7.350$ ,  $p = 0.021$ .

ANOVA					
Cilësia e Shërbimit					
	Shuma e katrove	Gradët e lirisë (gl).	Mesatarja e katrorëve	F	Sig.
Ndërmjet grupeve	546.271	1	546.271	7.530	.021

Brenda grupeve	20094. 489	277	72. 543		
Totali	20640. 760	278			

Meshkujt raportojnë mesatare më të larta pikësh në pyetësin e cilësisë së shërbimit krahasuar me femrat. Kjo diferencë pikësh është e rëndësishme nga pikëpamja statistikore. Për pasojë **konfirmohet Hipoteza 2**, e cila pohon se ekzistojnë diferenca gjinore në perceptimin e cilësisë së shërbimit.

Për të hetuar diferencat gjinore në nivelin e kënaqësisë konsumatore, u përdor procedura e analizës së variancës ANOVA. Rezultoi që kishte diferenca statistiki të rëndësishme ndërmjet mesatareve të pikëve të femrave dhe meshkujve në nivelin e kënaqësisë konsumatore ku,  $F(1, 276) = 2.781, p = 0.034$ .

<b>ANOVA</b>					
<b>Kënaqësia konsumatore</b>					
	Shuma e katrove	Gradët e lirisë (gl).	Mesatarja e katrorëve	F	Sig.
Ndërmjet grupeve	31. 485	1	31. 485	2. 781	. 034
Brenda grupeve	3124. 849	276	11. 322		
Totali	3156. 335	277			

Kjo diferencë pikësh jo vetëm që është e dukshme, por edhe është e rëndësishme nga pikëpamja statistikore. Rezultatet e përfuara **konfirmojnë Hipotezën 3**.

#### **4. DISKUTIME**

**Hipoteza 1:** Ekziston një lidhje pozitive ndërmjet cilësisë së shërbimit dhe nivelit kënaqësisë konsumatore tek klientët bankës Raiffeisen.

Vërtetimi i hipotezës mbështetet nga gjetjet e Lee dhe kolegët (2000); Gilbert dhe Veloutsou (2006) dhe Sulieman (2011) të cilët kanë konstatuar se ekziston një korrelacion pozitiv ndërmjet cilësisë së shërbimit dhe kënaqësisë konsumatore.



Ata kanë sugjeruar se për të përftuar nivele të larta të kënaqësisë konsumatore duhet ofruar një shërbim cilësor nga ana e ofruesve të shërbimit. Me përmirësimin e cilësisë së shërbimit, natyrshëm do të rritet dhe probabiliteti shfaqjes së kënaqësisë konsumatore.

Studime të tjera, kanë konfirmuar edhe një here, se kur vjen puna tek industrinë e orientuara drejt shërbimit, siç janë bankat, cilësia e shërbimit është burimi më i madh i kënaqësisë konsumatore.

**Hipoteza 2:** Ekzistojnë diferenca gjinore ndërmjet femrave dhe meshkujve në perceptimin e cilësisë së shërbimit.

Ashtu siç edhe pritej, u gjetën diferenca gjinore statistikisht të rëndësishme ndërmjet femrave dhe meshkujve në vlerësimin e cilësisë së shërbimit. Gjetja se femrat janë më pak të kënaqura me cilësinë e shërbimit është në konsistencë me gjetjet e Dimitriades (2006), kjo për arsye se femrat janë shumë kërkuese kur vjen puna tek cilësia e shërbimit, ndërsa meshkujt nga ana tjetër janë më pak kërkues dhe i kanë pritshmëritë më të ulta. Një tjetër studim, nga fqinji ynë Greqia, që mbështet tezën e diferencave gjinore në cilësinë e shërbimit është ai i Spathis (2004), i cili gjeti diferenca të rëndësishme ndërmjet klientëve femra dhe meshkuj të bankave greke, ku meshkujt rezultojnë se kishin perceptim pozitiv të cilësisë së shërbimit. Për shkak të këtyre evidencave mund të hamendësojmë se ndoshta edhe kultura ballkanase ka ndikimin e saj në këto diferenca gjinore. Diferenca të tilla në perceptimin e CSH mund t'i faturonhen mënyrës se si femrat ose meshkujt trajtohen gjatë ofrimit të shërbimit nga personeli i bankës (Guttek, 1995) ose diferencave të personalitetit dhe sjelljeve që ato shfaqin (Spathis, 2004).

**Hipoteza 3:** Ekzistojnë diferenca gjinore ndërmjet femrave dhe meshkujve në nivelin e kënaqësisë konsumatore.

Për shkak të korrelacionit, mund të jetë deri diku e pritshme dhe logjike që pasi meshkujt kanë shfaqur nivele më të larta në cilësinë e shërbimit, të jenë edhe konsumatorë më të kënaqur me shërbimet dhe produktet e ofruara nga banka. Ky konkluzion mbështet hipotezën e ngritur, pasi pohon që ka diferenca ndërmjet meshkujve dhe femrave në nivelin e kënaqësisë konsumatore, por gjithsesi kundërshton gjetjen specifike të këtij studimi. Gjithashtu edhe gjetjet e (Chisick, 1997; Singh, 1990) janë në një linjë dhe konfirmojnë faktin se meshkujt

janë konsumatorë më pak të kënaqur, pra nuk mbështesin rezultatin e këtij studimi. Studiues të tjerë, Chiu dhe Wu (2002) kanë zbuluar se ekzistojnë diferenca gjinore dhe shpjegojnë se femrat priren të jenë kliente më të kënaqura se meshkujt, në rast se ofruesi i shërbimit i kushton një rëndësi të veçantë komponentit të marrëdhënies afatgjatë me klientin.

## **KONKLUZION**

Për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së shërbimit rekomandohet që menaxherët të investojnë në ndërtimin e programeve efektive të menaxhimit të burimeve njerëzore që përfshijnë rekrutimin, përzgjedhjen dhe trajnimin dhe mbështetjen e punonjësve të kualifikuar.

Për të përmirësuar dimensionin e besueshmërisë sugjerohet që stafi të intensifikojë përpjekjet për t'i bërë shërbimet e arritshme për klientët. Sugjerohet që banka të përshtasë oraret e shërbimit me segmente të ndryshme të klientëve. Në këtë drejtim, Kumar dhe kolegët (2009) rekomandojnë hapjen e filialeve në zona ku ka qarkullim të madh njerëzish, zgjatjen e orarit të shërbimit ose edhe hapjen e degëve të shërbimit edhe në fundjavë, apo në ditë festash

Dimensioni i empatisë nënkupton që banka njeh problemet e konsumatorëve dhe operon duke pasur parasysh interesin më të lartë të tyre, ashtu sikurse dhe u kushton klientëve vëmendje personale klientëve. Për të investuar në reputacionin saj është e rëndësishme që banka të reklamojë veprimtarinë dhe produktet që ofron si dhe të investojë në marketingun social.

Vërtetimi i hipotezave në lidhje me diferencat gjinore, konfirmon edhe një herë se gjinia mund të përbëjë një bazë të shëndoshë për segmentimin e tregut bankar. Rrjedhimisht bankat mund të gjenerojnë produkte që i “thërrasin” nevojave të femrave dhe meshkujve. Ndaj është shumë e rëndësishme që menaxherët e bankave të hartojnë programe marketingu me orientim gjinor dhe strategji specifike, për këto dy segmente të ndryshme.

## **Referenca:**

1. Ahmossawi, M. (2001). Bank selection criteria employed by college students in Bahrain: an empirical analysis. *International Journal of Bank Marketing*, 19 (3), 115-25.

2. Anderson, W. T. Jr, Cox, E. P. III and Fulcher, D. H. (1976). Bank selection decisions and market segmentation. *Journal of Marketing*, 40 (1), 40-5.
3. Armstrong, G. and Kotler, P. (2011). *Marketing: An Introduction*. New Jersey: Pearson Education, Inc.
4. Chiu, H-C and H-C Wu (2002). *Exploring the Cognitive and Affective Roles of Service Quality Attitude Across Gender*. *The Services Industries Journal*, 22 (3), 63-76.
5. Dimitriadis, Z. S. (2006). *Customer satisfaction, loyalty and commitment in service organizations: some evidence from Greece*. *Management Research News*, 29 (12), 782-800.
6. Karatepe, O. (2011). Service Quality, Customer Satisfaction and Loyalty: The Moderating Role of Gender. *Journal of Business Economics and Management*, 12 (2), 278-300.
7. Kumar, M. , Kee, F. T. and Charles, V. (2010). Comparative evaluation of critical factors in delivering service quality of banks: An Application of Dominance Analysis in modified SERVQUAL model. *International Journal of Quality and Reliability Management*, 27 (3), 352 – 378.
8. Lee, H. , Lee, Y. and Yoo, D. (2000). The Determinants of Perceived Service Quality and its Relationship with Satisfaction. *Journal of Services Marketing*, 14 (3), 217 – 231.
9. Spathis, C. , Pteridou, E. , and Glaveli, N. (2004). Managing service quality in banks: customers' gender effects. *Managing Service Quality*, 14 (1), 90-102.
10. Taylor, S. A. et al (1994). An assessment of the relationship between service quality and customer satisfaction. *Journal of Retailing*, 70 (2), 163-78.
11. Thompson, A. M. et al (1993). Psychographic and lifestyle antecedents of service quality expectations: a segmentation approach. *Journal of Services Marketing*, 7 (4), 53-61.
12. Webster, C. (1989). Can consumers be segmented on the basis of their perceived service quality? *Journal of Services Marketing*, 3 (2), 35.
13. Zeithaml, V. A. , Berry, L. L. , and Parasuraman, A. (2006). The behavioral consequences of service quality. *Journal of Marketing*, 60 (2), 31-46.

**PERFORMANCE OF THE SMALL AND MEDIUM ENTERPRISES IN KOSOVO  
(FOCUS IN THE TOWN OF THERANDA/SUHAREKA)**

**Betim SPAHIU**

betim\_spahiu@hotmail.com

**Abstrakt**

The private sector in Kosovo consists mainly of small and medium Enterprises. They generate the largest number of new jobs and represent the spinal column of the local economy. In most countries in transition, small and medium enterprises have carried the greatest burden of transformation to a free market economy.

Small and medium enterprises (SMEs) are now the backbone of the modern economy and the development of a country, it's expressed in the effect that they have on private sector employment indicators, the contribution to the national income and the welfare of the population. Policies for the development of Kosovo can only succeed by involving and informing the local level. Local Economic Development is a holistic discipline and is defined as growth of the local economy's capacity to create wealth for local residents. Local economic development has to do with teamwork people in creating partnerships to promote sustainable economic development that brings economic benefits and improved quality of life for all citizens. This development can be achieved if local resources (land, labor and capital) are used more productively and sustainably. In the economic and social conditions in which Kosovo finds itself today, the development of small business enterprise occupies a very important and primary place.

The study aims to create unique strategy which would be best for a sustainable local economic development and successful entrepreneurship and create more partnerships between the public and private sector that will have an impact on job creation to new stable and efficient operation and use of local resources, and also to analyze and identify the key indicators that affect the success and growth of enterprises of small and medium enterprises (SMEs) in their performance, and to analyze the effects that give these indicators on growth of SMEs.

In this research are addressed several important issues and problems of the overall funding system, the financial situation and profitability of small and medium business enterprises in Kosovo. Also, this paper will present, both from the theoretical and empirical point of view, the connection between these key performance indicators, or in other words, the growth of SMEs.

**Keywords:** *SME Performance's, SME-s profitability, growth of SMEs, local economic development.*

## **INTRODUCTION**

Investment businesses have different challenges where come through different countries. In order their investments to take place in easiest way in other countries; they have to be informed as well about legal regulations about investments and business environment as well needed clear information for state condition regarding international relations. As much as possible information proven, closed to the current and potential business investments, as much we will have economic growth and generate new jobs.

Being new state means facing new challenges. As much as "new born" state pretend to establish well performance institution, acceptable economic growth, create jobs, international relation, integration, as much challenges appears in the way of achieving set objectives. New fragile institutions has legal gaps that allow appearance of negative phenomenon such as corruption, nepotism, political meritocracy, unfair competition, economic discrimination, create monopolies, granting unfair competences to the state and public companies etc.

For Kosovo, having international supervision of United Nation and European Union makes great opportunity of prevention most of negative phenomena. Some international missions brought opportunity of achieving objectives in short ways.

Pretending of being part of European Union makes more difficult the way of reaching objectives for ensuring fair competition on business national environment. Kosovo should be well oriented on competition based on the factors of price, quality, and service; not on the abuse of near-monopoly powers, competitor bashing, predatory pricing, etc. Competition between enterprises is important for the EU economy as a whole because it creates benefits for consumers and enterprises themselves in the form of lower prices and better products. To ensure fair competition, well-designed and effectively enforced competition rules are essential. *“The Community's competition policy should take account of modern technical developments and their impact on the Common Market's economy. Its competition policy must be more than a mere "anti-trust", policy whether directed against restrictive agreements or monopolies. True, bans on restrictive agreements and on abuses of dominant market positions provided for by the Common Market rules of competition are important and permanent components of competition policy. Care must be taken that the actions of firms or governments do not undo the Commission's aims and achievements in freeing trade from the artificial barriers and distortions set up by restraints of competition. Consumers and businessmen alike expect the Common Market to improve living standards. This expectation, in addition to the political desire for European unification, was one of the main motivations for concluding the Community Treaties”<sup>1</sup>.*

## **KOSOVO`S SHORT OVERVIEW**

Kosovo's central location in the Balkans makes it an excellent strategic trading location, offering close access to Skopje, Shengjin Port, Tirana, and Durres, and relatively close access to Sofia, Thessaloniki, Belgrade, Bar, and Sarajevo. Kosovo borders Albania, Serbia, Macedonia, and Montenegro, and it is only a four-hour drive away from Greece.

---

<sup>1</sup> Ensuring fair competition in the European Community, by Emmanuel M •J. A. Sassen Member of the Commission of the European Communities.

Kosovo has a land area of 10.908 square kilometers. According to the most recent data from the Statistical Office of Kosovo from June 2012, Kosovo has an estimated population of 1,815,606 (December 2012 estimation) million inhabitants. 205,133 of those inhabitants live in the capital city, Pristina. With an estimated 70% of the citizenry being under the age of 35, Kosovo has one of the youngest populations in all of Europe.<sup>2</sup>

Law on competition 2004/36 has aim to ensure sustainable development of the market economy of Kosovo by prohibited actions that limit, by doing pressure or disturb competition. This law operates to ensure free and effective competition in the market by relying on three main pillars that define the protection:

- **Anticartel**
- **Abuse of dominant position**
- **Mergers or concentrations of undertakings**

The establishment of free competition and its protection are a vital segment of the existence of the market economy that competition has an important place in economic policy. This institution outlines its function as promoter and advocates of competition and the interests of consumers and businesses, with the final aim that market to generate the development.

## **THE STATE OF BUSINESS ENVIRONMENT IN KOSOVO: MAIN CHALLENGES AND THEIR IMPACT ON BUSINESSES**

SMEs (small and medium enterprises) are a vital part of Kosovo's economy and account for approximately 40% of GDP. SMEs employ around 60% of formal sector employees and account for 99% of all businesses. However, despite their immense importance, especially as job generators, SMEs in Kosovo continue to face institutional barriers and other obstacles in the business environment (even after the declaration of independence in 2008 and the establishment of several relevant institutions).

---

<sup>2</sup> 2011, Kosovo Census

Table I. Rank of indicators in 2011 and 2012 (Source: World Bank Doing Business, 2014)

Indicator	Rank in 2011	Rank in 2012	Progress/Deterioration
1. Starting a business	165	168	↓ Deteriorated
2. Dealing with Construction Permits	169	171	↓ Deteriorated
3. Getting electricity	120	124	↓ Deteriorated
4. Registering property	66	73	↓ Deteriorated
5. Getting credit	24	21	↑ Improved
6. Protecting investors	172	174	↓ Deteriorated
7. Paying Taxes	45	46	↓ Deteriorated
8. Trading across borders	129	131	↓ Deteriorated
9. Enforcing contracts	157	157	↔
10. Resolving insolvency	31	31	↔

Inheriting a state-run economy from the former Yugoslavia, Kosovo faced huge problems in installing the basic standards and mechanisms of a market economy in the aftermath of 1999. For example, the level of unemployment in Kosovo is estimated at 45.4%, with the number of job seekers estimated at 335,260<sup>3</sup>. Moreover, the government's plan for privatization threatens to put additional strain on the job market; Kosovo's market experienced rather huge social upsets by the trade unions in response to the process of privatization undertaken by the government which was very influenced by political interest and was seen as fully corrupt. In addition, the lack of a coherent and legally certain path for foreign direct investments threatened many foreign industrial investments in Kosovo. In particular, the lack of confidence in Kosovo's market mechanisms prevented many competitive sectors in Kosovo (i.e. tourism, mining and energy etc) from receiving foreign investments.

<sup>3</sup> Ministry of Labour and Social Welfare, Annual Report (2011) 'Labour and Unemployment' p.17. Available at: <http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Librat/2011%20Raporti%20Vjetor%20Puna%20dhe%20Punesimi.pdf>.



As a result, there was no foundation for significant industrial development via foreign direct investments. Moreover, a sidelined but important facet relates with international recognition of Kosovo. As a result of its contested statehood, Kosovo was 'banned' from enjoying a customary capacity to export as well as communicate with international and regional markets. Most recently, the institutional capacity to fully implement the long list of newly printed regulations and laws is severely lacking. The new regulations and laws have in turn contributed to additional difficulties for businesses in Kosovo. Assessments of Kosovo's business environment report an unfavorable business climate that inhibits the establishment and growth of local businesses and discourages foreign investors. These reports<sup>4</sup> also paint a sobering picture of the state of business in Kosovo, which clearly hint to the fact that Kosovo's market did not improve significantly in the last years (see table 1). For example, the Progress Reports of the EU continuously highlight the weak, regionally uncompetitive, and financially unsound legal and economic policy standards in Kosovo's business environment.<sup>5</sup> Moreover, other reports note the weak rule of law, the large number of informal activities, corruption, and uncertainty over property rights as continual hindrances to the development of Kosovo's economy.<sup>6</sup>

With a reoccurring set of implications appearing in the business environment, the Government of Kosovo has undertaken reforms aimed at improving the business environment (see box 1). However, Kosovo institutions continue to lack a consistent and efficient policy response that could address these challenges more pragmatically. As a result, businesses are still confronted with several problems, with corruption, informality, and regulatory burden as the most prevalent challenges.

*Box 1: Reforms in Doing Business in Kosovo (Source: Ministry of Trade and Industry)*

---

<sup>4</sup> World Bank Doing Business Report, 2010 and 2011, p. 10

<sup>5</sup> European Commission, Kosovo Progress Report 2011. Brussels, 12.10.2011. SEC(2011) 1207

<sup>6</sup> 5 European Commission Progress Report on Kosovo 2011 and Riinvest Enterprise Barriers Survey 2011

*Aiming to enhance the capacity for conducting business in Kosovo and improve the ranking in the World Bank Doing Business Report, the Government of Kosovo has commenced a reform agenda. To date, several reforms have taken place:*

- 1. The requirement of obtaining a work permits in order to start-up a business has been eliminated, and the procedure for registering a business has been simplified.*
- 2. The business registration fee has been eliminated. Prior to this reform, it cost € 24 to register a LLC business.*
- 3. The required deposit of main assets for businesses of the Joint Stock Companies has been reduced from €25.000 to €10.000. While of the required rate of deposit for LLC businesses was formerly €1.000, this required deposit of businesses main assets has been removed.*
- 4. The declarations on conflicts of interest have been advanced for directors and relevant officers. Also, the competent courts can easily annul transactions that violate the rules on conflicts of interest.*
- 5. In order to export or import goods to or from Kosovo, businesses have been required to submit eight (8) different documents. Now the exporting and importing companies are not obliged to obtain export/import certificates. Yet, despite this reform, businesses still face several challenges due to the inefficient functioning of 'One Stop Shops'.*

### **Link the identification of informal businesses with rewards**

Authorities should consider establishing performance incentives for tax inspectors, offering rewards for identifying and transforming businesses that operated informally into part of the formal market. This will provide for a higher number of taxpayers resulting in a greater amount of tax revenue for the state. In addition, this would reduce the incentives for corrupt behavior by inspectors, as they would be provided with a financial stability.

### **Increase the efficiency of tax inspections**

In order to do this, the number of inspectors must be increased, as the authority is largely understaffed.

### **Full Functionalize of One-Stop Shops**

One-Stop Shops are expected to have a large effect on reducing informality, as the regulatory burden will be reduced. Thus, efforts must be directed towards making one stop shops fully functional and efficient (i.e. offering the services, issuing documents/permits).

**Reduce the regulatory burden**

Considering the high rate of informality, there is a considerable need to persuade informal businesses to translate their activities into the formal economy. Thus, the costs and lengthy procedures for obtaining licenses and permits and processing tax statements should be decreased.

**Increase awareness**

Once the aforementioned reforms and benefits are made available for the targeted audience, a communication program should be implemented to raise awareness of their existence and educate informal businesses on their use. This implies the need to provide training programs for businesses, which should emphasize the benefits of existing within the formal market economy.

**SMALL AND MEDIUM SIZE ENTERPRISE (SME) DEVELOPMENT**

Business environment in Kosovo actors across multiple jurisdictions must take place in order to reduce or even eliminate excessive and overlapping demands on businesses. Creating more jobs will largely depend on the ability of firms to enter markets and expand, as well as to restructure and improve competitiveness. Today, Kosovo possesses solid foundations for private sector development. Competitive forces in the markets for goods and services must introduce. However the problem occurred to the SME also could be the Procurement Regulations in Kosovo because the more frequent criteria are the lowest price. This effect negatively to the SME profit, low profit effects directly in the investments and low investments cause low employment. Also the privatization process is another problem because the highest price offered to privatize the public enterprises is the reason that no funds more kept by the new owners which could use for the additional investments in the privatize enterprises.

Therefore considerable progress is needed to establish an appropriate framework that is conducive to small and medium-sized enterprise (SME) development. Experiences in other transition countries highlight the importance of a proactive approach by forming and boosting

instruments to improve access to business advisory services, finance and business infrastructure that will support firm startup, expansion, restructuring and competitiveness.

The introduction of a guillotine practice should be considered, following the example of other countries such as Hungary and Croatia<sup>7</sup>. Concretely, the government should instruct all the relevant institutions to prepare inventory lists of their regulations. As a result, the unnecessary, outdated and illegal rules would be identified and removed from the lists.

### **BUILD AND ACCESS TO BUSINESS ADVISORY SERVICES**

Startup or early stage businesses in Kosovo, as in other transition countries, typically lack access to basic knowledge, skills and information that are vital for starting and successfully operating a business. For that reason a high level of donor assistance has been invested in the provision of business advisory services through subsidized business centers. Although highly important, the market for business advisory services still does not exist in Kosovo, as startup and early stage businesses are not able to buy BAS at market rates. Following the withdrawal of donor support these centers either collapsed or sought more profitable work in relation to larger enterprises. Experiences in other transition countries highlight the importance of continuing to provide support to private business advisory service providers for SME's for a considerable amount of time with public money<sup>8</sup>.

#### **Improving Access to Finance**

The volume of the banking sector has increased remarkably. Thus, there is still a long way to go. Restricted access to credit is most common for newly established firms and the categories which account for a large portion of total job creation. Rural enterprises, farms and non-farms alike, consider inadequate access to credit lines would lead to significant improvements in the labor market. Structural weaknesses still exist in financial sector development, in particular in the protection of creditors' rights.

---

<sup>7</sup> Prof. Dr. Nazmi Mustafa, International Business Journal, Nr VIII; Challenges Faced Economy of Region

<sup>8</sup> Prof. Dr. Nazmi Mustafa, International Business Journal, Nr VIII; Challenges Faced Economy of Region

## Access to Business Infrastructure

In general, one of the critical impediments to the growth of larger size enterprises is access to utilities, infrastructure facilities, land and one-window-services to investors in the establishment of their investment projects. Detailed feasibility studies have confirmed that the development of industrial zones and business incubators could actively be promoted in order to promote investments and technology transfer, boost production and employment, and promote investments.

### ADOPTING AND IMPLEMENTING OF EUROPEAN COMMISSION REGULATIONS

There are two directives that every member country even countries that are in the way of integration in EU, must adopt and have to be fully implemented:

- ❑ DIRECTIVE 2004/17 EC-coordinating the procurement procedures of entities operating in the water, energy, transport and postal services sector.
- ❑ DIRECTIVE 2004/18 EC on the coordination of procedures for the award of the public work contracts, public supply contracts and public service contracts

EU “PLANET” project in Kosovo in the framework of a European Union funded project, public procurement system is improved in Kosovo in order to ensure proper stewardship, transparency and effectiveness in public spending. The project “Improving Administrative Capacities in Public Procurement in Kosovo”– managed by the European Commission Office in Kosovo and implemented by an international consortium led by Planet S.A.– enhances regulatory and operational background of public procurement<sup>9</sup>.

The strategic objectives of KCC should focus on these points.

- Organization and internal capacity of Kosovo Competition Commission

---

<sup>9</sup> Improving procurement procedures in Kosovo; Presented by Muhamet Spahiu on GIZ Conference for Regional Cross-Border Initiatives

- Completion of secondary legislation in the field of *competition conform of European Directives*
- Monitoring and initiations of investigative procedures for violators of competition
- Advocacy, training and additional notifications for competition.

Common identifying of areas where violate free competition and to take measures for it's preventing.<sup>10</sup>

### **PROTECTING MINORITY INVESTORES**

Protecting minority investors matters for the ability of companies to raise the capital they need to grow, innovate, diversify and compete. Effective regulations define related-party transactions precisely, promote clear and efficient disclosure requirements, require shareholder participation in major decisions of the company and set detailed standards of accountability for company insiders. What do the indicators cover? Doing Business measures the protection of minority investors from conflicts of interest through one set of indicators and shareholders' rights in corporate governance through another. The ranking of economies on the strength of minority investor protections is determined by sorting their distance to frontier scores for protecting minority investors.

### **INSTALLING FAIR COMPETITION BETWEEN PUBLIC AND PRIVATE COMPANIES**

Public companies in Kosovo cover over than 95% of business of waste management. In order to access the segment market from private companies there are many unnecessary permits and procures. Public services offered from public companies in Kosovo are showed in lower performance due to lack of competition. There are most companies that express interest on market shares of public services that are granted unfair to public companies.

---

<sup>10</sup> Strategic objectives of Kosovo Authority of Competition

Government of Kosovo should remove granted rights on market from public companies and allow straight competition for private companies.

### **WHAT SHOULD BE THE ROLE AND FUNCTION OF THE KOSOVO COMPETITION AUTHORITY?**

The focus on what must be the work of Kosovo Competition Authority, as an independent public institution, is the effective implementation of the competition legal framework and advocacy in a way to influence the government and the public sector to execute pro-competition policies (International Competition Network – Seminar on Competition Agency Effectiveness, 2009). Until now the Commission has started only some investigation procedures in sectors like: GSM Mobile communication, bank system and insurance companies. Of course, this is not even close to the market needs of the country in the sphere of regulation of competition. Therefore, the obligation of competition legislation implementation should be related with decision that must be based in detail and general studies of the market. Providing information composes the fundamental element for a healthy judiciary. By reviewing the relations of the Kosovo Competition Authority with the court, this will increase the culture of the courts for the implementation of the competition legal framework. From the analysis for the activity of the Competition Authority we can conclude that the creation of contemporary legislation for the Competition respectively has not created the necessary conditions for the implementation of law and competition policies. This makes it necessary to strengthen the institutional and professional capacities of the Competition Authority in order to play a more proactive role to implement strictly and effectively the law on protection of competition and to be an advocate of the development of economic reforms according to the principles of competition. The Parliament of the country should focus on the completion of the Authority with the necessary human and financial resources to review and increase the budget in this segment (Lionis & Sokol, 2012).

It is essential that in exercising this function, the arbiters must be fair and provide a free and effective competition in the market between operators, where all actors should be satisfied. Competition policies and their implementation must ensure that all market players

The paper described, analysed and explored the relations between the complex theories, concepts and practice of sustainable marketing of cultural heritage in Albania and the way it is perceived and practised by the owners and employees of tourist agencies and operators. It was based in a mixed methodology of study of a qualitative and quantitative survey. A questionnaire with semi-structured interviews was compiled and distributed to the tourist agencies and operators in Albania and abroad. It was chosen a stratified, random and quota sample in which there were randomly selected 132 tourist agencies and operators which I have distributed a semi-structured questionnaire by email, phone and face to face interview. In this paper I presented the semi-structured interviews of 30 of them. The paper gave insights of Albanian cultural heritage institutions, experienced not only by the visitors as the 'consumers' of this 'product' but it is analysed also the 'market' of cultural heritage and its transformations in the post-communist Albania. This was done by using the paradigm of co-creation and the effects it had in the sustainable marketing of cultural heritage in Albania. further it was discussed the ways both visitors and other stakeholders such as institutions of cultural heritage, local municipalities, local people etc. can add value to the existing cultural heritage in Albania based mostly on ideas of Prahalad, Ramaswamy and Kotler.

The first argument was that cultural heritage in Albania is still a market dominated mostly by the Albanian state, although there are attempts to transform it according to the well-known Third Way of Labour Party in UK or a new kind of neo-liberalism. Secondly, the results of surveys and structured interviews show a gap of public and private institutions

dealing with cultural heritage and in their relation to the local people. Local people are not considered as important actors in this process, which makes them feel marginalized and without any decision – making opportunity. Another important result of the study is that the marketing strategies in itself are not sustainable and they need to be adjusted based on the ‘co-creation’ paradigm to bring more visitors and tourists to the Albanian cultural heritage.

### References :

1. Bourdieu, Pierre, 1995. "The Myth of 'Globalization' and the European Welfare State" in Acts of Resistance: Against the Tyranny of the Market. Cambridge: Polity Press.
2. Chhabra, Deepak. (2010). Sustainable marketing of cultural and heritage tourism. London: Routledge.
3. Creswell, John. W. (2009). Research design – qualitative, quantitative and mixed methods approaches. London: Sage.
4. Cros, H. D. & Lee, Y. F. (2007). Cultural heritage management in China. New York: Routledge.
5. Eriksen, Thomas Hylland, 2007. "Reembedding" in Globalization: The Key Concepts. Berg.
6. Gazeta Tema. Dikush futet ne Wikipedia dhe fyen rëndë shqiptarët. 11 December 2013. Retrived from: <http://www.gazetatema.net/web/2013/12/11/dikush-futet-ne-wikipedia-dhe-fyen-rende-shqiptaret/> .
7. Giddens, Anthony (1991): The Consequences of Modernity. Polity Press. Cambridge. pp. 70-78.
8. Kotler, P. Kartajaya, H. Setiawan, I. (2010). Marketing 3.0 – From products to consumers to the human spirit. New Jersey: Wiley.

9. Mehmeti, Sonila. (2017). Rama: Reducing tourism tax to 6%, another promise delivered. Albanian Telegraphic Agency. Retrieved from: <https://www.ata.gov.al/en/rama-cutting-down-on-tourism-tax-from-20-to-6-another-promise-delivered/> .
10. Pini, Fabrizio. M. (2009). The Role of Customers in Interactive Co-Creation Practices: The Italian Scenario. *Journal of Knowledge and Technology*. Vol. 22.
11. Prahalad, C.K. & Ramaswamy, V. (2004). Co-creating unique value with customers. *Journal of Strategy and Leadership*. Vol. 32 (4).
12. Roshi, E. & Abazi, A. (2011). The role of the World Heritage Sites in Albania in the Albanian culture heritage tourism; the need for public private partnerships in offering better tourism services.
13. Tourism Development International. (2010). *Albania Culture Marketing Strategy*. UNDP, July 2010.



**ROLI I ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS NË SHËRBIM TË  
TATIMPAGUESVE**

**Msc. Kushtrim DRESHAJ PhD (c)**

kushtrim.dreshaj@unhz.eu

**Msc. Fatmire Shala DRESHAJ PhD (c)**

fatmire17@hotmail.com

**Abstrakt**

Ky punim ka për qëllim të pasqyrojë ecurinë e ndërtimit të politikës së tatimeve në Kosovë. Qëllim tjetër i këtij punimi është definimi i aspekteve teorike dhe praktike, të politikës fiskale të Republikës së Kosovës. Ndërtimi i politikës fiskale – tatimore me reforma të reja duke u bazuar në kërkesat e bizneseve. Shteti ynë ka nevojë për të hyra me qëllim që të plotësojë përgjegjësitë për qytetaret dhe banorët e Kosovës për: rrugë, siguri, arsimit, spitale, programet e mirëqenies sociale, etj. Të gjitha këto kërkojnë fonde. Misioni i Administratës Tatimore është të mbledhë të hyra që mundesojnë financimin në mënyrë të drejtë dhe transparente. Varet nga tatimpaguesit që në mënyrë vullnetare të përcaktojnë detyrimin e tyre të saktë tatimor dhe të kryejnë me kohë pagesën e atij detyrimi. Administrata Tatimore e Kosovës si njësi ekonomike publike bënë mbledhjen e parave, këto para derdhën në buxhetin shtetëror, ndërsa qeveria harton plane që t'i shpërndaj këto në mënyrë transparente dhe në proporcion. Të gjitha këto të hyra mbledhen në bazë të një shkalle tatimi të përcaktuar me ligj. Kjo ndryshe në gjuhën ekonomike njihet si administrimi i politikës fiskale.

**Fjalë kyçe:** *ATK, tatime, reforma, fiskale, politikë, biznese, hierkarki, menaxhment, norma tatimore, TVSH.*

## **HYRJE**

Fillet e para të menaxhmentit i gjëjmë në përpjekjet e grupacioneve njerëzore për organizim më të cilin sigurohet egzistenca, efikasiteti dhe mirëqenia e tërësishme. Aftësia për organizim dhe udhëheqje, si veti e lindur dhe e ushtruar, solli deri të imponimi reciprok i atyre që duanin të udhëheqën dhe atyre që duanin të udhëheqin.

Termi menaxhim i referohet procesit të realizimit të punëve në mënyrë efektive dhe efikiente, përmes dhe me përsona të tjerë<sup>1</sup>. Pra termi process përfaqëson aktivitetet kryesore që kryejnë menaxherët.

Menaxhmenti paraqet tërësinë e aktiviteteve njerëzore kah realizimi i qëllimit-qëllimeve të caktuara, përkatësisht tërësinë e ndërlidhur të pesë funksioneve: planifikimit, organizimit, personelit, udhëheqjes dhe kontrollit.<sup>2</sup>

Format e para të shkrimeve për menaxhimin i hasim në shek. XVIII në kohën e Revolucionit industrial në Angli dhe pastaj në vendet tjera të Evropës dhe në Amerikë. Studimet shkencore në fushën e menaxhimit përparuar krahas zhvillimit të marrëdhënieve të punës në organizatat e ndryshme punuese dhe institucione shtetërore e publike. Mendimet e grupeve të ndryshme të shkencëtareve ndërtojnë teori të ndryshme për menaxhim profesional të organizatave dhe institucioneve të niveleve dhe madhësive të ndryshme.

Sipas teorisë së Frederick Taylor (1856-1915), e cila quhet edhe “Teoria e Menaxhimit Shkencorë”, ku synimi kryesorë teorik dhe praktik i kësaj teorie qëndron në ngritjen e efikasitetit të punës nëpërmjet zbrërthimit të punës në detyra më të vogla, të cilat përfaqësojnë njësitë themelore të punës.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Patric Montana and Bruce Charnov, management, Barron’s, faqe 2, Canada 2000

<sup>2</sup> Prof.Dr. Berim Ramosaj, Bazat e menaxhimit, Universiteti i Prishtines, faqe 15-16, Prishtine tetor 2007

<sup>3</sup> Patric Montana and Bruce Charnov, management, Barron’s, faqe22, Canada 2000

## **DOMOSDOSHMERIA E THEMELIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË ATK-SË**

Sistemi tatimor është i lidhur ngushtë me shtetin dhe funksionet e tij. Shikuar historikisht paraqitja e tatimit dhe sistemit tatimorë në përgjithësi është e lidhur ngushtë me zhvillimin e shtetit dhe funksioneve të tij.<sup>4</sup>

Si në çdo shtet edhe në Kosovë ekziston mekanizmi për mbledhjen dhe administrimin e tatimeve.

Administrata Tatimore bazën juridike të krijimit e ka në rregulloren e UNMIK-ut Nr.2000/20 mbi organizimin dhe procedurat e Administratës Tatimore si dhe udhëzimin e Administratës Tatimore Nr.1/2000 mbi “Organizimin dhe Procedurat e Administratës Tatimore”<sup>5</sup>.

Menjëherë pas luftës ATK-ja ka funksionuar në kuadër të AQF-së (Autoriteti Qendrorë Fiskal), ku krijimi i saj është bërë konform rregullores 1999/16 të datës 6 Nëntor 1999, ku mbi themelimin e këtij autoriteti krijohet Administrata Tatimore në kuadër të AQF-së dhe është e precizuar në Nenin 1: Krijimi i Administratës Tatimore dhe në Nenin 1.1 të udhëzimit administrative Nr. 1/2000.<sup>6</sup> Qëllimi dhe arsyeshmëria e themelimit të Administratës Tatimore është mbledhja e të hyrave të cilat shërbejnë për ti plotësuar nevojat shoqërore me karakter publik, si dhe me qëllim të stimulimit të biznesit dhe sigurimit të vetë-financimit buxhetorë.

Fillimisht ATK-ja ka administruar këto tatime:

- Tatimi në hoteleri, ku norma tatimore ka qenë 10% e qarkullimit bruto mujorë dhe që ka funksionuar deri me Qershor/2001.
- Tatimi i paragjykuar ku norma tatimore ka qenë 3% e qarkullimit bruto 3 mujorë, e që ka filluar prej 1 Korrik 2000 e deri në fund të vitit 2004.
- Me konsolidimin e kohë paskohshëm të ekonomisë dhe ekspansionit të regjistrimit të bizneseve të reja lindi nevoja dhe arsyeja për formësimin dhe implementimin e tatimeve të

<sup>4</sup> Prof.Dr.Musa Limani, Politika ekonomike, Universiteti i Prishtinës, faqe 260, Prishtinë 1994

<sup>5</sup> Rregullorja e UNMIK-ut nr.2000/20 mbi Organizimin dhe Procedurat e Administratës Tatimore

<sup>6</sup> Udhëzimi Administrativ Nr.1/2000

reja si nevojë e domosdoshme për të hyra suplementare, si nevojë e domosdoshme për mbushjen e buxhetit.

Kështu që me datën 1 Korrik 2001 hynë në fuqi tatimi i vlerës së shtuar me normën 15%.<sup>7</sup>

Në vitin 2002 sistemit tatimor i shtohet edhe ky lloj i tatimit:

- Tatimi në të ardhura personale (Tatimi në paga që vazhdon të ekzistoj edhe tani )
  - Tatimi në Fitim( i cili ka funksionuar deri në fund të vitit 2004)
- Tani tatimi në fitim është ndarë në dy lloje:
- Tatimi në të Ardhura Personale dhe
  - Tatimi në Korporata qe në një formë janë sinonime të tatimit në fitim.

Politika tatimore apo zbatimi i mirë i sistemit tatimor nuk matet me vetëm nëse administrata përgjegjëse mbledh më pak apo më shumë të ardhura nga tatimpaguesit, por matet me lehtësimin e procedurave për tatimpaguesit dhe veçanërisht për investitorët vendor dhe sidomos ata të huaj në mënyrë që atyre t'iu bëhet sa më atraktiv dhe jo burokratik tregu në Kosovë.<sup>7</sup> Masat tatimore të ndërmarra viteve të fundit pjesërisht kanë dhënë rezultatet e tyre të mira në mbledhjen e tatimeve tek ndërmarrjet dhe individit, por objektivi tjetër madhor i tërheqjes së investimeve të jashtme nuk pati ndonjë rezultat për lëvdatë, meqë ambienti kosovar i biznesit ende mbetet larg për të qenë i kënaqshëm për kapitalin e huaj.

Përvoja e viteve të fundit në Kosovë sinjalizon qartë se politikat tatimore nuk janë të vetmet kushte të nevojshme dhe të mjaftueshme për tërheqjen e investimeve të jashtme por për këtë kërkohet një qasje më gjithëpërfshirëse dhe sidomos në krijimin e një ambienti më të favorshëm biznesi; përmirësim në infrastrukturë dhe zhbërjen e imazhit në raport me korrupsionin që e ka Kosova së fundi.

Në një vend modern, që Kosova synon të jetë, nga qytetarët kërkohet pagesa e tatimeve dhe obligimeve tjera të cilat financojnë programet qeveritare, ofrimin e shërbimeve publike si dhe standardet e larta të arsimimit, mirëqenies, shëndetit, mbështetjes sociale,

<sup>7</sup> Rregullorja e TVSH-së nr.2000/11 të datës 3 Maj 2001

<sup>7</sup> Prof.Dr. Muhamet Sadiku, "Hyrye në Makroekonomi", Pejë 2007, fq. 27

mbrojtjes, zbatimit të ligjit, dhe infrastrukturës së përgjithshme. Të gjitha këto mund të sigurohen dhe të bëhen të mundshme vetëm me mbledhjen e duhur të tatimeve.

Përgjegjësi e Administratës Tatimore, si Agjencion Ekzekutiv me Autonomi të plotë, është që të administrojë zbatueshmërinë e çdo lloji të tatimit të aplikuar me Legjislacionin Tatimorë në Republikën e Kosovës.<sup>8</sup> Administrata Tatimore në mënyrë që të realizoj përgjegjësinë që i ka dhënë ligji, të gjitha përpjekjet i ka përqendruar në Përbushjen Vullnetare të Detyrimeve Tatimore nga ana e Tatimpaguesve. Përbushja vullnetare nënkupton deklarin dhe pagesën e detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit, duke respektuar dispozitat ligjore në lidhje me shumën e tatimit që duhet të paguhet dhe respektimin e afatit të pagesës së kësaj shume, pa ndërhyrjen e ATK-së.

Që të realizohet ky objektivi, ATK gjithmonë është në shërbim të tatimpaguesit. ATK në çdo rast mundohet që të krijoj kushte më të favorshme për tatimpaguesin dhe procedura sa më të lehta dhe më të thjeshta për t'i mundësuar tatimpaguesit që të përbush vullnetarisht detyrimin e tij tatimor. Pra misioni i ATK-së është zhvillimi në nivelin më të lartë të përbushjes vullnetare në përputhje me ligjet dhe rregulloret që janë në fuqi e gjithashtu edhe dhënia e shërbimeve profesionale, transparente dhe efektive për komunitetin.

Administrata Tatimore ka obligim dhe detyrë të vendosur me Ligj që të siguroj Zbatim të Njëtrajtshëm të dispozitave Ligjore për të gjithë tatimpaguesit në mënyrë të njëjtë për situata të njëjta.<sup>9</sup> Për këtë arsye ATK ka botuar këtë vëllim të parë të këtij libri, në mënyrë që ta njoftoj tatimpaguesin me Legjislacionin e zbatueshëm tatimor, me të drejtat dhe obligimet që ka Tatimpaguesi ndaj Administratës Tatimore si dhe të drejtat dhe obligimet që ka Administrata Tatimore ndaj Tatimpaguesit.

Secili Tatimpagues ka të drejtë që të jetë i informuar, ndihmuar dhe dëgjuar me kohë. ATK do të mundohet që të ju trajtoj me mirësjellje dhe në rrethana normale do të mundohemi

---

<sup>8</sup> Administrata Tatimore e Kosovës, Ligji 03 / L – 071. Më shumë në ëeb: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org)

<sup>9</sup> Administrata Tatimore e Kosovës, Ligji 03 / L – 071. Më shumë në ëeb: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org).

që të ju ofrojmë udhëzime, duke lëshuar vendime publike dhe individuale për tu shpjeguar se si të interpretoni dhe aplikoni dispozitat e legjislacionit tatimor.<sup>9</sup>

Në Kosovë përflitet se do të behen ndryshime në politikat tatimore të cilat janë shumë të disfavourshme për biznesin Kosovar. Shtrohet pyetja a mjafton një ndryshim i politikës tatimore në Kosove për të pasur ngritje të ekonomisë së vendit. Unë them se është një hap pozitiv por i pamjaftueshem për një avancim të mirëfilltë. Me rregullimin e politikës tatimore ne i japim vetëm një krahasim të Kosovës e me një krahasim shumë vështirë është të fluturon. Edhe po të ia heqesh të gjitha taksat një bujku në Kosovë ai prap nuk do të kishte mundësi të fillon prodhimin, ngase nuk ka kapital dhe mbështetje financiare, prandaj pa një politik monetare të favorshme, një ulje të normave të kamatës vështirë se do të ketë lëvizje të medhaja pozitive të Ekonomisë në Kosovë.

Administrata Tatimore e Kosovës është themeluar me datën 17 Janar 2000 nën drejtimin dhe administrimin e UNMIK-ut. Drejtor i parë i ATK-së ishte ndërkombëtar i punësuar nga një kontraktues i USAID-it. Nga Tetori i vitit 2001 deri në Shkurt të vitit 2003, kishte bashkë-drejtorë nga USAID-i dhe vendor që ndanin rolin e drejtorit. Me 18 Shkurt 2003, autoriteti për Administratën Tatimore u bart nga UNMIK-u te Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe mori detyrat e Drejtorit të ATK-së një vendor. Që nga ajo kohë, ATK ka funksionuar si një organizatë autonome, e menaxhuar krejtësisht nga banorë të Kosovës me këshillime dhe ndihmën e organizatave donatore ndërkombëtare në radhë të parë, USAID-i, BE dhe FMN.<sup>10</sup>

Gjatë historikut të shkurtër të saj, ATK ka zhvilluar një strukturë organizative funksionale e cila në pjesën më të madhe të saj është në pajtim me praktikën më të mira ndërkombëtare. Ka një qendër përpunimi të dokumenteve, të centralizuar, përmes së cilës përpunohen të gjitha deklaratat, po ashtu ka filluar decentralizimi procedimit të TVSH-se me qëllim të intervenimit të përbushjes së menjëhershme. Është krijuar edhe një njësi për tatimpaguesit e mëdhenj që merret me tatimpaguesit më të mëdhenj në Kosovë, që njëherit është praktika më e mirë ndërkombëtare.

---

<sup>9</sup> Administrata Tatimore e Kosovës, Ligji 03 / L – 071. Më shumë në ëeb: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org)

<sup>10</sup> Portali i Administratës Tatimore e Kosovës. Më shumë në ëeb: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org),

Legjislacioni tatimor i Kosovës është pranuar si nga FMN-ja ashtu edhe nga Komisioni Evropian si legjislacion transparent dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare.

Me gjithë zhvillimin e vet dhe asistencën e dhënë, ATK ende duhet shumë për të bërë që të jete Administratë Tatimore moderne, eficiente dhe një organizatë prijëse shtetërore në Kosovë.

### **Vizioni i Administratës Tatimore të Kosovës është që:**<sup>11</sup>

- ✓ të formojë dhe të ruaj një imazh pozitiv për të mirën e shtetit të Kosovës,
- ✓ të respektohet nga klientët tanë dhe të njihet nga organizatat dhe institucionet ndërkombëtare,
- ✓ të përbëhet nga personeli profesionist dhe energjik që do të garantojnë një nivel të lartë të transparencës dhe modernizimin e shërbimeve tona në raport me klientët tanë, përmes të cilës ne do të bëhemi burimi kryesor i të hyrave për shtetin e Kosovën.

### **Misioni i ATK-ës është:**<sup>12</sup>

- ✓ të shtohet në maksimum përmbushja vullnetare e obligimeve, duke i dhënë përqendrim të plotë legjislacionit dhe rregulloreve tatimore,
- ✓ të ofrojmë shërbime profesionale, transparente dhe efektive për komunitetin e tatimpaguesve në mënyrë që ata të kuptojnë obligimet e tyre të pagesës së tatimeve, dhe
- ✓ të sigurojmë zbatim të drejtë dhe të njëjlojshëm si dhe fuqizimin e ligjeve tatimore me
- ✓ qëllim që të mbliidhen të hyra për buxhetin e Kosovës në një mënyrë efikase dhe me
- ✓ kosto të ultë.

## **STRUKTURA ORGANIZATIVE E ATK-SË**

Konceptet bazë të organizimit të organizatës u formuluan në fillim të vite 1900 nga studiuesit e menaxhimit të cilët ju ofruan menaxherëve një tërësi parimesh që mund të

<sup>11</sup> Portali i Administratës Tatimore e Kosovës. Më shumë në ëeb: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org),

<sup>12</sup> Portali i Administratës Tatimore e Kosovës. Më shumë në Web: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org),

ndiqeshin prej tyre. Elementet e kësaj strukture janë: specializimi i detyrave, uniteti i urdhrave, spektri i kontrollit, autoriteti dhe përgjegjësia, centralizimi kundrejt decentralizimit dhe formimi i departamenteve.

Organizimi është njëçështje që ka tërhequr gjithmonë vëmendjen e studiuesve dhe të menaxherëve të praktikës. Drucker ka nënvizuar se “Një strukturë organizative nuk sjellë vetvetiu një performancë të mirë, por një strukturë organizative e keqe e bënë të pamundur performancën e mirë sado të zotët që të jenë menaxherët e saj. Të përmirësosh strukturën organizative do të thotë që gjithmonë të përmirësosh performancën”.<sup>13</sup>

Fjala organizim ka prejardhje greke ”organon” që ka domethënie e mjetit ose veglës, e që në këtë rast merret si mjet për realizimin e ndonjë pune. Pra organizimi është mjet, mënyre, mundësi, aksion i një detyre të caktuar për realizim sa më të mirë.<sup>14</sup>

Organizimi paraqet funksionin menaxherik ku bëhet projektimi dhe vendosja e marrëdhënieve midis aktiviteteve dhe njerëzve, në rrjedhen e sigurimit, vendosjes, rënditjes dhe shfrytëzimit apo kembimit të resurseve organizative.

Organizata varsisht nga lloji i aktivitetit që ushtron si dhe mjedisi në të cilin vepron, perzgjedhin struktura të pershtatshme organizative. Strukturat hirarkike influencojnë pranimin e shumë prej vlerave dhe normave burokratike si psh. Parimi i unitetit të komandes, zingjirit të komandes, kontrollin e përqendruar, formalizim të lartë, disiplin, centralizim të autoritetit, ndersa strukturat organike ka një piramid të rrafshet.

Një aspekt i rëndësishëm i strukture organizative është shkalla në të cilën një organizatë është e centralizuar apo e decentralizuar. Keto aspekte të vendimmarrjes administrative mund të ndikojnë në rezultatin e punës. Sa më e decentralizime të jetë një organizatë aq më vështirë është për menaxherët të imponojnë ose ndryshojnë sepse ata gëzojnë autoritet të deleguar neper tërë zingjirin skalar.

Struktura e një organizate shpesh reflekton fuqin politike të organizates dhe sistemit të saj mbeshtetes. Krijimi i departamentit të arsimit nga presidenti Jimmy Carter (1979) reflektoj rritjen e rëndësisë që i kushtohet arsimit nga ana administratës. Në menyrë të ngjajshme edhe

<sup>13</sup> Prof.Dr.Shyqyri Llaci, Menaxhimi, Alb Paper faqe 195, Tiranë 2002

<sup>14</sup> Baki Koleci, Fetah Reçica, Neritan Kurteshi, “Menaxhment (Bazat e menaxhimit)”, Prishtinë 2008, fq.80



presidenti George Bush mbeshteti krijimin e departamentit të çështjeve të veteranve nepermjet aktit të veteranve 1987 reflektoj dhe simbolizoj influencen e grupeve të veteranve. Struktura organizative është statike ajo reflekton gjendjen e organizimit vetem në nje moment të caktuar. Dizajnimi i struktures bëhet nga menaxher apo nga specialistet bazuar në provojat e tyre.

Një ndër teoritë e njohura kyqe sa i përket projektimit struktural organizativ është ajo e Mitzbergut, Ky model ka pesë komponente të colat janë:

1. Baza operative – në perberje të se ciles janë punëtorët qe kryen punët themelore
2. Niveli i mesem administrativ – ne këtë nivel organizativ hyjnë të gjithë ata persona qe kontrollojnë, mbikqyrin, mbeshtesin dhe ofrojnë perkrahe për punëtorët dhe punët qe behen në pjesen bazë të ndermarrjes.
3. Kulmi strategjik- ne perberje te se ciles zënë vend menaxher senior të ndermarrjes të cilet fokusohen në ambjentin e jashtem, sendertimin strategji, vendosjen e objektivave, percaktimin e misionit dhe vizionit, si dhe projektimin organizativ të ndermarrjes.
4. Struktura teorike – perfshin specialist , analistet, inxhinjeret etj.
5. Personeli ndihms – mbeshtesin dhe ndihmojnë punen e të tjerëve, sekretaret, juristet, kshilltaret .

## **KONKLuzion**


Struktura organizative e qarkullimit të informatave është mënyra në të cilën grupet e ndërlidhura të një organizate krijojnë raporte-komunikim në mes veti. Nga këndvështrimi menaxherial, çështjet kryesore janë sigurimi i komunikimit të mirëfilltë dhe koordinimi.

Menaxheri i resurseve humane mund ta inkurajojë organizatën që të ketë strategjinë e cila kujdeset për efikasitetin dhe përkushtimin e të punësuarëve. Punëtorët mund të specializohen në degë të veçanta të biznesit siç është prodhimi apo marketingu dhe ti ndjekin shtigjet e definuara mirë të karrierës.

Administrata Tatimore e Kosovës, graviton në tërë territorin e Kosovës, gjegjësisht në regionet e Kosovës. Ajo është e organizuar në :

1.Nivelin Qendror – Drejtoria

2.Nivelin Regional – Zyret Regjionale



*Figura 1. Struktura organizative e ATK-së<sup>15</sup>*

## Referenca:

1. Administrata Tatimore e Kosovës, Ligji 03 / L – 071. Më shumë në ëeb: [www.atk-ks.org](http://www.atk-ks.org) Prof.Dr. Muhamet Sadiku, "Hyrje në Makroekonomi", Pejë 2007, fq. 27.
2. Baki Koleci, Fetah Reçica, Neritan Kurteshi, "Menaxhment (Bazat e menaxhimit)", Prishtinë 2008, fq.80 .
3. [http://www.atk-ks.org/ëp-content/uploads/2010/10/Plani\\_Strategjik\\_materiali\\_Fundit\\_Shqip.pdf](http://www.atk-ks.org/ëp-content/uploads/2010/10/Plani_Strategjik_materiali_Fundit_Shqip.pdf),
4. Prof.Dr.Berim Ramosaj, Bazat e Menaxhimit, Universiteti I Prishtinës, faqe 140, Prishtinë tetor 2007 .

<sup>15</sup> [http://www.atk-ks.org/ëp-content/uploads/2010/10/Plani\\_Strategjik\\_materiali\\_Fundit\\_Shqip.pdf](http://www.atk-ks.org/ëp-content/uploads/2010/10/Plani_Strategjik_materiali_Fundit_Shqip.pdf), faqe 19

5. Prof.Dr.Musa Limani, Politika ekonomike, Universiteti i Prishtinës, faqe 260, Prishtinë 1994.
6. Prof.Dr.Shyqyri Llaci, Menaxhimi, Alb Paper faqe 195, Tiranë 2002.
7. Prof.Dr.Shyqyri Llaci, Menaxhimi, Alb Paper faqe 195, Tiranë 2002.
8. Rregullorja e TVSH-së nr.2000/11 të datës 3 Maj 2001.
9. Rregullorja e UNMIK-ut nr.2000/20 mbi Organizimin dhe Procedurat e Administratës Tatimore.
10. Udhëzimi Administrativ Nr.1/2000.

**E-BANKING DHE SHËRBIMET BANKARE ONLINE NË SHPARKASE BANK  
MAQEDONI AD SHKUP (EKSPozITURA – GOSTIVAR)**

**Naxhije XHEMAILI**

International University of Struga – Gostivar

n.xhemaili12gv@eust.edu.mk

**Abstrakt**

Veprimtaria e bankave është revolucionarizuar me aplikimin e Internetit. Një nga shërbimet e e-biznesit që po përparon më së shpejti është e-banking ose shërbimet bankare online. E-banking është pjesë ose model i e-biznesit, që ka për qëllim kryesor ofrimin e shërbimeve, dhe atë shërbimeve financiare-bankare, por nuk kufizohet me kaq. Pjesën e parë të këtij punimi shkencor e fillojmë me definimin dhe zhvillimin e e-banking. Pastaj do të sqarojmë për llojet apo modelet e e-banking, përparësitë e secilit model dhe çështjet e sigurisë.

Gjithashtu do të paraqesim ndikimin e internetit në shërbimet bankare dhe faktorët kryesorë të tregut që mund të përcaktojnë strategjinë e bankës për online banking. Do të diskutojmë për shërbimet bankare online, të cilat ofrohen nga bankat të bazuara vetëm në Internet dhe bankat të cilat ofrojnë njëkohësisht shërbime nga lokacionet fizike si dhe nga Interneti. Pastaj do të numërojmë dhe sqarojmë përparësitë e online bankig, llojet e shërbimeve online, paketë produktet për korporata dhe produktet apo shërbimet me pakicë për konsumatorët.

Pjesa e dytë e punimit përmban pjesën hulumtuese në të cilën do të paraqesim shërbimet financiare online që ofron Shparkase Bank AD Shkup (Ekspozitura – Gostivar). Do të

diskutojmë për paketat e produkteve (shërbimeve online) që ofron Shparkase Bank për personat juridik dhe për produktet apo shërbimet me pakicë që ofron për persona fizik,

Ndërsa në pjesën e fundit do të japim konkluzionet dhe rekomandimet.

**Fjalët kyçe:** *E-banking, shërbimet online, klientët, pagesat.*

## **HYRJE**

Me aplikimin e Internetit veprimtaria e bankave është revolucionarizuar. Një nga shërbimet e e-biznesit që po përparon më së shpejti është e-banking ose shërbimet bankare online.

Duke parë se online banking e kanë implementuar edhe bankat komerciale në Republikën e Maqedonisë, kjo më shtyu që të hulumtoj se çfarë lloje të shërbimeve online ofrojnë këto banka për klientët e tyre. Prandaj në rastin konkret do të sqarojmë se cilat janë ato paketa të produkteve (shërbimeve) nga interneti që ofron Shparkase Bank Maqedoni AD Shkup

( Ekspozitura - Gostivar ) për personat fizik dhe juridik, dhe cilat janë përfitimet e saja me implementimin i këtij modeli.

Mirëpo në këtë punim përkrah pjesës hulumtuese (praktike) kemi edhe pjesën teorike në të cilën do të paraqesim definimin dhe zhvillimin e online banking, llojet dhe përparësit e e-banking. Gjithashtu do të sqarojmë ndikimin e internetit në shërbimet bankare dhe faktorët kryesorë të tregut që mund të përcaktojnë strategjinë e bankës për online banking. Pastaj do të diskutojmë për shërbimet financiare online të cilat ofrohen nga bankat e bazuara vetëm në internet dhe nga bankat të cilat të cilat ofrojnë njëkohësisht shërbime nga lokacionet fizike si dhe nga Interneti.

Ndërsa në pjesën e fundit të këtij punimi shkencorë do të japim konkluzione dhe rekomandimet tona për Shparkase Bank.

## **E-BANKING**

Online banking (ose e-banking ose Internet banking) - është termi që ju mundëson konsumatorëve të bankave të shiqojnë llogaritë bankare, të informohen mbi shërbimet bankare dhe të realizojnë transaksione financiare në web faqe të sigurta të krijuara nga bankat ose institucionet tjera financiare.<sup>1</sup>

### **1.1.Zhvillimi i E-banking**

Shërbimet e bankave online filluan në New York në vitin 1981, kur katër bankat më të mëdha të qytetit (Citibank, Chase Manhattan, Chemical and Manufacturers Hanover) ofruan shërbimet bankara në shtëpi duke përdorur sistemin e quajtur videotext.

Në Maj të vitit 1995, Wells Fargo u bë banka e parë në botë (sipas Online Banking Report) që filloi ti ofrojë konsumatorëve qasje në llogaritë e tyre me anë të Internetit. Ky sistem i hershëm i Online Banking i mundësonte konsumatorëve vetëm të shihnin, jo të vepronin në llogaritë e tyre.

Security First Network Bank krijoi faqen e parë të Internetit me mundësi të veprimit në llogari të quajtura edhe si faqe të plota të transaksioneve më 18 Tetor të vitit 1995. Këto faqe e kanë kuptimin që konsumatorët mund ti qaseshin llogarive të tyre, dhe të vepronin me paratë në formë të transaksioneve elektronike. Kjo është konsideruar edhe si banka e parë me prani të plotë në Internet.<sup>2</sup>

### **1.2.Llojet e Online Banking**

Aktualisht ekzistojnë tri lloje të Online banking produkteve të implementuara në treg:

*Lloji informativ* – Ky është lloji themelor i Internet banking. Në esencë, banka ofron informata marketingu, informata dhe reklamime në lidhje me produktet dhe shërbimet e saj në kuadër të web faqes. Kjo faqe mund të jetë në një server i cili nuk është i lidhur me rrjetin e brendshëm të bankës. Nuk ka ndonjë interaksion në mes të web faqes dhe konsumatorëve. Rreziku nga problemet e sigurisë për implementimi e këtij modeli është i vogël.

---

<sup>1</sup> Ilir Doçi, E – BIZNESI, Prishtinë 2009, fq.83

<sup>2</sup> Ilir Doçi, E – BIZNESI, Prishtinë 2009, fq.84

*Komunikativ* – Ky lloj i Internet banking sistemeve mundëson një nivel të caktuar të interaksionit në mes të sistemeve të bankës dhe konsumatorëve. Interaksioni mund të jetë i limituar vetëm në e-mail, informata për llogarinë, aplikime për huamarrje si dhe ndryshimin e informatave statike (emri, adresa, etj.). Për shkak se web faqja është e lidhur me rrjetin e brendshëm të bankës, problemet e sigurisë janë më të mëdha. Kontrolla të shumta duhet të aplikohen në mënyrë që të evitohet mundësia e penetrimit të paautorizuar në rrjetin e brendshëm të bankës dhe në sistemet kompjuterike. Implementimi i mbrotjes nga virusët dhe nga softverët e dëmshëm duhet të jetë e domosdoshme.

*Transaksional* – Ky nivel i Internet banking i mundëson konsumatorëve të realizojnë të gjitha proceset si në modelin komunikativ por edhe të realizojnë transaksione. Transaksionet e konsumatorëve mund të pëfshijnë realizimin e pagesave, transferimin e fondeve, etj. Kontrolla e sistemit duhet të jetë shumë e avancuar dhe nën përkujdesje të vazhdueshme.<sup>3</sup>

### **1.3.Përcaktimi i strategjisë së E-banking**

Shumë faktorë kanë ndikuar në motivimin e bankave për të evaluuar teknologjinë e tyre dhe të rikapitulojnë strategjitë e tyre të e-commerce dhe e-banking. Ndër faktorët ndikues mund të përmendim:

*Konkurenca* – Studimet tregojnë që presioni i konkurrencës është forca kryesore shtytëse për implementimin e teknologjive të e-banking, e cila po i len prapa edhe faktorët tjerë ndikues siq janë reduktimi i kostove dhe rritja e përfitimeve. Bankat e shohin e-banking si mënyrë për mbajtjen e konsumatorëve ekzistues dhe tërheqjen e konsumatorëve të rinjë.

*Kostoja më e ulët* – Bankat mund të ofrojnë shërbime në Internet me kosto të transaksioneve shumë më të ulët sesa shërbimet që ofrohen në lokacionet fizike. Sipas studimeve, kostoja për të ofruar një shërbim manual në filijalat e bankave i kushton bankave më shumë se 1 €, transaksionet me ATM dhe me qendrën e thirrjeve rreth 25 cent, ndërsa transaksionet me Internet rreth 1 cent.

*Zgjerimi i lehtë gjeografik* – E-banking i mundëson konsumatorëve kontaktin edhe nga pjesë të largëta gjeografike duke u ofruar kanale të kontaktit me kosto të ulët. Në fakt, disa

---

<sup>3</sup> Të dhëna nga internet: <https://www.slideshare.net/Menaxherat/e-biznesi-ligjerata-kap-6-9>

banka po e realizojnë aktivitetin e tyre ekskluzivisht në Internet – ata nuk kanë zyre tradicionale të bankave dhe kontaktojnë me konsumatorët vetëm në mënyrë elektronike.

*Branding (krijimi i elementëve-faktorëve unik dhe identifikues)* – Ndërtimi i relacioneve me konsumatorët është prioritet strategjik për bankat. E-banking teknologjitë i mundësojnë bankava zhvillimin dhe mbajtjen e raporteve me konsumatorët me forimimin e një pakete të gjerë të prodhimeve dhe shërbimeve. Me krijimin e faktorëve identifikues të bankës tentohet të fitohet lojaliteti i konsumatorëve dhe ngritja e biznesit me konsumatorë.

*Struktura e konsumatorëve* – Konsumatorët janë të llojeve të ndryshme dhe me kërkesa të ndryshme. Disa konsumatorë ende e vlerësojnë se shkuarja në filialën e bankës për të kryer punë është mënyra më e mirë. Disa të tjerë e kanë të vështirë të adaptohen me ATM makinat. Të tjerët dijnë shumë pak për Internetin e lëre më për e-banking. Por, një pjesë e konsumatorëve, sidomos ata të gjeneratave të reja, do të pranojnë sfidat e reja të teknologjisë dhe do të pranojnë të punojnë me banka përmes e-banking. Struktura e konsumatorëve të bankave do të vazhdojë të ndryshojë. Sfidë për bankat është që të kuptojnë strukturën e konsumatorëve të tyre dhe të gjejnë mënyrat më të mira për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të tyre.<sup>4</sup>

#### **1.4.Përparësitë e Online Banking**

Ekzistojnë shumë arsye për të pasur qasje në Online banking. Do ti përmendim disa prej tyre:

– Nuk ka nevojë të pritët para sporteleve

Aplikimi i online banking ka evituar nevojën e prezencës fizike para sporteleve të bankave. Qëllimi i Online banking ka qenë që të evitohen këto pritje, që në disa raste mund të jenë të gjata dhe shumë frustruese për konsumatorët. Qasja online me anë të web faqes mundëson që procedurat të kryhen shpejt dhe në mënyrë efikase. Numër i madh i konsumatorëve mund të qasen në të njejtën kohë në llogaritë e tyre.

– Banka nuk është kurrë e mbyllur

Koncepti i Internet banking dhe ATM makinat kanë krijuar konceptin e qasjes 24 orëshe.

<sup>4</sup> Të dhëna nga internet: <https://www.slideshare.net/Menaxherat/e-biznesi-ligjerata-kap-6-9>



Internet banking mund të realizohet në çdo kohë edhe atë pa pasur nevojë të dilet nga lokacioni i qasjes, qoftë ai vend pune apo shtëpi.

– Qasja direkte në llogarinë bankare

Me anë të qasjes direkte në llogarinë bankare mund të shiqohet bilanci i gjendjes, i pagesave dhe i transaksioneve në çdo kohë. Me këtë evitohet shkuarja në bankë për të printuar gjendjen në llogarinë bankare apo ndonjë raport tjetër bankar.

– Qasja në llogarinë bankare nga çdo pjesë e botës

Nëse ekziston një kompjuter (apo edhe një pajisje mobile) dhe mundësia e lidhjes në Internet, atëherë qasja në llogaritë bankare dhe në realizimin e transaksioneve mund të realizohet pa marrë parasysh lokacionin ku ndodhet konsumatori. Mund të paramendohet sa i efektshëm është ky poroces për realizimin e atyre pagesave të cilat deri para Internet banking është dashur të dërgohen me anë të postës

– Qasja në llogarinë bankare edhe në rast të problemeve shëndetësore

Përparësi e madhe është përdorimi i Internet Banking për personat me paaftësi fizike apo ata që kanë probleme shëndetësore dhe nuk mund të shkojnë në bankë. Sidomos kjo vlen për rastin kur kërkohet realizimi i ndonjë transaksioni që ka kufizim kohor.

– Ofrimi i lehtësive në përdorimin e Online banking

Numër i madh i bankave shtyejnë konsumatroët në përdorimin më të shpeshtë të Online banking ashtu që ofrojnë lehtësira dhe shpërblime në rast të realizimit të transaksioneve me anë të Internet banking ose me anë të kartelave monetare. Kjo po realizohet me krijimin e bonuseve, me uljen apo heqjen e tarifave në transaksione, etj.<sup>5</sup>

### **1.5.Shërbimet e E-banking**

Shërbimet kryesore të e-banking në përgjithësi përmbajnë opcionet për shiqimin e llogarive rrjedhëse dhe të kursimit me anë të Internetit si dhe për realizimin e transaksioneve siç janë lëvizja e parave në mes të llogarive rrjedhëse dhe të kursimit dhe anasjelltas,

---

<sup>5</sup> Ilir Doçi, E – BIZNESI, Prishtinë 2009, fq.86-87

realizimi i pagesave të ndryshme, etj.

Në kuptimin e ofertës së produkteve dhe shërbimeve, bankat mund ti ofrojnë paketë produktet për korporata dhe produktet apo shërbimet me pakicë për konsumatorët. Njëkohësisht, produktet dhe shërbimet e ofruara me anë të internetit mund të jenë të njëjta me produktet dhe shërbimet e ofruara me anë të kanaleve tjera të bankës.

Disa shembuj të paketë produkteve për korporata përfshijnë:

- Menagjimi i parave dhe keshit;
- Transferi i parave nga një bankë, person apo institucion në tjetrin;
- Pagesat e fakturave të llojeve të ndryshme;
- Pagesat automatike të llojeve:
  - o Depozitat direkte të listave të rrogave, beneficioneve dhe kthim apo zbritje të taksave.
  - o Pagesat direkte të obligimeve të konsumatorëve, siq janë: këstet e patundshmërive, të kredive, të sigurimeve, etj.
  - o Pagesat B2B (Business-to-business)
  - o E-çeqet
  - o Pagesat E-commerce
  - o Pagesat e TVSH, taksës doganore, akcizave, taksave në të ardhurat personale, etj.

Shembuj të produkteve për konsumatorët përfshijnë:

- f* Raporti i bilansit
- f* Transfer i fondeve
- f* Shkarkim i informatave në lidhje me transaksionet
- f* Pagesa e fakturave dhe obligimeve online

*f* Aplikimi për kredi

*f* Aktivitetin e investimeve

Shërbime tjera me rëndësi që ofrohen nga bankat me anë të e-banking janë:

- Hapja e llogarive bankare direkt nga web faqja;
- Ofrimi i mundësisë për përcjelljen e detajizuar të aktiviteteve në llogaritë bankare, lëvizjes së transfereve, përdorimit të ATM, hyrjeve dhe daljeve në llogaritë bankare, etj., dhe atë sipas periudhave të caktuara kohore;
- Ofertat e marketingut dhe shitblerjes;
- Aplikimi për kartela kreditore;
- Shërbimet online për konsulta financiare dhe të kontabilitetit;
- Ofrimi online i produkteve të sigurimit;
- E-investing;
- Mundësia për tu përshtatur me softverin financiar të cilin e përdorin konsumatorët;
- Shërbimet telefonike 24 orëshe – në kuadër të këtij shërbimi hyn edhe e-mail shërbimi 24 orësh.
- Ofrimi i Internetit – Disa banka janë edhe ISP, të cilat mund tu ofrojnë konsumatorëve të tyre qasje në www. Modeli tjetër më i përhapur është që bankat hyjnë në partneritet me ISP Kompanitë për tu ofruar Internetin konsumatorëve të tyre.
- Informatat në lidhje me filialat dhe zyret e bankës si dhe lokacionin e tyre ;
- Informatat për lokacionin e ATM makinave;

- Ofrimi i çekut online;<sup>6</sup>

## **2. SHËRBIMET BANKARE ONLINE NË SHPARKASE BANK MAQEDONI AD SHKUP (EKSPOZITURA – GOSTIVAR)**

Si një ekspert i vërtetë në fushën e financave, Shparkase Bank Maqedoni AD Shkup ofron një gamë të gjerë të produkteve dhe shërbimeve bankare të dizajnuara për të mbështetur zhvillimin, financimin e personave fizik dhe juridik.

Me një fokus te klientët, 23 vjet traditë dhe përvojë në sektorin bankar, si një anëtare e Steiermarkische Sparkasse që është e vetmja bankë austriake në Maqedoni, Shparkase Bank ka për qëllim:

- ✓ të ofrojë zgjidhje tërheqëse dhe të qëndrueshme për nevojat financiare të klientëve saj;
- ✓ në krijimin e Shparkase Bank si një institucion financiar i besuar dhe i respektuar në Maqedoni;
- ✓ të jetë një partner i fortë për klientët e saj dhe për komunitetet ku veprojnë dhe punojnë.<sup>7</sup>

Shparkase Bank (Ekspozitura – Gostivar ) është bankë e nivelit të dytë e cila ofron shërbime financiare njëkohësisht nga lokacioni fizik dhe nga Interneti.

Sa i përket shërbimeve bankare online Shparkase Bank ofron paketë produktet për korporata (personat juridik) dhe produktet apo shërbimet me pakicë për konsumatorët (personat fizik).

### **2.1. Paketat e produkteve për personat fizik**

<sup>6</sup> Të dhëna nga internet: <https://www.slideshare.net/Menaxherat/e-biznesi-ligjerata-kap-6-9>

<sup>7</sup> Të dhëna nga internet: <https://sparkasse.mk/za-nas.nsp>

Paketat e produkteve (shërbimeve ) për konsumatorët që ofron Shparkase Bank janë dy:

1. IndividualNet
2. IndividualNetPlus

Përmes paketës së parë konsumatori mundet vetëm ta ndjek gjendjen e llogarisë së tij transaksionale në denarë, domethënë, mund ta shqyrtoj gjendjen e kartelës kreditore, hyrjet, daljet, të shqyrtoj gjendjen e depozitave dhe llogarin e kursimeve. Poashtu nëpërmjet kësaj pakete klienti mundet që të shkarkoj informata në lidhje me transaksionet me anë të kartelës kreditore (ekstraktet).

Ndërsa përmes paketës së dytë, IndividualNetPlus, klientët përveç se mund t'i realizojnë të gjitha proceset si në paketin IndividualNet, ato kanë mundësi të realizojnë edhe pagesa

(transaksione) elektronike. Mund të bëjnë pagesa në të gjithë personat fizik (individ) dhe juridik (biznese), pagesa të faturave dhe obligimeve, transferimin e fondeve prej llogarie në llogarie. Sa u përket pagesave që bëjnë personat fizik mund të përmendim, pagesa për rrymën, pagesa për telefon, etj.

Mirëpo për realizimin e pagesave elektronike nëpërmjet IndividualNetPlus klientët duhet të posedojnë S- Token ( 300 den) ose USB Token – VerbaK2 ( 1500 den) të cilin mund ta shfrytëzojnë për me shumë qëllime. Ndërsa për këto shërbime online që u ofron banka personave fizik nuk ua obligon provizionin mujor.<sup>8</sup>

## **2.2.Paketat e produkteve për personat juridik**

Shparkase Bank poashtu ofron dy paketa të produkteve - shërbimeve online për personat juridik (kompanitë):

1. BusinessNet
2. BusinessNetPlus

---

<sup>8</sup> Intervist me personelin e Shparkase Bank ( Ekspozitura – Gostivar )

Përmes paketës së parë, personi juridik (kompania), ku në fakt është pronari apo udhëheqësi i kompanisë, mundet vetëm ta ndjek llogarinë transaksionale në denarë apo në deviza, të shiqoj gjendjen e pagesave të kompanisë, të shkarkoj informata ( ekstrakte) në lidhje me transaksionet nga kartela kreditore e biznesit ( personit juridik).

Ndërsa përmes paketës së dytë, BusinessNetPlus, personi juridik përveç se mund t'i realizoj të gjitha proceset si në paketën e parë, ka mundësi që të realizoj edhe pagesa të llojeve të ndryshme brenda dhe jashtë shtetit,si për shembull pagesa me urdhërpagesa PP30, PP50, PP53, etj.

Për realizimin e pagesave elektronike, personi juridik duhet që të ketë Token ose Verba pro 2 i cili është më i kushtueshëm por nga ana tjetër biznesi mund ta shfrytëzoj edhe për qellime tjera, p.sh. për zgjerim – pjesëmarrja e biznesit nëpër tendera.

Sa i përket provizionit, personat juridik për dallim nga peronat fizik janë të obliguar nga ana e bankës që për shfrytëzimin e paketit BusinessNet të paguajnë provizion mujor prej 100 denar, ndërsa për paketin e dytë janë të obliguar që të paguajnë provizion mujor prej 300 denar.<sup>9</sup>

### **2.3.Përfitimet nga e-banking në Shparkase Bank**

Siç e cekëm edhe më lartë se implementimi i e – banking në veprimatrinë e bankave ka mjaft avantazhe dhe sjellë shumë përfitime, si për bankën që është institucion financiar ashtu edhe për klientët e saj, qofshin ato persona fizik apo persona juridik.

Ndër përfitimet e shumta që ka banka me implementimin e online banking, ne rastin konkret Shparkase Banka mund të veçojmë koston e ulët.

Shparkase Bank mund të ofrojë shërbime në Internet me kosto të transaksioneve shumë më të ulët sesa shërbimet që ofrohen në lokacionet fizike. Për shembull për pagesën e qarkullimit ditorë që bëjnë firmat deri në 10.000 denarë, me fletëpagesa të letrës në lokacionet fizike, bankës i kushton 20 denarë, ndërsa me fletëpagesa elektronike i kushton vetëm 7 denarë. Kurse për pagesën e qarkullimit ditor mbi 10.000 denarë (MKD), me fletëpagesa të

---

<sup>9</sup> Intervist me personelin e Shparkase Bank ( Ekspozitura – Gostivar )

letrës në lokacionet fizike bankës i kushton 30 denarë, ndërsa në mënyrë elektronike i kushton vetëm 11 denarë. <sup>10</sup>

## **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

Nga e gjithë ajo që u tha më lartë mund të vijmë në përfundim se implementimi i online banking me të madhe e ka ndryshuar veprimtarinë e bankave sa që disa banka po e realizojnë aktivitetin e tyre ekskluzivisht në Internet - ata nuk kanë zyre tradicionale dhe kontaktojnë me konsumatorët vetëm në mënyrë elektronike.

Sa i përket Shparkase Bank mundë të konkludojmë se kjo bankë përveç se ofron shërbime financiare në lokacionet fizike, ofron edhe paketa të shërbimeve online për korporata dhe për konsumatorë. Do të thotë se Shparkase me sukses e ka evaluuar teknologjinë dhe ka bërë rikapitullimin e strategjisë së saj të e-banking.

Ndër faktorët të cilët kanë ndikuar në implementimin e online banking në Shparkase Bank Maqedoni ( Ekspozitura – Gostivar ) mund të përmendim konkurrencën, koston e ulët, mirëpo edhe strukturën e konsumatorëve në vendin tonë.

Meqenëse Interneti tashmë veçse e ka ndryshuar mënyrën e realizimit të punëve tona, kjo ka ndikuar që një pjesë e konsumatorëve, e sidomos të gjeneratave të reja që shërbimet e tyre financiare t'i realizojnë në mënyrë online duke pasur parasysh përparësitë të cilat i përmendëm. Prandaj banka në qoftëse dëshiron të mbijetoj në tregë dhe t'i bëjë ballë konkurrencës duhet që shërbimet e saja të u'a përshtat strukturës së konsumatorëve të mjedisit ku e zhvillon veprimtarinë e saj.

Për këtë shkak Shparkase Bank ende ofronë shërbime në lokacionet fizike sepse ne Gostivarë por edhe në qytetet e tjera të Republikës së Maqedonisë ende kemi strukturë të konsumatorëve të cilët dijnë shumë pakë për Internetin e lëre më për e-banking. Disa konsumatorë ende e vlerësojnë se shkuarja në filialën e bankës për të kryer punë është mënyra

---

<sup>10</sup> Burime të shkruara nga Shparkase Bank( Ekspozitura – Gostivar ) – Tarifatat për personat juridik

më e mire. Disa të tjerë e kanë të vështirë të adaptohen me ATM makinat. Prandaj rekomandimet tona për Shparkase Bank janë:

- ✚ Të organizojë kurse trajnimi për klientët e saj për përdorimin e Internet banking;
- ✚ Të bëjë prezente për përdorimin e e-banking nëpër shkollat e mesme, si klient potencial;
- ✚ Të ulë provizionin e shërbimeve online ( për personat juridik )
- ✚ Të u mundësoj konsumatorëve realizimin e transaksioneve online 24/7;
- ✚ Të u mundësoj konsumatorëve shërbimin telefonik 24 orësh. etj..

### **Referenca:**

1. Ilir Doçi, E – BIZNESI, Prishtin 2009;
2. Të dhëna nga interneti: <https://www.slideshare.net/Menaxherat/e-biznesi-ligjerata-kap-6-9>;
3. Të dhëna nga interneti: <https://sparkasse.mk/za-nas.nspX>;
4. Intervist me personelin e Shparkase Bank ( Ekspozitura – Gostivar );
5. Burime të shkruara nga Shparkase Bank ( Ekspozitura – Gostivar ) - Tarifat për personat juridik.



## A STUDY ON THE CHARACTERISTICS OF CONSUMERS ON THE USE OF CREDIT AND CLIENTS CARDS

Elmira KUSHTA<sup>1</sup>,

<sup>1</sup>Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

kushtamira@gmail.com

### Abstrakt

The most common method used to analyze data with responsible variables, is logistic regression. In statistics, logistic regression is a kind of regression analysis, is used to predict the detailed results of a dependent variable based on one or more predictor variables. This article shows how they affect costs and if a customer has credit card in predicting the probability of the customer card use. It indicates that Credit Card Customers are six times more favorable to the customer than not using the card, regardless of costs that will do. In particular, logistical function of averages is linearly related to the explanatory variables then stand in relation to each other and in the same way-at odds and probability. Also it is shown that a customer is more likely to use customer card when costs rise despite have or no credit card.

**Keywords:** *Logistic regression, odds ratio, chances, method (LR).*

### INTRODUCTION

In the logistic regression the goal is the same as in the least squares method for linear regression (KMM). Regression methods have been an integral part of any data analysis related to the description of the link between a response variable and one or more explanatory variables. Already we want to model a dependent variable in the terms of one or more independent variables, i.e. with 2 levels of values e.g. with or without a customer card, etc.; However, linear regression is for continuous dependent variables; Logistic regression is for

categorical dependent variables. Independent variables are often presented as exponents, regressors or predictors, whereas the dependent variables are called explained or regressed variables and being qualitative and assuming 2 values can be encoded at 0 and 1. In the logistic regression after the model fit, the emphasis lies on the importance of the estimated coefficients as well as the interpretation of their values, where the methods for the assessment of adaptation are more of a technical nature.

Unlike the probability that moves to  $[0,1]$ , the probability ratio moves to the interval  $(0; +\infty)$ , while  $\ln(\text{odds})$  moves to the interval  $(-\infty; +\infty)$  but being stationary toward a negative number and Not descending immensely. It is important to note that probability, odds, and  $\log(\ln)$  are three different ways (different mathematical results) but that are the same. Logging is only useful to guarantee mathematical correctness of the analysis. But why are we interested in making probability transformation (odds)?

It is difficult to model a variable that has certain fixed limits, such as the probability case. This transformation is an attempt to avoid the problem of certain boundaries. It causes the probability values to pass from  $[0; 1]$  to the interval  $(-\infty; +\infty)$ . So  $\log(\text{odds})$  is a simpler transformation to work with, as well as to understand and interpret.

Thus, the interpretation involves two issues:

- 1- Determining the functional relationship between the dependent variable and the independent variable
- 2- Defining the change of the unit for the independent variable. This paper deals with the modeling of dependent variables (listed or unlinked) in SPSS.

There are different equivalent logistic regression specifications, which fit into different types of more general models. These different specifications are accepted for specific types of useful generalizations.

Samiti i NATO-s në Bukuresht, në 2-4 Prill të vitit 2008, është realizuar në periudhë jashtëzakonisht dinamike për marrëdhëniet ndërkombëtare, që ishin të ndërlidhura me: Pranimin e pavarësisë së Kosovës, Mbrojtja antiraketë e SHBA-ve në territorin e Polandës dhe Çekisë, që ka shqetësuar dukshëm diplomacinë evropiane dhe ruse, pasiguria e eksportimit të gazit rus drejtë Ukrainës dhe Evropës, kriza ruso-britanike për përzënjen e diplomatëve, mbështetja e Senatit Amerikan dhe administrata e presidentit Bush për zgjerimin e ri të Aleancës nëpërmjet dhënjes të statusit për shtet kandidat të Ukrainës dhe Gruzisë<sup>4</sup>.

Samiti i Bukureshtit ishte Samiti i fundit i Bushit dhe Putinit dhe i pari i Sarkozi-së. Për këtë arsye, sipas Lamfausit, „*Askush nuk ka dashur t'ju prishë kënaqësinë në Samitin e fundit të tyre*“<sup>5</sup>. Megjithatë, Greqia kërcënonte fuqishëm, duke përkrahur Shqipërinë dhe Kroacinë por jo edhe Maqedoninë. Ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, ka theksuar se

<sup>4</sup> НАТО во современите меѓународни односи, Д-р Нано Ружин, ст. 309

<sup>5</sup> НАТО во современите меѓународни односи, Д-р Нано Ружин, ст.311

„Greqia e përkrah kandidaturën e Kroacisë dhe Shqipërisë, kurse lidhur me Republikën së Maqedonisë, për shkak të pozicionit të tyre nacionalist, nuk kemi qëndrim të njëjtë rreth kandidaturës së saj “. Administrata amerikane, në krye me presidenti Bush paraqet një argument të fuqishëm në favor të Republikës së Maqedonisë, por, ashtu si që është shprehur gazetari i „Le Figaro”,<sup>6</sup> „Athina ka arritur ti paraqesë më mirë kontraargumentet”, „Sipas tyre, Maqedonia nuk ka qënë e gatshme për kompromis, edhe pse Javier Solana ka propozuar formulën Maqedonia e Re.”<sup>7</sup>

Dy ditë para fillimit të Samitit, Ish Sekretari Shtetëror për Mbrojtje të SHBA-ve, Donald Rumsfeld, ka inkurajuar tre aspirantët e Kartës të Adriatikut: „Këto tre shtete, në vitet e kaluara janë përgatitur mire për t’ju bashkangjitur Alenacës.....ndoshta gjeografikisht këto tre shtete nuk janë të mëdha, por në aspektin operativ kanë dhënë kontribut në Afganistan dhe Irak kanë treguar aftësitë e tyre më shumë sesa madhësia e tyre, për dallim prej disa shteteve më të mëdha që mbetën jashtë, osë jomjaftueshëm janë angazhuar....“.<sup>8</sup>

Përkundër pritshmërive optimiste për zgjërimin, dita e parë në Samitin e Bukureshtit të 26 shefave të shteteve, ose qeverive ka përfunduar me dështim për tre nga pesë kandidatët.<sup>9</sup>

Dy shtetet që përfituan dhe dolën nga statusi i përcaktuar me Kartën e Adriatikut në favor të antarësimit të barabartë me shtetet e tjera anëtare, ishin Shqipëria dhe Kroacia. Tirana dhe Zagrebi një javë më vonë kishin mundësinë të fillojnë negociatat për antarësim.

Dështimi më i madh i takonte Republikës së Maqedonisë, kanë konstatuar Loren Zakini nga gazeta „Le Monde“ dhe Majkl Evans nga „The Times“: „Greqia nuk ndryshoi qëndrimin. Maqedonia do mund të shpresojë për ftesë pasi të ketë zgjedhur problemin e emrit me Greqinë“.

Me bllokimin e Republikës së Maqedonisë në Samitin e Bukureshtit, më së shumti ka humbur Republika e Maqedonisë, reputacioni i presidentit Bush dhe reputacioni i NATO-s, si dhe politika e tyre për “dyer të hapura”.

<sup>6</sup> Thierry Portes (19.03.2008r.)

<sup>7</sup> The Wall Street Journal -NATO Expansion Should Continue, 28 mars, 2008 .

<sup>8</sup> The Wall Street Journal -NATO Expansion Should Continue, 28 mars ,2008 .

<sup>9</sup> Christoph Lamfalussy, „Deux sur cinq dans l’OTAN, Libre Belgique, 04.04.2008.

Dështimi në Bukuresht paraqiste një sinjal të rrezikshëm për stabilitetin rajonal sipas ministrit të punëve të jashtme të Danimarkës ,Uffe Ellemann-Jensen.<sup>10</sup>

Qëndrime të ngjajshme ka pasur edhe drejtori i Projekteve të reja demokratike nga Qendra për Studime Ndërkombëtare dhe Strategjike në Washington, Janusz Bugajski, i cili në „The Wall Street Journal“ ka deklaruar se:„ *Në mungesë të antarësimin në Alenacë, Republika e Maqedonisë po shëndrohet në një shtet të përkohshëm. Rusia, me siguri do të mundohet të përfitojë nga bashkëpunimi i përforcuar politik, ekonomik dhe të sigurisë me Shkupin, duke u munduar të imponohet si mbrojtëse e Republikës së Maqedonisë nga panalbanizmi në rajon dhe terrorizmi islamik...*”<sup>11</sup>

Humbësi më i madh në Samitin e Bukureshtit pa dyshim ka qënë Republika e Maqedonisë dhe kishte rrezik që të ballafaqohej me një stuhi të fuqishme të natoskepticizmit.

## **2.MAQEDONIA PAS BUKURESHTIT-MË I RËNDËSISHËM EMRI OSE ANTARËSIMI NË NATO?**

Dështimi i Bukureshtit paraqiste një frustrim politik shumë të thellë si për elitën politike ashtu edhe për qytetarët e Maqedonisë dhe hapi një morri procesesh të reja në politikën e brendshme dhe të jashtme të Republikës së Maqedonisë.

Në Planin e brendshëm, qeveria ka zhvilluar një kampanjë për rrënjët antikë të maqedonasve nëpërmejet financimit të spoteve të shtrenjta publicitare të rregjisorëve të afirmuar, u intensifikuan kërkimet arkeologjike në të gjithë territorin e shtetit, me qëllim që të gjenden artefakte të reja nga e kaluara antike.

Në planin e jashtëm, Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka vendosur që në 02.12.2008 të padisë Greqinë nëpërmet Gjykatës ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë.Me këtë veprim, kontesti me emrin kaloi nga një problem diplomatik në një problem juridik.

Maqedonia dërgoi kërkesë në Regjistrin e Gjykatës me qëllim që t'i kërkohet Greqisë t'i respektojë obligimet e veta ligjore të parapara me Marrëveshjen e përkohshme, e cila është juridikisht obliguese për të dy vendet. Gjykata në Hagë solli aktvendim se Greqia ka shkelur nenin 11 të Marrëveshjes së përkohshme duke bllokuar anëtarësimin e Maqedonisë në NATO

<sup>10</sup> NATO meetingsends dangerous signals“ - The Japan Times – 9 prill 2008.

<sup>11</sup> Janusz Bugajski - „Balkan Fix“ - The Wall street journal, 10.04.2008 .

në Samitin e Bukureshtit në vitin 2008. Megjithatë, Greqia sot e kësaj dite nuk e ka ndryshuar qëndrimin e saj. Derisa NATO-ja dhe bashkësia ndërkombëtare bëjnë thirrje për respektimin e së drejtës ndërkombëtare për të zgjidhur mosmarrëveshjet dhe konfliktet e tjera, autoritetet e Maqedonisë vazhdimisht bëjnë thirrje për respektimin e së njëjtës përmes njohjes së aktvendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë se Greqia nuk duhet ta bllokojë anëtarësimin në Aleancë.

Marrëdhëniet bilaterale mes Maqedonisë dhe Greqisë u avancuan në muajt e fundit në ndërtimin e mirëbesimit. Të dy vendet janë duke negociuar për 11 masa konkrete për mirëbesim nga sfera e arsimit, shëndetësisë, punëve të jashtme etj.

Por, a mund të gjendet një zgjidhje juridike për një kontest tipik politik? Sigurisht që është e mundur. Në fakt, aspekti juridik për një kontest politik lidhur me emrin ka qënë një veprim jo i zakonshëm sepse në Komunikatën përfundimtare të Samitit të Bukureshtit, në asnjë pjesë të saj nuk figuron Greqia si autore e vetos maqedonase por Aleanca , gjegjësisht Këshilli Veriatlantik, në format të shefave të shteteve dhe qeverive. Përveç kësaj, edhe pala greke do të paraqesë argumente për shkelje të Marrëveshjes të përkohshme.

Intelektualët, që u afirmuan si të afërt me qeverinë, mbronin tezën se emri është i barabartë me identitetin e Maqedonasit. Në qoftë se Maqedonia e humb emrin, do të humbasë edhe identitetin dhe do të zhduket nga harta e botës. Në mes të tjerash, Republika e Maqedonisë edhe të pranojë ndryshimin e emrit, kërkesat e Greqisë do të shkojnë më tej, duke kërkuar ndryshimin e emrit të gjuhës, popullatës dhe të gjitha emrat që kanë të bëjnë me nocionin Maqedoni<sup>12</sup>.

Kjo teori shkoi më së miri në favor të kundërshtarëve brenda NATO-s të cilët duke shfrytëzuar këtë pengesë hasën në arsyetim të mirëfilltë të veprojnë kundër hyrjes së Republikës së Maqedonisë në NATO.

Të gjitha palët që mbështetën kompromisin dhe ndryshimin e emrit u kategorizuan si tradhëtarë të kauzës shtetërore dhe interesit shtetëror ose shprehjen që Kardinali Rishelieu ka përdorur -*Raison d'etat*. Sipas tij, “*interesi primar i çdo shteti është integriteti dhe sovraniteti territorial si dhe mirëqënja e shtetit dhe popullit, ato kanë përparësi para prioriteteve tjera*”.

---

<sup>12</sup> НАТО во современите меѓународни односи, Д-р Нано Ружин, 318



Nëse merret parasysh kjo logjikë e të menduarit dhe shembulli i Maqedonisë, atëherë është më se e qartë se integriteti dhe sovraniteti territorial si dhe mirëqënja do të sigurohen nëpërmjet anëtarësimit në NATO dhe BE. Në qoftë se ndryshohet emri, nuk mund të humbet identiteti. Vetëm mund të hapet diskutim politik për përgjegjësinë e atij që ka firmosur kompromisin. Megjithatë, mendoj që shumë pak mendohet për përfitimet dhe efektet që do të ketë në të ardhmen antarësimi në NATO dhe BE për popullin.

## KONKLUZION

Identiteti i popullit maqedonas, stabiliteti i Rajonit dhe marrëdhëniet ndërnacionale në vend, veçanërisht ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve, janë ngushtë të lidhura. Kjo lidhje sado që të jetë racionale është edhe emocionale edhe psikologjike. Ajo ka bazë historike, e cila pasqyrohet në frikë dhe mosbesim dhe krijon trauma. Çdo angazhim për zgjidhjen e problemit me emrin do të duhet t'i ketë parasysh këto çështje.

Pozita e Republikës së Maqedonisë për politikën e Rajonit është mjaft delikate. Maqedonia mund të jetë shtytëse e vlerave evropiane në drejtim të lindjes, si dhe në drejtim të përfrimit të vlerave të lindjes kah vlerat perëndimore. Ajo është një barometër i tolerancës ndërmjet bashkësive dhe religjioneve. Prandaj, sfida e ndërtimit të identitetit të veçantë të popullit maqedonas, por edhe ruajtja e marrëdhënieve të mira ndëretnike në shtet, si parakusht për stabilitetin e Rajonit, mund të jetë një shembull i mirë për paradigmen e re. Sipas perceptimit tim, kjo është e mundshme nëse në mënyrë të barabartë përfshihen të tre faktorët dhe garantuesit e stabilitetit: maqedonasit, shqiptarët dhe bashkësia ndërkombëtare. Së këtejmi, secili prej tyre duhet të përgjigjet në pyetjet: Maqedonasit: Çfarë identiteti maqedonas dëshirojnë dhe çfarë shteti dëshirojnë të ndërtojnë viza-vi shqiptarëve? Shqiptarët: Çfarë Maqedonie dhe çfarë identiteti maqedonas janë të gatshëm të mbështesin? Evropa: Çfarë Ballkani dëshiron dhe cila do të ishte pozita e Maqedonisë në Rajon? Pa u përgjigje në këto pyetje dhe pa harmonizimin e këtyre qëndrimeve, vështirë se do të ketë zgjidhje, e cila do të rezultonte me paqe dhe stabilitet të përhershëm në Rajon.

Prandaj, duhet të merret parasysh se problemi me identitetin, stabilitetin e brendshëm dhe rajonal përbëjnë një tërësi dhe duhet të zhvillohet dhe trajtohet si projekt e jo si politikë.

**Referenca:**

1. Janusz Bugajski - „Balkan Fix“ - The Wall street journal, 10.04.2008 ;
2. The Wall Street Journal -NATO Expansion Should Continue, 28 mars 2008 ;
3. Christoph Lamfalussy, „Deux sur cinq dans l’OTAN, Libre Belgique, 04.04.2008;
4. Declaration du Sommet de Riga - Communiqué de Press 2006 - 150/29.11.2006;
5. Stenogrami nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, nr. 07- 1072/5, nga data 18 mars 2001. - Gëzim Ostreni, (2006);
6. Vështrim kritik mbi veprën “Lufta në Maqedoni në vitin 2001” të gjeneralit Mitre Arsovski, Prof. Dr. Stojan Kuzev dhe gjeneralit Prof. Dr. Risto Damjanovski”, Shkup, fq: 12;
7. Florian Bieber, (2008), “Ndarja e pushtetit dhe implementimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit”, Fondacioni “Fridrih Ebert”, Zyra Shkup, fq. 23;
8. Instituti për Studime Politike dhe Interkulturore, Shkup, “Maqedonia – demokratizimi përmes ekualizimit”, 16 dhjetor 2008;
9. K. Balalvovska, M. Zucconi, “Minority Politics in Southeast Europe: Crisis in Macedonia”, Ethnobarometer, 2002;
10. Rizvan Sulejmani, (2007), “Opinionit publik në Republikën e Maqedonisë dhe marrëdhëniet me Bashkimin Evropian dhe NATO-n – me theks të veçantë mbi procesin e decentralizimit” Disertacioni i doktoraturës;
11. Prof. Dr. Vladimir Prulović, Megatrend Universitet, “Savremeni međunarodni odnosi”, Beograd, 2008;
12. Dimitar Mirçev, “The Macedonian Foreign Policy 1991-2006”, AzBuki, Shkup 2006;
13. Gazeta “Borba”, 26 tetor të vitit 1992, Beograd, Kiro Gligorov e promovoi: “Balanca të reja në Ballkan”, që më vonë do të emërtohet politikë e ekuidistancës;
14. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë (03.06.2009) “Propozim – strategji shtetërore për zgjidhjen e dallimeve me Republikën e Greqisë në lidhje me emrin e Republikës së Maqedonisë”, e evidentuar në shërbimet me nr. 2544/1;
15. Rizvan Sulejmani, “Rezoluta e Andovit - cili duhet të jetë pozicioni i shqiptarëve?”, e përditshmja “Koha” e datës 13 qershor të vitit 2009;
16. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë (miratuar më datë 17 26 nëntor të vitit 1991), “Gazeta Zyrtare e RM”-së, nr. 52 nga data 22.11.1991 dhe Amendamenti IV nga data 20 nëntor të vitit 2001;

17. Amendamentet I dhe II të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të cilat i miratoi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në seancën e mbajtur më 6 janar 1992;

18. Sam Vaknin, “Macedonians in Denial about the Name Issue Dispute with Greece”, <http://www.worldsentinel.com/articlesview/105022> - Edward P. Joseph, “How to Solve the Greek Dispute over Macedonia’s Name”, This article has been provided by Internationale Politik - Global Edition as part of a special agreement with SPIEGEL ONLINE;

19. НАТО во современите меѓународни односи, Д-р Нано Ружин, Fondacioni Fridrih Ebert, Shkup, 2010.

## MISIONI I EULEX-IT DHE IMAZHI I TIJ NË KOSOVË

**Phd. Cand. Arbër BEHLULI**

arber\_behluli@live.com

Tel: +37744112388

### Abstrakt

Misioni i EULEX-it është misioni më i madh që Bashkimi Evropian ka ndërmarrë ndonjëherë, përveç madhësisë së stafit pjesëmarrës, ky mision është gjithashtu shumë i kushtueshëm për taksapaguesit evropian.

Puna e Misionit të EULEX-it ka një ndikim të madh në imazhin e Kosovës si sukcesi po ashtu edhe dështimi i këtij misioni. Kemi shumë Raporte negative për Kosovën, në lidhje me luftën kundër korrupsionit, krimet të organizuar po ashtu është themeluar një Gjykatë Special për krimet e kryera gjatë Kohës së luftës dhe një periudh të caktuar pas saj, e gjithë kjo vjen si rezultat nga mos përmbushja e detyrimeve nga ana EULEX-it.

Është detyrë e EULEX-it që të luftoj këto fenomene negative të shoqërisë kosovare, dhe të asistojë në krijimin e një shteti ligjor ku mbizotron sundimi i ligjit.

**Keywords :** *EULEX, Kosovo, Image.*

### HYRJE

“Ora më e errët e natës është pak para agimit”<sup>1</sup> ky citat përshkruan më së miri se si janë ndier qytetarët e Kosovës pak para se EULEX-i të fillonte mandatin e tij. Është

<sup>1</sup> Citat nga #Film #“The Dark Knight”.

shpresuar se qeverisjes të gjatë dhe të zhytur në korrupsion të Unmik-ut do t'i vinte fundi. U shpresua shumë për Misionin e Eulex-it që do të sjellte ndryshimin, ndoshta edhe kjo ishte arsya pse Eulex-i asnjëher nuk mund t'i arrinte pritjet që erdhen bashkë me misionin e tij. Çka do që bëntë Eulex-i nuk mjaftonte. Por çka ka bërë në realitet deri tani Eulex-i që mund ta dalloj atë nga UNMIK-u..?

Pas fillimit të mandatit të këtij misioni u shpresua shumë që në Kosovë do të ndërtoheshin dhe të zbatohen institucione demokratike me standarde evropiane. Deri më tani misioni i EULEX-it ka qenë vetëm një zhgënjim i madh, kapacitetet të mëdha janë investuar në të por deri tani asgjë e mirë s'ka dalë prej tij.

Në një intervistë në Radiotelevizionin e Kosovë, i dërguari special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Martii Ahtisaari u shpreh në lidhje me misionet e huaja se : "Misionet e huaja janë si cigaret, të qetësojnë për një kohë të shkurtër, por ju shpejt do të krijoni varësi ndaj tyre"<sup>2</sup>. Pas një misioni të stër zgjatur dhe "të pasuksesshëm" të UNMIK-ut, misioni i EULEX-it duhet të ishte shumë efikas. Ky mision duhet të sigurote që kosovarët të "ndalonin duhanin" (thënë kushtimisht), që pas Eulex-it të mos ketë më nevoj për ndonjë mision tjetër për ndërtimin e institucioneve demokratike.

EULEX-i menjëherë pas arritjes në Kosovë është parë nga qytetarët e saj si një "kalorës të bardhë" që do të pastronte "kaosin" që UNMIK-u e kishte lënë mrapa. Kjo i tregon pritjet që kosovarët kishin për këtë mision dhe efektshmërin që Eulex-i mund të kishte, gjëja e fundit që Kosova kishte nevoj ishte një tjetër mision si ai i UNMIK-ut. Për këtë edhe Eulex-i duhej të distancohej nga ombrella e Unmik-ut përndryshe do të humbte besimin e qytetarëve në të para se të fillonte punën.

Si misioni më i madh civil nën Politikën e Sigurisë dhe Mbrojtjes Europiane (ESDP), ky misioni i ndihmon autoritetet e Kosovës në fushat e administrimit të drejtësisë, policisë dhe doganave përmes monitorimit, mentorimit dhe udhëzime për të mundësuar ndërtimin e strukturave të këtyre institucioneve. Misioni i EULEX-it ka një rol qëndror në zhvillimin e Kosovës, në të njëjtën kohë, është edhe një provë e besueshmërisë dhe

---

<sup>2</sup> Martii Ahtisarit në një Intervist në RTK/ 2008.

efikasitetit të BE-së dhe PESM-së të saj<sup>3</sup>. Eulex-i është një mision i pavarur, i cili vepron nën politikën evropiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe nuk paraqet një vazhdimësi të angazhimit ekzistues evropian në kuadër të UNMIK-ut por një mision në vete jashtë UNMIK-ut.

Një rezultat i punës së efektshme të EULEX-it në Kosovë do të forcohej roli i Bashkimit Evropian në çështjet ndërkombëtare dhe do të dërgonte një "mesazh" se BE-ja është në gjendje me anë të një misioni civil për krijimin e institucioneve demokratike, rendit dhe sundimit të ligjit edhe jashtë kufijve të saj<sup>4</sup>.

Me misionin e EULEX-it, Bashkimi Evropian ka marrë një përgjegjësi të madhe mbi vete sa i përket të ardhmes së Kosovës, gjithashtu ky mision është i rëndësishëm edhe për vet BE-në. Me gjithë rëndësinë që mund të ketë ky mision për BE-në ai prapë mbetet vetëm një mision jashtë vendit, misioni të tilla mund edhe të dështojnë, por për kosovarët suksesi i këtij misioni është jetësore dhe përmbushja e objektivave të tij.

### **A MUNDET EULEX-I TË JETË NJË HISTORI SUKSESI...?**

Misioni i EULEX-it është bërë një simbol i paaftësisë, i cili i fsheh veprimet korruptive dhe kriminale të elitave politike<sup>5</sup> nga opinioni publik<sup>6</sup>. BE-ja duhet t'a reformojë këtë mision. Të bëjë ndryshime në menaxhmentin e tij dhe t'i jap udhëheqjes së misionit mbështetjen politike të nevojshme për të përmbushur detyrat e tij<sup>7</sup>.

EULEX-it është bërë "nuskë" për Politikën e Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë, BE-ja ka investuar shumë në suksesin e shtetit të Kosovës si në aspektin diplomatik, politike

<sup>3</sup> Džihic, V. /"Eulex-Mission im Kosovo-Eine kritische politikwissenschaftliche Bilanz"/, S. 8/ Möllers/ van Ooyen, *Jahrbuch Öffentliche Sicherheits/ Zweiter Halbband, Sonderdruck, 2010-2011.*

<sup>4</sup> Greiçevci, L., /"EU Actorness in International Affairs: The Case of EULEX Mission in Kosovo"/, Faculty of Political Sciences, Universiteit Gent, Belgium, 2011, S. 297-301.

<sup>5</sup> Der Standard /"Problem in den Köpfen der Regierung"/, Der Standard.at – Interview mit Robert Muharremi, / 21. Mai 2010/, Mund të gjendet në <http://derstandard.at/1271374861224/derStandardat-Interview-Problem-in-den-Koepfen-der-Regierung>

<sup>6</sup> Capussela, A.L., /"Eulex in Kosovo: a shining symbol of incompetence", (9 April 2011). Mund të gjendet në <http://www.theguardian.com/commentisfree/2011/apr/09/eulex-kosovo-eu-mission>.

<sup>7</sup> Capussela, A.L., /"Eulex in Kosovo: a shining symbol of incompetence", (9 April 2011). Abgerufen vom <http://www.theguardian.com/commentisfree/2011/apr/09/eulex-kosovo-eu-mission>.

si edhe financiar. Në vend të ruajtjes së një mision thjesht teknik, misioni i EULEX-it ka qenë vazhdimisht nën ndikimin politik të BE-së dhe Shteteve Anëtare<sup>8</sup>. Fakti që pesë prej shteteve anëtare të saj – siç janë Qipro, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja - nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, e komplikon në mënyrë të pamohueshme ndikimin e BE-së në punën e Eulex-it. Në një mënyrë, EULEX-i duket si një mision inovative, i cili është detyruar të veprojë në rrethana të vështira nga mungesa e një konsensusi brenda Këshillit Evropian.

Ndër kritikak më të ashpra në drejtim të Eulex-it erdhi edhe nga ministri i mbrojtjes të Gjermanisë, i cili u shpreh se policët e Eulex-it në Kosovë "janë në rrugë të gabuar" dhe duhet riorganizuar, dhe u ankua se dështimi për të bërë punën e tyre siç duhet, është një barrë e padrejtë edhe për forcat e NATO-s. De Maiziere u shpreh se "Gjermania nuk është e kënaqur me situatën" dhe se "kështu nuk mund të vazhdohet dhe se ka nevojë për ndryshime"<sup>9</sup>

Futja e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, si dhe zbatimin marrëveshjeve që vijojnë pjesë e këtij dialogu në agjendën EULEX-it, do të komplikojë më shumë punën e këtij misioni. Ky mision ka nevojë për ndryshim dhe për një çasje më serioze sa i përket detyrimeve që ka karshi qytetarëve të Kosovës, dhe jo ngarkimin e tij me detyra të reja që mund të jenë jashtë mundësive të tij për të vepruar.

Në vitet e fundit, misioni i EULEX-it ka arritur një lloj suksesi, ai ka hapur disa hetime ndaj disa politikanëve më prominent të themi, por megjithatë gjyqësori i Kosovës nuk është përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme. Shkaqet kryesore janë klasifikuar si të brendshme - paaftësinë, menaxhimi e dobët dhe jo besnikëri ndaj parimeve të mandatit të vet misionit<sup>10</sup>.

Si ndryshime të mundshme por edhe shumë të nevojshme janë se misioni i ri duhet të jetë më i vogël, por duhet të ruajë rolin e tij ekzekutiv në rastet e ndjeshme të korrupsionit,

<sup>8</sup> Group for Legal and Political Studies, /"Rock and Rule: Dancing with EULEX", (Forum 2015 - KFOS operational project). Mund të gjendet në <http://kfos.org/wp-content/uploads/2013/06/ROCK-AND-RULE-Dancing-with-EULEX-ENG.pdf>.

<sup>9</sup> Reuters/ "Germany says EU Kosovo police force failing, hurting NATO", BRUSSELS Wed Oct 10, 2012. Mund të gjendet në <http://www.reuters.com/article/2012/10/10/us-kosovo-germany-idUSBRE8990QS20121010>.

<sup>10</sup> The Guardian/ "Eulex in Kosovo: a shining symbol of incompetence",/9 April 2011,/. Mund të gjendet në <http://www.theguardian.com/commentisfree/2011/apr/09/eulex-kosovo-eu-mission>.

sidomos në gjyqësor dhe polici. Rastet e ndjeshme duhet të transferohen nga EULEX-i tek gjykatësit vendor, prokurorët dhe zyrtarët e policisë së Kosovës, si dhe duhet të ketë një bashkëpunim me homologët e tyre ndërkombëtarë (personeli i EULEX-it) duhet gjyqtarët vendor t'i detyrojë që të merren me këto raste. EULEX-i duhet të vazhdojë të merret edhe me raste të reja të krimit të organizuar dhe korrupsionit por gjithashtu funksionet e tij ekzekutive duhet të organizohen në panele të përziera me kapacitetet vendore.

### **INEFICIENCA E EULEX-IT DHE IMAZHI I KOSOVËS...!**

Në çdo gazetë, website apo ku do çoftë që kërkon EULEX-in do të hasni në disa përshkrime siç janë EULEX-i, misioni më i madh dhe më i shtrenjtë i Bashkimit Evropian. Gjithashtu do të dalin edhe kritika të pafund drejtuar këtij misioni, siç janë raporte të ndryshme nga institucionet e BE-së, raporti i Gjykatës evropiane të Auditorëve<sup>11</sup> e të gjitha këto krijojnë një imazh negativ për Kosovën<sup>12</sup>.

Të shumtë janë artikujt nëpër gazeta të ndryshme evropiane për dukurit negative që e kanë kapluar shoqërin kosovare siç janë korrupsioni, krimi i organizuar e të gjitha këto vijn si rrjedhojë e mungesës së efikasitetit të EULEX-it. Gjendja ekzistuese është edhe në kundërshtim me vet objektivat e këtij misioni.

Krijimi i një Gjykate Speciale<sup>13</sup> për krimet e luftës në Kosovë, duhet të shihet si një rezultat i drejtpërdrejtë i paaftësisë së misionit të EULEX-it për t'i bërë detyrat e tij. Kjo përgjegjësi ishte një nga funksionet ekzekutive të EULEX-it, për t'u marrë me krimet e luftës, dhe nuk duhej që këtë përgjegjësi t'ja kalojë një gjykatë ndërkombëtare që vet krijimi i saj dëmton rënd imazhin ndërkombëtar të Kosovës.

<sup>11</sup> European Court of Auditors, (Kosovo Special Report 2012, No 18). Marrë nga <http://www.europarl.europa.eu/document/activities/cont/201305/20130506ATT65663/20130506ATT65663EN.pdf>.

<sup>12</sup> Andreas,E./“ Kosovo: Scandal and Social Change, The Consequences of the Marty-Report for Kosovo’s Perception”/ Südosht Europa Mitteilungen/ 02/2011/ Mund të gjendet në [http://www.academia.edu/6351903/Kosovo\\_Skandal\\_und\\_sozialer\\_Wandel\\_Der\\_Marty-Bericht\\_und\\_die\\_Folgen](http://www.academia.edu/6351903/Kosovo_Skandal_und_sozialer_Wandel_Der_Marty-Bericht_und_die_Folgen).

<sup>13</sup> “Kosovo court to be established in The Hague”/ Government of the Netherlands/ Marrë nga <https://www.government.nl/latest/news/2016/01/15/kosovo-court-to-be-established-in-the-hague>.



Për qytetarët e BE-së, parat që derdhen në buxhetin e këtij misioni të kushtueshëm është shumë me rëndësi që të ketë të pakten rezultate konkrete, nga se janë parat e tyre (si taksapagues) që shpenzohen, dhe prapë atyre ju duhet të lexojn artikuj e raporte të ndryshme që dëshmojnë mbi gjendjen e sundimit të ligjit në Kosovë, dhe pa marrë parasysh gjithë atij investimi nuk është arritur që të ketë një zhvillim të qëndrueshëm si ekonomik ashtu edhe krijimi i institucioneve të pavarura nga ndikimi i jashtëm politik.

E gjithë kjo ka pasur ndikim negativ në krijimin e një imazhi negativ të Kosovës dhe kjo është shprehur në punën e anëtarëve të Parlamentit Evropian dhe në këtë mënyrë edhe në vendimet e tyre në lidhje me proceset integruese dhe të ardhmen evropiane të Kosovës, që edhe kanë shkaktuar vonesa në ecurin e këtyre proceseve të Kosovës në rrugën drejt Bashkimit Evropian.

## **KONKLuzion**

Misioni i EULEX-it duhet për shumë arsye të konsiderohet si një nga misionet më të rëndësishme të BE-së. Pjesëmarrja e gjerë e shteteve në mision ku përfshin edhe vendet brenda dhe jashtë BE-së si Zvicra, Norvegjia, Kanadaja, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Turqia, gjithashtu shtete anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, të tilla si Spanja, Sllovakia, Greqia, Qipro dhe Rumania që kanë marrë pjesë në objektivat e misionit, kjo tregon rëndësinë e këtij misioni. Përgjegjësia që BE-ja ka marrë me dërgimin e një misioni kaq të tillë nuk është e rëndësishme vetëm për vet Bashkimin Evropian por e një rëndësie jetike për zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokratik të Kosovës dhe shoqërisë së saj.

Duke u nisur nga investimet e mëdha politike dhe financiare në këtë mision, një dështim i tij do të vë në pyetje kredibilitetin e politikës së Përbashkët të Jashtme të BE-së. Deri më tani, misioni i EULEX-it nuk ka ndonjë të arritur konkrete, çka paraqet një mundësi të humbur për Bashkimin Evropian.

Skandalet e korrupsionit në kuadër të misionit të EULEX-it, akuzat që i janë bërë kanë përkeqësuar edhe më shumë imazhin e misionit.

EULEX-it duhet tani të merret me korrupsionin në radhët e veta tyre dhe të padisë zyrtarët e tij të korruptuar. Atë për të cilën erdhi Eulex-i që ta luftonte në Kosovë, shpejt u bë

problemi i vet Eulex-it brenda zyrtarëve të vet të korruptuar<sup>14</sup>. Ajo çka i duhet tani këtij misioni është një ndryshim thelbësor sidomos sa i përket personelit, në qoft se do të fitoj besueshmërin tek qytetarët e Kosovës dhe t'i qëndroj besnik objektivave të veta.

Edhe pse Eulex-i ka bërë disa reforma në gjyqësor, polici dhe dogana, nevoja për të krijuar një gjykatë të veçantë për krimet e luftës të ndodhura në Kosovë, është një dështim i tij. Edhe pse krijimi i një gjykate të tillë do thotë heqja e një barre të madhe për këtë mision dhe ndoshta tani ai mund të fokusohet në objektivat e tij të tjera.

Megjithatë, është e diskutueshme nëse misioni i EULEX-it e ka besueshmërinë e nevojshme që të vazhdojë punën e tij edhe më tej. Duke pasur parasysh të gjitha dështimet, skandalet dhe akuzat, që kanë ardhur në drejtim të Eulex-it nga ish-punonjësja Maria Bamieh<sup>15</sup>, një shtetase britaneze, mund të themi për EULEX-i që ka pak mundësi për të t'a shohim si një histori suksesi as për shoqërinë në Kosovë, e as për Bashkimin Evropian.

Mbi rëndësin e punës së Eulex-it dhe ndikimin e suksesit apo dështimit të këtij misioni më së miri e shpreh deklarata e Zv.Kryeministrit në Qeverinë e Kosovës z. Hajredin Kuçi, i cili u shpreh kështu : "Unë nuk dua të imagjinojë se si do ishte Kosova pa misionin e EULEX-it"<sup>16</sup>. Këtë deklaratë e bëri Z. Kuçi në një debat mbi rolin e punës së EULEX-it deri në vitin 2013, deklaratë e cila përshkruan shumë mirë rëndësinë e suksesit si dhe pasojat e dështimit të këtij misioni.

<sup>14</sup> "Maria Bamieh: The British lawyer claiming to expose corruption at heart of EU mission to Kosovo."/ Independent/ Thursday 6 November 2014/ Marrë nga <http://www.independent.co.uk/news/world/europe/maria-bamieh-the-british-lawyer-claiming-to-expose-corruption-at-heart-of-eu-mission-to-kosovo-9844893.html>.

<sup>15</sup> "Maria Bamieh: The British lawyer claiming to expose corruption at heart of EU mission to Kosovo."/ Independent/ Thursday 6 November 2014/ abrufbar unter <http://www.independent.co.uk/news/world/europe/maria-bamieh-the-british-lawyer-claiming-to-expose-corruption-at-heart-of-eu-mission-to-kosovo-9844893.html>.

<sup>16</sup> Forum 2015 discussion: ROCK AND RULE: Dancing with EULEX 02.07.2013, të pranishëm ishin edhe B.Bochart (head of the Eulex Mission), SH.Ahmeti (Kryetar i Prishtinës,Vetevendosje), V.Osmani (LDK) H.Kuci (zv. Kryeminister/PDK). Mund të gjendet në <http://kfos.org/forum-2015-discussion-rock-and-rule-dancing-with-eulex/>

Tani ne jemi edhe vet dëshmitarë për pasojat e mos suksesit të këtij misioni, kjo është shumë e dukshme në gjendjen e që mbizotëron sa i përket sundimit të ligjit, korrupsionit, krimi i organizuar dhe ndërhyrjes së politikës në gjyqësor.

### References:

1. Capussela.A.L./ “State-Building in Kosovo: Democracy, Corruption and the EU in the Balkans”/ 2015/S.196.
2. Eulex Programm Report. Mund të gjendet në [http://www.eulex-kosovo.eu/docs/Accountability/2012/EULEX Programme Report 2012-Low Quality.pdf](http://www.eulex-kosovo.eu/docs/Accountability/2012/EULEX_Programme_Report_2012-Low_Quality.pdf)
3. Europäische Union,/ Gemeinsame Aktion 2008/124/GASP des Rates vom 4.2.2008 über die Rechtsstaatlichkeitsmission der Europäischen Union im Kosovo, Bulletin DerEuropäischen Union,1/2, 2008.
4. EUROPÄISCHER RECHNUNGSHOF : Rechtsstaatlichkeitshilfe der Europäischen Union für das Kosovo/Sonderbericht Nr.18, 2012. abrufbar unter [http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/SR12\\_18/SR12\\_18 EN.PDF](http://www.eca.europa.eu/Lists/ECADocuments/SR12_18/SR12_18_EN.PDF).
5. Forum 2015 discussion/: ROCK AND RULE: Dancing with EULEX /02.07.2013/, dabei waren auch B.Bochart (head of the Eulex Mission), SH.Ahmeti (Vetevendosje), V.Osmani (LDK) H.Kuci (Stellvertretender PM /PDK). Mund të gjendet në <http://kfos.org/forum-2015-discussion-rock-and-rule-dancing-with-eulex/>.
6. Ferati,V.,/ “Critical Discourse Analysis (De-) Constructing EULEX Discourse”, /Kosova Center for Security,/ Prishtine,/ September 2012,/S 14.
7. Radio Televizioni i Kosoves/ Martii Ahtisaari Interview / RTK/2008
8. Andreas,E./“ Kosovo: Scandal and Social Change, The Consequences of thMarty-Report for Kosovo’s Perception”/ Südosht Europa Mitteilungen/ 02/2011/ Mund të gjendet në [http://www.academia.edu/6351903/Kosovo Skandal und sozialer Wandel. Der Marty-Bericht und die Folgen](http://www.academia.edu/6351903/Kosovo_Skandal_und_sozialer_Wandel._Der_Marty-Bericht_und_die_Folgen).

9. Cadier, D./"EU Mission in Kosovo (EULEX): Constructing Ambiguity or Constructive Disunity?"/ Johns Hopkins University/n°08/11TransatlanticSecurity Paper N.3/June 2011.
10. Capussela, A.L./ "Why is the EU failing in Kosovo?"/ Europeanvoice.com/22 November 2012. Mund të gjendet në <http://www.europeanvoice.com/CWS/Index.aspx?PageID=208&articleID=75764>.
11. Dzihic, V./ "Eulex-Mission im Kosovo- Eine kritische politikwissenschaftliche Bilanz"/, S. 8/ Möllers/ van Ooyen, *jahrbuch Öffentliche Sicherheits*,/ Zweiter Halbband, Sonderdruck, /2010-2011.
12. Dzihic, V./"Ein Plädoyer für die EU-Erweiterung Warum es zum europäischen Erweiterungsprojekt am Westbalkan keine Alternative gibt"/, Österreichische Institut für Internationale Politik/07.12.2012/S 9.
13. Der Standard /"Problem in den Köpfen der Regierung"/, Der Standard.at – Interview mit Robert Muharremi,/ 21. Mai 2010/, Mund të gjendet në <http://derstandard.at/1271374861224/derStandardat-Interview-Problem-in-den-Koepfen-der-Regierung>.
14. Der Spiegel/ "Im Griff der Kriminalität"/, 45/2012,/(05.11.2012). Mund të gjendet në <http://www.spiegel.de/spiegel/print/d-89470560.html>.
15. Derks, M., und Price, M./ "The EU and Rule of Law Reform in Kosovo" /S.27/ November 2010. Mund të gjendet në [http://www.clingendael.nl/sites/default/files/20110106\\_CRU\\_publication\\_mderks.pdf](http://www.clingendael.nl/sites/default/files/20110106_CRU_publication_mderks.pdf)
16. Group for Political and Judicial Studies/ „EULEX(i)- DREJT NJË STRATEGJIE PËRFUNDIMTARE - Fuqizimi i shtetit të së drejtës përmes integritetit në BE“ / Raport Politikash nga GLPS AND DPC/ nr.5/Aprill 2014/Prishtine.
17. Government of the Netherlands /"Kosovo court to be established in The Hague"// abrufbar unter <https://www.government.nl/latest/news/2016/01/15/kosovo-court-to-be-established-in-the-hague>.
18. Greiçevci, L./ "EU Actorness in International Affairs: The Case of EULEX Mission in Kosovo"/, Faculty of Political Sciences/, Universiteit Gent/, Belgium, / 2011,/ S. 297-301.

19. KIPRED,/ “Making or Breaking the European Future of Kosovo”,/ Policy Recommendations for the EU and Kosovo authorities,/ Paper prepared by a group of Kosovar experts and representatives of Kosovo civil Society ,/2010.
20. Montanaro,L. /The Kosovo statebuilding Conundrum: Addressing Fragility in a Contested State/ FRIDE-European Think Tank for Global Action / October 2009.
21. Muharremi,R.,/ “The European Union Rule of Law Mission in Kosovo (EULEX) from the Perspective of Kosovo Constitutional Law”,/ S. 18,/2010.
22. Richter,S.,/ „Zwischen Kooperation und Konfrontation. Die Eulex-Mission und der Aufbau von Rechtsstaatlichkeit in Kosovo“,/Southeast Europe.Journal of Politics and Society/04/2011/S 449.
23. Rathfelder, E. und Schneider, W.,/„Aktion scharf“ gegen Korruption im Kosovo”,/ Die Presse/17.05.2010/.  
Mund të gjendet në  
<http://diepresse.com/home/politik/aussenpolitik/565782/Aktion-scharf-gegen-Korruption-im-Kosovo?from=suche.intern.portal>.
24. Silander,D., and Janzekovitz, J.,/State – Building and Democracy : Prosperity, Representation and Security in Kosovo/International Studies, Interdisciplinary Political and Cultural Journal/ Vol. 14, No. 1/2012.
25. Tolksdorf,D., /“EU and U.S. cooperation in rule of law assistance in Kosovo”/Transatlantic Post-Doc Fellow for International Relations and Security (TAPIR) /18 - 22 September 2013, Warsaw.
26. The Independent / “Maria Bamieh: The British lawyer claiming to expose corruption at heart of EU mission to Kosovo”, /, Thursday 20 November 2014, Mund të gjendet në  
<http://www.independent.co.uk/news/world/europe/maria-bamieh-the-british-lawyer-claiming-to-expose-corruption-at-heart-of-eu-mission-to-kosovo-9844893.html>.
27. Vogel, T. /”Auditors say eu mission in kosovo ineffective”  
/2012,10/30. /Europeanvoice/  
Mund të gjendet në  
<http://www.europeanvoice.com/article/2012/october/auditors-say-eu-mission-in-kosovo-ineffective/75543.aspx>.
28. Vaicekauskaite,A., /,Verwalten in Modernen Protektoraten II : “Die EULEX-Mission der Europäischen Union im Kosovo”/Deutsche Forschungsgemeinschaft / 2011.

29. Vetëvendosje (2009a): Newsletter of the Movement for Self- Determination,/ No. 134,/ 16.2.2009.
30. Wulf, A./“Eu-mission kommt nicht gegen korruption an”,/ Deutsche Welle/2012, 10 30./ Mund të gjendet në <http://www.dw.de/eu-mission-kommt-nicht-gegen-korruption-an/a-16343636>.

**“ROLI I POLITIKËS SË JASHTME TË REPUBLIKËES SË MAQEDONISË ME  
SHTETET FQINJE”**

**Visar RUSTEMI**

**Rudina KAJA**

**Abstrakt**

Që në fillim duhet theksuar se filozofia për politikë të jashtme bazohet në fuqinë e veprimit praktik, që doemos mbështetet në një kornizë intelektuale, por jo në tërësi e kufizuar nga normat, vlerat dhe burimet ligjore vendore dhe ndërkombëtare. Fushat kryesore të politikës së jashtme të Maqedonisë, duhet veshtruar si një përmbledhje e historisë, sfidave dhe arritjeve të Maqedonisë në sigurimin e njohjeve diplomatike, anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, kultivimin e marrëdhënieve diplomatike dhe partneritetit special me disa shtete, dialogut me shtetet fqinje, si dhe procesin e integritimit në strukturat euro-atlantike.

Në fushën e diplomacisë multilaterale, duhet përkushtuar rëndësisë në anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, si dhe të shqyrtohet kostoja që mund të sjellin ato.

Çfarë kutojme me politikë të fqinjësisë konstruktive, dhe çfare roli luan Maqedonia me politiken e jashtme, në esencë ka të bëjë më qasjen pragmatike të Maqedonisë që ka mbajtur ndaj rajonit, duke fokusuar tërë vëmendjen në ndërtimin e një rendi rajonal gjeopolitik ku secili shtet të ofroj marrëdhënie reciproke diplomatike, që problemet bilaterale të zgjidhen përmes dialogut paqësor, të ketë pjesëmarrje të barabartë në organizata rajonale, si dhe të ofrohet solidaritet dhe përkrahje e ndërsjellët në integrimin euro-atlantik. Në trekëndëshin e parë është përfshirë partneriteti strategjik me Shqipërinë, marrëdhëniet e shkëlqyera me të, si dhe raportet e mira me shtetin e Kosovës. Duke i'u ikur polemikave se përfrimi i Kosovës

me Shqipërinë është indicie e një bashkimi kombëtar, bashkëpunimi strategjik me Shqipërinë është bërë në frymën evropiane dhe sipas praktikave rajonale. Në trekëndëshin e dytë kemi Kroacinë, Sërbine, Bullgarinë, Greqinë.

**Fjale kyçe :** *Partneritet strategjik, marrëdhëni diplomatike, procesi i integritetit.*

## HYRJE

*Intelektualet analizojnë veprimet e sistemeve ndërkombëtare, shtetarët i ndërtojnë ato. Dhe ka një ndryshim të madh midis prespektivës së një analisti dhe asaj të një shtetari. Analisti mund të zgjedh problemin që ai e dëshiron për të studiuar, kurse shtetarit problemet i imponohen. Analisti mund të caktojë aq kohë sa është e nevojshme për të arritur në një konkluzion të qartë, sfida më e madhe për një shtetar është presioni kohës.<sup>1</sup>*

**Henry Kissinger**

Ndërlidhshmëria e madhe e marrëdhënieve ndërmjet kombeve dhe shteteve të cilat janë njeherësh politike, ekonomike dhe kulturore, përbën një rebus magjepsës i cili të fton ta zbulosh. Ai përmban histori njerëzore në të cilat janë zhvilluar ngjarje të mëdha: luftë e paqe, tragjedi e triumf, konflikt dhe bashkim ndërmjet grupeve të ndryshme njerëzore. Në jetën tonë të përditshme marrëdhëniet ndërkombëtare janë të pranishme si kurrë më parë .

Për ta kuptuar dhe për ta shpjeguar arsyen pse njerëzit – të ndarë nga kufij politikë – përpiqen të veprojnë edhe të ndikojnë në mënyrë reciproke në marrëdhëniet mes tyre, dhe në ç'mënyrë veprojnë në këto marrëdhënie, një rëndësi krejt të veçantë mer historia e marrëdhënieve ndërkombëtare.<sup>2</sup> Kjo fushë e shkencave historike në të shumtën e rasteve ka qënë ndryshuar nga fqinjë më të fuqishëm dhe më ambicioz. Ndërmarrja e studimeve historike në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare ka dy objektiva të ndryshëm. Nga njëra anë, meqenëse historia është një përpjekje për ta rindërtuar dhe për ta shpjeguar veprimtarinë

<sup>1</sup> Kissinger, Henri, "Diplomacia", "B.K". Tiranë, 1999, fq 21.

<sup>2</sup> Nathanali, Petrit, " Marrëdhëniet ndërkombëtare nga origjina – deri më sot ", "FILARA", Tiranë, 2009, fq 85.



njerëzore në të kaluarën, ka rëndësi të dallohen ato aktivitete me natyrë politike, ekonomike, kulturore, shoqërore, ideologjike, etnike që u përkasin marrëdhënieve midis shteteve.

Tashmë vendet e Ballkanit ku ben pjese Republika e Maqedonisë, kanë synime të sinqerta, përkatësinë evropiane për të bërë të mundur normalizimin tërësor të sistemit ekonomik-shoqëror dhe arritjen e standarteve të vendeve Evropiane. Evropa është bërë parësore për interesat kombëtare të shteteve Ballkanike. Prandaj duhet ta vështrojmë Ballkanin me sytë e së nesërme ku ai po shkon.

Njëra nga shoqëritë politike (shtetet) që po i përjetuan këto dinamika është edhe RM-ja. Duke përjetuar akoma pasojat e periudhës së tranzicionit, domethënë atë të kalimit nga sistemi politik dhe ekonomik jo i qëlluar në sistemin e tregut që bazohet në vlerat qytetërore si pluralizmi, shoqëria e hapur etj<sup>3</sup>, kjo periudhë me vete solli edhe shumë çështje që presin zgjidhje. Prej cilësive të proceseve të transformimit janë ngjarjet që sjellin konfrontime e përleshje të rënda e katastrofike etnike. Shembull më konkret lidhur me këtë kemi në luftën qytetare ne 2001. Këto procese përshkoheshin nga fleksibiliteti, emocionaliteti, subjektivizmi, spiritualiteti, frustracionet dhe orgjitë, shpërthimet dhe mosrehatitë.<sup>4</sup>

## **1. OBJEKTIVAT E POLITIKËS SË JASHTME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Dinamika e zhvillimeve politike ndërkombëtare është shumë intensive. Pjesëmarrësit e politikës së jashtme duhet të jenë në gjendje t'u përshtaten shpejt këtyre zhvillimeve. Politika e jashtme e Republikës së Maqedonisë duhet ti shërbejë realizimit të aspiratave të popullit të Maqedonise për ta bërë Maqedonine anëtare të respektuar të familjes së shteteve të pavarura dhe demokratike.

Republika e Maqedonisë duhet te synoj që, në arenën ndërkombëtare, t'i kontribuojë ndërtimit dhe forcimit të një rendi ndërkombëtar, të bazuar në marrëdhënie miqësore në mes

<sup>3</sup> Nikola Kqusev, *Republika Makedonija vo period na tranzicija*, Matica Makedonska, Shkup, 1995, f. 215.

<sup>4</sup> Sejfedin Sulejmani, *Za tranzicijata*, Elnat, Kumanovë, 1994, f. 49. Gjithashtu shih: *Economics and Politics of Transition*, Zagreb, 1993

të popujve e shteteve, respektim të vlerave të lirisë dhe dinjitetit njerëzor dhe parimeve të demokracisë. Dinamika e zhvillimeve politike ndërkombëtare është shumë intensive. Pjesëmarrësit e politikës së jashtme duhet të jenë në gjendje t'u përshtaten shpejt këtyre zhvillimeve. Republika e Maqedonise, si një pjesëmarrës relativisht i ri në skenën politike globale, nuk mund të veprojë e vetme në të gjitha sfidat ndërkombëtare dhe të luajë rol vendimtar në të gjitha çështjet që dominojnë agjendat e politikës ndërkombëtare.

Republika e Maqedonise duhet të synon një politikë të jashtme aktive, e cila duhet të jetë në përputhje me synimet e popullit të Maqedonise për integritet euro-atlantike, ruajtjen dhe forcimin e lidhjeve me vendet mike, thellimin e marrëdhënieve të mira me vendet e rajonit, si dhe arritjen e statusit të një partneri të besueshëm në luftën kundër kërcënimeve të sigurisë ndërkombëtare. Në formulimin e qëndrimeve dhe veprimeve politike lidhur me çështjet e tjera të politikës globale (që nuk prekin drejtpërdrejt Maqedoninë), politika e jashtme e RM-së ndërtohet mbi frymën e aspiratave dhe vlerave euro-atlantike. Prandaj, është e domosdoshme të identifikohen çështjet prioritare dhe të ndërtohet një strategji e veprimit sa i përket çështjeve të tjera të politikës globale, dhe si të tilla ne do të veçojmë disa nga prioritetet primare siç janë: Inegrimi Euro-Atlantik, Zgjedhja e kontestit të Emrit si dhe Promovimi i interesave ekonomike të RM:

- a) **Integritet euro-atlantike** - Inegrimi në strukturat euro-atlantike duhet të jetë një ndër aspiratat kryesore të shoqërisë në shtetin e Maqedonisë. Rrjedhimisht, anëtarësimi në organizatat kryesore euro-atlantike përbën një prej objektivave kryesore të politikës së jashtme të Republikës së Maqedonisë. Këtu veçohet anëtarësimi në: Bashkimin Europian dhe NATO. Politika e jashtme e Maqedonisë duhet të luajë rol qenësor në lehtësimin e komunikimit dhe të bashkëpunimit në mes të strukturave euro-atlantike, në radhë të parë BE-së, NATO-s dhe Maqedonisë. Meqenëse integrimi në BE dhe NATO është synim parësor, intensifikimi i nivelit të bashkëpunimit dypalësh me shtetet anëtare të BE-së dhe NATO-s, sidomos me shtetet prijëse, duhet të jetë një ndër prioritetet kryesore të politikës së jashtme të Maqedonisë.
- b) **Zgjedhja e kontestit të Emrit**- Maqedonia e ka të patjetërsueshëm që në afat sa më të shkurt dhe me përkushtim të gjejë një zgjidhje me Greqinë rreth kontestit të emrit, i cili kompromis do të zgjidhte përfundimisht mosmarrveshjet mes dy shteteve.

Kompromisi do të arrihej vetëm nëse që të dy palët do të tërhiqeshin nga pozicionet e tyre. Maqedonia disa herë ka ndryshuar qëndrimin e saj, që ndikon dukshëm negativisht në pozicionin e saj negociues. Kontesti i emrit kërkon një zgjidhje të shpejt me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar, që do ti ndihmonte Maqedonin në procesin e integritimit në strukturat euro-atlantike, së bashku me vendet e Ballkanit Perëndimor. Paralajërimet e fundit tregojnë qartë, se Maqedonia po e humbë pozicionin e saj përball BE-së edhe pse e para vendosi marrëdhëniet me BE-në në krahasim me Kroacine dhe Shqipërinë, vende të cilat tani më janë anetare të plota të NATO-s.

- c) **Promovimi i interesave ekonomike të Republikës së Maqedonisë** - Zhvillimi ekonomik është një faktor themelor që ndikon në pozicionin ndërkombëtar të shtetit të Maqedonisë. Prandaj, një komponentë e rëndësishme e politikës së jashtme të Republikës së Maqedonisë është promovimi i interesave ekonomike të Maqedonisë në botë. Politika e jashtme e Maqedonisë duhet që ti shërbejë si një instrument për lehtësimin e bashkëpunimit ekonomik me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë, si dhe tërheqjen e investimeve të jashtme në Republikën e Maqedonisë, duke u bazuar në parimet e ekonomisë së tregut dhe të konkurrencës së lirë.

## **2. POLITIKA DHE BASHKËPUNIMI RAJONAL-SHANS PËR STABILITETIN E RAJONIT**

Sa i përket integritimit dhe bashkëpunimit rajonal ende shtrihen përpara disa sfida të qenësishme për RM-ne : akoma kemi një sistem të brendshëm politik dhe social të dominuar nga konflikte të pafund. Kështu, e njëjta pyetje për integrimin rajonal duket me vend edhe në këtë këndvështrim: A mundet një vend të vazhdojë me sukses në rrugën e integritimit, qoftë ky integrim rajonal apo integrim në Bashkimin Evropian pa shëruar njëherë çarjet e veta të brendshme e të thella? Si mundet një entitet më i vogël të integrohet në një më të madh kur ai vetë është ende i shpërbërë? Parë nga këndvështrimi i entitetit më të madh, mund të ekzistojë një hezitim i fortë ndaj importimit të problemeve të mundshme.

Pikësëpari, niveli i lartë i konfliktit politik e pengon zhvillimin dhe progresin e shëndoshë të një shoqërie duke thithur energjinë e kufizuar njerëzore për çështje kryesisht joproduktive. Së dyti, jo vetëm shkojnë dëm koha dhe burimet e kufizuara njerëzore për punë jokrijuese, por e gjithë shoqëria mbahet peng nga një atmosferë e vazhdueshme konflikti, duke tërhequr shumicën e vëmendjes. Cila mund të jetë zgjidhja? Çfarë mund ta ndërpresë rrethin vicioz të krijimit të konflikteve të njëpasnjëshme? Së pari, nëse shoqëritë dhe shtetet që preken nga ky fenomen dëshirojnë ta këpusin zinxhirin e pafund të konflikteve, ato duhet ta bëjnë këtë me bindjen dhe vullnetin e tyre të brendshëm. Të huajt mund të ndihmojnë, por nuk mund ta marrin kurrë përsipër përgjegjësinë e një përpjekjeje të tillë. Nëse një proces i tillë udhëhiqet nga institucione apo persona të jashtëm, ai mund të funksionojë për ca kohë, por rrezikon të jetë i paqëndrueshëm.

Për prosperitetin dhe stabilitetin e mëtejshëm të rajonit Maqedoninë, integrimi në strukturat euroatlantike është alternativë e pazëvendësueshme. Bashkëpunimi nuk mund të kufizohet vetëm në marrëdhëniet dypalëshe. Ato përbëhen nga dimensionin shumë i rëndësishëm rajonal. Fakti që vendet tona janë të orientuara qartë dhe në mënyrë të vendosur e të përkushtura drejt qëllimeve të përbashkëta që prekin politiken e jashtme, i pasuron marrëdhëniet dhe dimensionin e rëndësishëm integruar dhe plotëson kuadrin e gjërë të këtij bashkëpunimi.

Maqedoninë dhe Shqipërinë i lidhin shumë çështje siç është historia, gjeografia, sfidat e përbashkëta në pjesën e reformave dhe transformimit shoqëror. Segment kryesor në marrëdhëniet ndërmjet Maqedonisë dhe Shqipërisë duhet të jetë bashkëpunimi ekonomik, i cili nuk korrespondon me nivelin e marrëdhënieve politike midis dy vendeve. Maqedonia dhe Shqipëria kanë edhe nevojën për përkrahjen e ndërsjellë në planin e integritit në organizatat ndërkombetare.

Tani më qytetarët e Maqedonisë dhe Shqipërisë lëvizin të gjithë të lirë në një kohë sa më të afërt, sepse çdo ditë keto vendet po japin sinjale shumë të forta të komunikimit, të bashkëpunimit dhe të një qetësie rajonale. Sigurisht që ky fakt gëzon qytetarët e dy vendeve për lëvizjen e lirë të fqinjëve qoftë edhe të popullit serb, atë të kosoves, bullgar, grek etj.. Hapësirën e lirisë duhet ta shijojnë të gjithë.

Marrëdhëniet midis Maqedonisë dhe Shqipërisë janë dëshmi e bashkëpunimit dhe fqinjësisë shumë të mirë. Dy vendet kanë një bilanc pozitiv të bashkëpunimit në të gjitha fushat, si ato politike, ekonomike, social-kulturore, në fushën e sigurisë dhe luftën kundër trafikëve, në fushën ushtarake dhe të reformave integruese. Për më tepër, te dy vendet fqinje kanë luajtur dhe po luajnë një rol të rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajonin tonë.

Duke lënë anash për një moment bilancin protokollar të vizitave në nivele politike, marrëveshjet e nënshkruara dhe bilancin e shkëmbimeve tregtare e kulturore, mund të themi se në themel të këtij bashkëpunimi qëndron vizioni i përbashkët për të ardhmen euro-atlantike të shtetit të Maqedonisë. Ekziston një vizion, ekzistojnë këto sfida që bashkojnë te dy vendet çdo ditë, çdo javë, çdo muaj dhe në vijimësi për të ecur përpara si dy vende që me modelin e tyre të bashkëpunimit dhe integritit, frymëzojnë gjithë rajonin. Çdo progres në këtë drejtim është pikësëpari në dobi të popujve tanë, në dobi të dy vendeve tona dhe të rajonit në përgjithësi.

Edhe në fushën e turizmit, kulturës, arsimit, shkencës etj, kemi vend për përmirësime dhe ato kanë nisur. Një rëndësi domethënëse ka infrastruktura që lidh dy vendet tona. Në këtë drejtim, mund të përmend ndërtimin e rrjetit të transmetimit të energjisë Elbasan-Shkup, përfundimin e hekurudhës që lidh Shqipërinë me Maqedoninë si dhe ndërtimin e rrugës Tiranë –Dibër (e quajtur Rruga e Arbërit) e cila lidh portin e Durrësit me Shkupin. Rruga e Arbërit do të përfundojë deri në vitin 2018 dhe ajo do të shumëfishojë bashkëpunimin ekonomik e tregtar midis Maqedonisë e Shqipërisë si dhe do të afrojë portet tona me Maqedoninë dhe Bullgarinë jugore.

## **KONKLUZION**

Objekt bosht i studimit është kuadri institucional, politik e juridik, vendor e ndërkombëtar i angazhuar për zgjidhjen e krizes në Republikën e Maqedonisë, e cila shkaktoi lëkundje të thella diplomatike me përmasa edhe në territoret e shteteve fqinje e më gjërë.

Ka shume arsye për brengosje. Një pjesë e madhe e territorit ,ku dominon popullata shqiptare, ende janë jasht kontrollit të zbatimit të ligjit. Popullata, në përgjithësi, është e lënduar, kurse policia frigohet për sigurinë e vet. Kriminaliteti i organizuar dhe gërmadha e

armëve, veçanërisht në rajonet kufitare të cilat po kontrollohen dobët, sollën deri aty që një pjesë e mirë e vendit të jetë në rrezik. Mosbesimi mes dy bashkësive etnike mbetet real.

Sistemi gjyqësor mbetet i pareformuar dhe jofunksional. Vendi me 2 milion banorë ka rreth 1,2 milion raste të pashqyrtuara. Ky sistem i gjymtë që pëson me të madhe nga ndikimi i ekzekutivit dhe korrupsioni, i shërben interesave të ngushta politike. Bashkësia ndërkombëtare e ka vërejtur këtë problem vonë, vetëm atëherë kur sistemi gjyqësor filloi të kërcënojë përparimin e bërë në fushat tjera. Qeveria ka përpiluar disa amendamente kushtetuese që synojnë të promovojnë pavarësinë e gjyqësorit, përfshirë emërimet e përjetshme dhe nevojën e marrjes së shumicës, dy të tretat e votave në parlament, për t'u emëruar. Por tani duhet edhe të implementojë këto masa dhe të ndërmarrë hapa të menjëhershëm që të përmirësojë kualitetin dhe të shtojë përgjegjësinë duke larguar gjyqtarët e korruptuar dhe të papërgjegjshëm si dhe duke trajnuar ata që janë të kualifikuar dhe të aftë. Institucionet e brendshme të sigurimit të Maqedonisë - Policia dhe Armata - janë të dobëta, në esencë të pareformuara dhe mbështeten në taktika të vjetërsuara të cilat nxisin mosbesim dhe dobësojnë efikasitetin. Organizatat ndërkombëtare me siguri do të kenë bashkëpunim të gjerë me Qeverinë e re, por për shumë programe të sigurimit të cilat i kanë sjellë do të nevojiten muaj të tërë (në disa raste edhe vite) për t'i rumbullaksuar ato. Në ndërkohë, mbetet rreziku nga destabilizimi i Maqedonisë, veçanërisht nga kriminaliteti i organizuar që ka kapluar këtë rajon.

Maqedonia ende mbetet një demokraci e papjekur, e prekshme nga keqdashësit që kërkojnë t'i keqpërdorin reformat e papërsosura. Rruga drejt Evropës do të jetë e sigurt vetëm atëherë kur vendi do të implementojë iniciativat e nevojshme dhe do t'i menaxhojë sfidat politike para se këto të shndërrohen në kriza. Këta janë disa nga hapat e nevojshëm:

- **Gjyqësia.** reformën e gjyqësorit, përfshirë mbajtjen e trajnimeve të veçanta për gjyqtarët që merren me krimet serioze; teknikat e hetimeve në vendin e ngjarjes; një program funksional të mbrojtjes së dëshmitarëve; dhe një gjykatë për krimet serioze. Pasi të jenë miratuar amendamentet kushtetuese, qeveria duhet që menjëherë të lirohet nga gjyqtarët e korruptuar dhe ata të dobët, të themelojë një gjykatë të re administrative për shkeljet më

të lehta të ligjit, dhe të themelojë një akademi të përhershme për gjyqtarët dhe prokurorët e ri.

- **Policia.** Ligji për policinë duhet që të delegojë më tepër, e jo më pak, kompetenca në rajonet policore. Njësisë për Standarde Profesionale duhet t'i shtohen personeli dhe resurset (përfshirë edhe prezencën e BE-së) ashtu që të jetë në gjendje të hetojë korrupsionin dhe keqpërdorimet përbrenda policisë, si dhe të zhvillohet praktika e avancimit në karrierë në bazë të meritave dhe kjo praktikë të zbatohet me shpejtësi në rastin e oficerëve më të dalluar. Gjithashtu, policia duhet të koordinojë më për së afërmi punën e vet me agjencitë tjera qeveritare.
- **BE-Duke** përfituar nga personeli dhe përvoja e misioneve të mëparshme, Brukseli duhet të vejë një mision të ri, me resurse më të mëdha financiare e njerëzore. Raportimi para Përfaqësuesit Special të BE-së (PSBE) duhet të zgjerohet dhe të përfshijë tërë sektorin gjyqësisë, përfshirë punën e gjyqtarëve, prokurorëve dhe të burgjeve. Duhet të dërgojë këshilltarë në Ministrinë e drejtësisë dhe të punëve të brendshme, në Zyrën e prokurorit

Udhëheqësit e Maqedonisë janë të vetëdijshëm për kontributin e nderkombetareve, por edhe për kufizimet e veta sa i përket sigurisë. Ata qartë thonë se nuk duan as varësi të përhershme, as protektorat të fshehur, por ndihmë të zgjatur kohore deri në vendosjen e kontrollit të plotë dhe sundimit të së drejtës dhe rendit nëpër tërë vendin. SHBA-të treguan vullnet për vazhdimin e misionit të NATO-s, edhe pse në terren gjenden pak përfaqësues nga forcat e SHBA-ve. Angazhmani i veçantë i SHBA-ve në terren do të nevojitet vetëm në raste më ekstrem.

Nga aspekti i bashkepunimeve rajonale duhet që dialogu Kosovë-Serbi, si një nga çështjet më të rëndësishme të marrëdhënieve rajonale, duhet të intensifikohet. Njohja e realitetit të Kosovës nga ana e Serbisë është një hap tjetër përpara që nxit më tej bashkëpunim më të ngushtë dhe integrimin rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Shoqëria civile duhet të bashkëpunojë në mënyrë aktive në rajon dhe të jetë një alternativë e fuqishme në mbështetje të nismave rajonale dhe të përqendrohet në mbrojtjen e funksionimit demokratik të institucioneve, në mbrojtje të parimeve të demokracisë liberale. Shoqëria civile e vendeve të rajonit duhet të ketë prioritet të aktivitetit të saj edhe luftën kundër terrorizmit.

Lufta kundër korrupsionit, reduktimi i informalitetit ekonomik, etj, do të zvogëlojë kostot e transaksionit dhe rrisë efikasitetin e investimeve. Krijimi i një modeli rajonal të bashkëpunimit ekonomik, bazuar në modelet e mëparshme të suksesshme të bashkëpunimit rajonal. Krijimi i një qendre të tillë ekonomike do t'ju mundësojë shteteve të rajonit që të lidhen me qendrat e tjera të mëdha dhe me ndikim ekonomik, të tilla si Bashkimi Evropian. Krijimi i zyrave rajonale të koordinimit do të jetë një nga hapat e mëtejshëm për koordinim më të mirë të politikave dhe bashkëpunimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor.

### References:

1. Nathanali, Petrit, “ *Marredheniet nderkombetare nga origjina – deri me sot* “, “FILARA”, Tirane, 2009.
2. Nikola Kqusev, *Republika Makedonija vo period na tranzicija*, Matica Makedonska, Shkup, 1995, f. 215.
3. Sejfedin Sulejmani, *Za tranzicijata*, Elnat, Kumanovë, 1994, f. 49. Gjithashtu shih: *Economics and Politics of Transition*, Zagreb, 1993.
4. Blerim Reka, “*E drejta e Unionit Evropian*”, Prishtinë, 2000.
5. Lleshi, Abaz, “ *Gjeopolitika e Ballkanit dhe prespektivat e sigurisë në rajon* “, GEER, 2009.
6. Maksuti, Mersim, “ *Aspekti juridiko – kushtetues dhe politike i statusit shtetformues te popullit shqiptar ne Maqedoni*”, Shkup, u.a ISBN, 2005.
7. Tali, Driton, “ *Integrimi i Europes ne UE* “, Prishtine, 2008.
8. Menaj, Petrit, “ *Dilemat e Integrimit te Maqedonise dhe shqiptaret* “, “ Furkan ISM “, Shkup, 2000.
9. Dokumenti, “*Marreveshja Kornize e Ohrit* “, Shkup, Gusht, 2001.
10. Kissinger, Henri, “*Diplomacia*”, “B.K”.Tirane,1999.
11. Bashkurti, Lisen, “ *Evropa, Ballkani dhe sfida e Kosoves* “, GEER, 2006.
12. S. Goldstain, Joshua, “ *Marredheniet Nderkombetare* “, botimi i katert, Tiranë, Dituria, 2003.



**PROCESI I INTEGRIMIT EURO-ATLLANTIK TE BALLKANIT PERENDIMOR**  
**(Sammiti i NATO-s, Stamboll, 2004)**

**Dilara OZTURK**

PhD Kandidat, Fakulteti Histori-Filologji

Universiteti i Tiranës

**Abstrakt**

Pas përfundimit të “Luftës së Ftohtë”, marrëdhëniet e NATO-s me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e Traktatit të Varshavës nisën të stabilizohen, në mënyrë graduale. Në korrik të vitit 1990, në sesionin e NATO-s, në Londër, u morr vendimi për uljen e rolit të armëve atomike në strategjinë ushtarake të NATO-s. Në nëntor, të po atij viti, në Samitin e vendeve të NATO-s, në Romë, u propozua krijimi i Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut Verior (NACC), në cilësinë e “formulës bazë” të dialogut me vendet e ish Traktatit të Varshavës, mbledhja e parë e të cilit u mbajt, në dhjetor të vitit 1991, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të 16 vendeve të Aleancës së atëhershme të Atlantikut Verior dhe të 9 vendeve “partnere”, të Europës Qëndrore dhe Lindore, duke shënuar, kështu, një ngjarje historike. Njëherësh, “befasia” shokuese e këtij takimi ishte, se gjatë miratimit të komunikatës së përbashkët, ambasadori sovjetik kërkoi “*të hiqeshin nga teksti i saj, të gjitha emërtimet për BRSS-në dhe deklaroi se, pas kësaj ngjarjeje, ai përfaqësonte vetëm Federatën ruse*”. Në mars të vitit 1992, në Këshill (ku, tashmë, ishin pranuar Bullgaria dhe Rumania), u pranuan

edhe dhjetë shtete të pavarura të ish BS-së. Ndërsa, në qërshor të po atij viti, “hyri” Gruzia dhe Shqipëria.<sup>1</sup>

*Fjalët kyçe: BE, Nato integrimi euro-atlantik, Ballkani Perendimor, Samiti i NATO-s, ”partneriteti per paqe”.*

## **HYRJE**

Hapi i radhës i zgjerimit të NATO-s *si proces politiko-historik*, pas kësaj ngjarjeje, u bë Programi “*Partneritet për Paqe*” (PfP) i pranuar, në janar të vitit 1994, nëpërmjet të cilit do të realizoheshin programe individuale të bashkëpunimit dhe të forcimit të marrëdhënieve politike, mbi baza bilaterale. Gjatë gjashtëmujorit të parë, programin e nënshkruan 20 shtete, në këtë numër edhe shtete ballkanike: *Rumania (26 janar), Bullgaria (14 shkurt), Shqipëria (23 shkurt)*.<sup>2</sup> Ndërsa, gjatë kohës së Luftës në Bosnjë, një radhë shtetesh pjesëmarrëse në programin e mësipërm i ofruan gadishmëri Aleancës verioro-atlantike në kontrollin për tregetinë dhe embargon e armëve, të vendosur për të gjithë Jugosllavinë, që u pasua me sanksione ekonomike ndaj Sërbisë dhe Malit të Zi dhe ndalimin e fluturimeve mbi Bosnjë. Në atë kohë, Shqipëria u lejoi anijeve luftarake të NATO-s të shfrytëzojnë ujrat e saj territoriale për të realizuar vëzhgimin e kontrollit të embargos së armëve dhe të sanksioneve ekonomike.<sup>3</sup> Me qëllim të thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit praktik, NATO, në bashkëpunim me partnerët më aktivë të Europës Qendrore dhe Lindore, themeloi, në maj të vitit 1997, Këshillin e Partneritetit Euro-Atlantik, i cili “bashkonte” 19 vendet e Aleancës dhe 27 vende partnere, në takime dhe konsultime të rregullta në nivel ambasadorësh, ministrash e nivele të tjera të larta, të këtyre vendeve.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> Gazeta NATO, 2001, vjeshtë, f.7.

<sup>2</sup> NATO review, No.3, June. f. 6.

<sup>3</sup> Gazeta NATO, 2001, Vjeshtë, f. 8.

<sup>4</sup> EAPC – **Euro Atlantic Partnership Council**. Kryetaret e shteteve dhe te Qeverive te EAPC-se perpiluan dy dokumente te rendesishme: 1. Kuadrin politico-ushtarak per NATO-n, qe udheheq veprimet e “Partneritetit per Paqe”. 2. Drejt nje partneriteti per shekullin e XXI-te.

Marrëdhëniet midis NATO-s dhe Ruisë filluan të relaxohen në bazë të Aktit për Marrëdhënie të ndërsjellta Bashkëpunimi dhe Sigurie, të nënshkruar në Paris, më 27 maj të vitit 1997, në të njëjtën kohë kur u themelua edhe Këshilli i Përbashkët e i Përhershëm midis të dy partnerëve, në cilësinë e një strukture për zhvillimin e konsultimeve, të koordinimit të veprimtarisë dhe të formimit të konsensusit midis NATO-s dhe Ruisë. Në vitet 1998 – 1999, në kuadër të Këshillit, u zhvilluan bisedime intensive lidhur me gjendjen në Ballkan e në veçanti rreth Kosovës, megjithëse papajtueshmeria lidhur me sulmet ajrore të NATO-s ndaj Jugosllavisë, i ndërpreu këto bisedime, duke “ngrirë”, përkohësisht, edhe marrëdhëniet midis Ruisë dhe NATO-s. Mundësi të reja të bashkëpunimit “u aktivizuan” pas nënshkrimit të marrëveshjes të Këshillit NATO – Rusi, në Maj të vitit 2002, si mekanizëm konsultimi për problemet e aktuale të sigurisë ndërkombëtare.

### **“KONCEPTI STRATEGJIK” I NATO-s DHE BALLKANI PERËNDIMOR**

Për vendet e Ballkanit Perëndimor kishte një rëndësi të posaçme Samiti i NATO-s, i mbajtur në prill të vitit 1999, në Washington, si dhe “*Koncepti Strategjik*” i NATO-s, që u deklarua në këtë Samit, i cili, për arsye të kuptueshme, u mbajt në “*kulmin*” e bombardimeve të NATO-s kundër Jugosllavisë dhe, jo rastësisht, vëmendja kryesore e tij u përqëndrua tek “*ecuria e punëve*” në rajonin e Ballkanit.

Samiti, jo vetëm theksoi detyrat e reja të ndërlikuara dhe faktorët e rinj të rrezikut, që qëndronin përpara aleancës, por edhe, në mënyrë thelbësore, zgjëroi e shpjegoi vetë **konceptin e sigurisë për Europën**. Lidhur me këtë, u bë e qartë se gjatë dekadës së fundit ishin shfaqur “*faktorë të tillë të rinj e të ndërlikuar të rrezikut për paqen dhe stabilitetin në rajonin euro-atlantik, si shqetsime, konflikte ndëretnike, dështime ekonomike, rrënim i pushtetit politik dhe përhapje të armëve të shkatërrimit në masë.*”<sup>5</sup>

Në Samitin e Washingtonit u miratua “*Deklarata për Kosovën*”, që shpjegonte e sqaronte qëllimet dhe detyrat e operacionit ushtarak në Ballkan, bashkë me dokumentet për takimet e drejtuesve të Këshillit të NATO-s me Krerët e Shteteve dhe me Ministrat e Jashtëm

<sup>5</sup> Koncepti strategjik i Aleancës të Atlantikut të Veriut. Miratuar nga krerët e Shteteve dhe të Qeverive në sesionin e NATO-s të 23-24 prillit të vitit 1999. Përmbledhje e materialeve të Samitit të NATO-s, në Washington, f.47-62.

të vendeve të rajonit të Ballkanit. Në këto dokumente, të formuluar vetëm një muaj pas fillimit të operacionit luftarak kundër Beogradit, ishte paraqitur argumentimi, nga ana e politikanëve perëndimorë, lidhur me shkaqet e konfliktit në territorin e Kosovës, që përbënte “ *kulmin e një politike të qëllimshme të shtypjes, të pastrimit etnik dhe të dhunës, të zbatuar nga regjimi i Beogradit*”. Qëllimi politik i aksionit luftarak ishte krijimi i “ *një Kosove paqësore, demokratike, multietnike, ku i gjithë populli i saj të mund të jetojë në siguri dhe të shfrytëzojë, mbi një bazë të barabartë, të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut.*” <sup>6</sup>

Dokumentet e miratuara në Samitin e Washingtonit, qëndrojnë në bazament të të gjitha proceseve, të transformimeve dhe të modernizimit të NATO-s dhe të hapave të parë praktikë për rregullimin e krizave nderkombetare, madje, përtej kufijve të zones së përgjegjesise të Aleances, pikërisht në rajonin e Ballkanit. Nga përmbajtja e tyre dhe nga fryma për realizimin e qëllimit, dokumentet e mësipërme janë të një rëndësie kapitale, si për zgjidhjen e krizës së Kosovës, ashtu dhe për rolin unik të NATO-s, si mburojë e lirisë dhe demokracisë, në kushtet e reja të krijuara.

Në aspekte të ndryshme të Konceptit Strategjik dhe në dokumente të tjera të Samitit të Washingtonit u shpalosën perspektivat dhe mundësitë e integritit të vendeve të tjera të Ballkanit në aleancën euroatlantike: *kushtet e barabarta për të gjitha vendet për fillimin e bisedimeve për integrimin në NATO; rregullimi i mosmarreveshjeve e grindjeve ndërkombëtare me mjete paqësore; zgjidhja e konflikteve ndëretnike e territoriale me fqinjët; demonstrimi dhe përkushtimi ndaj ruajtjes së të drejtave të njeriut, heqja dorë nga kërcënimi, përdorimi i forcës dhe krijimi i sistemit të kontrollit demokratik dhe civil të forcave të armatosura; shkëmbime të informacionit për gjendjen dhe situatat ekonomike për principet e ekonomisë politike.*<sup>7</sup>

Megjithatë, marrëdhëniet midis vendeve pretendente për “*hyrje*” në NATO (ashtu si u vu re në praktike), përcaktohej, në një masë të caktuar, nga faktore të tjera, të cilat bene të mundur aktivizimin, në raste të vecanta, të kundërvënies të vendeve të rajonit e të shfaqjes së kontradiktave të reja midis tyre.

---

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Koncepti Strategjik i Aleances të Atlantikut Verior. f.74 – 75.

Udheheqja e NATO-s ishte dhe eshte e ndergjegjishme per kompleksitetin e detyres se transformimit te aleances sidomos ne kushtet specifike te Ballkanit. *“Kushtet e sigurise ne kete rajon strategjik jane, relativisht, te qendrueshme, por mbeten perhere te brishta e delikate”*- thuhet ne dokumentin *“ Riorganizimi i NATO-s dhe risite në marrëdhëniet NATO – Rusi”*,<sup>8</sup> të formuluar në shkurt të vitit 2004. Më tej, në këtë dokument vihen në dukje zhvillimet pozitive në rajonin e Ballkanit, të ndodhura veçanërisht lidhur me situatën në Bosnjë – Hercegovinë, që u dhanë mundësi prezencës së forcave paqeruajtëse. Po ashtu, në dokumentin e përmendur, nënvizohet përgjegjësia e të dy aktorëve - të NATO-s dhe të Rusisë - për stabilitetin e gjendjes në Kosovë.

Rumania dhe Bullgaria munden, ndonëse me disa kushte, ta përballojnë planin e paraqitur nga aleanca. Përsa i përket perspektivës të integritetit të shteteve të pjesës perëndimore të Ballkanit, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Scheffer, duke folur për integritetin e Bosnjës dhe Hercegovinës në Aleancë e kondicionoi procesin e mëtejshëm plotësues për realizimin e programit të reformave ushtarake të këtij vendi, *“ me demonstrimin dhe bashkëpunimin aktiv të saj me Tribunalin e Hagës”* dhe se vetëm atëherë, *“ajo do të bëhet pjesë e programit “Partneritet për paqe”*. Të njëjtat kushte, ai i parashtrroi dhe për Serbinë dhe Malin e Zi.<sup>9</sup>

Në korrik të vitit 2005, u nënshkrua marrëveshja për kalimin tranzit të reparteve të forcave speciale të NATO-s nëpërmjet territorit të Sërbisë dhe të Malit të Zi për realizimin e operacioneve paqeruajtëse në Ballkan. Sipas ekspertëve, politikanëve e diplomatëve perëndimorë të kohës, në rast të përmbushjes të të gjitha kushteve të njohura paraprake, shtetet e Ballkanit Perëndimor mund të pretendonin të bëheshin pjesë e aleancës atlantike, deri në fund të vitit 2008.<sup>10</sup>

Në këtë mënyrë, proceset e transformimit të NATO-s në rajonin e Ballkanit Perëndimor rezultuan se ishin mjaft të vështira, të ndërlikuara e specifike, për arsye se krizat ballkanike, që rodhën më pas, luftrat e ashpra ndëretnike, që shoqëruan fragmetimin e ish

<sup>8</sup> “NATO – Permanent Joint Council “– PJC.

<sup>9</sup> Gazeta NATO, Ndryshimet historike ne Ballkan, Bruksel, 2005, f.7.

<sup>10</sup> Po aty.

Jugosllavisë, treguan, se vendet e këtij rajoni ishin, realisht, larg të të qënit “*faktor i përshpejtimit të modernizimit të aleancës*”, si ishin cilësuar në Konceptin Strategjik të Aleancës atlantiko-veriore.

Për këtë arsye, u bë i domosdoshëm aktivizimi i bashkëpunimit të ngushtë midis NATO-s dhe BE-së, në këtë rajon të ndërlikuar e shpërthyes, si një nevojë në kërkim të veprimeve të kombinuara e të përzgjedhura, bashkarisht, për zgjidhjen afatgjatë të problemeve të Ballkanit Perëndimor.

### **VENDET E BALLKANIT PERENDIMOR, NE KONTEKSTIN E PARTNERITETIT STRATEGJIK NATO – BE.**

Hapi tjetër tepër i rëndësishëm ishte marrja e “*Vendimit për partneritet strategjik midis NATO-s dhe BE-së, në marrëdhëniet me vendet e rajonit të Ballkanit dhe për ndalimin e zgjerimit të zonave të konfliktit*”, të marra në **Samitin e Stambollit, të Aleancës së Atlantikut Verior**, në korrik të vitit 2004. Në këtë kohë u deklarua për ndalimin e operacioneve të NATO-s dhe për kalimin e funksioneve operative në drejtim të stabilizimit të situatës në Bosnjë dhe Hercegovinë nën drejtimin e Bashkimit Europian. Por, ruajtja dhe konservimi i tensioneve edhe sot në Ballkanin Perëndimor, si dhe performanca e dobët e BE-së në “*funksinin*” e ngarkuar,<sup>11</sup> tregoi se veprimtaria e BE-së, si forcë paqeruajtëse dhe perspektiva e saj, *ishite e mundur vetëm në kushtet e lidhjes dhe bashkëpunimit të ngushtë me Shtabin e NATO-s*, i cili morri përsipër përgjegjësinë planifikimit dhe sigurimin e mbështetjes së operacioneve të BE-së në Maqedoni (më pas në Bosnjë), në bazë të një marrëveshjeje speciale midis të dy organizatave.<sup>12</sup>

E njëjta “*formulë*” bashkëpunimi midis NATO-s dhe BE-së ishte e domosdosshme dhe për parandalimin e acarimit të situatave të ndërlikuara në Kosovë dhe rreth saj.

Pa mbështetjen e strukturave europiane dhe euroatlantike, shtetet e Ballkanit Perëndimor ( *në veçanti, Sërbia, Malit të Zi dhe Bosnjë Herzegovinë*) *ishin në “target” të*

<sup>11</sup> Bëhet fjalë për vendimin e Samitit të Stambollit për kalimin e funksioneve operative paqeruajtëse të BE-ja.

<sup>12</sup> Zagorski A.V. “NATO: transformim apo agoni? // Siguria europiane: ngjarje vlerësime prognoza.2004,f.6

*kërcënimeve, jo vetëm nga konfliktet ndëretnike, por edhe nga destabilizimi ekonomik e politik, nga rreziku për të mbetur “oborri i prapëm i Europës”.* Kjo ishte një nga arsyet, midis të tjerave, se pse BE-ja u ofroi këtyre vendeve një mbështetje më të vogël, në raport me pjesën lindore të Ballkanit. Megjithëse me një popullsi, përafërsisht të barabartë, pjesa lindore e gadishullit ka përfituar nga BE-ja, gjatë viteve 2004 – 2006, “*për zhvillimin e reformave*”: Rumania dhe Bullgaria - 1.5 miliardë euro (2.6% të mesatares të GDP-se të tyre), ndërsa shtetet e Ballkanit Perëndimor “*ndanë*” midis tyre vetëm 500 milionë euro (1% te GDP-se të tyre).<sup>13</sup>

Një analizë e detajuar e gjendjes të subrajonit të Ballkanit Perëndimor dhe i zhvillimeve për rrugën që ka pershuar rajoni drejt integritit euroatlantik të tij është shprehur qartë në raportin e titulluar “*Ballkani Perëndimor – 2004. Ndikime, bashkime dhe kufij të rinj*“, të përgatitur nga Iniciativa e Stabilizimit European.<sup>14</sup> Sipas autorëve të këtij dokumenti, Europa duhet t’u ofrojë vendeve të Ballkanit Perëndimor shumë më tepër sesa “shtrirja e dorës së ndihmës”, me qëllim që ky rajon të mos mbetet një “ishull i pastabilizuar” në qendër të Europës. Sipas tyre, është e domosdoshme përgatitja e programeve shumëvjeçare të zhvillimit, mbi bazën e një partneriteti të sigurtë midis BE-së, qeverive nacionale, pushtetit vendor dhe shoqërive civile për përcaktimin e prioritetëve të zhvillimit dhe të monitorimit të realizimit të këtyre programeve. Në formë konkluzionesh, në raport thuhet se pa ndihmen e Europës, rajoni kërcënohet nga konfliktet dhe dasitë ndëretnike, nga mungesa e stabilitetit ekonomik dhe politik, nga krjimi i një “stuhie” papunësie dhe nga zhgënjimet e dështimit të reformave demokratike.

Për ruajtjen e stabilitetit, sipas mendimit të autorëve të raportit, ishte e domosdoshme përfshirja e Ballkanit Perëndimor në proceset e bashkëpunimit ekonomik dhe politik dhe krijimi i një bazë financiare ( të vlerësuar rreth 900 milionë euro), për mbështetjen e këtij subrajonit, duke marrë në konsideratë, se krizat dhe konfliktet e mundshme në rajon, do të kishin një kosto shumë herë më të lartë.<sup>15</sup>

<sup>13</sup> Road to Saloniki. Cohesion and the Western Balkans. Berlin 12 march 2003.( [http:// www. Esiweb.org/](http://www.Esiweb.org/)).

<sup>14</sup> ESI – Iniciativa e Stabilizimit European.

<sup>15</sup> Cohesion and the Western Balkans. Berlin, March 2003.

## BASHKIMI EUROPIAN DHE BALLKANI PERËNDIMOR

Vendimi parimor për hapjen e bisedimeve të Bashkimit Europian me shtetet e Ballkanit Perëndimor, midis të cilëve i Serbisë dhe Malit të Zi, u morr në Samitin e Selanikut (2003), ndonëse BE-ja u përball me shumë probleme konkrete, që bëheshin pengesë për realizimin e tij. Procesi u ngadalësua, midis të tjerash, nga dështimi i referendumit për pranimin e Kushtetutës Europiane (2005), që i shtoi më shumë dyshimet e politikanëve dhe të ekspertëve lidhur me domosdoshmërinë e forcimit të procesit të zgjerimit të Bashkimit Europian.<sup>16</sup> Por, në çfardollosj situatë, skenari i fillimit të bisedimeve të njëkohshme për Shqipërinë, Bosnjë - Hercegovinën, Serbinë, Malin e Zi, Kroacinë dhe Maqedoninë u hodh poshtë dhe bisedimet e mëtejshme vazhduan me çdo vend, veçmas.

Pas përmbushjes së kushteve të Tribunalit të Hagës, ranë pengesat për nisjen e dialogut dhe me Kroacinë, por siç ka theksuar përfaqësuesi i BE-së për çështjet e zgjerimit të asaj kohe, Oli Rehn, procesi i negociatave me Kroacinë duhej të kalonte, “*sipas kushteve të barabarta për të gjithë*”. Pas plotësimit të këtyre kushteve Kroacia arriti t’i bashkohet BE-së.

Pavarësisht nga vlerësimet pozitive të proceseve të formimit të Serbisë dhe të Malit të Zi, ekspertet e BE-se konfirmonin se e ardhmja e tyre ende nuk mund të vendosej përfundimisht, pa u përcaktuar statusi përfundimtar i Kosovës dhe zgjidhja e problemit të saj. Kjo gjendje mund të bëhej pengesë jo vetëm për progresin ekonomik të të gjithë rajonit, por do të pengonte dhe integrimin e Serbisë dhe të Malit të Zi, në BE.<sup>17</sup> Aq më tepër, kur kriteret politike për pranimin në BE, nuk ishin më pak të rëndësishme se sa ato ekonomike.<sup>18</sup> Mbi këtë bazë i’u ofrua atyre ftesa për t’u bërë pjesë e BE-së.

E papërcaktuar ishte dhe perspektiva e fillimit të bisedimeve midis BE-së dhe Bosnjës dhe Hercegovinës. Ekspertët më të njohur të ESI-it ( *Iniciativa e Stabilizimit Europian*), konfirman, se bisedimet me Bosnje-Hercegovinën do të bëheshin të mundura vetëm atëherë, kur do të arrihej të largohej Përfaqësuesi i Lartë ndërkombëtar, d.m.th. kur të “*sfumohej*” posti i tij dhe vendi do të ishte “*de facto*” dhe “*de jure*” i pavarur. Për kalimin në

<sup>16</sup> IWPR, Balkan Crisis Report. 2005. Nr.560, 17 june.

<sup>17</sup> Papadimitriou P. Op.cit. p. 87.

<sup>18</sup> Atlantis. Atlantic Council of Serbia and Montenegro. 2006. No.3, p. 24.



gjendjen e re”, sigurisht, do të ishte e domosdoshme reforma e forcave të ruajtjes së rendit publik (*policia*), reformim, të cilën BE-ja e klasifikon në cilësinë e kushtit bazë, për të filluar bisedimet, e penguar nga qeveria e Sërbisë.<sup>19</sup> Me kryerjen e këtyre reformave, faktet treguan se mbërriti edhe ftesa për në BE.

Përsa i përket Shqipërisë, në shkurt të vitit 2006, u nënshkrua me BE-në MSA - ja (*Marreveshja e Stabilizim Associmit*), megjithëse, një vit përpara këtij nënshkrimi, në Bruksel ishte deklaruar se “*nuk vënë re konsensusin e nevojshëm ndërpartiak lidhur me integrimin në BE. Mungonin, po ashtu, përpjekjet e Tiranës për të zbatuar reformat e domosdoshme.*”<sup>20</sup> Zhvillimet e mëtejshme përcaktuan “*stacionin*” e dhjetorit të kaluar për të marrë statusin e kandidatit, të kushtëzuar, kryesisht, me zgjedhjet e qershorit, të vitit të kaluar. Por partneret europiano përendimore menduan që ftesës për Shqipërinë t’i adresohen në qershor të këtij viti.

Në një plan tjetër u analizua problemi i integritit në BE të Maqedonisë, e cila megjithatë vështirësitë e dukshme ekonomike ishte vendosur në një pozicion më të përparuar “*në të njëjtën radhë të integritit*” me Kroacinë. Komisioni i BE-së e kishte marrë këtë vendim, për arsye stimulimi, pasi për disa vjet radhazi qeveria e Maqedonisë ruante detyrimet e veprimtarisë qeverisëse të koalicionit ndëretnik, të nënshkruar në vitin 2002, në Marrëveshjen e Ohrit, mbi bazën e së cilës, *politikanët e Maqedonisë arritën të parandalonin rreshqitjen e konfliktit të brendshëm etnik drejt një konflikti etnik ballkanik.*<sup>21</sup>

Të bën përshtypje, po ashtu, fakti se lidhshipi i Maqedonisë i drejtohet, paralelisht, për mbështetje ShBA-së për rregullimin e mosmarreveshjes, lidhur me çështjen e kontestit të emrit të saj nga ana e Greqisë, pa të cilën do të ishte e pamundur zgjidhja përfundimtare e çështjes së antarësimit të Shkupit, në BE.<sup>22</sup>

<sup>19</sup> IPWR. Balkan Crisis Report, 2005, No. 560. 17 June.

<sup>20</sup> IPWR. Balkan Crisis Report, 2005. No.550. 06 April.

<sup>21</sup> Balkan Investigative Reporting Network. 2005, 16 December. ( Sahin M. The EU should seize the opportunity and accept Macedonia as a candidate for membership).

<sup>22</sup> IWPR. Balkan Crisis Report. 2005. No. 581, 28 October.

Kroacia, tashmë, e ka kaluar “portën” e lirë të Europes. “Llogaritë” e saj me BE-në i ka mbyllur.

Në “rrugën” drejt Europës janë Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova, në përpjekje të plotësimit të kushteve paraprake dhe në “garën” individuale për përmbushjen e standarteve: *zgjedhje të lira e demokratike, respektim të ligjit dhe të shtetit ligjor, ruajtja e të drejtave të njeriut, në veçanti, të të drejtave nacionale të pakicave; reforma ekonomike, që çojnë drejt ekonomisë së tregut; hapësira të shoqërisë civile, respektim të qytetarëve të vet, etj.*

Kosova – shteti më i ri i pavarur i Europës, vazhdon “rrugën e vet specifike” drejt Brukselit, me atributet, me kushtetutën më moderne të kohës dhe me një mbështetje ndërkombëtare të aktorëve më të fuqishëm politik, ekonomik e diplomatik të kohës sonë, në një projekt të qartë ndërkombëtar, për t’u bërë shtet modern demokratik, multietnik evropian, në qendër të Ballkanit.

## **KONKLuzion**

1. Pas luftës së ftohtë, me rënien e Traktatit të Varshavës, zgjerimi i Natos u bë me vendet e Bllokut Lindor, duke ruajtur karakterin e zhvillimit në formën e një procesi politiko- historik dhe duke ruajtur realizimin nëpërmjet programeve individuale të bashkëpunimit e të forcimit të marrëdhënieve politike mbi baza bilaterale.
2. Marrëdhëniet midis Natos dhe Ruisë filluan të relaksohen pas miratimit të aktit për marrëdhënie të ndërsjellta sigurie të nënshkruara në Paris më 27 maj të vitit 1997, kur u themelua edhe Këshilli i Përbashkët i Përhershëm midis tyre.
3. Deklarata për Kosovën, që shpjegonte qëllimet dhe detyrat e operacionit ushtarak në Ballkan bashkë me dokumentet për takimet e drejtuesve të Këshillit të Natos u bë nga krerët e shteteve dhe ministrat e jashtëm të vendeve të rajonit të Ballkanit.
4. Një hap tepër i rëndësishëm ishte marrja e “vendimit për partneritet strategjik midis Natos dhe BE-së në marrëdhëniet me vendet e rajonit të Ballkanit dhe ndalimin e zgjerimit të zonave

të konfliktit” në Samitin e Stambollit.(2004).

**Referenca:**

- 1.Koncepti strategjik i Aleancës të Atlantikut të Veriut.
- 2.Ndryshimet historike në Ballkan, Bruksel 2005.
3. ESI- inisiativa e stabilizimit europian.
- 4.Zagorski A.V.” Nato : transformim apo agoni ?
5. Cohesion and the Western Balkans, Berlin 2003.
- 6.IWPR, Balkan Crisis Report 2005.
- 7.Balkan Crisis Report, 2005.

# LAW

**KULTIVIMI DHE TRAFIKIMI I BIMËVE NARKOTIKE - EFEKTET NEGATIVE  
DHE MASAT LIGJORE QË DUHEN MARRË PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN  
NDAJ KËTIJ FENOMENI**

**Adnan XHOLI, PHD candidate**

International University of Struga

xholiadnan@gmail.com

**Abstrakt**

Me këtë punim mendoj se do sjell një kontribut për pasurimin e diskutimeve dhe debateve në rradhët e juristëve, që të përdorin njohuritë e fituara në funksion të parandalimit dhe luftës kundër kultivimit të bimëve narkotike dhe trafikimit të lëndëve narkotike, nisur nga fakti se ky fenomen është aktual dhe tejet shqetësues si në Shqipëri, ashtu dhe në rajon e më gjerë.

Kultivimi i bimëve narkotike dhe trafikimi i tyre është diskutuar vazhdimisht, jo vetëm nga ekspertët e fushës, analistë apo gazetarë, por edhe nga politikanët e të gjitha forcave politike. Sa ju përket këtyre të fundit, për ironi propagandohet së tepërmi gjatë fushatave elektorale, (në Shqipëri korrespondojnë një herë në dy vjet), por me përfundimin e zgjedhjeve, asnjë fjalë e thënë dhe premtim i dhënë nuk është marrë seriozisht për parandalimin dhe goditjen e këtij fenomeni.

Megjithëse institucionet e zbatimit të ligjit kanë marrë vazhdimisht masa për parandalimin dhe goditjen e kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, ky fenomen vijon të jetë shumë i përhapur dhe tejet problematik për vendin, sidomos gjatë vitit 2016, sikundër pasqyrohet edhe në progres Raportin e Komisionit Evropian të vitit 2016, sipas së cilit

Shqipëria ka intensifikuar luftën kundër kultivimit të drogës (kryesisht kundër cannabis sattiva), por ajo ende mbetet një sfidë serioze.<sup>1</sup>

Për vetë specifikën që paraqet kultivimi dhe trafikimi i bimëve narkotike, dhe dëmeve shëndetësore të parikuperueshme që sjell përdorimi i tyre, ndikon ndër të tjerave edhe tek sipërmarjet e ndershme. Përfshirja në këtë aktivitet e shtresave në nevojë të shoqërisë, jep efekte negative si në ekonominë e vendit, ashtu dhe në ekzistencën e bizneseve të ligjshme, pasi investimi i të ardhurave të fituara nga ky aktivitet, është i prirur që të dëmtojë bizneset e ndershme apo ti orientojë drejt falimentit, për shkak të lulëzimit të dukurisë së pastrimit të parave.

Kultivimi i bimëve narkotike e mandej trafikimi i tyre ka qenë prezent ndër vite dhe me tendenca në rritje gjatë vitit 2016, por do vijojë të jetë i pranishëm dhe nëse nuk luftohet në kohën e me mekanizmat ligjorë të duhur, është i aftë që me të ardhurat e paligjshme të fituara, të depërtojë në nivele të ndryshme të administratës e për rrjedhojë, të destabilizojë rendin juridik dhe shtetin e së drejtës.

Në këtë punim janë pasqyruar disa koncepte mbi krimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe trafikimit të lëndëve narkotike, shkaqet e tij dhe efektet që synohet të arrihen në luftën kundër këtij fenomeni. Po ashtu, kemi paraqitur edhe disa rekomandime me qëllim për ta bërë parandalimin dhe luftën kundër tij, sa me efikas në praktikë.

**Fjalë kyçe:** *Kanabis, kultivim, efekt, strategji, faktor, problematik.*

## **HYRJE**

Bima e kërpit (*Cannabis sativa L.*), e njohur gjithashtu nën emrin e tij latin cannabis, është një lloj bime vjetore e familjes Cannabaceae dhe është një nga bimët e para të përdorura nga njeriu, që në periudhën neolitike, probabilisht në Azi. Teksti më i vjetër i shkruar i njohur për përdorimin e cannabis-it vjen nga periudha e perandorit kinez Shen Nung, në vitin 2727

---

<sup>1</sup> European Union, European Commission. (2016), *Albania Report*, (Commission Staff Working Document) [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key\\_documents/2016/20161109\\_report\\_albania.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf)

para Erës së Re. Cannabis është përmendur në tekstet Vedas të hinduve,<sup>2</sup> në vitet 2000 dhe 1400 para Erës së Re, në Atharvaveda.<sup>3</sup>

Prejardhja e fjalës “hashash” e ka origjinën nga arabishtja e vjetër, nga Siria dhe Persia, që do të thotë “flakje”, “braktisje”, një nofkë që arabët e Azisë qendrore dhe juglindore ja vunë bimëve toksike, helmatisëse narkotike dhe kanabisit qysh rreth 1000 vjet më parë, për shkak të pasojave të dëmshme shëndetësore dhe fundin tragjik që ato shkaktonin.<sup>4</sup> Sipas studiuesve, kanabisi është sjellë në Evropën Perëndimore që në shekullin XVI. Në bazë të disa referencave dhe të dhënave të ardhura deri në ditët tona, në Francë, droga është sjellë nëpërmjet ushtarëve të Napoleonit, gjatë luftërave në Egjipt. Më vonë, në Paris (1844) u formua Klubi i Miqve të Hashashit (Club de hashashines).<sup>5</sup>

### **FENOMENI I KULTIVIMI TË BIMËVE NARKOTIKE NË SHQIPËRI**

Si dukuri, kultivimi i bimëve narkotike cannabis sativa, u bë i njohur në Shqipëri zyrtarisht në vitin 1993. Më pas kjo dukuri erdhi duke u përhapur me shpejtësi. Kanabisi shqiptar, i kultivuar fillimisht si mall i destinuar “për eksport” dhe grupet kriminale që merren me kultivimin dhe trafikimin e tij, u integruan më së miri në tregun evropian, duke ndikuar në krijimin e një imazhi mjaft negativ për Shqipërinë dhe shqiptarët. Kultivimi masiv i bimëve narkotike sjell pasoja negative për komunitetin dhe sigurinë e tij. Ai ndikon në rritjen e kriminalitetit në vend, vonon integrimin e vendit në Bashkimin Europian; penalizon një numër të madh personash brenda dhe jashtë vendit; ndikon në rritjen e numrit të përdoruesve të marihuanës në popullsinë vendase, sidomos në brezin e ri; humbet interesin e të rinjve për t’u angazhuar në veprimtari të ligjshme fitimprurëse; ndikon që fermerët e zonave kultivuese të bimëve narkotike të humbasin traditën e kultivimit të bimëve të tjera bujqësore, etj.<sup>6</sup>

<sup>2</sup> <https://www.mjeket.al/index.php?go=drogat&id=142>

<sup>3</sup> <https://sq.wikipedia.org/wiki/Hinduizmi>. (*Atharvaveda: Është veda e fjalëve magjike. Është një përmbledhje e madhe e përbërë prej 731 himneve fetare me 6000 strofa.*)

<sup>4</sup> Prof.asoc.Dr. Dine Merja, Lëndët narkotike , dëmet shëndetësore dhe sensibilizimi politik. 18.08.2014. Gazeta telegraf.

<sup>5</sup> Hysi Vasilika, “Kriminologjia”, Shtypshkronja “Kristalina”, Tiranë, 2005/2010.

<sup>6</sup> Xhavit Shala, “Kanabisi dhe fushata elektorale”.

Vitet në vijim, kanë shënjuar një duel të pandërprerë mes institucioneve ligj-zbatuese dhe rrjeteve e grupeve të trafikimit. Fenomeni i kultivimit dhe trafikimit të kanabisit nga grupet e kriminit të organizuar është intensifikuar gjatë dhe pas vitit 1997, si pasojë e mosfunksionimit të institucioneve shtetërore, kryesisht atyre të sigurisë e të inteligjencës. Tolerimi i rrezikshëm i kultivimit të hapur të kanabisit në Lazarat krijoi kushte të favorshme për grupet kriminale, të cilat, për më shumë se një dekadë, arritën të konsolidojnë financat, rrjetet, tregjet dhe lidhjet politike. Modeli negativ i krijuar në Lazarat ndikoi shumë, jo vetëm në fuqizimin e shumanshëm të grupeve dhe rrjeteve kriminale, por edhe në inkurajimin e kultivimit të kanabisit në rajone të tjera të vendit, si dhe në përkeqësimin e imazhit ndërkombëtar të Shqipërisë.<sup>7</sup>

Pas ndërrimit të sistemit të qeverisjes në Shqipëri, (nga monist në atë demokratik), vijoi dhe u shfaq fenomeni i kultivimit e prodhimit të bimëve narkotike. Fillimisht janë mbjellë bimë narkotike në disa zona të kufizuara, por me kalimin e viteve ka vijuar me një shtrirje pothuajse të gjithë territorin e vendit, duke u përhapur edhe në ato zona ku më parë nuk kanë qenë kultivuar, apo nuk ka qenë në nivele shqetësuese. Gjatë viteve të fundit, organizatorët e këtij aktiviteti të paligjshëm, për shkak të terrenit të përshtatshëm si dhe mungesës së reagimit nga ana e institucioneve ligjzbatuese, bazuar dhe në eksperiencën disa vjeçare në kultivimin e bimëve narkotike kanë sofistikuar edhe format e prodhimit dhe të përpunimit të bimëve narkotike, duke u investuar shuma të konsiderueshme parash në ngritjen e një infrastrukture të fuqishme si për sigurimin e farës, hapjen e tokave apo parcelave të reja, (kryesisht në zona të vështira malore e të pyllëzuara), ngritjen e serave dhe punishteve për prodhimin e fidanëve, kujdesin dhe ruajtjen e parcelave apo ambjenteve si gjatë procesit të kultivimit, ashtu edhe gjatë vjeljes, për magazinimin, përpunimin e trafikimin e prodhimit të përftuar në drejtim të vendeve të BE-së.

Konstatohet se në disa rrethe (Rrëshen, Durrës, Përmet, Skrapar., etj), organizatorët e këtij aktiviteti kanë investuar jo vetëm në teknologjinë e përpunimit (ngritjen e laboratorëve të teknologjisë së lartë), por edhe në drejtim të “punësimit të specialistëve, kryesisht nga

---

<sup>7</sup> Vendimi nr. 248, datë 29.3.2017 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020”



Lazarati”, për realizimin sa më mirë të procesit të kultivimit të bimëve narkotike, me qëllim për të përfutur sa më shumë prodhim, e për rrjedhojë për të patur një fitim të konsiderueshëm.

Sipas raportit që ka publikuar për vitin 2016, Departamenti Amerikan i Shtetit për narkotikët, pasqyrohet se pati të dhëna se, kultivimi i kanabisit u rrit”. Shqipëria mbetet një burim i rëndësishëm për marijuanën dhe një rrugë e kokainës dhe heroinës që ka si destinacion tregjet europiane. Mbi 2 milionë e 450 mijë bimë kanabis mendohet se janë asgjësuar nga policia, ndërsa nga vëzhgimi me avionë janë zbuluar mbi 2 mijë plantacione të mbjella me kanabis. Sasia e heroinës së kapur në Shqipëri arrin mbi 57 kilogram, ndërsa kokainë pak më shumë se 7 kilogramë. Ndërkohë në raportin për pastrimin e parave, Departamenti Amerikan i Shtetit është shprehur se Shqipëria është vend ku pastrohen lehtësisht paratë e drogës dhe ku sundon korrupsioni i shfrenuar. Raporti i institucionit thekson se, Shqipëria është “një vend tranzit për trafikimin e narkotikëve, armëve, mallrave kontrabandë dhe qenieve njerëzore dhe mbetet në rrezik për pastrimin e parave”.<sup>8</sup>

Në përgjithësi, organizatorët dhe kultivuesit e bimëve narkotike në Shqipëri kanë synuar dhe vijojnë ta bëjnë, përdorimin e fidanëve të bimëve canabis sativa, me cikël vegetativ pjekjeje, si më poshtë:

- me cikël pjekje **45 ditor**, por nuk është shumë i preferuar nga kultivuesit në vendin tonë, pasi jep një produkt të thatë nga 50 - 70 gramë për bimë, shkak i cili nuk ofron leverdi ekonomike, pasi kultivimi i bimës ka kosto dhe fitimi në këtë rast nuk është i madh.
- me cikël pjekje **tre mujor**, është lloji më i përhapur që është mbjellë në Shqipëri, pasi jep produkt të thatë nga 200 - 400 gramë për bimë, nuk rritet shumë dhe mbillet në distancë 0.7-1 metër nga njëra-tjetra. Kultivuesit e bimëve narkotike janë në gjendje ta mbrojnë e kamuflojnë më mirë për shkak të ciklit të shkurtër të pjekjes.
- me cikël pjekje **gjashtë mujor**, mbillet gjatë muajit qershor, për tu korrur gjatë muajit nëntor. Jep produkt të thatë rreth 700 gramë - 1 kg për bimë, mbillet në distancë 1.5-2 metra nga njëra-tjetra, por rritet mbi 2 metra lartësi. Pavarësisht sasisë së produktit, nuk është e preferuar nga kultivuesit pasi është e vështirë për tu kamufluar, kërkon një

<sup>8</sup> <https://www.state.gov/documents/organization/268025.pdf>

kohë më të gjatë ruajtje dhe kujdesi. Për rrjedhojë, bie më shumë në sy dhe ka rrezik më të madh që të zbulohet dhe asgjësohet.

## **PROBLEMET SOCIALE QË SJELL KULTIVIMI I BIMËVE NARKOTIKE**

Bimët narkotike dhe problematikat që shoqërojnë ato janë tashëm një fenomen global. Asnjë vend nuk është i imunizuar nga problemet që shoqërojnë kultivimin, prodhimin, trafikimin, përdorimin e drogave të paligjshme. Shteti Shqiptar e njeh dhe e pranon natyrën serioze të problemit si në nivelin kombëtar ashtu dhe në atë ndërkombëtar, duke pranuar që fenomenet janë të lidhura, dhe kërkohet ndërhyrje aktive, serioze, me plane veprimi konkrete dhe të qëndrueshme, të shoqëruara me politika për integrimin e ish-përdoruesve dhe përmirësimin e kushteve socialo-ekonomike.

Nxitja e kultivimi i kanabisit nga grupet kriminale, i “është përshtatur”, masave që ka marrë shteti me institucionet e specializuara për dënimin e kultivuesve të bimës së kanabis. Kjo përshtatje, në radhë të parë, është shfaqur duke përqendruar financimin e grupeve kriminale për mbjelljen e saj në zona kodrinore dhe malore me terrene të thyera, në toka kryesisht jo bujqësore, (që administrohen nga fondi i pyjeve dhe kullotave). Gjithashtu, për mbjelljen e bimës së kanabis janë shfrytëzuar zonat ku banon popullsi me të ardhura të pakta, kushte përgjithësisht të varfra të popullsisë së këtyre zonave, zona pa infrastrukturë rrugore si dhe të vështira për tu kontrolluar. Megjithëse në dukje ky fenomen i paligjshëm gjeneron të ardhura pasi është ndër aktivitetet tejet fitimprurës, përveç dëmeve të mëdha për shëndetin, sjell pasoja negative në aspektin ekonomik por edhe në prodhimin bujqësor, pasi:<sup>9</sup>

- Shpërqendrohet vëmendja e fermerëve nga kultivimi i bimëve bujqësore duke sjellë jo vetëm pakësimin e prodhimit bujqësor, uljen e të ardhurave të familjeve bujqësore të këtyre zonave, por edhe lënien e tokës bujqësore të pakultivuar me bimë bujqësore të dobishme.
- Rendja pas fitimit të paligjshëm sjell edhe konflikte sociale, pasi mbjellja e kanabis në toka “pa zot”, rrit mundësinë e konflikteve mes banorëve për zaptim pronash që janë të shtetit.

<sup>9</sup> Sipas të dhënave zyrtare të raportuara nga ana e Ministrisë së Bujqësisë për vitin 2016.

- Bie ndjeshëm interesi i popullatës veçanërisht i brezit të ri për t'u marrë me punë të ligjshme.

### **EFEKTET NEGATIVE NË EKONOMI TË KËTIJ FENOMENI SI REZULTAT I DUKURISË SË PASTRIMIT TË PARAVE <sup>10</sup>**

Kultivimi dhe trafikimi i bimëve narkotike jo vetëm që ndikon në ekonominë e vendit, por është i destinuar që ti falimentojë dhe bizneset e ndershme, pasi investimi i të ardhurave të fituara nga aktiviteti i paligjshëm, errësohet nëpërmjet një sërë transfertash dhe marrvëshjesh, me qëllim që të njëjtat fonde eventualisht të shfaqen si të ardhura të ligjshme, për shkak të dukurisë së pastrimit të parave. Pastrimi i parave quhet i tillë sepse përshkruan në mënyrë perfekte dhe origjinale atë që ndodh, para të paligjshme ose të “pista” i nështrohen një cikli transaksionesh duke u “larë” dhe duke u shfaqur në krahun tjetër si para e “pastër” ose e ligjshme. Me fjalë të tjera, pastrimi i parave është procesi nëpërmjet të cilit sasive të mëdha të parave të siguruar nga krimi (kultivim dhe trafik droge, aktivitete terroriste ose krime të tjera), u jepet aparenca e rrjedhjes nga burime të ligjshme. Më konkretisht, pastrimi i parave ndikon në ekonomi pasi:

- cënon biznesmenin e ndershëm i cili duhet të nxjerrë fitime që të mbijetojë, ndërkohë që ai që pastron para, thjesht ka nevojë që biznesi i tij të duket i suksesshëm;
- lejohen kriminelët të shijojnë “frutet” e krimeve të tyre duke i bërë këto të fundit më tërheqëse, si dhe lejon organizatat kriminale të financojnë aktivitete të tjera kriminale;
- dëmton integritetin e sistemit financiar si dhe sjell efekte negative makroekonomike, (prek kursin e valutës, shtrembëron raportin kërkesë-ofertë, si dhe shpërndarjen e pasurive);
- mund të çojë në mosbindje ndaj ligjit, duke nxitur krimin ekonomik, (si p.sh mashtrimet shkëmbimet financiare të pakontrolluara, evazionin fiskal), si dhe;

---

<sup>10</sup> Prezantim pranë Shkollës së Magjistraturës, Tiranë, Adnan Xholi, 2 Maj 2014.

- lehtëson korrupsionin, pasi përqendrimi i pushtetit ekonomik dhe financiar në duart e politikanëve të inkriminuar dhe organizatave kriminale dëmton ekonominë kombëtare dhe sistemin demokratik.

### **RREZIQET QË VIJNË NGA PASTRIMI I PARAVE**

Në aspektin juridik, rrit rrezikun që vjen nga krimet e rënda (kultivimi dhe trafiku i bimëve narkotike, armëve, shfrytëzimi i prostitucionit etj), duke lehtësuar kryerjen e këtyre krimeve si dhe duke mundësuar sigurimin e fondeve për riinvestim, (lejon sipërmarrjet kriminale të vazhdojnë operacionet e tyre).

Në aspektin ekonomik, zvogëlon të ardhurat nga tatim-taksat sepse krijon ekonomi paralele me përmasa të konsiderueshme (ekonomi virtuale), të cilat asfiksojnë bizenset e ligjshme, destabilizojnë sektorët dhe institucionet financiare, si dhe konsolidon pushtetin ekonomik të organizatave kriminale;

Në aspektin politik, dobëson institucionet demokratike dhe qeverisjen e drejtë sepse nxit korrupsionin publik nëpërmjet mitmarrjes, kontributeve financiare të paligjshme në fushata elektorale, përvetsimit të taksave dhe pagesave për leje apo liçensa., etj.

### **FAKTORËT QË NXISIN KULTIVIMIN DHE TRAFIKIMIN E KANABISIT NË VEND.**

Kultivimi dhe trafikimi i kanabisit ka ndikim negativ të konsiderueshëm në jetën ekonomike, shoqërore, politike, kulturore të vendit. Përveç dëmeve të mëdha që sjell për shëndetin e popullsisë, ky fenomen ndikon cënimin e rendit dhe të sigurisë publike, ka ndikimin negativ në zhvillimin ekonomik, prishjen e imazhit të vendit dhe ngadalësimin e procesit të integritimit në BE. <sup>11</sup>

---

<sup>11</sup> Vendimi nr. 248, datë 29.3.2017 i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit 2017-2020"

Në zhvillimin dhe përhapjen e këtij aktiviteti kriminal në vendin tonë kanë ndikuar disa faktorë, por më kryesoret mund të përmendim:

- Kushtet ende të vështira social-ekonomike për një pjese të madhe të popullsisë, dhe numri i madh i krahut të punës. (Sipas të dhënave statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2016, vihet re se 81,1 %, e personave të proceduar kanë qenë të papunë);
- Kërkesë - Oferta në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar, përherë në rritje;
- Standardet e ndryshme ligjore që zbatohen në vendet e destinacionit (kryesisht në Evropë), për konsumin e lëndëve narkotike;
- Pozicioni gjeografik ku përgjithësisht mbillet lënda narkotike;
- Kushtet klimaterike të favorshme për kultivimin e bimëve narkotike;
- Vitet e tranzicionit në vendin tonë krijuan dhe kushtet kryesore për kultivimin e kësaj bime narkotike;
- Emigracioni i popullsisë drejt vendeve të tjera;
- Fitimet e larta financiare që sigurohen nëpërmjet kultivimit të bimëve narkotike dhe trafikimit të lëndëve narkotike, nuk mund të konkurrojnë ndonjë bimë tjetër të destinuar për industrinë, si një nga format e pasurimit të qytetarëve në një kohë të shpejtë;
- Ndërthurja e ngushtë e veprimtarisë së rrjeteve kriminale me ato që veprojnë në vendet e Bashkimit Evropian si dhe fuqia e konsiderueshme financiare e grupeve dhe rrjeteve kriminale., etj.


## **VEPRAT PENALE TË REGJISTRUARA PËR NARKOTIKËT GJATË VITIT 2016**

Në kriminologji, krimi korporatave u referohet krimeve të kryera ose nga një shoqëri ( p.sh. një njësi biznesi që ka një personalitet të veçantë juridik nga personat fizikë që menaxhojnë aktivitetet e saj), ose nga individë që veprojnë në emër të një korporate apo subjekti tjetër biznesi (shih deleguar detyrimi dhe përgjegjësia e korporatave). Disa sjellje negative nga korporatat nuk mund që në të vërtetë të jetë penale; Ligjet ndryshojnë midis juridiksioneve. Për shembull, disa juridiksione lejojnë tregtimin të brendshëm.

Krimi korporatave përputhet me:

- Krimin e jakës së bardhë, sepse shumica e individëve që mund të veprojnë si ose të përfaqësojnë interesat e korporatës janë profesionistë të jakës të bardhë;
- krimin të organizuar, për shkak se kriminelët mund të ngrenë korporata ose për qëllimet e krimin apo si mjete për pastrimin e produkteve të krimin; dhe
- Krimi shtet-korporatave, sepse, në shumë kontekste, mundësi për të kryer krimin del nga marrëdhëniet midis korporatës dhe shtetit.

Lloji i veçantë i “white-collar crime” është *krimi i korporatës* ( krimi kolektiv ose korporativ- corporate crime), që i përfshin aktivitetet kriminale të personave juridik ose aktivitetet e ndërlidhura të individëve ose të organizatave kriminale në kryerjen e veprimeve të tyre profesionale, dhe për të cilin lloji krimi, më shumë vlerë dhe rëndësi ka vetë organizimi se sa veprimet me të cilat kryhen aktet kriminale. Si formë e “ krimin të jakave të bardha”, krimi i korporatave ka për qëllim më shumë arritjen e fitimeve të paligjshme për kompaninë se sa për fitime personale ( direkte). Për këtë shkak, në legjislativat moderne më shumë fillon të “peshojë” njohuria se lënia mënjanë e aktiviteteve kriminale të korporatave, në emër të autonomive të tregut dhe në emër të lirisë së sipërmarrjeve, dhe fokusimi ose përqëndrimi i interesit tek e drejta penale mbi krimin e shtresave më të ulta , ose eventualisht mbi individët e oligarkisë ekonomiko-politike, nuk rezulton me ulje, por përkundrazi me një rritje shpërthyesë të krimin të lidhur me krijimin e fitimeve jolegale. Rezultat i një ndryshimi të tillë

është rivënia e përgjegjësive penale për personat juridikë në të gjithë legjislacionet moderne penale. Pjesë plotësuese e Rregullativës së re është ndarja e qartë e dy bazave të përgjegjësive të strukturave udhëheqëse në kompanitë private:

1. Përgjegjësi për vepra të kryera në emër të kompanisë dhe për kompaninë, dhe
2. Përgjegjësi për vepra të kryera kundër interesave të kompanisë ose kundër aksionerëve të saj (mashtime, keqpërdorime financiare nga ana e menaxhuesve të kompanive etj).

Krimi i korporatave është bërë i ndjeshëm politikisht në disa vende. Në Mbretërinë e Bashkuar, për shembull, pas publicitetit të gjerë të aksidenteve fatale në rrjetin hekurudhor dhe në det, termi është përdorur zakonisht në lidhje të korporatave me vrasje dhe janë të përfshira në diskutime më të përgjithshme në lidhje me rreziqet teknologjike që vijnë nga ndërmarrjet e biznesit<sup>1</sup>.

Në Shtetet e Bashkuara, Akti Sarbanes-Oxley e 2002 u miratua për të reformuar praktikat e biznesit, duke përfshirë përgjegjësi të zgjeruara të korporatave, shpalesjeve financiare, dhe mashtime luftarake, pas skandaleve që patën shumë publicitetet, si korporata Enron, Worldcom, Freddie Mac, Lehman Brothers, dhe Bernie Madoff. Shefi ekzekutiv i kompanisë (CEO) dhe zyrtari kryesor financiar i kësaj kompanie (CFO) janë detyruar që për të personalisht të vërtetojnë raporteve financiare të jenë të sakta dhe në përputhje me ligjet në fuqi, me dënime penale për sjellje të keqe me dashje duke përfshirë gjopa monetare deri në 5.000.000 \$ dhe dënim me burg deri në 20 vjet.

Komisioni i Reformës Ligjore i New South Wales ofron një shpjegim të aktiviteteve të tilla kriminale:

Krimi i korporatave paraqet një kërcënim të rëndësishëm për mirëqenien e komunitetit. Duke pasur parasysh praninë e përhapur të korporatave në një gamë të gjerë të aktiviteteve në shoqërinë tonë, dhe ndikimi i veprimeve të tyre në një grup më të gjerë të njerëzve që janë të prekur nga veprimi individual, dëmi ekonomik dhe fizik i shkaktuar nga një korporatë është shumë i madh<sup>2</sup>.

---

<sup>1</sup> shih Wells : 2001

<sup>2</sup> Komisioni i Ligjeve Reforma e New South Wales: 2001

Aktivitetet individuale për biznes e përforcojnë rolin e korporatave, enteve tregtare, me qëllim pamvarësisë prej qëndrimeve të mëparshme liberale për tu ruajtur të drejtat e konsumatorëve dhe konkurrencës së ligjshmërive të tjera tregtare dhe parandalimin e akteve joligjore të personave juridik. Krimi korporativ ka për qëllim sa më shumë përfitim ilegal se sa profit personal. ( individual),

Legjislativa (ligjvënja) bashkëkohore me qëllim të ruajtjes së interesit të shtresave të varfëra, ose eventuaisht të anëtarëve të oligarhisë ekonomiko-politike nuk rezulton me zvogëlimin, por përkundrazi me zmadhim eksploziv të krimit të lidhur me krijimin e profiteve ilagale(jolegale).

Përgjegjësia ndëshkuese e personave juridik në legjisllativën bashkëkohore është pjesë komplementare e rregullativës së re dhe ndarje e elementeve të përgjegjësisë të strukturave udhëheqëse dhe përgjegjësi për veprat kundër interesave të kopmanisë ose aksionerëve. Përgjegjësia ndëshkuese e personave juridik është e përforcuar me përgjegjësinë e personave përgjegjës dhe keqpërdorimin e pozitës zyrtare.

### **3. DISA NGA LLOJET E KRIMIT TË KORPORATAVE DHE KRIMIT TË JAKAVE TË BARDHA**

Falsifikimi i informacionit financiar:

- *keqinterpretime të gjendjes financiare;*
- *projektimi i mashtrimeve tregtare duke fryrë fitimet ose për të fshehur humbjet; dhe*
- *transaksionet e paligjshme të dizajnuara për të shmangur mbikëqyrjen rregullatore.*

Veti që kanë të bëjnë me organizimin e brendshëm të korporatave:

- *Tregtimin të brendshëm (tregtar bazuar në materiale, informacion jo publik);*
- *Ryshfete;*
- *Keqpërdorimi i pronës së përbashkët për përfitime personale; dhe*
- *Shkeljet individuale tatimore që lidhen me vetë-trajtimin.*
- *Mashtrimi në lidhje me një fond tjetër në mënyrë legjitime me qëllim të tregtimit vonë;*
- *Disa Skema për kohën e tregut; dhe*



- *Falsifikimi i vlerave të aseteve neto.*

Pengimi i drejtësisë i projektuar për të fshehur ndonjë nga llojet e mësipërme, vuri në dukje sjelljet kriminale.

### **Pastrim parash**

Pastrimi i parave është proces me të cilin kriminelët bëjnë fshehjen ose kamuflimin e të ardhurave të tyre dhe t'i bëjnë ata që të duken se kanë ardhur nga burime të ligjshme.

Pastrimi i parave lejon kriminelët për të fshehur dhe për të grumbulluar pasuri, për të shmangur ndjekjen penale, për t'iu shmangur taksave, të rritur fitimet nëpërmjet riinvestimit, dhe financimin e aktiviteteve të mëtejshme krimiale.

Ndërsa ekzistojnë shumë përkufizime për pastrimin e parave, ajo mund të përkufizohet shumë thjesht si kthimi nga para "të pista" në të holla "të pastra" dhe të regullta. Dhe kjo është një e rëndësishme e pastrimit të parave të krimit, që mund të minojnë integritetin dhe stabilitetin e institucioneve financiare dhe të sistemeve, dekurajojnë investimet e huaja, dhe të shtrembërojnë flukset ndërkombëtare të kapitalit.

Pastrimi i parave është i lidhur zakonisht me krimet që ofrojnë një fitim financiar dhe kriminelëve të cilët angazhohen në pastrimin e parave, u rrjedhin të ardhurat e tyre në shumë mënyra.

Disa nga krimet e tyre përfshijnë:

- *krimet komplekse financiare*
- *mashtrim me kujdesin shëndetësor*
- *trafikimi i qenieve njerëzore*
- *korrupsionit publik ndërkombëtar dhe vendas*
- *trafikimi i narkotikëve*
- *terrorizëm*

Numri dhe shumëllojshmëria e metodave të përdorura nga kriminelët për të pastruar paratë e bën të vështirë për të siguruar një listë të plotë, por këtu janë disa nga mënyrat me të cilat kriminelët pastrojnë të ardhurat e tyre të paligjshme:

- *institucionet financiare*
- *tregtia ndërkombëtare*
- *metale të çmuara*

- *pasuri të patundshme*
- *ofruesit e shërbimeve palës së tretë*
- *monedhat virtuale etj*

Ka tre hapa në procesin e pastrimit të parave-*vendosjen, layering, dhe integritit*. Vendosja paraqet hyrjen fillestare të të ardhurave të kriminelëve në sistemin financiar. Layering<sup>3</sup> është më komplekse dhe shpesh përfshin lëvizjen ndërkombëtare të fondeve. Layering ndan të ardhurat e kriminelit nga burimi i tyre origjinale dhe krijon një shteg të ndërlikuar të auditimit nëpërmjet një seri transaksionesh financiare. Dhe integrimi ndodh kur të ardhurat kriminale janë kthyer në atë fazë që duken se vijnë nga burime të ligjshme.

### **Letrat me vlerë**

Integrimi i vazhdueshëm i tregjeve kapitale globale ka krijuar mundësi të paparë për bizneset për të hyrë në kapitalin dhe investorët për të diversifikuar portofolet e tyre. Qoftë nëpërmjet llogarive individuale, planet e kursimeve, ose llogaritë e daljes në pension, gjithnjë e më shumë njerëz sot po zgjedhin për të investuar në letrat me vlerë dhe mallrave në tregjet e ndërkombëtare. Kjo rritje ka çuar në një rritje korresponduese në vlerë prej mashtrimit dhe sjellje parë në këto tregje. Krijimi i mjeteve komplekse të investimeve dhe rritja e madhe në sasinë e parave të investuara kanë krijuar mundësi më të mëdha për individët dhe bizneset për të kryer skemat mashtruese të investimeve.

Në vijim janë llojet më të përhapura të letrave me vlerë dhe të mallrave skemat e mashtrimit:

**Mashtrimi i investimeve:** Skemat e mashtrimit e investimeve tipike karakterizohen nga oferta të ulëta ose pa-rrezik me investimet, kthimit të garantuar, kthimit tepërtë qëndrueshëm, strategjive komplekse, apo letrat me vlerë të paregjistruara. Këto skema shpesh kërkojnë që të përndjekin grupe të tilla me prirje si grupe me një fe të përbashkët apo etnie, të shfrytëzojnë interesat e përbashkëta për të ndërtuar besimin për të vepruar në mënyrë efektive mashtrimin e investimeve kundër tyre. Investitori duhet të mbledhë sa më shumë informacion të jetë e mundur para se të hyjnë në ndonjë nga mundësitë e reja për investime. Këtu janë disa shembuj të llojeve më të zakonshme të skemave të mashtrimit të investimeve:

---

<sup>3</sup> Kthimi në para të ligjshme

**Skemat Ponzi:** Këto skema përfshijnë pagesën e kthimit të supozuar për investitorët ekzistues nga fonde të kontribuara nga investitorët e rinj. Skemat Ponzi shpesh ndajnë karakteristika të përbashkëta, të tilla si duke ofruar kthime tepër të qëndrueshme të investimeve, investimet e paregjistruara, të kthimit të lartë me strategjitë pak ose aspak rrezik, apo të fshehta apo komplekse.

**Skemat piramidale:** Në këto skema, si në skemat Ponzi, paratë e mbledhura nga pjesëmarrësit e ri u paguhet pjesëmarrësve të mëparshëm. Në skemat piramidale, megjithatë, pjesëmarrësit marrin nga komisionet për rekrutimin e pjesëmarrësve të rinj në skemë. Skemat piramidale janë të maskuar shpesh si programet e marketingut multi-nivel.

**Mashtrimet me tarifa të avancuara:** Skemat tarifave të avancuara kërkojnë viktimat të paguajnë tarifa të majme me shpresën për të realizuar fitime shumë më të mëdha. Në mënyrë tipike, viktimat thuhet se për të marrë pjesë në një program investimi fitimprurës ose për të marrë çmimin nga një llotari / lotari, ata së pari duhet të dërgojnë fonde për të mbuluar kosto, shpesh të maskuar si një tarifë tatimore ose pjesëmarrje. Pas pagesës së parë, kryerësi do të kërkojë fonde shtesë për shpenzimet e tjera "të papritura".

#### **4. AFERA PANAMA PAPPERS NXORRI NË PAH KRIMIN E JAKAVE TË BARDHA**

Një nga dëshmitë më të mëdha në lidhje me krimin e korporatave, krimine jakave të bardha si dhe kycjen e politikanëve më të fuqishëm botëror në këtë lloj kriminaliteti, e cila ka bërë bujë në mediumet botërore, është afera shekullore "Panama Pappers", e cila nxorri në pah shumë transaksione të dyshimta.

Gazetarët hulumtues kanë postuar online për herë të parë një bazë të të dhënave, e cila tregon për asetet dhe pasurinë jashtë vendit të politikanëve dhe njerëzve të njohur nga e gjithë bota.

Baza e të dhënave e Konsorciumit Ndërkombëtar të Gazetarëve Hulumtues, që mbulon më shumë se 200 mijë kompani inaktive në Panama, nga 9 maji mund të përdoret në faqen, [offshoreleaks.icij.org](http://offshoreleaks.icij.org).

Aty ka informacione të ndryshme, të nxjerra nga rrjedhja e miliona dokumenteve nga një firmë ligjore, Mossack Fonseca në Panama, e cila është e specializuar në krijimin e këtyre lloj kompanive inaktive, me qëllim të kryerjes së manovrave të ndryshme financiare.

Kjo firmë ligjore kishte provuar, por pa sukses, që ta bllokonte punën e këtij konsorciumi, i cili përfshin redaktorë e gazetarë nga dhjetëra vende. Baza e të dhënave përmban hollësi për asetet e fshehura të qindra politikanëve, zyrtarëve, njerëzve të njohur e të famshëm, si dhe yjeve të sportit, të përmendur në këto storje.

Por, kjo bazë realisht përmban vetëm një fraksion të materialeve të “Letrave origjinale të Panamasë”. Aty përjashtohen emailt e kompanive, transaksionet financiare, pasaportat e skanuara, dhe dokumente të tjera origjinale, që janë pjesë e rrjedhjes masive. Gjithashtu, jo secili pronar i një kompanie në “Letrat e Panamasë” paraqitet në bazën e të dhënave, që tashmë është publike, ka njoftuar Konsorciumi. Sipas tyre, meqë disa informacione janë vetëm në emailt e kompanisë Mossack Fonseca dhe dokumentet e tyre të brendshme, ato nuk mund të nxirren sistematikisht. Konsorciumi kishte për qëllim ta ngrisë vetëdijen e publikut për mënyrat se si sistemet bankare jashtë vendit u mundësojnë individëve të pasur që t’u ikin taksave, përderisa zyrtarët e korruptuar qeveritarë kanë mundësi t’i fshehin plaçkitjet e tyre.

“*Dokumentet e Panamasë*” treguan se si disa njerëz të pasur përdorën kompani jashtë vendeve të tyre për të shmangur taksat dhe sanksionet. Dokumentet kanë treguar asetet e fshehura të qindra politikanëve, zyrtarëve, ish-liderëve dhe liderëve të kombeve në detyrë, njerëz të famshëm dhe yje të sportit. Mes tyre janë ish Kryeministri i Britanisë së Madhe, David Cameron, presidentët Vladimir Putin i Rusisë, Petro Poroshekno i Ukrainës dhe Mauricio Macri i Argjentinës, bashkë me yllin e futbollit Lionel Messi, aktorin Jackie Chan dhe regjisorin spanjoll, Pedro Almodovar. Ish-kryeministri i Islandës, Sigmundur Gunnlaugsson, dha dorëheqjen pasi këto dokumente dolën në dritë. Pikërisht, file-t e zbuluara, të njohura si Panama Papers, përmbajnë, midis të tjerash, zotërimet offshore të këtyre individëve.

Këto file-e, në total mbi 11.5 miliona dokumente, përmbajnë detaje të një skandali financiar global. Nuk kanë munguar dhe emra individësh e kompanish në listën e zezë të SHBA-ve, për përfshirje në biznes me lordët e drogës, me organizata terroriste, me vende të tilla si Koreja e

Veriut etj. Shtojmë se një pjesë e informacionit përftohet nga “rrjedhjet” prej fileve të ndryshme, regjistrimeve të pronës, dokumenteve financiare, vendimeve gjyqësore, intervistave me ekspertë të pastrimit të parasë, zyrtarëve të zbatimit të ligjit etj.

Ashtu si dhe në shtete të tjera dhe në Sqipëri ekzistojnë firma që kanë investuar dhe që janë pjesë e skemës “off shore”. Deri më tani kanë mbi 20 firma që rezultojnë të kenë lidhje me këtë proces. Sa i përket R. të Maqedonisë nuk ka ndonjë informacion të saktë në lidhje me atë se a ka persona të involvuar në këtë aferë shekullore.

Për të ilustruar tronditjen e krijuar në botë nga Panama Papers po sjellim këtu shembujt e mëposhtëm:

Pas botimit të dokumenteve, i pari që dha dorëheqjen nën një trysni popullore ishte Kryeministri i Islandës, Gunnlaugsson.

Ai zotëronte së bashku me gruan një kompani offshore në ishujt britanikë të Virxhinias.

Kur ky politikan i ri erdhi në pushtet, në vitin 2013, ai premtoi vendosjen e interesit kombëtar mbi interesat e tij financiare. Në fakt, ai me kolapsin e bankave kishte në zotërim miliona dollarë në bonde si gjysmë-pronar i një kompanie offshore të quajtur Wintris Inc. Por, me futjen e tij në Parlament një gjë e tillë dhunonte etikën parlamentare dhe shprehte një konflikt interesi, pavarësisht që ai ia kaloi këtë zotërim gruas së tij, që më 2009. Madje, sipas tij, ajo kishte qenë zotëruesja e vërtetë e aksioneve edhe më parë.

Edhe Kryeministri britanik, David Cameron, u ndodh në një situatë politike tepër të vështirë dhe një acarimi të dukshëm të opinionit pas bërjes publike të detajeve të fondit të investimeve offshore të babait të tij, prej të cilit ai kishte përfutuar mjaft asete, që i shiti sapo u bë

Kryeministër.

Nën këtë trysni publike, ndryshe nga praktika e deritanishme, ai e bëri plotësisht transparent bilancin e tij financiar për vitet e fundit (sipas këtij bilanci, edhe e ëma i kishte transferuar 200,000 paund në llogarinë e tij, të ndara në dy pagesa, për të shmangur taksën e trashëgimisë).

Pas tij, e bënë publike këtë bilanc kancelari G. Osborne, kryetari i opozitës J. Corbyn dhe kryetari i Bashkisë së Londrës B. Johnson.

Po ashtu, në fjalën e tij në Parlament, Cameron premtoi krijimin e një “task-force” lidhur me Panama Papers, si dhe formulimin e rregullave të reja, në shërbim të autoriteteve tatimore për të penalizuar firmat e korporatat, që do të lehtësojnë evazionin fiskal. Po ashtu, sipas tij, edhe rajone të tilla si Ishujt Virxhinia apo Kejman do të detyrohen që të furnizojnë informacion mbi zotëruesit e kompanive off-shore për autoritetet tatimore dhe ato të zbatimit të ligjit (por jo patjetër për publikun!).

Sipas Panama Papers, mbi 2 miliardë dollarë janë shpërndarë nëpër banka dhe kompani hije nga bashkëpunëtorë të Putinit. Por, ama, në file-et e Mossack Fonseca nuk ekziston emri i Presidentit rus, edhe pse është vështirë që ai të mos jetë në dijëni të këtyre veprimeve të miqve të tij.

Vetë Banka Rossiya është identifikuar si instrumentale në ndërtimin e një rrjeti të fshehtë kompanish offshore, duke realizuar transaksione bankare në Rusi, Qipro dhe Zvicër. Kina. Nuk është sot sekret që fëmijë apo nipër e mbesa të heronjve të Revolucionit Kinez kanë arritur suksese në botën e biznesit. Sot, ekonomia e Kinës është bërë ekonomia e dytë në botë, duke mundësuar kështu krijimin e disa qindra miliardëve kinezë. Në fakt, kjo lidhet dhe me një politikë konkrete për ruajtjen e pushtetit! Por, problemi qëndron tek ata individë që nëpërmjet lidhjeve politike janë përfshirë në rrjetet offshore për të fshehur zotërimet e tyre. Aq më tepër që disa prej tyre i mësuan “sekretet” e botës offshore në moshë fare të re!

Pavarësisht se autoritetet kineze i hodhën poshtë akuzat e “Panama Papers”, në këto dokumente flitej për të afërm të disa drejtuesve më të lartë të Partisë Komuniste (p.sh., lidhje familjare të Xi Jinping, një nip nga gruaja e Mao Zedong, vajza e Li Peng dhe i shoqi i saj, mbesa e Jia Qinglin, dhëndri i Zhang Gaoli, nusja e Liu Yunshan, vëllai i Zeng Qinghong, djali i Hu Yaobang, etj.) me kompani, prona, zotërimet apo tituj offshore. Dorëheqja e ministrit në Spanjë. Margarita Garcia-Valdecasas Salgada, që drejton zyrën e

investigimit të abuzimeve në agjencinë e taksave në Spanjë, iu drejtua direkt ICIJ duke kërkuar: “shkëmbimin e informacionit për individë spanjollë dhe entitete që do të na ndihmonin për luftuar evazionin tatimor dhe abuzimet me taksat në Spanjë”. I pari që dha dorëheqjen, prej informacioneve të ICIJ, ishte ministri spanjoll i Industrisë, José Manuel Soria, për zotërimet e tij offshore. Në fakt, ai, fillimisht, në gazetën online “El Confidencial” dhe në televizionin “La Sexta”, mohoi çdo lidhje me kompaninë e vendosur në Panama apo me ndonjë parajsë tjetër taksash. Por, shumë shpejt, media spanjolle zbuloi një mori gënjeshtresh mbi përfshirjen e tij në kompani offshore, që kulmoi me gazetën “El Mundo”.

Aty, u provua se ministri kishte qenë drejtor i një kompanie me qendër në Xhersi, që nga viti 2002, kur ai ishte i përfshirë në politikë. Duke dhënë dorëheqjen, ai theksoi se po tërhiqej nga posti për shkak të një “serie gabimesh” të ditëve të fundit në shpjegimin e aktiviteteve të biznesit të tij, gjë që i bëri një dëm të madh edhe vetë qeverisë spanjolle. Protestat në Maltë. Sipas Panama Papers, ministri i Shëndetësisë dhe Energjisë i Maltës, Konrad Mizzi, zotëron një kompani në Panama dhe një trust në Zelandën e Re. Përballë këtij “dekonspirimi”, ai u kërkoi autoriteteve tatimore të kryenin një auditim të financave të tij dhe se me mbarimin e tij ai do ta mbyllte kompaninë. Nën të njëjtat akuza u ndodh edhe shefi i kabinetit i Kryeministrit, Keith Schembri. Këto fakte, tashmë të ekspozuara, e kanë rritur presionin e opozitës mbi Kryeministrin e Maltës, Joseph Muscat, për të dhënë dorëheqjen.

Midis emrave e vendeve të përfshirë në Panama Papers janë dhe disa individë e kompani nga Shqipëria. Sipas të dhënave të deritanishme, të publikuara nga ICIJ, janë 2 kompani, 3 individë përfitues e 22 aksionerë shqiptarë të gjetur në dokumentet e firmës. Njëri prej tyre është bashkëthemeluesi i kompanisë “GFI Technologies”, të regjistruar në vitin 2013 në ishullin Anguila, për të investuar më tej në kompani shqiptare të teknologjisë së lartë. Sipas të njëjtave burime dhe gazetës izraelite “Haaretz”, Ismail Mulleti, avokati Asaaf Halkin dhe firma kanadeze “Global Fluid International” janë pronarët e kompanisë “GFI Technologies”. Madje, sipas të dhënave të qendrës kombëtare të regjistrimit “Global Fluid International”, është një nga ortakët e kompanisë “GFI Albania”. Kjo e fundit është shoqëria e kontraktuar, në shkurt të 2013- s, për markimin dhe monitorimin e karburanteve në Shqipëri.

Zyrtarët e taksave të 28 vendeve më të fuqishme, të cilat janë të përfshira në aferën Panama Papers janë takuar në Paris për të zhvilluar strategjinë e një veprimi të përbashkët, pas daljes së skandaleve të Panama Papers. Midis tyre përfshihen dhe propozimet për një investigim tatimor global dhe përpunimin e një sistemi rregullator ndërkombëtar, që të shmangë shformimet në veprimtari të tilla, ose kontrollin ligjor të tyre

## **KONKLUZION**

Nga e gjitha ajo që folëm më sipër, si dhe nga gjithë studimi ynë, kemi ardhur në përfundim se brenga më e madhe, krimi më i rrezikshëm i kohës moderne është krimi i korporatave dhe krimi i jakave të bardha pasi që në këtë lloj krimi kryesisht janë të involvuar pikërisht shumica e individëve ose grupe individësh të cilët duhet të luftojnë kete fenomen në mënyre të drejtpërdrejtë apo tërthorazi.

Jemi të mendimit se Organizatat dhe Unionet Ndërkombëtare duhet të formojnë një sektor të vecantë të përbashkët me njerëz të kualifikuar. Të cilët duhet të merren në mënyrë të detajuar me çdo lëvizje financiare. Përvoja e deritanishme tregon se personat e impikuar në afera të tilla në një mënyrë apo një tjetër ia kanë dalë që të dënohen minimalisht ose janë lënë të lirë, prandaj mendojmë se masat që duhet të ndërmerren duhet të jenë më të ashpra dhe të mos kihet mëshirë për personat e kyqur në këtë lloj kriminaliteti.

## **Referenca:**

1. Forensic Accounting and Fraud Examination, by Mary-Jo Kranacher, Richard Riley, Joseph T. Wells (Wiley 2010);
2. D. Nasufi. Krimi i Organizuar dhe Masat e vecanta per zbulimin e tij ne RM. Struge, 2016;



3. Fabian. Zhilla. & Besfort Lamallari. Vlerësim i riskut të krimit të Organizuar në Shqipëri. Tirane.2015;
4. Sally.S. Simpson & David Weisburd. The criminology of white collar crime;
5. Crazy Eddie CFO: 'We are in the golden era of white-collar crime', by Matt Eagan, CNN Inside Wall Street, November 17, 2014;
6. Analiza nga ILIR DHIMA. Përfitimi ekonomik si bazë e krimittë organizuar. Tirane.2014
7. <http://fax.al/read/news/3749950/11706011/panama-papers-dalin-emrat-e-firmave-qe-kane-investime-ne-shqiperi>;
8. <http://www.xlpress.tv/37154-2/>;
9. [https://en.wikipedia.org/wiki/Panama\\_Papers](https://en.wikipedia.org/wiki/Panama_Papers);
10. <http://www.askk-ks.com/mafia-krimi-i-organizuar-krimi-i-jakave-te-bardha/>;
11. <https://www.theguardian.com/news/series/panama-papers>.

**MAQEDONIA DHE UNIONI EVROPIAN****Msc.Liridon ZENKU**

Mehmed Mehmedi Nr. 31 Kërçovë R. Maqedonisë

zenku78@hotmail.com

**Abstrakt**

Integrimi i Maqedonisë në Unionin Evropian është një temë mjetë diskutabile dhe aktuale por jo edhe e re. Unioni Evropian prej themelimit 1951, vazhdimisht i ka pasur të hapura duert për anëtarë të ri, në vitin 1993 në Kopenhagë u vendosën disa kritere për anëtarët të cilët dëshironin të bëhen pjese e saj, Maqedonia nuk e shrytzoj këtë për shkaqe të shumta si emri, konflikti etnik, korrupcioni, gjuqësori, mediat e lira etj.

Komisioni Evropian në vitin 1999, zhvilloji të ashtuquajturën Marveshja për Stabilizim-Asocimi, që është një strukturë politike e cila shërbente për nxitjen e vlerave dhe parimeve evropiane, hapjen dhe mundësinë e gjetjes së rrugës për integrim në UE dhe krijimin e kushteve për zbatimin e reformave.

Samitit të Thesalonik-it në qershor të vitit 2003 që kishte si agjendë Ballkanin perëndimore dhe rrugën e saj drejt anëtarësimit në UE, u bëri thirrje të gjithë anëtarëve që deshën të bëheshin anëtarë të unionit Evropian, se do të bëhen pjesë integruese e UE-së, pasi ti kenë plotësuar kriteret e Kopenhagën-it.

Kushti më i rëndësishëm që Unioni Evropian dhe Shtetet Evropiane i kërkojnë Maqedonisë për tu pranuar në familjen e madhe Evropiane, është kushti politik.

Një ndër kushtet që Unioni European kërkon prej Maqedonisë është sigurimi i të drejtave të të gjithë qytetarve të saj , në mënyrë të barabartë pa dallime race, fesë, komunitetit etj.

Në këtë punim do të bëjmë një analizë të shkurtër se në çfarë etape kanë arritur aktivitetet për antarsimin e Maqedonisë, fazat nëpër të cilat ka kaluar Maqedonia, krizat të cilat e cinguan integrimin e Maqedonisë si dhe problematikat kryesore që janë shkaku kryesor që ky vend ngelet jashtë kornizës të ashtuquajtur Unioni Evropian.

**Fjalët kyçe:** *Integrimi, kushtet, aktivitetet, Maqedonia, Unioni Evropian.*

## **HYRJE**

Kushti më i rëndësishëm që Unioni European dhe Shtetet Europiane i kërkojnë Maqedonisë për tu pranuar në familjen e madhe Europiane, është kushti politik. Një ndër kushtet që Unioni European kërkon prej Maqedonisë është sigurimi i të drejtave të të gjithë qytetarve të saj , në mënyrë të barabartë pa dallime race, fesë, komunitetit etj.

Ekonomia është në fazën e tranzicionit , me shumë probleme ende të pazgjidhura të tranzicionit. Papunësia është problemi më i madh , 38 % ( 2005) . Korrupsioni është një dukuri sistemike. Gjyqësia joefikase gjithashtu ndikon negativisht në ekonominë. Niveli i investimeve të brendshme dhe të jashtme është i ulët. Infrastruktura është në gjendje relativisht të mirë, por ka nevojë për investime në këtë fushë (në radhë të parë në atë të transportit dhe komunikimit që lidhë lindje-perëndim ).Maqedonia është anëtare e organizatës ndërkombëtare tregtare dhe ka një ekonomi të hapur.

Konflikti etnik në Maqedoni, që ishte pasojë e mosë respektimit të të drejtave dhe lirive të shqiptarëve dhe pakicave të tjera në këtë vend, i kushtoi Maqedonisë goxha shumë që cungoji integrimin e Maqedonisë drejtë UE. Një ndër shqetësimet më të mëdha që pengojnë integrimin e Maqedonisë drejtë Unionit Evropian është përmbushja e kriterve që i ka vënë UE-ja në Kopenhagë.

## 1.HISTORIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

**Maqedonia**, (*greqisht: Μακεδονία*, *latinisht: Makedonía*) ishte emri i mbretërisë që shtrihej në pjesën veriore të Greqisë antike, e kufizuar me mbretërinë e Epirit gjer në perëndim dhe me Thrrakinë në lindje. Maqedonia antike ekzistoi që nga viti 800 p.e.s. e gjer në vitin 146 p.e.s. Për një periudhë shumë të shkurtër u bë shteti më i fuqishëm në Lindjen e Afërt antike, pasi që Leka i Madh pushtoi pjesën e madhe të botës së njohur duke inauguruar periudhën helenike të historisë antike greke<sup>1</sup>.

Në OKB ky shtet njihet me emrin ish Republika Jugosllave e Maqedonisë për shkak të konfliktit rreth emrit me Greqinë e cila pretendon territorin e Maqedonisë antike.

Kryeqytet i Republikës së Maqedonisë është Shkupi.

Si çdo shtetë edhe R. Maqedonisë ka elemente kryesore si që janë : flamuri, stema dhe himni.

### 1.1.Gjeografia e Maqedonisë

Republika e Maqedonisë (sllavomaqedonisht: Република Македонија) është shtet që shtrihet në pjesën juglindore të Evropës (koordinatat gjeografike 41°50' V, 22°00' L) e që kufizohet në lindje me Bullgarinë në një vi kufitare të gjatë 148 km, në jug me Greqinë në një vi kufitare prej 246 km, në perëndim me Shqipërinë në një vi kufitare prej 151 km dhe në veri me Kosovën dhe Serbinë.

Sipërfaqja e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë është 25,333 km<sup>2</sup>. Vendi shtrihet në koordinatat gjeografike 41 50 V, 22 00 L ku 24,856 km<sup>2</sup> të kësaj sipërfaqeje janë tokë ndërsa 477 km<sup>2</sup> ujë. Vija kufitare e Republikës së Maqedonisë është 25,333 km ndërsa vijë bregdeare nuk ka. Klima e Republikës së Maqedonisë është e ngajshme me të Mesdheut e nxehtë me vera të thata e dimra të ftohta me reshje dëbore të mëdha. Pjesa më e madhe e relievit është terren i vrazhdë, përpos luginës së Vardarit këtë e zbusin edhe rrethina e liqeneve të mëdha. Pika më e ultë e relievit gjendet përgjatë bregut të lumit Vardar (50m) dhe ajo më e larta në lartësi mbidetare prej 2,764 metrave në vendin e quajtur Maja e Korabit.

<sup>1</sup> Maqedonia e lashtë [http://sq.wikipedia.org/wiki/Maqedonia\\_e\\_lasht%C3%AB](http://sq.wikipedia.org/wiki/Maqedonia_e_lasht%C3%AB)

## 1.2. Demografia e Maqedonisë

Sipas regjistrimit të vitit 2002 në Maqedoni jetojnë:

- Maqedonë 1.297.981 (64,18 %)
- Shqiptarë 509.083 (25,17 %)
- Turq 77.959 (3,85 %)
- Romë 53.879 (2,66 %)
- Serbë 35.939 (1,78 %)
- Boshnjakë 17.018 (0,84 %)
- Rumunë 9.695 (0,48 %)
- Të tjerë 20.993 (1,04 %).

Në Maqedoni jetojnë gjithësej 2,022,547 banorë, ku prej tyre 1,015,377 ( 50,20%) të gjinisë mashkullore, dhe 1,007,170 (49,80%) të gjinisë femrore.

Sipas regjistrimit të fundit në Maqedoni ka 564,296 shtëpi dhe 698,143 banesa.

Në këtë vend jetojnë më shumë etnitete si: maqedonë, shqiptarë, turqë, romë, serb, vllahë, bullgarë, kroatë, grekë etj.

Përdoren këto gjuhë: maqedonishtja, shqipja, turqishtja, gjuha rome, serbishtja etj.

## 1.3. Ekonomia e Maqedonisë

Maqedonia pas pavarësisë së saj nga Jugosllavia pas referendumit, Ekonomia ka shkuarë në rënie në vitet nëntëdhjetë për shkak të faktorëve të shumtë: rënia e tregut të përbashkët, luftërat në ish-Jugosllavi, bllokada Greke , sanksionet kundër Jugosllavisë dhe shumë etj . Në fund të viteve nëntëdhjetë ekonomia ngadalë fillon të rritet dukshëm, por ajo është ndërprerë sërish nga lufta në Kosovë në vitin 1999 dhe konfliktin i brendshëm etnik i vitit 2001. Ekonomia sotë ngadalë shkonë përpara.

Ekonomia është në fazën e tranzicionit, me shumë probleme ende të pazgjidhura të tranzicionit . Papunësia është problemi më i madh , 38 % ( 2005) . Korrupsioni është një dukuri sistemike . Gjyqësia joefikase gjithashtu ndikon negativisht në ekonominë. Niveli i investimeve të brendshme dhe të jashtme është i ulët. Infrastruktura është në gjendje relativisht të mirë, por ka nevojë për investime në këtë fushë ( në radhë të parë në të transportit dhe komunikimit që lidhë lindje-perëndim ).Maqedonia është anëtare e organizarës nderkombëtare tregtare dhe ka një ekonomi të hapur.

Sot disa nga problemet janë zgjidhur dhe disa janë në procesin e kapërcimit. Kjo është veçanërisht për shkak të reformave në mënyrë që të bëjë progres drejt BE-së. Gjithashtu ndikim pozitiv pritet nga statusi e vendit kandidat për anëtarësim në BE. Republika e Maqedonisë ka për të realizuar rritje të vazhdueshme dhe të shpejtë të ekonomisë, nëse dëshiron të shkojë më afër me mesataren evropiane .

Monedhës kombëtare - denari i Maqedonisë ( MKD )

Papunësia - 34.9 % ( 2007)

Inflacioni - 2.3 % ( 2007)

**BVP për banorë:** \$8,400 (2007)

**Borxhi publik:** 26.1% nga BVP

**Buxheti:**të ardhura : \$2.381 miliard, shpenzime: \$2.456 miliard,(2007)

**Elektriciteti - prodhim:** 5.935 miliard kwh (2006), **harxhim:** 8.929 miliard kwh (2006), **eksport:** 0 kwh (2003), **import:** 2.994 miliard kwh (2006)

**Nafta** - prodhimi: 0 fuçi/ditë (2005), **konsumi:** 20,000 fuçi/ditë (2005)

## 2.HISTORIA E ZHVILLIMIT POLITIK PREJ VITIT 1991-2000

Njohja ndërkombëtare e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë nga Jugosllavia në vitin 1991 është kundërshtuar nga Greqia për shkak të flamurit dhe emrit Maqedoni (të

konsideruara si simbole të Helenëve). Marrëdhëniet me Greqinë përfundimisht u normalizuan në vitin 1995, por problemet me emrin e Republikës së Maqedonisë akoma ekzistojnë.

Paralelisht me procesin e fitimit të pavarësisë së Republikës së Maqedonisë në vitin 1991, filloi procesin e krijimit dhe pozicionimi i Republikës së Maqedonisë në nivel ndërkombëtar duke krijuar, të komunikimit e bashkëpunimit të zhvillimit dhe duke fituar anëtarësim në organizatat ndërkombëtare. Maqedonia u bë anëtare e Kombeve të Bashkuara më 7 prill 1993, dhe si pasojë e të gjitha agjencive të specializuara, programe dhe fonde nga sistemi i OKB-së. Dy vjet më vonë, në vitin 1995, Maqedonia u bë anëtare e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Këshilli i Evropës, si dhe organizatat tjera relevante rajonale dhe iniciativa.

Pas shpalljes së pavarësisë në janar të vitit 1991, Republika e Maqedonisë e shprehu qartë anëtarësimin në Unionin Evropian si një nga interesat e saj strategjike. Duke e realizuar këtë përcaktim, Republika e Maqedonisë u legjitimua si partner i besueshëm dhe aleat i Unionit Evropian, që kaloi nëpër një varg etapash të ndryshme në zhvillimin e marrëdhënieve, të afrimit dhe të integritimit në UE.

Më 15 janar të vitit 1992, Unioni Evropian formoi Komisionin e arbitrazhit, i udhëhequr nga kryetari i Gjykatës Kushtetues të Francës, Rober Badinter. Komisioni erdhi në përfundim se Republika e Maqedonisë i plotëson të gjitha kushtet për pranimin ndërkombëtar dhe se emri nuk paraqet kërcënim territorial.

Por, për shkak të kundërshtimit të Greqisë që Republika e Maqedonisë të pranohet me emrin kushtetues, u vonua procesi i pranimit ndërkombëtar dhe i vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me UE-në. Marrëdhëniet e plota diplomatike ndërmjet RM-së dhe UE-së janë vendosur në dhjetor të vitit 1995 kur është hapur edhe misioni i RM-së në UE.

Zhvillimet politike dhe ekonomike të Ballkanit perëndimor ka qenë zhgënjyese. Arsyet për këtë kanë qenë: çështjet e sigurisë dhe tranzicioni i ngadalsuar dhe i papërcaktuar<sup>2</sup>.

---

<sup>2</sup> Fedinand Xhaeraj: Deballkanizimi i Ballkanit, Tiranë 2007, fq.99.

Në vitin 1993, Këshilli Evropian, i Kopenhagës përcaktoi kriteret dhe kushtet për anëtarësim në Unionin Evropian, që janë <sup>3</sup>:

1. Kriteri politik- Të ketë institucione stabile që garantojnë demokracinë , sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave.
2. Kriteri Ekonomik- Të ketë ekonomi funksionale të tregut, si dhe kapacitetin për të përballuar presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut Brenda Unionit Evropian.
3. Kriteri Juridik- Aftësia e shtetit për të implementuar *acquis communautaire* (tërsi e të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta që i bashkon të gjitha shtetet anëtare të UE).
4. Kriteri Administrativ- Kapaciteti administrativ i një shteti për të implementuar politikat dhe të drejtën e Unionit Evropian.

Republika e Maqedonisë nga viti 1996 është shfrytëzuese e Programit FARE (PHARE), program i themeluar nga BE për ndihmë reformave të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, të drejtuara kah hyrja në BE.

Në prill të vitit 1997 u nënshkrua Marrëveshja për bashkëpunim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësisë Evropiane, si dhe Marrëveshja nga sfera e transportit, e pastaj edhe për tekstilin. Pastaj Unioni Evropian hapi përfaqësi, përkatësisht zyrë të Komisionit Evropian në Republikën e Maqedonisë.

Në prill të vitit 1998 për herë të parë u mbajt dialogu politik ndërmjet RM dhe BE, ndërsa në mars po të njëjtin vit u mbajt mbledhja e parë e Këshillit për bashkëpunim ndërmjet RM dhe BE. Ai funksiononte me sukses deri në vendosjen e trupit të ri me Marrëveshjen për stabilizim dhe asociim.

Komisioni Evropian në vitin 1999, formon kornizën e re në të cilën zhvillohet bashkëpunim i BE me shtetet e të ashtuquajtur Ballkani Perëndimor. (Republika e

---

<sup>3</sup> Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela, „Institucionet dhe politika e Unionit Evropian, Tetovë 2010, fq.170



Maqedonisë, Bosnje e Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Republika e Kroacisë), të cilin e quajti Proces për stabilizim dhe asociim (PSA)<sup>4</sup>.

Procesi i Asociim-Stabilizimit ishte një strukturë politike e cila shërbente për nxitjen e vlerave dhe parimeve evropiane, hapjen dhe mundësinë e gjetjes së rrugës për integrim në UE dhe krijimin e kushteve për zbatimin e reformave.

### **3.ECURITË INTEGRUESE TË MAQEDONISË PAS VITIT 2000**

Kriza që preku ballkanin përëndimorë vërshtirsojë procesin e integritit të këtyre vendeve drejt UE-së. Maqedonia në vitin 2001 pati një krizë politike, ekonomike, juridike, etnike, që përfundoi me konfliktin etnik.

Konflikti etnik në Maqedoni, që ishte pasojë e mosë respektimit të të drejtave dhe lirive të shqiptarëve dhe pakicave të tjera në këtë vend, i kushtoi Maqedonisë goxha shumë që cungoji integrimin e Maqedonise drejtë UE.

Po në këtë vitë Maqedonia u detyrua ta nënshkrujë të ashtuquajturën Marrëveshja Kornizë e Ohrid, e cila do ta zbutëte kushtetutën, me anë të disa amadamenteve.

Kjo marrveshje Kornizë e Ohrid përbehej prej tri anekseve edhe atë: Aneksi „A”- Amendamentet kushtetuese, Aneksi “B”-Ndryshimet në legjislacion, Aneksi „C”- Implementimi dhe masat e ndërtimit të besimit.

Kjo marrveshje siguron ardhmërinë e demokracisë në Maqedoni dhe mundësimin e zhvillimit të marrëdhënive më të afërta dhe më të integruara ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkësisë Evropiane. Kjo marrëveshje kornizë do ta promovojë zhvillimin e qetë dhe harmonik të shoqërisë qytetare, duke respektuar njëkohësisht identitetin etnik dhe interesat e të gjithë qytetarëve të Maqedonisë<sup>5</sup>.

<sup>4</sup> Kuvendi I Republikës së Maqedonis: <http://www.sobranie.mk/al/?ItemID=4C8C1343A4DB5D4CBB39AD1410F0F87F>

<sup>5</sup> Mersim Maksuti, E drejta kushtetuese, Tetovë 2010, fq.251.

Republika e Maqedonisë është shteti i parë pjesëmarrëse në PSA e cila e nënshkroi Marrëveshjen për stabilizim dhe asocim në prill të vitin 2001.

Marreveshja për Stabilizim dhe Asocim në mes të UE dhe Republikës së Maqedonisë hyri në fuqi më 1 prill 2004 duke sjellur kështu vendin një hap më afër në rrugën drejt integritimeve Europiane. Kjo është marrëveshja e parë për Stabilizim dhe Asocim që hynë në fuqi. Tani marrëveshja i lidh palët që të punojn edhe me tej në stabilizimin politik, ekonomik dhe institucional të vendit, ndërtim institucional dhe reforma në administratë, bashkpunim të zgjëruar tregtar dhe ekonomik, dhe afrim të legjislacionit me *acquis* – in (kriterin juridik) e komunitetit dhe një bashkpunim me të përforcuar në drejtësi dhe punë të mbrendshme. Implementimi i tërësishëm i Marrëveshjes gjithashtu do të krijojë një klimë të re për zhvillimin e tregëtisë dhe investimeve që janë faktorë për ristrukturimin ekonomik dhe modernizimin e vendit.

Hap tjetër i rëndësishëm në zhvillimet të marrëdhënieve ndërmjet Unionit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor u pasuruan edhe më tutje gjatë Samitit të Thesalonik-it në qershor të vitit 2003 që kishte si agjendë Ballkanin perëndimor dhe rrugën e saj drejt anëtarësimit në UE. Në këtë Samit, udhëheqësit e shteteve dhe qeverive të shteteve anëtare, të shteteve që priteshin të hyjnë më 1 maj 2004 dhe shteteve të cilat ishin tashmë të inkuadruara në procesin e Stabilizim dhe asocimit konfirmuan edhe njëherë prespektivën e vendeve të ballkanit Perëndimor, se do të bëhen pjesë integruese e UE-së, pasi ti kenë plotësuar kriteret e Kopenhagën-it<sup>6</sup>.

#### **4.PROBLEMATIKA E SOTME E INTEGRIMIT TË MAQEDONISË**

*"Bashkimi Evropian do anëtarë të rinj, por nuk do që problemet e tyre të importohen brenda saj".*

Principi i raporteve të mira fqinjësore është një nga kriteret themelore të Kopenhagës. Kjo është kërkesë bazik për gjithsecilin që do të anëtarësohet në Bashkimin Evropian dhe qëllimi është shumë i pastër – BE do anëtarë të rinj, por nuk do që problemet e tyre të

---

<sup>6</sup> Deklarata e Samitit të Thesalonikit, të mbajtur më 21 qershor 2003 në Selanik

importohen në të. Qëndrimin e Brukselit është se çështja e emrit duhet zgjidhur nën patronazhin e OKB-së dhe se BE do të dëshironte të kishte zgjidhje për këtë çështje<sup>7</sup>.

Çështja e emrit është celsi i vetëm i këtij vendi drejtë integritit evropian, ky problem që ka lindur midis Greqisë dhe Maqedonisë është një ndër pengesat që Maqedonia të antarsohet në UE.

Njohja ndërkombëtare e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë nga Jugosllavia në vitin 1991 është kundërshtuar nga Greqia për shkak të flamurit dhe emrit Maqedoni (të konsideruara si simbole të Helenëve)<sup>8</sup>.

Poashtu është me rëndësi të theksohet se ka pasur shumë negociatë rrethë emrit , por bëhet e ditur se problem nuk është Greqia, por qeveria e Maqedonisë e cila e zvarrit këtë process dhe nuk merë asnjë hapë për ta ndryshuar emrin. Një ndër shqetësimet më të mëdha që pengojnë integritin e Maqedonisë drejtë Unionit Evropian është përmbushja e kriterve që i ka vënë UE-ja në Kopenhagë.

Pra, Maqedonia duhet të stabilizojë dhe standardizoj tregun e përgjithshëm, duke plasuar vetë mallëra të verifikuar.

Po ashtu duhet përmendur ambijenti jetësor, Maqedonia duhet të detyrohet të respektoj kriteret dhe standardet për ambijentin jetësor, duke gjetur zgjidhje për deponit e shumta, poashtu është edhe klasifikimi i mbeturinave në veçanti mbetyrinat spitalore që hudhen bashkë në një vend me mbeturinat tjera.

Poashtu, Maqedonia duhet të bëjë reforma në fushën e kulturës multinacionale. Demokracia, shteti i së drejtës, mbrojtja e të drejtave të njeriut, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të pakicave kombëtare.

Përfaqësimi i vlerave të demokracisë është vendimtar dhe themelor për vendet që aspirojnë për anëtarësim në BE.

<sup>7</sup> Deklarata e Stefan Fules, <http://www.tetova1.com/portali/maqedoni/fyle-maqedonia-ne-be-por-jo-me-problemet-qe-i-ka>

<sup>8</sup> Republika e Maqedonisë, [http://sq.wikipedia.org/wiki/Republika\\_e\\_Maqedonisë](http://sq.wikipedia.org/wiki/Republika_e_Maqedonisë)

Përveç emrit dhe kriterëve që përmenda, problematik e Maqedonisë është edhe zbatimi jo i plotë i Marrveshjes Kornizë të Ohrit e cila është simbol i harmonisë dhe demokratizimit të vendit.

## **KONKLUZION**

Kushti më i rëndësishëm që Unioni Europian dhe Shtetet Europiane i kërkojnë prej Maqedonisë për tu pranuar në familjen e madhe Europiane, është kushti politik.

Një ndër kushtet që Unioni Europian kërkon prej Maqedonisë është sigurimi i të drejtave të të gjithë qytetarëve të saj , në mënyrë të barabartë pa dallime rrace, fesë, komunitetit etj .

Maqedonia me Marrveshjen Kornizë të Ohrit bëri një hap para drejt anëtarimit në Unionin Europian .

Kjo marrveshje garanton të drejtat e çdo qytetari në Maqedoni dhe barazinë e plotë të tyre .Të gjithë ne duhet ta kemi të qartë se nëse duam që një ditë të bëhemi anëtare të një Europe të Bashkuar, atëherë duhet të punojmë në këtë drejtim. Në veçanti të gjithë politikanët e Maqedonisë , qofshin shqipëtar apo maqedonas duhet ta kuptojnë se ardhmëria e këtij shteti është në duart e tyre .

Kohëve të fundit jemi dëshmitar se edhe pse u arrit një marrveshje historike, prap se prap bëhen manipulime të ndryshme që kjo të mos respektohet deri në pikën e fundit. Por shpresojmë se keto manipulime do të marrin fund ngase tek e fundit garantues të kësaj marrëveshje janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Shtetet Europiane . Maqedonia do ta ketë shumë më të vështirë anëtarimin për shkak të problemit me Greqinë shkak i emrit. Shpresojmë që ky problem të zgjidhet shpejt dhe të arrihet një kompromis midis palve Maqedone dhe atyre Greke për shkakun e emrit të Maqedonisë që ky problem të mos bëhet pengesë për përparimin e Maqedonisë në aspiratat Europiane .

Me gjithë përpjekjet e bëra në këtë punim dhe mendoj se ja kamë arritur të shkruaj për Maqedoninë, historinë dhe problemet historike, politike dhe ekonomike që ky shtet i ka kaluar prej vitit 1991 e deri më sotë, si dhe problematikat kryesore që janë shkak kryesor që ku shtet akoma rrinë jashtë margjinave të shoqërisë Evropiane.

**Referenca:**

1. Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela, „Institucionet dhe politika e Unionit Evropian, Tetovë 2010,
2. Mersim Maksuti, E drejta kushtetuese, Tetovë 2010,
3. Fedinand Xhaferaj: Deballkanizimi i Ballkanit, Tiranë 2007,
4. Arta Ibrahim: Integrimi i Ballkanit perëndimorë në UE, Shkup 2009,
5. Sadik Zenku, Institucionet e Bashkimit evropian dhe procesi i integrimit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian, Kërcovë 2013,
6. Deklarata e Samitit të Thesalonikut, të mbajtur më 21 qershor 2003 në Selanik
7. Deklarata e Stefan Fules, <http://www.tetova1.com/portali/maqedoni/fyle-maqedonia-ne-be-por-jo-me-problemet-qe-i-ka>
8. Republika e Maqedonisë, [http://sq.wikipedia.org/wiki/Republika\\_e\\_Maqedonisë](http://sq.wikipedia.org/wiki/Republika_e_Maqedonisë)
9. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë: <http://www.sobranie.mk/al/?ItemID=4C8C1343A4DB5D4CBB39AD1410F0F87F>
10. Maqedonia e lashtë [http://sq.wikipedia.org/wiki/Maqedonia\\_e\\_lasht%C3%AB](http://sq.wikipedia.org/wiki/Maqedonia_e_lasht%C3%AB).

**KONTRATA E SIGURIMIT NË SISTEMIN E TË DREJTËS SHQIPTARE****Silvana BELLO, PHD candidate****Abstrakt**

Në veprimtarinë e sigurimit, një rol thelbësor luan edhe kontrata e sigurimit, e cila mund të konsiderohet në ditët e sotme si një nga kontratat më të rëndësishme në qarkullimin civil. Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror, përmirësimi i cilësisë së jetës dhe akumulimi i të mirave materiale shoqërohet në mënyrë të pashmangshme me nevojën e garantimit të tyre nëpërmjet lidhjes së kontratave të sigurimit.

Në këtë kontekst, shtetit i lind detyrimi për të krijuar dhe garantuar krijimin e një kuadri të favorshëm rregullator për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimeve nga siguruesit si dhe për të mbrojtur interesat e të siguruarëve, në rastet e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Në legjislacionin shqiptar, kontrata e sigurimit është e rregulluar nga dispozitat e Kodit Civil të vitit 1994 si dhe nga Ligji 10076/2009 « Për sigurimin e detyruar në sektorin e transportit », i amenduar në vitin 2011, i cili rregullon sigurimin e detyruar për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara nga aksidentet automobilistike.

Ashtu si në legjislacionin e vendeve europiane, edhe në Shqipëri kontratat e sigurimit shfaqet si kontratë e papërcaktuar, me shpërblim, e dyanshme, adezioni, etj. Megjithatë, ndryshe nga karakteri konsensual që kanë kontratat e sigurimit në të drejtën europiane, në legjislacionin shqiptar kjo lloj kontratë ka karakter solemn.

**Fjalë kyçe:** *Veprimtari sigurimi, kontratë sigurimi, siguruesi, i siguruari, ngjarja e sigurimit, primi dhe shpërblimi i sigurimit.*

**HYRJE**

Veprimtaria e sigurimit paraqet interes të madh edhe për shtetin, i cili në kuadër të parimit të organizimit të ekonomisë së tregut, duhet të ndërhyjë, nga njëra anë për të lehtësuar krijimin e një kuadri të favorshëm rregullator për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimeve nga siguruesit dhe risiguruesit, ndërsa nga ana tjetër, për të përmirësuar dhe konsoliduar disa rregulla me qëllim për të mbrojtur të siguarit.

Falë natyrës shumë komplekse të operacioneve të sigurimit, ndërhyrja e shtetit është e rëndësishme, pasi të siguarit, duke mos e njohur mirë këtë lloj veprimtarie, mund të jenë viktima të abuzimeve nga ana e shoqërive të sigurimit. Kjo është edhe arsyeja kryesore përse shtetet kanë krijuar autoritete të natyrës administrative, të cilat marrin kontrollin, mbikëqyrin dhe në fund sanksionojnë sa herë ato konstatojnë praktika abuzive të shoqërive.

**I. RREGULLIMET LIGJORE TË KONTRATËS SË SIGURIMIT**

Në të drejtën shqiptare, kontrata e sigurimit është e rregulluar parimisht në Kodin Civil të vitit 1994. Veprimtaria e sigurimeve është një veprimtari e veçantë, jo vetëm për shkak të pasojave juridike që ajo sjell, por edhe si rezultat i ekzistencës së entiteteve të ndryshme në tregun financiar jobankar, disa nga të cilat janë persona juridikë, ndërsa disa të tjerë persona fizikë, disa janë me kapital shtetëror, të tjerë me kapital privat vendas, ose të huaj.

Si veprimtari financiare jobankare, veprimtaria e sigurimit ushtrohet nga shoqëritë e sigurimit, të cilat sipas legjislacionit shqiptar, mund të jenë shoqëri vendase, ose degë të shoqërive të huaja që operojnë në Shqipëri. Në lidhjen e kontratës së sigurimit, një rol kanë edhe ndërmjetësit në sigurime, të cilët ndërmjetësojnë marrëdhëniet e sigurimit ndërmjet siguruesit dhe të siguarit. Ndërmjetësit në sigurime si rregull janë persona të specializuar, respektivisht agjentë dhe brokera në sigurime. Agjentët në sigurime mund të jenë persona fizikë ose juridikë, ndërsa brokeri në sigurime mund të ushtrojë veprimtarinë e sigurimit si shoqëri aksionere<sup>1</sup>, njëlloj si në shoqëritë e sigurimit<sup>5</sup>.

---

<sup>1</sup> Ashtu sikurse ndodh në të drejtën rumune dhe me institucionet kredituese, duke qënë një kërkesë ligjore që lidhet me aftësinë paguese të shoqërive dhe besueshmërinë e tyre në publik. Lidhur me formën e tyre si shoqëri të institucioneve të kredisë, për më tepër shih Lucian Sauleanu, Lavinia Smarandache, Alina Dodocioiu, *E drejta*

**1. Evolucionit i legjislacionit në fushën e sigurimit-**Veprimtaria e sigurimit në Republikën e Shqipërisë është i rregulluar në kapitullin XXIII të Kodit Civil, i cili është miratuar me Ligjin 7850/1994 dhe Ligjin 52/2014, datë 4 qershor 2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Ligjin 10076/2009, i cili është amenduar me ligjin 10455/2011, i cili rregullon sigurimin e detyruar për përgjegjësinë civile për dëmet si rezultat i aksidententeve automobilistike.

Kodi civil shqiptar rregullon dy tipe kontratash sigurimi : sigurimin e personave dhe sigurimin e pasurisë.

Kontrata e sigurimit është e rregulluar në kapitullin XXIII, seksioni “Sigurime”, nenet 1113-1161 të Kodit Civil, i cili përmban dispozita për kontratat e sigurimit, sikurse kontrata e sigurimit të personave dhe kontrata e sigurimit të pasurisë.

**2. Detyrimet e Siguruesit-** Nëpërmjet kontratës së sigurimit, njera nga palët (siguruesi), kur ndodh rasti i sigurimit të parashikuar në kontratë, ka detyrimin që :

a) në rastin e sigurimit të pasurisë, të dëmshpërblejë palën tjetër ose personin përfitues, në dobi të të cilit, ka qënë lidhur kontrata e sigurimit, dëmin e pësuar në limitet e shumës së parashikuar në kontratë;

b) në rastin e sigurimit të personave, t’i paguajë palës tjetër ose personit të tretë, në emër të të cilit ka qënë lidhur kontrata e sigurimit, shumën e parashikuar në kontratë.

**3. Forma e kontratës së sigurimit-** Kontrata e sigurimit duhet lidhur në një formë të shkruar, përmes dëshmisë së sigurimit (polica e sigurimit), të cilën siguruesi ia lëshon të siguruarit; në rast të kundërt, kontrata e sigurimit është e pavlefshme. Në këtë mënyrë, forma e shkruar kthehet

---

*bankare, edicioni II, i rishikuar dhe i zgjeruar, Shtëpia botuese Universi Juridik, Bukuresht, 2011, faqe 55 dhe vijuese.*

<sup>2</sup> Njëlloj si në të drejtën rumune, nuk ka rëndësi nëse brokerat respektive janë të punësuar efektivë të shoqërive të sigurimit, duke qënë se ata mund të jenë të punësuar edhe të një shoqërie tjetër, e cila ka tjetër formë organizimi, sikurse shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k). Po kështu, nuk ka rëndësi nëse vendi i lidhjes së kontratës së sigurimit është një degë ose zyrë me seli të përhershme, përveç selisë kryesore ( shih Lucian Sauleanu, *Shoqëritë tregëtare, Studime*, ed. Universi Juridik, Bukuresht, 2012, faqe 179), pasi akti juridik do të prodhojë pasoja pikërisht kundrejt shoqërisë kryesore.



në një kusht *ad validitatem*, jo *ad probationem*<sup>3</sup>, sikurse është në të drejtën rumune. Vlerësojmë se, në ndryshim nga rastet e njohura në të drejtën rumune për aktet që kërkojnë formën e shkruar *ad validitatem*, sikurse për shembull *dhurimi, testamenti, revokimi shprehimisht i një trashëgimie testamentare*<sup>6</sup>, kontrata e sigurimit nuk e justifikon një kusht të tillë, pasi karakteristikat e kontratave civile dallojnë nga ato të kontratave specifike, për të cilat, është e nevojshme forma e shkruar *ad validitatem*.

Në dëshminë e sigurimit duhet të jenë parashikuar:

1. emërtimi i shoqërisë së sigurimit;
2. emri i të siguruarit ose përfituesit të dëmshërblimit;
3. objekti i sigurimit;
4. rasti i siguruar;
5. periudha e sigurimit;
6. momenti i lindjes dhe shuarjes së përgjegjësisë të siguruarit;
7. vlerësim i riskut të sigurimit;
8. shumë e sigurimit;
9. primi i sigurimit.

**4.Elementët e detyrueshëm të policës së sigurimit në të drejtën shqiptare-** Kodi civil shqiptar parashikon elementë detyrues të policës së sigurimit. Më konkretisht, neni 1115<sup>5</sup> parashikon se elementët detyrues janë: “emri i siguruarit, emri i të siguruarit ose përfituesit në rastin e sigurimit të personave, prona e siguruar dhe vendodhja e saj në kontratën e sigurimit të pasurisë, rasti i siguruar, koha kur fillon përgjegjësia e siguruarit, vlerësimi i pasurive para marrjes në sigurim”.

---

<sup>3</sup> Për një analizë më të plotë të këtyre aspekteve të së drejtës shqiptare, shih Mariana Tutulani Semini *E drejta e detyrimeve dhe kontratave. Pjesa e përgjithshme*, Shtëpia botuese Skënderbej 2006, faqe 104.

<sup>4</sup> Ion Dogaru, Nicolae Popa, Dan Claudiu Dănișor, Sevastian Cercel, *Bazat e të drejtës civile. Vëllimi I. Teoria e përgjithshme*, ed. CH Beck, Bukuresht, 2008, faqe 470.

<sup>5</sup> Kodi civil shqiptar, Bot. Alb Juris, 2014, faqe 331.

<sup>6</sup> Idem 94, faqe 81

Personi i siguruar duhet të njoftojë siguruesin, në momentin e lidhjes së kontratës, për të gjitha rrethanat për të cilat ai ka dijeni dhe që janë thelbësore për të përcaktuar natyrën dhe vlerësimin e riskut.

**5. Të drejtat e siguruesit në të drejtën shqiptare-** Kodi civil shqiptar parashikon në nenin 1118<sup>7</sup> që siguruesi, brenda një afati 3-mujor që nga momenti kur personi i siguruar ka dhënë informacione të gabuara ose jo korrekte, ka këto të drejta :

a) të ndryshojë primin e sigurimit, shumën e sigurimit ose afatin e sigurimit ;

b) të zgjidhë kontratën e sigurimit në rastin kur, nëse siguruesi do t'i kishte ditur këto rrethana nuk do ta kishte lidhur kontratën e sigurimit, duke e sanksionuar të siguarin nëpërmjet mbajtjes së primit të sigurimit nga ana e siguruesit ;

c) nëse rasti i siguruar ka ndodhur përpara se siguruesi të merrte dijeni ose të njihej me këtë informacion, siguruesi është i detyruar të dëmshpërblejë të siguarin jo me shumën e sigurimit të specifikuar në kontratën e sigurimit, por me shumën e sigurimit të korrigjuar me koeficientin e korektimit (raporti i shumës reale të sigurimit me shumën e specifikuar në kontratën e sigurimit)

d) kur kontrata e sigurimit është e lidhur me më shumë persona, kjo kontratë mbetet e vlefshme për personat, të cilët kanë dhënë deklarata të sakta.

**6. Rastet e zgjidhjes së kontratës së sigurimit në të drejtën shqiptare-** Nëpërmjet nenit 1119<sup>7</sup> të Kodit Civil të Shqipërisë janë rregulluar në mënyrë të qartë rastet e zgjidhjes së kontratës së sigurimit në hipotezën kur i siguruari ka vepruar me mirëbesim ose keqbesim. Nga ana tjetër, nëse personi i siguruar ka dhënë informata të pasakta, ose i ka lënë ato në harresë, në rast se vërtetohet se nuk janë bërë me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, ky rast nuk përbën shkak për zgjidhjen e kontratës së sigurimit, por siguruesi ka mundësi të heqë dorë nga kontrata, duke njoftuar të siguarin me shkrim brenda një afati 3-mujor nga marrja dijeni e tyre. Kontrata nuk është lidhur në mënyrë të rregullt, nëse vërtetohet e kundërta, pra nëse personi i siguruar nuk ka sjellë informata, të cilat, në rast se do të njiheshin nga siguruesi, nuk do ta kishin bindur atë që të lidhte kontratë me të siguarin. Në hipotezën kur rasti i siguruar ka ndodhur përpara se siguruesi të kishte dijeni për të, shuma e sigurimit ulet në proporcion

---

<sup>7</sup> Idem 94, faqe 333.

me diferencën e shumës së caktuar në kontratë dhe asaj që do të ishte zbatuar nëse do të njihej gjendja e vërtetë e fakteve.

Në vijim, neni 1121<sup>8</sup> parashikon se ‘kontrata e sigurimit nuk është e vlefshme nëse vërtetohet se rreziku i sigurimit nuk ka ekzistuar ose ka pushuar së qeni para përfundimit të kontratës`, ndërsa neni 1122<sup>8</sup> nënvizon se ‘kontrata e sigurimit zgjidhet në qoftë se rreziku i sigurimit pushon së qeni pas përfundimit të kontratës, por siguruesi ka të drejtën e pagimit të primeve, derisa pushimi i qenies së rrezikut të sigurimit t’i jetë njoftuar ose t’i jetë bërë e ditur në një mënyrë tjetër’.

Nëpërmjet nenit 1123<sup>9</sup> përcaktohet se gjatë kohës që kontrata e sigurimit është në fuqi, i siguruari detyrohet t’i njoftojë siguruesit të gjitha ndryshimet e rrethanave, për të cilat ka marrë dijeni pas lidhjes së kontratës së sigurimit dhe që mund të influencojnë mbi shtimin e rrezikut. Në rastet kur i siguruari nuk bën njoftimin e përmendur më sipër, siguruesi ka të drejtë që, nga çasti i shtimit të rrezikut të ndryshojë masën e primit të sigurimit, të shumës së sigurimit, afatin e sigurimit ose ta zgjidhë fare kontratën.

Në përputhje me nenin 1125<sup>10</sup> të Kodit civil shqiptar, kontraktuesi detyrohet t’i paguajë siguruesit primin e sigurimit në afatet e caktuara në kontratë. Në qoftë se primi ose kësti i parë i tij nuk paguhet në afat, sigurimi pezullohet deri në orën 24 të ditës që kontraktuesi paguan shumën që detyrohet. Kur kontraktuesi nuk paguan primet në vazhdim, sipas afateve të caktuara, sigurimi pezullohet nga ora 24 e ditës së pesëmbëdhjetë pas mbarimit të afatit të pagimit dhe siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës.

Neni 1126 i Kodit civil shqiptar i referohet obligimit të të siguruarit për ta njoftuar siguruesin brenda afatit të parashkuar në kontratë. Në qoftë se i siguruari nuk e bën këtë

---

<sup>8</sup> Ibidem 94

<sup>9</sup> Idem 94, faqe 334

<sup>10</sup> Ibidem 94

<sup>11</sup> Idem 94, faqe 335.

njoftim, siguruesi ka të drejtë të mos paguajë dëmshpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit.

**7. Detyrimet e siguruesit në të drejtën shqiptare-** Në lidhje me detyrimet e të siguruarit ose përfituesit, neni 1127 i Kodit civil shqiptar evidenton faktin se i siguruari ose personi i tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata e sigurimit, detyrohet të provojë se ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe, në rastin e sigurimit të pasurisë të provojë edhe sasinë e dëmit si dhe t'i njoftojë siguruesit, sipas kërkesës së këtij, të gjitha informatat që janë në dijeni të tij dhe që kanë lidhje me ngjarjen e sigurimit. Në rastin e sigurimit të personit, kur vërtetohet humbja e aftësisë për punë, bëhet edhe ekspertimi mjekësor. Kur detyrimet e mësipërme nuk përmbushen, siguruesit i lind e drejta që të mos paguajë shpërblimin e sigurimit ose shumën e sigurimit.

Kompensimi ose vlera e sigurimit që duhet t'i paguhet jo të siguruarit, por personit të tretë, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, nuk mund të sekuestrohet për borxhet e të siguruarit. Siguruesi ka të drejtë të ndalojë nga shpërblimi i sigurimit ose shuma e sigurimit atë që ka për të marrë i siguruari nga e njëjta kontratë e sigurimit. Gjithashtu, siguruesi mund t'i kundërdrejtojë personit, në dobinë e të cilit është lidhur kontrata, të gjitha prapësimet që aim und t'i kundërdrejtojë të siguruarit nga e njëjta kontratë sigurimi.

Në përputhje me nenin 1130<sup>12</sup> të Kodit civil shqiptar, kur një person lidh një kontratë sigurimi në emër të një tjetri, pa patur një tagër të tillë prej tij, ky i fundit mund ta pranojë kontratën e lidhur edhe pas vërtetimit të ngjarjes së sigurimit.

Personi që ka lidhur kontratën është i detyruar të zbatojë vetë detyrimet që rrjedhin nga vetë kontrata e sigurimit, deri në momentin kur siguruesi ka marrë njoftim për pranimin ose jo të saj, nga personi në emër të të cilit është lidhur ajo kontratë. Primi i sigurimit i paguhet siguruesit nga kontraktuesi i mësipërm, për të gjithë periudhën deri në momentin kur siguruesi ka marrë dijeni për mospranimin e kontratës.

Duhet theksuar gjithashtu se një pjesë të mirë të rregullimeve ligjore në fushën e sigurimeve sjell edhe Ligji nr. 52/2014 “Mbi veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”<sup>11</sup>, i cili

<sup>12</sup> Idem 94, faqe 336.

<sup>13</sup> Ligji nr.52 i 22 majit 2014 i përmbledhur në 16 kapituj, përfaqëson shembullin më modern të teknikës legjislative në fushën e sigurimeve në Republikën e Shqipërisë.

përbëhet nga 16 kapituj që trajtojnë aspekte lidhur me sqarimin dhe saktësimin e nocioneve mbi operacionet e sigurimit, klasifikimin e rreziqeve, ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit nga ana e shoqërive të sigurimit. Akti normativ në fjalë përfshin dispozita të zgjeruara në lidhje me: formën juridike dhe ushtrimin e veprimtarisë nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit, autorizimin e shoqërive të sigurimit, detyrimet e shoqërive të sigurimit, aspekte lidhur me administrimin e rreziqeve, kontrollin e brendshëm të shoqërive të sigurimit, masat e mbikëqyrjes financiare në fushën e sigurimeve, veprimtarinë e brokerave dhe inspektorëve të dëmit si dhe sanksionet në rastet e mosrespektimit të dispozitave ligjore.

## **II.KARAKTERISTIKAT JURIDIKE TË KONTRATËS SË SIGURIMIT**

Në shumicën e legjislacioneve të vendeve europiane, karakteristikat juridike të kontratës së sigurimit janë të përafërta dhe ato mund të përmbliken në: konsensuale, të dyanshme, me shpërblim, adezioni, rastësore ose të papërcaktuara, të sigurimit vullnetar ose të detyruar etj.

### **A. Karakteri konsensual i kontratës së sigurimit**

Për të përcaktuar nëse me një kontratë siguri nënkuptojmë një kontratë konsensuale, duhet më së pari të analizojmë kushtet e kërkuara për vlefshmërinë e saj. Një analizë e tillë do ta vendoste kontratën e sigurimit në njërin prej tri kategorive kryesore të kontratës në përgjithësi: kontratë konsensuale, kontratë solemne apo kontratë reale.

Rregulla e përgjithshme, e njohur në sistemin kontinental, është ajo e konsensualitetit të kontratave, sipas së cilës, për lidhjen e një kontrate të ligjshme është i nevojshëm vullneti i palëve, vullneti i cili nuk kërkohet të materializohet me patjetër në një formë të shkruar. Kontrata e sigurimit ka në thelb karakter konsensual, pasi edhe vetë ligjëbërësi nuk ka imponuar formën e shkruar për vlefshmërinë e saj. Kështu, Kodi Civil italian<sup>14</sup>, por edhe legjislacioni rumun, respektivisht Ligji 136/1995<sup>15</sup> dhe Kodi Civil aktual<sup>12</sup> flasin për formën e

---

<sup>14</sup> Shih nenin 1888 të Kodit Civil Italian 1942, i cili flet për “Dëshminë e kontratës së sigurimit”

<sup>15</sup> Në përputhje me nenin 10 të Ligjit 136/1995, „Kontrata e sigurimit lidhet në formë të shkruar. Ajo nuk mund të provohet me dëshmitarë, edhe në rast se ka një fillim dëshmie të shkruar. Në rastet e forcës madhore, si

shkruar të kontratës së sigurimit, por vetëm në aspektin e vërtetimit të saj. Kodi e shpreh qartë se forma e shkruar duhet vetëm për të dëshmuar ekzistencën e kontratës si një kërkesë *ad probationem*, pra forma e shkruar është e nevojshme për ta provuar ekzistencën e kontratës dhe jo për lidhjen e saj.

Përkundrazi, ligjvënësi shqiptar e konsideron kontratën e sigurimit si një kontratë solemne (formale), duke e kushtëzuar formën e shkruar të kontratës me vlefshmërinë e saj, pra e konsideron atë si një kusht *ad validitatem*.

Në lidhje me karakterin solemn të kontratës së sigurimit, autorë të ndryshëm në fushën e sigurimit në Shqipëri janë përpjekur të shpjegojnë motivet që kanë detyruar ligjvënësin që të kushtëzojë formën e shkruar të kontratës së sigurimit me vlefshmërinë e saj. Kështu, për disa autorë<sup>13</sup>, motivi kryesor i cili shpjegon përse në Kodin Civil është këmbëngulur për formën e shkruar të policës së sigurimit, lidhet me rëndësinë në vetvete të kësaj lloj kontrate në qarkullimin civil si dhe numurin e lartë të interesave që ajo mbulon. Për autorë të tjerë<sup>14</sup>, forma solemne e kontratës së sigurimit mund t'i ndihmojë shumë palët në proces, sepse instancat gjyqësore do ta kishin më të lehtë të interpretonin kushtet e kontratës në rastet kur ato janë të shprehura qartë në formë të shkruar. Por, ka edhe autorë të tjerë<sup>15</sup>, të cilët vlerësojnë se forma e shkruar e policës së sigurimit lehtëson në mënyrë të ndjeshme standartizimin dhe uniformizimin e marrëdhënieve juridike që rrjedhin nga kontrata respektive midis subjekteve të së drejtës që paraqesin disa karakteristika të veçanta, krahasuar me llojet e tjera të kontratave.

---

rezultat i së cilës, dokumentet e sigurimit kanë humbur dhe nuk ekziston kurrfarë mundësie për nxjerrjen e një duplikate, pranohet çdolloj dëshmie e ligjshme që mund të konfirmojë ekzistencën e tyre”.

<sup>16</sup> Në përputhje me nenin 2200 të Kodit Civil, „Që kontrata e sigurimit të mund të vërtetohet, duhet që ajo të lidhet në një formë të shkruar. Kontrata nuk mund të vërtetohet me ndihmën e dëshmitarëve, edhe atëhere kur ekzistojnë fillësë të formës së shkruar. Nëse dokumentat e sigurimit janë zhdukur për shkak të forcave madhore ose shkaqe të tjera dhe nuk ekziston mundësia e nxjerrjes së një duplikate, ekzistenca dhe përmbajtja e tyre mund të vërtetohen me anë të çdo forme tjetër të provave.”

<sup>17</sup> Shih Juliana Bylykbashi “Aspekte juridike të biznesit të sigurimit vullnetar”, Tezë doktore, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë;

<sup>18</sup> Shih Luan Hasneziri, “Kontrata e sigurimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë”;

<sup>19</sup> Për më tepër shih Mariana Semini, “E drejta e detyrimeve dhe kontratave”. Pjesa e Përgjithshme, Tiranë 2006.

Por, autorja e këtij studimi nuk ndan të njëjtën pikëpamje me autorët e sipërcituar, sa i përket formës së kontratës së sigurimit, duke arritur në konkluzionin se një kontratë e tillë, megjithë rëndësinë që paraqet nuk mund të jetë kontratë solemne, por një kontratë konsensuale.

Për të konkluduar kështu, autorja është nisur nga analogjia me sistemet e tjera të së drejtës dhe ka kombinuar metodat e interpretimit gramatikor dhe logjik. Pikësëpari, ajo ka mbajtur parasysh faktin se e drejta shqiptare, njëlloj si e drejta italiane apo rumune aplikon sistemin “civil laë”. Së dyti, shumica e dispozitave të Kodit Civil shqiptar janë marrë nga Kodi Civil Italian i vitit 1942, i cili, sikurse kemi theksuar më sipër, parashikon në nenin 1888 se “kontrata e sigurimit lidhet në formë të shkruar. Siguruesi është i detyruar t’i lëshojë kontraktuesit policën e sigurimit, ose çdo document tjetër që konfirmon lidhjen e kontratës. Ai është gjithashtu i detyruar të lëshojë, me kërkesën dhe shpenzimet e kontraktuesit, duplikata ose kopje të policës së sigurimit”. Së treti, fakti që edhe Kodi Civil shqiptar përdor termin “dëshmi”, tregon ndoshta se për ligjvënësin forma e shkruar është e rëndësishme pikërisht për të vërtetuar ekzistencën e kontratës, si një instrument ad probationem. Së fundi, edhe praktika gjyqësore në Republikën e Shqipërisë e ka kundërshtuar prej kohësh formën solemne të kontratës së sigurimit, pasi i ka lejuar njërës prej palëve në process, të cilës i kishte humbur policën e sigurimit, ta dëshmonte ekzistencën e kontratës nëpërmjet formave të tjera, të konfirmuara nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

## **B. Karakteri sinalagmatik ose i dyanshëm i kontratës së sigurimit**

Karakterit i dyanshëm i kontratës së sigurimit është rezultat i aplikimit të kriterit të përmbajtjes së kontratave. Veçoria e kontratave të dyanshme është se ato, ndryshe nga kontratat e njëanshme, vendosin detyrime reciproke për palët<sup>20</sup>. Kontrata e sigurimit është në fakt një kontratë e dyanshme, sepse prej saj lindin detyrime reciproke ndërmjet palëve (i siguruari dhe siguruesi). Kështu, detyrimi kryesor i të siguarit është të paguajë policën e sigurimit, ndërsa siguruesi detyrohet t’i paguajë të siguarit vlerën e dëmit të pësuar, në rast aksidenti automobilistik.

<sup>20</sup> Kështu, neni 1171 i Kodit Civil parashikon se „kontrata është e dyanshme atëhere kur detyrimet që lindin prej saj janë reciproke dhe të ndërvarura. Në të kundërt, kontrata është e njëanshme, edhe nëse ekzekutimi i saj presupozon detyrime në kurriz të të dyja palëve”.

Vlen të vihet në dukje se detyrimet reciproke ndërmjet palëve janë të ndërruarura, në kuptimin që detyrimi për shpërblimin e dëmit nga ana e siguruesit përcaktohet tërësisht nga detyrimi i të siguruarit për të treguar rrezikun e sigurimit dhe pagesën e policës së sigurimit.

### **C. Kontrata e sigurimit si kontratë me shpërblim**

Kjo karakteristikë e kontratës përcaktohet nga kriteri i klasifikimit të kontratave, nisur nga qëllimi apo synimi i palëve në momentin e lidhjes së tyre. Për pasojë, kontratat mund të klasifikohen në kontrata pa shpërblim dhe kontrata me shpërblim. Në rastin e kontratave pa shpërblim, palët nuk synojnë të përfitojnë ndonjë avantazh pasuror të tyre, ndërsa tek kontratat me shpërblim, secila palë ka si qëllim të sigurojë përfitimin e vet pasuror.

Kontrata e sigurimit, pavarësisht nga lloji i saj, është në thelb kontratë me shpërblim, pasi të dyja palët e saj ndjekin realizimin e përfitimeve pasurore. Në këtë mënyrë, qëllimi pasuror i të siguruarit është që të përfitojë shumën e sigurimit, edhe kur ngjarja e sigurimit nuk është tërësisht e sigurt, ndoshta nga që është cënuar prej modaliteteve të kushtit pezullues. Siguruesi, nga ana tjetër, synon të arkëtojë primin e sigurimit nga i siguruari, me shpresën se rasti i sigurimit nuk ka për të ndodhur, në mënyrë që përfitimi i tij të jetë maksimal.

### **D. Karakteri i papërcaktuar ose aleator<sup>21</sup> i kontratës së sigurimit**

Karakterit aleator i kontratës rezulton nga kriteri i njohjes së shtrirjes së detyrimit të palëve, në funksion të të cilave, kontratat mund të klasifikohen në kontrata të përcaktuara dhe kontrata të papërcaktuara ose aleatore.

Në rastin e kontratave të përcaktuara, palët njohin që nga momenti i lidhjes së kontratës se deri ku do të shtrihen të drejtat dhe detyrimet atëhere kur ajo do të zbatohet. Në kontratat aleatore, palët nuk i njohin, në momentin e lidhjes së kontratës, limitet, brenda të cilave, do të realizohen detyrimet apo do të vlerësohen të drejtat e tyre.<sup>22</sup>

Kontrata e sigurimit presupozon në thelbin e saj një element aleator, pasi as i siguruari, as siguruesi nuk mund ta dinë, në momentin e lidhjes së saj, nëse do të ndodhë rasti i sigurimit

<sup>21</sup> Për detaje të karakterit aleator të kontratave dhe pasojave të tyre specifike, shih Ion Dogaru, Pompil Draghic “*Bazat e të drejtës civile, Vëll.III. Teoria e përgjithshme e detyrimeve*”, Edit. CH.Beck, Bukuresht, 2008, faqe 48-49; Roberta Nitoiu, “*Teoria e përgjithshme e kontratave e aleatore*”, Edit. All Beck, Bukuresht, 2003.

<sup>22</sup> Lidhur me detyrimin aleator, shih Anne Marin, *Contribution a l’etude des contrats aleatoires*, Edit. Les Presses Universitaires de la Faculte de Droit Clermont-Ferrand, 2002, faqe. 18.



dhe, për pasojë, nuk dinë as sesa do të jetë shuma e shpërblimit të dëmit. Nga kjo analizë rezulton se karakteri aleator është thelbësor për ekzistencën e vetë kontratës së sigurimit. Në fakt, mungesa e elementit aleator do të sillte pavlefshmërinë absolute<sup>23</sup> të kontratës së sigurimit, në rastin kur nuk përcaktohet dot rasti i sigurimit<sup>24</sup>, duke patur parasysh se ky është elementi thelbësor që ndikon tek palët për të lidhur kontratën e sigurimit.

### **E. Karakteri vullnetar dhe i detyrueshëm i kontratës**

Një tjetër karakteristikë e kontratës së sigurimit është se ajo mund të jetë kontratë e sigurimit vullnetar dhe kontratë e sigurimit të detyrueshëm. Kontrata e sigurimit është vullnetare kur ajo lidhet vetëm duke u bazuar tek vullneti i lirë i palëve kontraktuese. Kjo kontratë mund të shfaqet në formën e kontratës së sigurimit të personit ose të sigurimit të pasurisë, e cila përfshin në vetëvete sigurimin e çdo lloj pasurie.

Kontrata e sigurimit është e detyrueshme, kur vullneti për lidhjen e saj nuk buron nga personi apo subjektet e së drejtës, por nga vetë ligji. Në këtë rast është vullneti i ligjit dhe jo i subjektit ai që bën që të lindë kontrata e sigurimit, ndërkohë që subjektet janë të detyruara që ta lidhin këtë kontratë, pavarësisht vullnetit të tyre. Pra, është ligji ai që imponon vullnetin e personit dhe kjo është një nga përjashtimet e rralla në fushën e të drejtës civile, ku ligji ndërhyt në vullnetin e personit, duke e detyruar që të lidhë një kontratë, pasi në pothuajse të gjitha rastet e tjera, është vullneti i palëve që çon në krijimin e një kontrate dhe jo vullneti i ligjit<sup>25</sup>.

### **F. Kontrata e sigurimit si kontratë adezioni**

Në të drejtën shqiptare, njëlloj si në sistemet juridike të vendeve europiane njihet edhe ekzistenca e një kategorie të veçantë të kontratës që është kontrata e adezionit. Në rastin e kontratës së adezionit, njera nga palët pranon kushtet e paravendosura nga pala tjetër.

<sup>23</sup> Lidhur me dallimin e rasteve të pavlefshmërisë absolute nga ato të pavlefshmërisë relative, shih Gabriel Boroi, Carla Alexandra Angheliescu, *Kurs i të drejtës civile. Pjesa e përgjithshme.. Bot. i 2-të*, Shtëpia botuese Hamangiu, Bukuresht, 2012, faqe 253-259.

<sup>24</sup> Shih Ion Dogaru, Edmond Gabriel Olteanu, Lucian Sauleanu, vepr.cit., faqe 1045.

<sup>25</sup> Luan Hasneziri, vepr.cit., f.16.

Në lidhje me kontratën e sigurimit, klauzolat e saj janë të paracaktuara nga ana e siguruesit, pa i lënë mundësi të siguruarit që të negociojë. Praktikisht, mundësia e vetme e të siguruarit është të përzgjedhë midis ofertave që paraqesin siguruesit, në lidhje me rrezikun e sigurimit. Në thelb, zgjedhja e ofertës varet nga elementi ekonomik, vlera e primit të sigurimit dhe shuma e sigurimit të ofruar.

Në këtë mënyrë, të siguruarit i mbetet për të negociuar vetëm shuma e sigurimit, masa e dëmit, afatet dhe kushtet, në bazë të të cilave, kryhet pagesa e primit dhe shpërblimi i sigurimit.

#### **Referenca:**

1. Boroj Gabriel ,''*Curs de drept civil. Partea generala*'', Edit.II, Shtëpia botuese Hamangiu, Bukuresht 2012, f.253-259;
2. Bylykbashi Juliana, ''*Aspekte juridike të biznesit vulletar*''. Tezë doktore, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë;
3. Dogaru Ion, Nicolae Popa, *Bazele dreptului civil. Vol. IV- Contracte speciale*, ed. C.H. Beck, București, 2009;
4. Errante Edward, ''*The Anglo-American Law of Contracts*'', L.G.D.J Paris, 2001;
5. Hasneziri Luan, ''*Kontrata e sigurimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë*'';
6. Marin Anne, ''*Contribution a l'etude des contracts aleatoires*'', Edit. Les presses universitaires de la Faculte Clermont-Ferrand 2002, f.18;
7. Nitoiu Roberta, ''*Teoria generală a contractelor aleatorii*'', Ed. All Beck, Bucuresht, 2003, f.70
8. Sauleanu L, Smarandache L, Dodociou A, ''*Dreptul bancar*'', Edit.Universul Juridic, Bukuresti, f.55;
9. Sauleanu Lucian, ''*Companile comerciale*'', Edit. Univ. Juridic, Bukuresht 2012, f.179;
10. Tutulani Semini Mariana, ''*E drejta e detyrimeve dhe kontratave. Pjesa e Përgjithshme*'', Shtëpia botuese Skenderbej 2006, f.104;

11. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë 1994, Bot. ALBJURIS 2014, f.331 e vijim;
12. Kodi Civil italian i vitit 1942;
13. Kodi Civil rumun i vitit 2011;
14. Ligji nr.10076, datë 12.02.2009 „Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i amenduar në vitin 2011;
15. Ligji nr.52, datë 22.05.2014 „Mbi veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

**NDARJA E PUSHTETIT SHETËROR - ME THEKS TË VEÇANTË QEVERISJA  
DHE SISTEMI I NDARJES SË PUSHTETIT NË SHBA**

**Bajram SEFERAJ- Ph.D. Candidate**

Faculty of Law, International University of Struga

Zyrtar i Lartë Ligjor, Departament Ligjor, MBPZHR

**Abstrakt**

Teoria e përgjithshme e shtetit dhe e së drejtës, një nga karakteristikat e përgjithshme të shtetit është *pushteti shtetëror* apo aparati përmes të cilës ai realizon vullnetin e vet politik.

Ky pushtet shprehet në autorizimet kushtetuese dhe ligjore të organeve shtetërore që të nxjerrin aktet e caktuara, të sigurojnë zbatimin dhe mbrojtjen e tyre përmes monopolit të dhunës fizike. Pra ky pushtet manifestohet përmes 3formave themelore e që janë:

- Pushteti kushtetutdhënës dhe legjislativ,
- Pushteti ekzekutiv- administrativ
- Pushteti gjyqësor.

E njëra ndër teoritë që do të shtjelloj në këtë punim është Parimi i ndarjes së pushtetit shtetëror në botë e veqanërisht qeverisja dhe sistemi amerikan i ndarjes së pushtetit.

Sistemi i ndarjes së pushtetit sot gjen zbatim në pjesën dërmuese të sistemeve bashkëkohore politike. Varësisht nga raporti i organeve të degëve të ndryshme të pushtetit shtetëror, pozitës dhe rolit të tyre janë të njohura 3 sisteme të bazuara në parimin e ndarjes së pushtetit:

- Sistemi parlamentar,
- Sistemi presidencial, dhe

- Sistemi i përzier (parlamentar-presidencial)

Parimi i ndarjes dhe i kufizimit të pushtetit është një nga parakushtet elementare të demokracisë. Vendosja e një balance ose ekuilibri midis tre pushteteve është bazë, për funksionimin e demokracisë në një shtet.

Balanca dhe ekuilibri i pushteteve në shtetet demokratike parlamentare duhet të arrijë dy qëllime: e para, të sigurojë pavarësinë e pushteteve, e dyta, të kufizojë pushtetet, duke përcaktuar mekanizma të kontrollit të tyre reciprok.

**Fjalët kyçe:** *Pushteti Shtetëror, Sistemet, Balanci dhe Ekuilibri, Parimi, Shteti dhe e Drejta.*

## **HYRJE**

Nuk ka një sistem universal të ndarjes së pushteteve. Edhe në sistemet me të cilat kontrolli dhe kufizimet për ndërhyrjen e një dege të pushtetit tek tjetra janë më të përcaktuara, përseri nuk mund të pretendojmë se kemi një ndarje absolute të pushteteve.

Parimi i ndarjes së pushteteve, nga njëra anë, njeh funksionimin e pavarur të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. E në anën tjetër, parimi i kontrollit dhe balancës përqëndrohet në garantimin e rregullt kushtetues si një të tërë, duke parandaluar uzurpimin e një dege të pushtetit mbi tjetrin. Kushtetuta Amerikane nuk është vetëm kategoria e qështjeve që zë vendin parësor në jetën publike amerikane, por padyshim segmenti më i rëndësishëm i vet shtetit amerikan. Hapat e parë për të themeluar sistemin qeverisës amerikan janë shpallja e pavarësisë së trembëdhjetë kolonive angleze që gjendeshin në Amerikë. Deklarata e Pavarësisë e nxjerrur më 1776 është akti i parë konstituiv që shpreh vullnetin e popullit për të vendosur për vete, respektivisht për të vetëvendosur mbi statusin e vet juridik dhe politik. Zingjiri i bashkimit të shteteve amerikane që sapo kishin shpallur pavarësinë, vazhdon me formimin e Konfederatës Amerikane e që themelohet me nxjerrjen e Neneve të Konfederatës respektivisht të aktit juridik që vendosi bazën dhe formësoi konstituimin e kësaj konfederate. Për nga forma sistemi qeverisës amerikan njihet si Sistem Presidencial. Por roli i Presidentit të SHBA-ve kurrësi nuk mund të konsiderohet se është autoriteti mbi të tjerët, përkundrazi praktika ka treguar se ai është autoriteti që cilësisht realizon vullnetin e popullit dhe për më tepër është dëshmuar se është shëndërruar në element të demokracisë. Sistemi elektoral i

zgjedhjeve presidenciale në SHBA është padyshim i vjeter sa edhe vet SHBA-të, i pandryshuar në esencë por jo i pandryshueshëm dhe në detaje të tij.

### **HISTORIKU MBI NDARJEN E PUSHTETEVE**

Një nga aspektet më të rëndësishme të demokracisë është sistemi i kontrollit dhe balancës midis degëve të ndryshme të pushtetit. Ky koncept është rrënjësor në teorinë e ndarjes së pushteteve. Qëllimi i kësaj ndarje në legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor është në fund të fundit që forca e këtyre pushteteve të mos përdoret në mënyrë abuzive. Rrënjët e teorisë së ndarjes së pushteteve gjëjmë që në filozofët antikë, ku Aristoteli për të parën herë në histori, përmendi pushtetet në shtet:

- *i pari* Asambleja e Përgjithsme e cila duhet të vendosë për qështjet publike,
- *i dyti* është i përbërë nga trupi i funksionarëve, dhe
- *i treti* nga trupi gjyqësor.<sup>1</sup>

Mirpo autorët që e përpunuan më tej teorinë e ndarjes së pushteteve dhe që njihen si “baballarët” e saj janë John Lock, dhe Monteskej. John Lock në librat e tij “Qeverisja Civile” (1690) theksoi se menyra më e mirë për të shmangur një qeverisje të prishur, është promovimi kushtetues i ndarjes së pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv.

Ndërkaq, Monteskej i inspiruar nga përvoja Britanike në vepren e tij “The Spirit of Law” shtoi fuqinë e tretë të gjyqësorit në këtë koncept dhe kjo shprehje e ndarjes së pushteteve u bë realitet. Ideja e Monteskej për ndarjen e pushteteve shërbeu si direktivë e cila u pasqyrua në shumicën e kushtetutave botërore. Ndërkaq doktrina e “Kontrollit dhe Balancës” në Sistemin Amerikan është bazuar në premisën së të tri degët e pushtetit shtetëror nuk do të jenë aq shumë të larguara sa të humbin kontrollin njera ndaj tjetres. Pra qdo organ duhet të jetë në gjendje të kontrolloj pushtetin e kontrolluar ndaj te tjeret, duke ndarë funksionet, diskutuar për to, ose duke kontrolluar ushtrimin e tyre. Pra modeli amerikan i pushtetit, sëbashku me sektorizmin e pushtetit dhe me funksionet e tyre të përziera sigurojnë armen e nevojshme për qdo pushtet përfshirë edhe Gjyqësorin, me pak fjalë pra të

<sup>1</sup> Luan Omari “ Parime dhe Institucione të së Drejtës Publike”, Tiranë,, fq. 110

parandalojnë ose rregullojnë gabimet në veprimet e autoriteteve publike, kështu ky model Amerikan “ Check and Balanc” edhe lindi. - Qëllimi i përhershëm i ndarjes së pushteteve ishte që ndarja dhe rregullimi i disa instancave në mënyrë të atillë që secila prej tyre të kishte kontroll mbi tjetren. Ndërkaq W.Caesar në mbrojtje të pushtetit të ndarjeve së pushteteve ka venë se shumë kritikë ankohen se sistemit i mungon elementi unitar politik-bërjes, i venosur si një lloj oficeri ekzekutiv.<sup>2</sup>

Ndarja e ngurtë e pushteteve, funksionon kryesisht në sistemet presidenciale, në të cilat tri pushtetet janë të pavarura në ushtrimin e veprimtarisë së tyre dhe dhe në parim nuk ndërhyjnë në pushtetet tjera. Tek këto sisteme pushteti legjislativ i besohet tërësisht parlamentit, ai ekzekutiv presidentit, kurse gjyqësorit ushtrohet nga gjykatat e pavarura. Te kjo formë e ndarjes së pushtetit, qeveria nuk i nënshtrohet kontrollit parlamentar dhe mocionit të mosbesimit. Ajo është e varur nga presidenti i cili dhe është shefi i shtetit.

Ndarja e butë e pushteteve, është tipike për sistemet parlamentare të qeverisjes, qoftë për mbretërinë parlamentare ose republikat parlamentare. Te ky sistem ndonëse ekziston dhe funksionon parimi i ndarjes së pushteteve, paraqiten fërkime dhe ndërhyrje të shpeshta midis tyre dhe një sistem i kontrollit reciprok i cili shpeshhere shkakton konflikte politike midis pushteteve dhe kriza parlamentare<sup>3</sup>.

Ndërsa sistemi mikst i ndarjes së pushteteve paraqitet në shtetet që zbatojnë sistemin e kombinuar parlamentar – presidencial të qeverisjes. Tek këto shtete kemi një bashkëdyzim të elementeve parlamentare dhe presidenciale të qeverisjes. Jo pse sistemi qeverisës amerikan ka karakter historik, sepse është ndër sistemet e vetme qeverisëse që pavarësisht në kontestin politik ka ndikim më të madh në rrjedhet historike, nëse me histori do të kuptonim ngjarje të kaluara, por sepse sistemi qeverisës amerikan nuk është i kaluar as i tejkaluar, por për më tepër është aktual dhe sot, bile për më tepër efikasiteti dhe stabiliteti i tij janë në nivelin më të lartë, dhe sot e kësaj dite i prin sfidave të kohës në këtë fushë, duke argumentuar se është ndër të rrallët sisteme të qeverisjes që e ka sfiduar të kaluarën, e sfidon të sotmen dhe në të

---

<sup>2</sup> James W. Caesar, Ne mbrojtje te ndarjes se pushteteve.

<sup>3</sup> Demokracia Parlamentare, Prof.Dr. Arsim Bajrami, Prishtine 2005,, fq. 74

ardhmen<sup>4</sup>. Për herë të pare në historinë e së drejtës, lind Parimi i kufizimit të shtetit nga institucionet e pavarura që bëjnë interpretimin e ligjit në menyre profesionale \*Gjykatat\* të ndara nga pushtetet tjera. Kushtetuta Amerikane do të vështrohet nga dy aspekte: nga forma dhe përmbajtja. Për nga forma, sistemi qeverisës amerikan njihet si Sistem Presidencial qeverisës. Ndërkaq sistemi amerikan i qeverisjes për nga përmbajtja i qëndron besnike formës së këtij sistemi. Sistemi qeverisës amerikan në nivel federal për nga organet qendrore përbëhet nga Kongresi, institucioni i Presidentit dhe Gjykata Supreme<sup>5</sup>.

### **NDARJA E PUSHTETEVE SHETËTOR NË SHETËTET E BOTËS**

Parimi i ndarjes së Pushtetit Shtetëror nënkupton formën e qeverisjes shtetërore që bazohet në ushtrimin e pavarur të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Sistemi i ndarjes së pushtetit sot gjen zbatim në pjesën dërrmuese të sistemeve bashkëkohore politike, pra paraqet një nga komponentët kryesorë të shtetit modern të bazuar në qeverisjen e së drejtës dhe në parimin e pluralizmit shumë partiak. Kemi 3 lloj ndarjesh të sistemeve si:

- **Sistemi Parlamentar**
- **Sistemi Presidencial, dhe**
- **Sistemi Përzier.**

**Sistemi parlamentar** është formë e qeverisjes së pushtetit e bazuar në parimin e ndarjes së pushtetit, në të cilin ekziston një ndarje e tre pushteteve dhe një kontroll i tyre reciprok. Pra për here të parë ky sistem është aplikuar në Angli në shek. XVIII, e më vonë edhe në disa shtete tjera të Europës e të botës<sup>6</sup>.

**Sistemi Presidencial** është formë e qeverisjes shtetërore, e bazuar në ndarjen e funksioneve midis parlamentit dhe shefit të shtetit. Shefi i shtetit në sis. Presidenciale paraqet barte të pushtetit ekzekutiv. Si karakteristik e këtij sistemi është koncentrimi dhe ushtrimi i pushtetit ekzekutiv nga ana e presidentit. Këtë hasim në SHBA, Federatën Ruse, Filipine e shtete tjera.

<sup>4</sup> Kushtetuta Amerikane, Grupi për studime Juridike dhe Politike, Prishtine 2005, fq. 16

<sup>5</sup> Kushtetuta Amerikane... , fq. 27

<sup>6</sup> Demokracia Parlamentare, Dr. Arsim Bajrami,, Prishtine 2005,, fq. 71-75



**Sistemi Përzier ( parlamentar-presidencial )** paraqet një formë hibride të organizimit dhe të ushtrimit të pushtetit, e bazuar në parimin e ndarjes së pushtetit. Ky sistem ndryshe quhet edhe si sistem gjysem–presidencial. Paraqitja dhe zhvillimi i sistemit është si rezultat i një periudhe të gjatë të luftës së forcave demokratike për kufizimin e absolutizmit të monarkive feudale dhe për sovranitetin popullor të shprehur në institucionet politike përfaqësuese. Gjenezën e sistemit parlamentar dhe të demokracisë parlamentare e hasim në Angli e që konsiderohet *djep i parlamentarizmit*.

### **Sistemi Parlamentar**

#### **Mbretëria e Bashkuar** – djep i parlamentarizmit

Anglia, Skocia, Irlanda Veriore dhe Uells i përbëjnë Mbretërinë e Bashkuar siq njihet Anglia. Anglia është vendi në të cilën për herë të parë paraqitet rregjimi parlamentar dhe rregullat e qeverisjes të demokracisë përfaqësuese të bazuara në parlamentarizëm, e që fillet i hasim qysh në shek. XII kur edhe u aplikuan format e para të këtij sistemi. Si karakteristikë themelore e Anglisë në raport me sistemet tjera parlamentare: *Mungesa e kushtetutës së shkruar dhe tradicionalizmit*. Parlamenti anglez është paraqitur për herë të parë në vitin 1240 me emërtimin Magnum Conzulum e pastaj në vitin 1295 konsituohet si parlamenti i madh, e që nga viti 1400 merr karakter bikameral (dydhomësh) si dhoma e Lordëve dhe dhoma e Komunave. Qeveria paraqet shtyllën kryesore të sistemit parlamentar në Angli. Kryeministri është figura kryesore politike në vend.

#### **Republika e Francës**

Kushtetuta e pestë e proklamuar me Kushtetutën e De Golit të vitit 1958 u atribuua me frymën për një republikë presidenciale. Franca ka një qeveri e cila realisht ndikohet nga Presidenti por që i nënshtrohet kontrollit parlamentar me një mandat presidencial prej 7vitesh. Presidenti është autoriteti kryesor politik, udhëheqja e qeverisë dhe e drejta e përdorimit të vetos dhe shpërndarja e parlamentit. Si institucione kryesore janë: Presidenti i Republikës, Qeveria dhe Parlamenti.

#### **Republika e Italisë**

Organizmi qeverisës shtetëror në Itali përcaktohet me Kushtetutën e vitit 1948 e si Republikë Parlamentare Demokratike, e bazuar në punën. Sipas kushtetutës kemi këto institucione kryesore: Parlamenti (dhoma e deputetve dhe Senati), Presidenti i Republikës dhe Qeveria.

### **Republika e Gjermanisë**

Federalizmi gjerman paraqet modelin me të zhvilluar në Europë dhe funksionon mbi bazën e ndarjes së pushtetit dhe një decentralizim federal. Gjermania në bazë të nenit 20 të Ligjit Themelor (Kushtetutës) është njësi federale e ndarë në lande, ku pushteti shtetëror është i koncentruar në tri institucione si: Parlamentin federal, Presidentin dhe Kancelaren.

### **Republika e Shqipërisë**

Sistemi parlamentar ndonëse me shumë kufizime filloi me krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Tranzicioni demokratik që filloi në Shqipëri në vitet e 90ta shenoi edhe një proces të ndryshimeve politike, ekonomike, e shoqërore. Parimet e qeverisjes shtetërore u përcaktuan fillimisht me Ligjin për Dispozitat Kryesore Kushtetuese nr.7491 të vitit 1991, ku neni 1 i kësaj Kushtetute thotë se *Shqipëria është Republikë Parlamentare*. Struktura organizative shtetërore janë: Kuvendi, Këshilli i Ministrave, dhe Presidenti i Republikës.

### **Republika e Kosovës**

Fillimet e tranzicionit demokratik në Kosovë hasim në fillim të viteve 90ta në kohën kur filloj shpërbërja e RSFJ. Me ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë në Qershor të vitit 1999 për ta perfundue luftën, atëher u instalua një administratë civile nderkombetare si protektorat i Kombeve të Bashkuara të quajtur si UNMIK. Fillimisht u miratua Korniza Kushtetuese pasi që Kosova nuk ishte shtet. Tani Kosova me 17.02.2008 shpalli pavarësinë dhe u bë shtet sovran e i pavarur, edhe miratoj Kushtetutën e parë të njohur ndërkombtarisht ashtu si shtet i pavarur.

Kushtetuta në Nenin 1 paragrafi 1 përcakton “*Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm*”. Kosova është Republikë Parlamentare, e bazuar në sistemin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit të ballancimit në mes tyre, sikurse përcaktohet me Kushtetutë. Kuvendi i Republikës ushtron pushtetin Legjislativ,

kurse Qeveria atë Ekzekutiv. Presidenti i Republikës përfaqëson Unitetin e popullit. Pushteti Gjyqësor ushtrohet nga gjykatat e pavarura.

## **Sistemi Presidential**

### **Shtetet e Bashkuara të Amerikës – SHBA**

Kushtetuta e SHBA-ve është Kushtetuta e parë në botë e shkruar thellësisht me karakter juridik. Kushtetuta përbëhet nga 7 nene dhe e amadamentuar plot 26 herë. Sipas Kushtetutës pushteti shtetëror në SHBA ndahet në Legjislativ- Kongresi, në Ekzekutiv- Presidenti, dhe në Gjyqësor- Gjykata Supreme. Pra SHBA-të kanë tipik sistem presidencial<sup>7</sup>.

### **Federata Ruse**

Pas shpërbërjes së ish BRSS dhe diktatura komuniste, Federata Ruse me kushtetutën e vitit 1993 filloj ndërtimin e demokracisë parlamentare, ku neni 1 citon se Rusia përcaktohet si shtet demokratik federativ juridik në formë të qeverisjes republikane, përbëhet nga republikat, krahinat, rajonet, qytetet me rendësi federale, rajonet autonome, qarqet autonome, të cilat janë subjekte të barabarta në Rusi. Federata Ruse zbaton një sistem presidencial të ngjajshëm me sistemin amerikan. Dallimi konsiston në faktin se në Rusi funksionon qeveria si organ ekzekutiv me kryeministër, kurse në SHBA nuk ka kryeminister dhe qeveri të pavarur sepse ajo është pjesë e ekzekutivit që e kryeson presidenti.

## **Sistem i Përzier**

### **Republika e Sllovenisë**

Ish republika e parë Jugosllave që filloi procesin e demokratizimit dhe pavarësisë së saj. Në vitin 1991 kuvendi Slloven miratoi deklaratën e Pavarësisë duke shkëputur qdo lidhje me Federatën Jugosllave, pra miratoi Kushtetutën e saj si shtet i pavarur me 23 Dhjetor 1991, ku sipas Kushtetutës, Sllovenia përcaktohet si shtet sovran dhe i pavarur, si republikë demokratike dhe shtet ligjor dhe social. Kushtetuta përcakton një model të përzier të

---

<sup>7</sup> E drejta Kushtetuese, Dr.Kurteh Saliu, Prishtinë 2004, fq. 399

qeverisjes parlamentare-presidenciale si nga: Kuvendi Shtetëror, Këshilli i Shtetit, Presidenti i Republikës, Qeveria, Gjykatat dhe Gjykata Kushtetuese.

### **Republika e Kroacisë**

Pas një lufte të përgjakshme disa vjeqare ndërmjet Kroacisë dhe Serbisë edhe pas perfundimit të luftës me shpalljen e pavarësisë së Kroacisë, në vitin 1991 u kurorëzua Kushtetuta e Republikës së Kroacisë e që përcakton se Kroacia është shtet unitar dhe i pandarshem demokratik dhe social. Kushtetuta zbaton një sistem të përzier parlamentar-presidencial duke garantuar këto organe: Sabori i Republikës(Parlamenti), Presidenti i Republikës, Qeveria, Gjykatat dhe Gjykata Kushtetuese.

## **QEVERISJA DHE SISTEMI I NDARJES SË PUSHTETIT NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS**

Bazuar në dokumentet historike të kohës, mijëra vjet para ardhjes së europjaneve, Kontinenti i Amerikës Veriore ka qenë i popullarizuar me popullsi aziatike që kishte shkuar atje nga Siberia. Marinari Kristofer Kolombo \*1451-1506\* i cili gjendej në shërbim të mbretit Ferdinand dhe mbretëreshës Isabella të Spanjës, mendohet të ketë qenë europjani i parë që zbuloi Amerikën, ku kishte bërë 4lundërime për në ishujt e Karaibeve dhe Amerikën e jugut, kurse në vitin 1492 duke menduar se kishte mbërritur ne brigjet e Indisë, Kolombo kishte shkelur në ujdhesat e Kubës dhe Hispanjollës. Mirëpo bota e re që e zbuloi Kolombo nuk u emërua sipas emrit të tij por sipas një peshkatari të quajtur Ameriko Vespuqi. Me pastaj filluan emigrimet e para gjatë shekullit XVII dhe vitet e para të shek. XVIII ku mijera emigrantë shkuan nga Europa, kryesisht nga Britania e Madhe emigruan për në Amerikë. Emigrantet e pare britanik qe kaluan Atlantikun për në “*tokën e premtuar*” e që sot njihet si SHBA, u vendosën atje pas themelimit të kolonive spanjolle në Meksikë dhe në Amerikë Jugore. Shteti i Virgjinisë ishte kolonia e pare nga Britanikët.

Dy fuqitë e mëdha të kohës \* Britania dhe Franca\* të përkrahura nga fiset indiane kah vitet 1756-1763 kanë zhvilluar një luftë 7vjeqare për kontrollimin e territoreve të Amerikës Veriore. Si kundërpërgjigje ndaj presionit britanik, në shtator 1774 përfaqësuesit e 12kolonive u mbledhën në Kongresin e parë Kontinental në Filadelfi. Gjatë këtij kongresi nuk u diskutua shumë për pavarësinë por delegatet e mbledhur në Kongresin e Parë Kontinental morën disa vendime të ndryshme përfshirë vendimin për bojkotimin e produkteve britanike duke hartuar edhe një deklaratë politike. Pastaj vazhdoi edhe me Kongresi e dytë Kontinental në Filadelfia më 1775 në Konkord dhe në Leksinton të shtetit Masaqusets që shpërtheu revolta e kolonive kundër pushtetit britanik. Nder vendimet që u morën delegatet ishin ngritja e një ushtrie kombëtare dhe për zgjedhjen e Xhorxh Uashingtonit për komandant të ushtrisë. Kurse në aspektin politik kjo ky kongres luajti rolin e Qeverisë së parë Amerikane<sup>8</sup>. Kongresi luajti rolin e Qeverisë Amerikane që nga shpallja e pavarësisë në korrik të vitit 1776 e deri në prill të vitit 1781 kur edhe e mori drejtimin e vendit Qeveria e dal nga nenet e Konfederatës i cili ishte njëdhomësh. Gjatë punës për hartimin e hartimit të Deklaratës së Pavarësisë, të kolonët patën ndikim të jashtëzakonshëm mendimet e filozofëve anglez të shek.XVII, Xhon Loku dhe Tomas Hobsi. Edhe pse kolonit e kishin shpallur formalisht pavarësinë mirpo lufta mes tyre dhe Britanisë së Madhe vazhdoi edhe për 5vite me rradhe. Marrëveshja që u paraqit “ Nenet e Konfederatës dhe Bashkimit të Përhjetshëm” në vitin 1777 u miratua një nga kongres shtetesh dhe në Korrik 1778 u nënshkrua zyrtarisht. Për ta kuptuar se pse SHBA e kanë një sistem të qëndrueshëm të qeverisjes, ju sjellim disa nga teoritë të cilat u bazuan Etërit Themelues të SHBA gjatë punës së tyre për hartimin e kushtetutës së vendit, me të cilin iu vunë bazat sistemit të sotëm politik të SHBA.

Përgjithësisht shumica e amerikanëve identifikohen si Konservator ose Liberal, por ka edhe tjerë që identifikohen si Libertariane, Socialistë dhe Komunistë. Ndersa në vitin 1787 kur u adaptua Kushtetuta e re e SHBA përbëheshin prej 13 kolonive me më pak se 4miljon banorë, kurse sot kemi një shtet federativ me mbi 50shtetesh me afro 320 milion banorë<sup>8</sup>.

Pra, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë shteti më i vjetër dhe i parë federativ në botë. Sipas kushtetutës duke u nisur nga parimi i ndarjes së pushteteve në SHBA është zbatuar

<sup>8</sup> Politika dhe Qeverisja e SHBA, Prof.Dr. Zenun Halili, Prishtine 2006, fq.14-15

<sup>8</sup> Politika dhe Qeverisja e SHBA, Prof.Dr. Zenun Halili, Prishtine 2006, fq.23

sistemi Presidencial. Organi më i lartë legjislativ i Federates Amerikane është Kongresi që përbëhet nga dy dhoma: dhoma e përfaqësuesve që zgjidhen anetaret e saj qdo 2vite dhe Senati për qdo 6vjet. Përndryshe Kushtetuta e SHBA e vitit 1787 është plotësuar me 26 amandamente e prej tyre 24 janë në fuqi.<sup>9</sup> Kushtetuta amerikane vështrohet në dy aspekte: për nga forma dhe përmbajtja. Sistemi qeverisës amerikan për nga forma njihet si sistem presidencial qeverisës, kurse për nga përmbajtja sistemi qeverisës amerikan i qëndron besnike formës së këtij sistemi pra në nivel federal përbëhet nga Kongresi, Presidenti, dhe Gjykata Supreme<sup>10</sup>. Me ndarjen e pushtetit bëhej ndarja e kompetencave mes Legjislativit, Ekzekutivit dhe Gjyqësorit.

Neni 1 i Kushtetutës së SHBA-ve i jep të gjitha kompetencat ligjevendëse të Qeverisë Kombëtare Kongresit, të ndarë në dy dhoma: Senatit dhe dhoma e Përfaqësuesit. Dhoma e përfaqësuesve është dhoma më e madhe ku anëtarët e saj zgjedhen drejtpërdrejt nga populli për një mandat dy vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Senati amerikan përbëhet nga dy Senator për qdo shtet të cilët fillimisht janë zgjedhur nga legjislaturat shtetërore por nga viti 1913, kur u adoptua Amandamenti 17, zgjedhja e senatorëve bëhet nga populli. Kongresi ka edhe komitetet e saj siq janë disa komitetet e përhershme, komitetet e përbashkëta, komitetet e zgjeruara dhe komitetet speciale. - Sipas formulës së Kontrollëve dhe Balancimeve, instrumentet me të cilat Kongresi e kontrollon ekzekutivin janë:

- Impeachmenti ( Dhoma e përfesuesve e ngreh akuzën);
- Gjykimi i rasteve të impeachmentit (Senati);
- Kongresi mund ta rrezoj veton e Presidentit;
- Presidenti është Komandant Suprem i Forcave të Armatosura etj.

Presidenca e SHBA është themeluar më shumë se 200vjet më parë si institucion i vogël dhe jo aq i fuqishëm. Sot Ekzekutivi është shumë më e madhe, më e fuqishme dhe më e kontrolluar. Neni II i Kushtetutës thekson se pushteti ekzekutiv ushtrohet nga Presidenti i cili

<sup>9</sup> E drejta Kushtetuese, DR.Arsim Bajrami, Prishtine 2004, fq.400

<sup>10</sup> Kushtetuta Amerikane, Grupi për studime Juridike dhe Politike, Prishtinë, 2005, fq. 25-27

sebashku me zv.presidentin zgjidhen me anë të Kolegjiut Elektoral për një mandat 4vjeçar, me të drejtë rizgjedhje dhe për një mandat tjetër.

Presidenti disponon me kompetenca të gjëra politike dhe operative si: ti rekomandoj Kongresit akte legislative, të thërras Kongresin në sesione të veqanta, ti drejtoj mesazhe Kongresit të vërë veto mbi projektligjet, ti emëroj gjyqtarët federal, ti zgjedh Sekretarët e Departamenteve dhe te Agjencive, të emëroj Ambasadorët, të jetë Komandant Suprem i Ushtrisë, dhe të jap falje ndaj SHBA-së.

Kongresi i parë i SHBA nëpërmjet Aktit juridik të vitit 1789 e formoi strukturën e gjykatave federale. Gjykata të këtij lloji janë: Gjykata Doganore, Gjykata e Doganave dhe e Apeleve për Patentat, pastaj Gjykata e Rivendikimeve, por mbi të gjitha në nivel federal është Gjyk. Supreme. Shtetet e Bashkuara janë një vend unikal në sistemin federal të qeverisjes në të cilin pushteti dhe autoriteti ndahen dhe ushtrohen nga Qeveria Kombëtare, nga qeveritë e shteteve dhe nga qeveritë lokale. Përveq qeverisë Kombëtare që gjendet me seli në Distriktin e Kolumbisë ( Washington D.C. ), janë edhe 50 qeveri shtetesh si dhe qeverit lokale si: 3.000 konte me ekzekutiv të zgjedhur, 20.000 Bashkësi të udhëhequra nga Këshilli bashkiak +Kryebashkiak etj.

Sa i përket qështjes së grupimit partiak, në SHBA janë dy forca politike të mëdha e cilat janë: *Partia Demokratike* e cila u formua në vitin 1800 e cila konsiderohet edhe si partia më e vjetër në botën perendimore, me themeluesin e saj Tomas Xheferson e orientuar si parti e majtë, ndërsa tani ajo mban epitetin e një partie të majte qendrore (sentriste).

*Partia Republikane* e formuar në vitin 1854 është parti e krahut të djathtë dhe si e tillë është më konservatore se PD. Por kuptohet se ka edhe grupime tjera partiake apo me mirë të them ka edhe parti tjera por më të vogla e që numërohen rreth 54 parti politike<sup>11</sup>. Sot SHBA janë superfuqia botërore si në aspektin ekonomik, politik e ushtarak, e sfera tjera duke marrë primatin botëror.

## KONKLuzion

<sup>11</sup> Zgjedhjet Presidenciale ne SHBA, Mr. Amir Ahmeti, Prishtine 2008, fq.44.

Për të parashikuar kontributin e ndarjes së pushteteve në konsolidimin e sistemit demokratik dot theksojmë aspektet pozitive apo konstruktive të këtij sistemi. Ku pretendohet se tre degët e pushteteve të ndara veprojnë të paktën katër drejtime të dallueshme por që qendrojnë në nivele të ndërvarrura.

*Ndarja e ngurtë* e pushteteve, funksionon kryesisht në sistemet presidenciale, në të cilat tri pushtetet janë të pavarura në ushtrimin e veprimtarisë së tyre dhe në parim nuk ndërhyjnë në pushtetet tjera. Tek këto sisteme pushteti legjislativ i besohet tërësisht parlamentit, ai ekzekutiv presidentit, kurse gjyqësorit ushtrohet nga gjykatat e pavarura. *Ndarja e butë* e pushteteve, është tipike për sistemet parlamentare të qeverisjes, qoftë për mbretërinë parlamentare ose republikat parlamentare. Te ky sistem ndonëse ekziston dhe funksionon parimi i ndarjes së pushteteve, paraqiten fërkime dhe ndërhyrje të shpeshta midis tyre dhe një sistem i kontrollit reciprok i cili shpeshherë shkakton konflikte politike midis pushteteve dhe kriza parlamentare. Kushtetuta Amerikane vështrohet në dy aspekte: nga forma dhe përmbajtja. Kur flasim për burimet e demokracisë është “ e padiskutueshme” që kushtetuta amerikane ka vendin e saj merituar aty. Por kur flasim për burimet e demokracisë, padyshim Kushtetuta e SHBA ka vendin kryesor aty. Një aspekt tjetër i Kushtetutës SHBA që konsiderohet sot burim i demokracisë është që “*subjektet që kanë kompetencën*” të nxjerrin ligjet, si akte juridike me fuqi më të lartë pas kushtetutës, zgjedhen nga populli.

#### **Referenca:**

1. Politika dhe Qeverisja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Prof.Dr.Zenun Halili, Prishtinë 2006;
2. Demokracia Parlamentare, Prof. Dr. Arsim Bajrami, Prishtinë 2005;
3. Kushtetuta Amerikane ....., Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtinë 2005;
4. E Drejta Kushtetuese, Prof. Dr. Kurtesh Saliu, Prishtinë 2004;
5. E Drejta e Kosovës në Tranzicion, Prof.Dr. Arsim Bajrami, Prishtinë 2002;



6. Zgjedhjet Presidenciale në SHBA, Mr.sc. Amir Ahmeti, Prishtine 2008;
7. Shqiptarët në Ballkan, Daniel Server, ISHSN, Tiranë 2001;
8. Parime dhe Institucione të së Drejtës Publike, Prof. Luan Omari, Tiranë;
9. Në mbrojtje të ndarjes së pushteteve, James W. Caeser;
10. Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (1787);
11. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (2008);
12. [www.wikiwand.com/sq/Shtetet\\_e\\_Bashkuara\\_të\\_Amerikës](http://www.wikiwand.com/sq/Shtetet_e_Bashkuara_të_Amerikës) ;

## E DREJTA E SERVITUTEVE REALE DHE PERSONALE

**Nurten Kala DAUTI, PhD candidate**

International University of Struga

Faculty law, teaching assistant

n.kala@eust.edu.mk

### Abstrakt

E drejta e servitutit është e drejtë reale që nënkupton të drejtëne një personi që, në përmasë dhe në mënyrë të caktuar, të shfrytëzon sendin pronar i të cilit është personi tjetër.

Servitutet reale janë e drejtë e pronarit të një patundshmërie që për nevoja të asaj patundshmërie të ndërmmerr veprime të caktuara në paluejtshmërinë e pronarit tjetër ( e mira shërbyese), apo të kërkon nga pronari i të mirës shërbyese që ai të përmbahet nga ndërmarrja e ndonjë veprimi për të cilin ka të drejtë. E drejta e servitutit real mund të fitohet: në bazë të punës juridike, me vendim të organit shtetëror dhe mbi bazën e posedimit.

Servituti personal nënkupton të drejtën reale në sendin e huaj. Kjo e drejtë e mundëson përdorimin, përkatësisht shfrytëzimin e sendit të huaj dhe i përket vetëm personit të caktuar. Kjo e drejtë nuk mund të bartet te tjetri e as të trashëgohet dhe janë të kufizuara në kohë.

Servitute personale janë: shfrytëzimi i frytave, përdorimi i sendit dhe e drejta e banimit. Nga praktika gjyqësore për fitimin, humbjen dhe vërtetimin e ekzistimit të së drejtës së servitutit ekzistojnë disa padi që do të shtjellohen më poshtë.

**Fjalët kyçe:** *E drejta e servitut, servitutet reale, servitute personale, fitimi, humbja.*

## **HYRJE**

E drejta e servitutit në të drejtën sendore ka një vend të rëndësishëm si insitut juridik. E drejta e servituteve është e drejtë sendore mbi sendin e huaj e cila titullarit të vet i mundëson që ta shfrytëzoj sendin e tjetrit ose të kërkoj që pronari i sendit të kufizohet në shfrytëzimin e së drejtës së vet, në interes të titullarit të të drejtës së servitutit. Pra, e drejta e servitutit është e drejtë sendore mbi sendin e huaj në bazë të së cilave, të autorizuarit i lejohet shfrytëzimi i caktuar i sendit të huaj. Servituti është një e drejtë e sendore mbi një send të huaj, e cila titullarit të servitutit i bënë të mundshëm që sendin e huaj ta shfrytëzojë në një mënyrë të caktuar.

## **E DREJTA E SERVITUTIT**

Në të drejtën romake, servituti lindi si pasojë e shtimit të pronës private dhe të nevojës për të respektuar secili nga pronarët tjetrin. Servitutet përcaktoheshin si shërbime të përhershme që krijoheshin midis dy pasurive fqinje me vullnetin e pronarëve të tyre. Juristët e quajtën të drejta civile të pasurive (iura praediorum).<sup>1</sup>

Sipas nenit 261 të Kodit civil të Shqipërisë servituti nënkupton barrën që i ngarkohet një prone, për përdorimin dhe dobinë e një pronari tjetër.<sup>2</sup> Pra, kjo e drejtë reale gëzimi, nënkupton një pronë i nënshtrohet një prone tjetër për ti shërbyer.

Nga këtu konstatohet se janë tre karakteristika themelore të së drejtës së servitutit, edhe atë së pari, e drejta e servitutit ekziston mbi sendin e huaj, së dyti, nga ajo rrjedh autorizimi për bartësin e saj që nga pronari i të mirës shërbyese të kërkon të durojë kalimin nëpër pronën e tij, dhe së treti, duke shfrytëzuar këtë të drejtë, duhet sa është e mundur më pak të ngarkohet e mira shërbyese.<sup>3</sup>

Përveç karakteristikave, e drejta e servituteve ka dhe disa parime siç janë:

<sup>1</sup> Kondili, Valentina” E drejta civile II- pjesa e Posaçme”, Gerr,2008, fq 166

<sup>2</sup> Kodi civil i Republikës së Shqipërisë

<sup>3</sup> Aliu, Abdulla. E drejta reale” ligjërata të autorizuar, 2010. Fq.130

- Parimi sipas së cilës servituti ka të bëj me sendin e huaj,
- Parimi sipas së cilës servituti nuk mund të ekzistojë në të vepruar,
- Parimi i restriksionit të servitutit dhe
- Parimi i pacenueshmërsisë së servituteve.

Sipas parimit të parë, servituti ka të bëjë me sendin e huaj, i përcakton vendin kësaj të drejte sendore në grupin e të drejtave sendore mbi sendin e huaj. Kuptimi i këtij parimi daton që nga e drejta romake, ku është thënë se e drejta e servitutit mund të ekzistoj vetëm mbi sendin e huaj pra, ka ekzistuar mendimi se mbi sendin e vet nuk mund të ekzistoj servituti.

Sipas parimit të dytë servituti nuk mund të ekzistoj në të vepruar, pronari i pasurisë shërbyese (atij që është ngarkuar me servitut), duhet vetëm të durojë që titullari i servituteve të kryej veprime të caktuara ose duhet të heq dorë nga kryerja e disa veprimeve, të cilat përndryshe do të kishte të drejtë ti bënte si titullar i së drejtës së pronësisë. Pronari duhet të mirëmbajë sendin që është pasuri shërbyese në mënyrë që servituti të ushtrohet në mënyrë të rregullt.

Parimi i restriksionit nënkupton se, titullari i së drejtës së servitutit duhet të ushtrojë të drejtën e vet në mënyrë që sa më pak të ngarkojë apo të dëmtojë tokën shërbyese. Ky parim nënkupton atë që me rastin e ushtrimit të së drejtës së servitutit, objekti i pronësisë me të cilin ka të bëjë servitutit duhet të kursehet sa më shumë që është e mundur. Në Ligjin mbi Mardhëniet Themelore Juridiko- Pronësore, parashihet se, servitutit real ushtrohet ashtu që sa më pak të ngarkohet prona shërbyese.

Parimi i pacenueshmërisë nënkupton faktin se servitutet nuk mund të ndahen. E drejta e servitutit është një e drejtë unike dhe nuk ka kurrfarë varshmërie nga fakti i pjestimit të pasurisë doninuese apo ndonjë veprimi tjetër në pasurinë dominuese. Servitutet nuk mund të fitohen ose shuhen vetëm në një pjesë të sipërfaqes së tokës, por vetëm në favor ose barrë të një palujtshmërie të tërë.

## **LLOJET E SERVITUTEVE**

Servitutet edhe pse janë një institut juridik unik, prapëseparapë brenda tyre ekzistojnë lloje të servituteve. Servitutet ndahen në serviotute reale dhe personale.

## 1.1 Servitutet reale

**Servituti real** është e drejtë e pronarit të një paluejtshmërie (e mira e privilegjuar) që për nevoja të asaj paluejtshmërie të ndërmerr veprime të caktuara në paluejtshmërinë e pronarit tjetër (e mira shërbyese) apo të kërkon nga pronari i të mirës shërbyese që ai të përmbahet nga ndërmarrja e ndonjë veprimi për të cilin ka të drejtë .<sup>4</sup>

Me fjalë të tjera servitutet reale janë ato në bazë të të cilave pronari i përditshëm i një sendi të paluajtshëm duhet të durojë që pronari i përditshëm i një sendi tjetër të paluajtshëm të shfrytëzojë në një kuptim sendin e tij të paluajtshëm ose në një kuptim tjetër të mos shërbehet në interesin e këtij pronari të dytë me sendin e vet të paluajtshëm edhe pse ndryshe, është i autorizuar në këtë.

Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore i Maqedonisë, në nenin 192, al.2, servitutit real e percakton kështu” servituti sendor është e drejtë e pronarit të një paluajtshmërie ( send i privilegjuar) për nevojat e asaj paluajtshmërie të kryej veprime të caktuara në paluajtshmërinë e pronarit tjetër (sendi shërbyes) ose të kërkoj nga nga pronari i sendit shërbyes të përmbahet nga kryerja e veprimeve të caktuara, çka përndryshe do të kishte të drejtë ti kryejë në sendin e vet të paluajtshëm.<sup>5</sup>

Servituti real ka për objekt gjithmonë sendet e paluajtshme dhe në këtë mënyrë, krijon lidhje të përhershme midis dy sendeve të paluajtshme. Pra e drejta sendore përfshin tërësinë e normave juridike-civile, gjegjësisht sendore me të cilat rregullohen marrdhëniet juridike personave lidhur me sendin e caktuar, sepse nuk mund të ekzistojë marrdhënie shoqërore, e aq më pak juridike midis njeriut dhe sendit. Këto marrdhënie ekzistojnë midis njerëzve lidhur me sendet. Përkatësia e sendit është me rëndësi për njerëzit-subjektet, e jo për vet sendet, sepse ato as që dalin në qarkullim juridik vetëpërveti. Prandaj, te servituti real marrdhënia juridike ekziston midis pronarëve të përditshëm të dy sendeve të paluajtshme. Paluajtshmëria e titullarit të servitutit quhet pasuri dominuese (*praedium dominans*), ndërsa paluajtshmëria,

<sup>4</sup> Ligji mbi Marrdhënien Themelore Juridiko- Pronësore, n.49, al.1

<sup>5</sup> Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore i Maqedonisë, në nenin 192, al.2

mbi të cilën ushtrohet servituti, gjegjësisht pronësia e të cilit është kufizuar me servitut, quhet pasuri shërbyese (*praedium serviens*). Pra, pronarët e paluajtshmërisë dominuese dhe asaj shërbyese janë subjekte të ndryshëm. Paluajtshmëria dominuese dhe ajo shërbyese nuk është e thënë të jenë në fqinjësi.

Servitutet reale si mardhënie juridike sendore ndahen në: servitute të fushës dhe urbane.

*Servitutet fushës(tokësore)* ekzistojnë gjithmonë midis dy tokave. Servitutet toksore është lloj i servituteve më të vjetra, që në të drejtë e lashtë të shkruar, ato janë përfshirë në *Ligjin e Dymbëdhjetë Tabelave*. Sipas autorit E.Stavileci, servituti tokësor është një e drejtë sendore në sendin e huaj e cila krijohet në dobi të pronarit aktual të tokës dominante duke engarkuar pronarin aktual të tokës shërbyese, me qëllim të shfrytëzimit sa më të mirë ekonomik si dhe shtimin e vlerës së tokës dominante. Servitutet tokësore mundësojnë shfrytëzimin e shumë të drejtave si psh.e drejta e rrugëkalimit të njerëzve nëpër të mirën shërbyese; e drejta e kalimit të kafshëve; e drejta e marrjes së ujit nga e mira shërbyese; e drejta e kullotjes së kafshëve,etj.

*Servituti urban* është një e drejtë sendore në sendin e huaj, i cili krijohet në dobi të pronarit ose poseduesit aktual të sendit shërbyes, me qëllim të përdorimit të shtëpisë ( ndërtesës dhe tokës ndërtimore). Përkufizimi tjetër është “ servitute shtëpiake ose të qytetit janë ato të cilat paluejtshmëri sunduese janë ndërtesat ose toka rreth ndërtesave, ndërsa autorizojnë në ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në paluajtshmërinë e fqit si pasuri shërbyese, çka ai është i detyruar të durojë”.<sup>6</sup>

Si servitute urbane konsiderohen: servituti i mbështetjes së shtëpisë së vet në të huaj; e drejta që trarin e vet ta përforcoj në murin e huaj; dritaren e vet ta hap në murin, qoftë për shkak të dritës qoftë për shkak të shikimit; e drejta e kalimit të tymit apo gazrave nëpër oxhakun e huaj; e drejta e kalimit të ujrave të ndryshme nëpër tokën e huaj; detyrimi që shtëpinë e vet mos ta ndërtojë më tepër në lartësi,etj.

Sipas përmbajtjes servitutet ndahen në pozitive dhe negative.

Pozitive janë servitutet të cilat i njohin titullarit të tyre të drejtën të përdorë në ndonjë mënyrë pronën e tjetrit, si psh., servituti i kalimit, i mbushjes së ujit,etj.

<sup>6</sup> M. Vedrish dhe P. Klaric. Vepra e cituar, fq.312

Negative janë servitutet të cilat injohin titullarit vetëm të drejtën për të ndaluar përdorimin e lirë të pronës shërbyese, si psh., servituti për të ndaluar lartësimin e ndërtesës së tjetrit, etj.<sup>7</sup>

Pra, te servitutet pozitive autorizohet titullari i të drejtës së servitutit të shfrytëzon të mirën shërbyese në mënyrë dhe vëllim të caktuar, ndërsa negative- titullari i së drejtës ka autorizim të kërkojë që pronari i të mirës shërbyese të përmbahet nga shfrytëzimi i të mirës shërbyese në mënyrë dhe vëllim të caktuar. Vëllimin e servituteve sendore e caktojnë dispozitat ligjore, në shumicën e rasteve rregullat juridike, e në mungesë të rregullave juridike vijnë në shprehje zakonet lokale.

E drejta e servituteve reale mund të fitohet:

- Në bazë të punës juridike,
- me vendim të organit shtetëror dhe
- mbi bazën e posedimit (n.51 LBMJP).

Për të fituar të drejtën e servitutit me punë juridike, sikur edhe te e drejta e pronësisë, nevojiten baza juridike ( kontrata) dhe mënyra e fitimit( regjistrimi në regjistër të paluajtshmërive). Me vendim të organit shtetëror e drejta e servitutit real fitohet nga dita e plotëfuqishmërisë së atij vendimi.

Mbi bazën e posedimit fitohet në rast se pronari i të mirës së privilegjuar faktikisht ka qenë në posedim të servitutit 20 vite e pronari i të mirës shërbyese këtë nuk e ka kundërshtuar, me kusht që shfrytëzimi i kësaj të drejte mos të ketë qenë me keqpërdorim të besimit, me forcë apo mashtrim.

Sipas ligjit, deri te humbja e kësaj të drejte do të vjen nëse pronari i të mirës shërbyese kundërshton, duke mos lejuar ushtrimin e saj, e pronari i të mirës së privilegjuar nuk e shfrytëzon këtë të drejtë deri në tre vjet radhazi, e as që kërkon mbrojtjen juridike të kësaj të drejte (n.58 LBMJP). kjo e drejtë humbet edhe në rastet kur vjen deri te ndryshimi i rrethanave, psh. është i pa nevojshëm servituti i rrugëkalimit për shkak se është ndërtuar rruga

---

<sup>7</sup> Kondili, Valentina” E drejta civile II- pjesa e Posaçme”, Gerr,2008, fq.168

publike deri te e mira e privilegjuar. E drejta e servitutit real humbet nëse nuk ushtrohet 20 vite, sa edhe nevojitet për fitimin e kësaj të drejte në bazë të posedimit, në rastet kur i njëjti person bëhet pronar dhe i të mirës sëprivilegjuar edhe i asaj shërbyese, si dhe me zhdukjen e të mirës së privilegjuar apo asaj shërbyese.

Sipas Kodit Civil të Shqipërisë n.293 , rastet e shuarjes së servituteve janë: konfondimi, mospërdorimi dhe pamundësia për të përdorur servitutin, që lidhet me dëmtimin ose konsumimin e sendeve deri në një shkallë sa nuk mund të përdoren për qëllimet e tyre.<sup>8</sup>

Konfondim konsiderohet kur në një person të vetëm bashkohet pronësia e pronës mbizotëruese me atë të pronës shërbyese. Në këtë rast zbatohet parimi *nemini res sua servit*.

Mospërdorimi ka të bëjë me institutin e quajtur parashkrimi i servitutit. Servitutet shuhen në rastet nëse nuk përdoren për 10 vjet. Ligjvënësi prezumon se pronari i pronës mbizotëruese ka hequr dorë nga e drejta që ka pasur, kur ky nuk e ka përdorur atë për një kohë të gjatë, konkretisht 10 vjet.<sup>9</sup>

Kushtet që zakonisht shpjen deri te shuarja e të drejtës së servituteve janë përafërsisht këto:

- me heqje dorë të të titullarit të tokës dominuese,
- me shkatrimin e tokës dominuese ose shërbyese,
- nëse i njëjti person fiton të drejtën e pronësisë edhe në tokën dominuese edhe në tokën shërbyese,
- nëse servituti ka qënë i kontraktuar për kohën e caktuar ajo shuhet me kalimin e kohës dhe
- nëse përgjithmonë bie fitimiapo interesi për tokën dominuese.

<sup>8</sup> Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë, n.293

<sup>9</sup> Baltazar, Benussi. “sendet, zotërimi dhe modifikimet e tij, botim i Ministrisë së Drejtësisë së R.Shqipërisë,v.1931 ,f.210.



Pronari i pronës shërbyese mund të kërkojë që të pushojë e drejta e servitutit real, kur ai bëhet i panevojshëm për shfrytëzimin e pronës sunduese ose kur nuk ekziston arsyeja për të cilin ai është vendosur.<sup>10</sup>

## 1.2. Servitutet Personale

Me servitut personal nënkuptojmë të drejtën reale në sendin e huaj. Kjo e drejtë mundëson përdorimin, përkatësisht shfrytëzimin e sendit të huaj dhe i përket vetëm personit të caktuar.

Servitutet personale nuk mund të barten te subjekti tjetër i së drejtës dhe as nuk mund të trashëgohen dhe janë të kufizuara në kohë.<sup>11</sup>

Servitutet personale ju takojnë personave të caktuar të cilët kanë autorizime që ekonomikisht në tërësi ose pjesërisht të shfrytëzojnë sendin e luajshëm apo të paluajshëm të huaj. Në këtë mënyrë servitutet personale janë të përkufizuara në kohë, nga se janë të lidhura me personin dhe pushojnë me vdekjen e titullarit e të drejtës së servitutit personal, në dallim nga servitutet reale të cilat janë të lidhura me paluajtshmërinë dhe nuk janë të kufizuara në kohë.

Servitute personale janë: shfrytëzimi i fryteve (usufructus), përdorimi i sendit (usus) dhe e drejta e banimit (habitatio).

Shfrytëzuesi i frytave ka të drejtë në të gjitha të mirat dhe frytat të cilat i sjeoll sendi për kohën sa e shfrytëzon sendin. Frytat i merr me rastin e ndarjes së tyre nga sendi i cili jep fryta. Shfrytëzuesi i frytave ka detyrim që sendin ta mirëmbaj dhe të mos ta ndryshoj supstancën ekonomike të tij. Ai njëherësh mban shpenzimet rreth prodhimit të frytave dhe ngarkesat publike. Shpenzimet e jashtëzakonshme i mban pronari i sendit, nga se ai i merr edhe të ardhurat e jashtëzakonshme nga sendi. Shfrytëzuesi i sendit përgjigjet për çdo lloj dëmi ndaj sendit, përpos asaj të rastësishme dhe nuk përgjigjet për zvoglimin e vlerës së sendit të shkaktuar nga përdorimi i rregullt. Frytat ndahen në fryta natyrore dhe civile.

<sup>10</sup> Aliu, Abdulla.” E drejta Reale”, ligjerata të autorizuara, fq 140.

<sup>11</sup> Ligji mbi Marrëdhënien Themelore Juridiko- Pronësore, n.60

Uzefrukti është e drejtë me përmbajtje të përgjithshme. Mund të themi se destinacioni ekonomik i sendit mund të ndryshohet me vullnetin e të dy palëve, me iniciativën e pronarit të zhvshur dhe me konsesusin e uzufuktarit. Në këtë rast uzufrukti do ta përfshijë të drejtën për të marr nga sendi shërbime të ndryshme të bëra të mundura nga ndryshimi i destinacionit ekonomik, megjithëse flasim për të njëjtin uzufrukt që ekzistonte më parë.<sup>12</sup> Në uzufrukt objekt mund të jenë sende të ndryshme dhe uzufrukti, është i caktuar, pra nuk mund të kalojë jetën e uzufuktarit, nëse bëhet fjalë për person juridik atëherë afati kohor nuk mund të zgjasë më shumë se 30 vjet.

Uzefrukti shuhet kur bashkohet cilësia e pronarit e uzufuktarit në një person të vetëm kur sendi nuk përdoret 10 vjet,<sup>13</sup> dhe 20 vjet për uzufruktin<sup>14</sup> kur sendi i dhënë në servitut dëmtohet ose konsumohet deri në atë shkallë sa nuk mund të përdoret për qëllimin e tij, ndërsa për uzufruktin, kur shkatrohet ose humbet. Dallimet në mënyrat e shuarjes është se uzufrukti mbaron me vdekjen e uzufuktarit ose me mbarimin e personit kuridik.

Uzefrukti mund të pushojë kur uzufuktari shpërdoron të drejtat dhe nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga uzufrukti ose uzufuktari mund të kërkojë të heq dorë nga uzufrukti për shkak të barrëve dhe detyrimeve që rrjedhin prej tij.<sup>15</sup>

Përdorimi i sendit (usus) ka të bëjë me përdorimin e sendit të huaj dhe marrjen e frutave nga ai send vetëm për nevoja personale dhe për nevojat e anëtarëve të familjes së tij. Përshkak të vëllimit të përdorimit dallohet nga shfrytëzimi i fryteve.

E drejta e banimit (habitatio) është një lloj servituti të përdorimit të lokaleve për banim për nevoja personale të titullarit të kësaj të drejte dhe të anëtarëve të familjes së tij. Shpenzimet lidhur me mirëmbajtjen e banesës i mban pronari. Titullari i kësaj të drejte ka autorizim ta shfrytëzon ndërtesën për nevoja personale dhe anëtarëve të familjes së tij, pa cenuar substancën e banesës.

---

<sup>12</sup> Kondili, Valentina” E drejta civile II- pjesa e Posaçme”, Gerr,2008, fq.174

<sup>13</sup> Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë, n.293, al.2

<sup>14</sup> Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë, n.255

<sup>15</sup> Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë, n.255-256

## 2. MBROJTJA E SERVITUTEVE

Servitutet si të drejta sendore gëzojnë mbrojtje juridike, andaj edhe legjislacioni pozitiv është kujdesur në këtë drejtim që të parasheh mënyrën e mbrojtjes së servituteve. Në nenin 57 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike- Pronësore thuhet: në qoftë se pronari i pronës sunduese pa bazë ndalohej ose pengohet në ushtrimin e servitutit real, ai mund të kërkojë me padi që ky ndalim ose pengim të pushojë.

Duke u nisur nga mundësitë ligjore për të fituar apo mbrojtur të drejtën e servitutit real, përkatësisht kundërshtuar ekzistimin e kësaj të drejte, mund të paraqiten këto padi:

*-Padi për konstituimin e së drejtës së servitutit real-* paditës është pronari i paluajtshmërisë në favor të së cilës duhet konstatuar kjo e drejtë, ndërsa i paditur është pronari i paluajtshmërisë së cilës duhet të konstituohet kjo e drejtë. Kërkesa do të jetë konstituimi i së drejtës së servitutit real.

*- Padi për vërtetimin e ekzistimit të drejtës së servitutit real-* paditës është pronari i paluajtshmërisë së privilegjuar i cili e konsideron se e ka këtë të drejtë mbi ndonjë bazë ligjore, ndërsa i paditur është pronari i të mirës shërbyese. Fjala është për padi për vërtetimin e një të drejte. Kërkesa është vërtetimi i ekzistimit të së drejtës së servitutit real. I padituri mund të bëjë kundërshtim se kjo e drejtë nuk është e fituar mbi ndonjë bazë ligjore dhe në këtë mënyrë nuk ekziston.

*-Padi për vërtetimin e mosekzistimit të së drejtës së servitutit real-* paditës është pronari i paluajtshmërisë e cila konsiderohet si e mirë shërbyese i cili konsideron se i padituri nuk e ka këtë të drejtë ndërsa, i paditur është pronari i paluajtshmërisë e cila konsiderohet si e mirë privilegjuese e cila e konsideron se këtë të drejtë e ka filluar mbi ndonjë bazë të parashikuar ligjore. Këtu fjala është për padi për vërtetim.

Kërkesa është që të vërtetohet mosekzistimi të drejtës së servitutitreal në favor të të mirës së privilegjuar e në dëm të së mirës shërbyese. I padituri mund të kundërshton se

paditësinuk e ka fituarkëtë të drejtë mbi ndonjë bazë ligjore, ose atë e ka humbur në ndonjë mënyrë të parashikuar me ligj (n.58 al.1 LBMJP).<sup>16</sup>

*-Padia për ndërprerjen e të drejtës së servitutit real-* paditës është pronari i të mirës shërbyese, ndërsa i paditur pronari i të mirës së privilegjuar. Kërkesa në padi është ndërprerja e të drejtës ekzistuese e servitutit real. Nuk është kontestuese se kjo e drejtë ekziston andaj edhe kërkohet ndërprerja e saj përshkak se është e panevojshme për shfrytëzimin e të mirës së privilegjuar ose pushon së ekzistuari arsya tjetër në tëcilën ështëbazuar kjo e drejtë.

Varësisht nga arsya për të cilën kërkohet ndërprerja i padituri mund të bënë kundërshtim duke paraqitur fakte se nuk janë paraqitur rrethana të reja për shkak të të cilave kjo e drejtë do të ishte e panevojshme ose se në ndërkohë nuk ka pushuar së ekzistuari arsya në të cilën është bazuar ajo.

## **KONKLuzion**

Në të gjitha sistemet juridike domosdo paraqitet nevoja e ekzistimit të të dejtave subjektive sendore mbi sendin e vet dhe mbi sendin e huaj. E drejta subjektive sendore mbi sendin e huaj, ekziston atëherë kur titullari shfrytëzon për nevojat e vetaose të sendit të tij sendin e huaj, faktikisht sendin i cili është në pronësi të dikujt tjetër.

Titullari i së drejtës së pronësisë, të drejtën e vet jo vetëm që duhet ta ushtroj në kufijt e ligjit, por duhet ti respektojë edhe të drejtat e të tjerëve nëse ato rastësisht kanë ndonjë të drejtë mbi sendin e tij. Të drejtat sendore mbi sendin e huaj mundësojnë përdorimin e sendit të vet sipas destinimit, dhe të ushtroj të drejtën e vet në mënyrë më të lehtë apo të rris vlerën e sendit të vet duke përdorur sendin e huaj.

Servitutet ndahen në servitute reale dhe personale. Servitutet reale janë ato në bazë të të cilave pronari i përditshëm i një sendi të paluajtshëm duhet të durojë që pronari i përditshëm i një sendi tjetër të paluajtshëm të shfrytëzojë në një kuptim sendin e tij të paluajtshëm ose në një kuptim tjetër të mos shërbehet në interesin e këtij pronari të dytë me sendin e vet të paluajtshëm edhe pse ndryshe, është i autorizuar në këtë. Ato mëtuje ndahen

---

<sup>16</sup> Ligji mbi Marrëdhënien Themelore Juridiko- Pronësore, n.58

në tokësore dhe urbane. Servitutet tokësore janë servitutet me të vjetera që datojnë që nga edrejta romake.

Servitutet personale ju takojnë personave të caktuar të cilët kanë autorizime që ekonomikisht në tërësi ose pjesërisht të shfrytëzojnë sendin e luajtshëm apo të paluajtshëm të huaj. Mënyrat se si mund të fitohen, të humben apo të shuhen servitutet, si mbrohen ato, na garanton rëndësinë që kanë ato në të drejtën pozitive, si institut mjaftë i rëndësishëm juridik.

### **Referenca:**

1. Kondili, Valentina” E drejta civile II- pjesa e Posaçme”, Gerr,2008;
2. Aliu, Abdulla.” E drejta Reale”, ligjerata të autorizuara;
3. Baltazar, Benussi. “sendet, zotërimi dhe modifikimet e tij, botim i Ministrisë së Drejtsisë së R.Shqipërisë,v.1931;
4. Ligji mbi Marrëdhënien Themelore Juridiko- Pronësore;
5. Kodi Civil I Republikës së Shqipërisë;
6. Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore i R. Maqedonisë.

**ORGANIZIMI I NOTERIT NË PROCEDURË TRASHËGIMORE NË REPUBLIKËN  
E MAQEDONISË**

**Ardian STAFAI ,**

International University of Struga

ardijan.s14gv@eust.edu.mk

**Ardiana STAFAI ,**

International University of Struga

a.stafai14gv@eust.edu.mk

**Abstrakt**

Noteriat është shërbim juridik dhe publik që e ka për qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme të personave fizik dhe juridik në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet. Shërbimi Noteri publik është se sistemi ligjor i Republikës së Maqedonisë ka të veprojë më shumë se një dekadë.

Shërbimi Noter kryhet nga noterët si bartës autonome dhe të pavarura që shërbimi si një besim publik të njerëzve kujt ecuria e këtij shërbimi është vetëm profesion. Në kuadër të ligjit noteri rast do të studiojnë rregullat ligjore ( organizative dhe funksionale ) kanë të bëjnë me shërbimet noteriale si mjetet juridike parandaluese që me punën e tij ofron siguri ligjore, shmangien e mosmarrëveshjeve në fushën e marrëdhënieve dhe të ngarkimit-shkarkimit të gjykatat kompetente në lëmin e drejtës civile –procedura civile.

Noteri, punët noteriale i kryen në mënyrë të lirë, të pavarura, të mëvetësishme, profesionale dhe të paanshme në bazë të Kushtetutës, ligjit, marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare dhe dispozitave të tjera dhe akteve të përgjithshme të bazuara në ligj.

Punët noteriale kryhen me zbatimin e parimeve për garantimin e kryerjes së ligjshme të punëve, përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar në kryerjen e punëve noteriale, dispozicionin dhe pamohueshmërinë e raportit juridik, mbikëqyrjen ndaj ligjshmërisë në kryerjen e punëve noteriale dhe kompensimin për punët e kryera.

Kryetari i gjykatës themelore është i autorizuar që në pajtim me dispozitat ligjore, lëndët trashëgimore t'ia besojë në veprim noterëve me seli në rajonin e gjykatës kompetente themelore. Noterët, si përfaqësues gjyqësor, ndërmarrin veprime dhe marrin vendime në procedurën trashëgimore në pajtim me dispozitat ligjore. Noteri punët e besuara në procedurën trashëgimore i kryen në pajtim me dispozitat ligjore.

Në procedurën që mbahet para noterit, pjesëmarrësi mund të përfaqësohet në bazë të dispozitave të cilat zbatohen për përfaqësim në procedurën kontestimore. Pjesëmarrësit në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë janë: pasardhësit dhe trashëgimtarët dhe personat tjerë të cilët realizojnë ndonjë të drejtë të trashëgimisë.

## **HYRJE**

Fillimi i noterisë, me siguri duhet të gjurmohen kryesisht në vendet perëndimore dhe Evropës së Mesme kontinentale të cilat egzistojnë si vende të botës Latino-Amerikane, edhe pse prej veprimtarive janë kryer në mënyra të ndryshme, me efekte të ndryshme me persona të ndryshëm qysh nga periudha Romake. Njëra nga supozimet për një funksionim të një shteti juridik modern është egzistimi i noterëve-shërbimi i noteriatit. Ky shërbim ka rol të veçantë në zbatimin dhe realizimin e rendit juridik *in concreto*, pse, nëse rendi juridik parasheh disa forma juridike, noteri është i detyruar ti përpilojë dhe ti realizojë.

Noteriatit është shërbim i pavarur, i mëvetësishëm në të cilin kryhen punë nga lloji i autorizimeve publike në bazë të ligjit, me kërkesën e qytetarëve, organeve shtetërore, personave juridikë dhe institucioneve të tjera të interesuara. Noteri e kryen detyrën e vet si profesion themelor, për kohën për të cilën është emëruar.

Për shqyrtimin e trashëgimisë qytetarit të Republikës së Maqedonisë lidhur me pronën e tij, e cila gjendet në Republikën e Maqedonisë ekskluzivisht është kompetent gjyqi i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht noteri si përfaqësues i gjykatës. Gjykata mund t'ia besojë noterit zbatimin e procedurës së trashëgimisë dhe do t'ia dorëzojë lëndën e trashëgimisë me të gjitha shënimet. Për shqyrtimin e trashëgimisë qytetarit të Republikës së Maqedonisë lidhur me pronën e tij, e cila gjendet në Republikën e Maqedonisë ekskluzivisht është kompetent gjyqi i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht noteri si përfaqësuese i gjykatës. Gjykata mund t'ia besojë noterit zbatimin e procedurës së trashëgimisë dhe do t'ia dorëzojë lëndën e trashëgimisë me të gjitha shënimet, në afat prej 8 ditësh nga dita kur lënda do të regjistrohet. Kur noteri zbaton veprime në procedurën trashëgimore si përfaqësues i gjykatës, është i autorizuar t'i ndërmarrë të gjitha veprimet në procedurën dhe t'i marrë të gjitha vendimet përveç atyre për të cilat me këtë ligj është përcaktuar ndryshe.

Gjyqi i Republikës së Maqedonisë ekskluzivisht është kompetent për shqyrtimin e trashëgimisë së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në lidhje me pronën e tij të luajtshme që gjendet vend, kurse në lidhje me pronën e tij të patundshme e cila gjendet jashtë vendit, do të jetë kompetent vetëm nëse sipas ligjeve të shtetit në të cilin gjendet prona nuk është kompetent organi i huaj.

## **1. SI INICOHET PROCEDURA E TRASHËGIMISË – KOMPETENCA E NOTERIT NË PROCEDURE E TRASHËGIMISË**

Çështjet e trashëgimisë tani jenë ekskluzivitet i noterëve dhe kjo kompetencë i hiqet gjykatave që nga 2008-ta. Ndryshimi në ligj ka hyrë në fuqi që nga 2008 dhe vjen pas ndryshimit të Ligjit për jashtëkontestimoren dhe reflektimit të tyre edhe në ligjin për noterinë. Noterët, si përfaqësues gjyqësor, ndërmarrin veprime dhe marrin vendime në procedurën trashëgimore në pajtim me dispozitat ligjore.

Noteri punët e besuara në procedurën trashëgimore i kryen në pajtim me dispozitat ligjore. Në procedurën që mbahet para noterit, pjesëmarrësi mund të përfaqësohet në bazë të dispozitave të cilat zbatohen për përfaqësim në procedurën kontestimore. Pjesëmarrësit në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë janë: pasardhësit dhe trashëgimtarët dhe personat tjerë të cilët realizojnë ndonjë të drejtë të trashëgimisë.



Në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë gjyqi i përcakton trashëgimtarët e të vdekurit, pronën të cilën e përbën trashëgimia e tij dhe të drejtat nga trashëgimia që u takojnë pasardhësve, trashëgimtarëve dhe personave tjere .Procedura për shqyrtimin e trashëgimisë ngrihet me detyrë zyrtare, menjëherë mbasi të njoftohet gjyqi për vdekjen e personit ose se personi është shpall i vdekur. Pjesëmarrësit në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë janë: pasardhësit dhe trashëgimtarët dhe personat tjerë të cilët realizojnë ndonjë të drejtë të trashëgimisë.

Për shqyrtimin e trashëgimisë qytetarit të Republikës së Maqedonisë lidhur me pronën e tij, e cila gjendet në Republikën e Maqedonisë ekskluzivisht është kompetent gjyqi i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht noteri si përfaqësuese i gjykatës.Gjykata mund t'ia besojë noterit zbatimin e procedurës së trashëgimisë dhe do t'ia dorëzojë lëndën e trashëgimisë me të gjitha shënimet, në afat prej 8 ditësh nga dita kur lënda do të regjistrohet. Kur noteri zbaton veprime në procedurën trashëgimore si përfaqësues i gjykatës, është i autorizuar t'i ndërmarrë të gjitha veprimet në procedurën dhe t'i marrë të gjitha vendimet përveç atyre për të cilat me këtë ligj është përcaktuar ndryshe.

Gjyqi i Republikës së Maqedonisë ekskluzivisht është kompetent për shqyrtimin e trashëgimisë së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në lidhje me pronën e tij të luajtshme që gjendet vend, kurse në lidhje me pronën e tij të patundshme e cila gjendet jashtë vendit, do të jetë kompetent vetëm nëse sipas ligjeve të shtetit në të cilin gjendet prona nuk është kompetent organi i huaj.Procedura e trashëgimisë fillon me përgatitjen e dorëzimit e për hapjen e trashëgimis ,kur përpilohet aktvdekja e ndonji personi të vdekur ose është shpallur I vdekur .

## 2. SEANCA PËR SHQYRTIMIN E TRASHËGIMISË

**Testamenti** që e ka lënë i vdekuri i dorëzohet gjykatës për shpallje.Gjyqit të cilit i është dorëzuar ose te i cili ruhet testamenti, kur do të vërtetohet përpiluesi i tij se është i vdekur ose i shpallur si i vdekur, është i detyruar ta hapë testamentin, pa mos e prishur vulën, ta lexojë dhe për këtë të përpilojë procesverbal. Me këtë testamenti është i shpallur.

Gjyqi do të veprojë pa marrë parasysh atë se testamenti a është i plotfuqishëm në bazë të ligjit dhe pa marrë parasysh se a ka më tepër testamente nga personi i njëjtë i vdekur . Hapja

dhe leximi i testamentit kryhet në prani të dy qytetarëve të moshës madhore, të cilët mund të jenë edhe nga radhët e pasardhësve.

Gjatë shpalljes së testamentit mund të marrin pjesë pasardhësit, trashëgimtarët dhe personat e tjerë të interesuar dhe të kërkojnë kopje nga testamenti, përkatësisht nga procesverbali për shpalljen e testamentit Gjyqi, te i cili testamenti ndodhet ose të cilit i është dorëzuar, do ta shpallë testamentin edhe përkundër asaj që për shqyrtimin e trashëgimisë është kompetente gjykata tjetër ose organ i huaj .

***Për shpalljen e testamentit përpilohet procesverbal, i cili përmban:***

- 1) sa testamente janë gjetur, ku janë gjendur dhe cilat data mbajnë;
- 2) kush ia ka dorëzuar testamentin gjykatës ose përpiluesit të aktvdekjes;
- 3) dëshmitarët që kanë marrë pjesë në shpalljen e testamentit;
- 4) testamenti a është dorëzuar i mbyllur ose i hapur dhe me çfarë vule ka qenë i vulosur, dhe
- 5) përmbajtjen të testamentit. Nëse gjatë hapjes së testamentit vërehet se vula është prishur ose në testament diçka është shlyer, hequr vijë ose përmirësuar ose nëse gjendet diçka tjetër e dyshimtë, e gjitha evidentohet në procesverbal.

***Procesverbalin e nënshkruajnë gjykatësi,*** procesverbalmajtësi dhe dëshmitarët. Në testamentin e shpallur gjyqi do të vë vërtetim se është i shpallur, do ta vë edhe datën e shpalljes, dhe do të shënojë edhe numrin dhe datën e testamenteve tjera që janë gjendur ose shpallur.

### **3. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Objekti i Trashëgimisë** -E drejta e trashëgimis rregullohet me ligj. Trashëgimia është kalimi me ligj ose në bazë të testamentit i pasurisë (trashëgimit) së personit të vdekur (trashëgimlënësit) tek një ose më shumë persona (trashëgimtarët ose legatarët), sipas rregullave të caktuara me ligj. Me ligj rregullohen procedurat në bazë të të cilave gjykata, organet tjera dhe personat tjerë të autorizuar duhet të veprojnë në çështjet trashëgimore Në

kuptim të ligji emrat në gjininë mashkullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë femërore dhe anasjelltas pa diskriminim.<sup>1</sup>

#### **4. KALIMI I PASURISË TRASHËGIMORE TE TRASHËGIMTARËT**

**4.1 Hapja e trashëgimit -Vdekja dhe shpallja e personit i vdekur-**Me vdekjen e personit hapet trashëgimi i tij. Të njëjtin efekt e ka edhe shpallja e personit si të vdekur.

**4.2 Hapja e trashëgimit të personit të shpallur i vdekur dhe fillimi i afateve-**Si ditë e hapjes së trashëgimit të personit që është shpallur i vdekur konsiderohet dita kur aktvendimi mbi shpalljen e personit i vdekur ka marrë formën e prerë, po që se në vetë vendimin si ditë e vdekjes nuk është caktuar ndonjë ditë tjetër. Në rast të shpalljes së personit i vdekur, afatet fillojnë të llogariten nga dita kur aktvendimi për shpalljen e tij person i vdekur ka marrë formën e prerë.

**4.3 Zotësia për të trashëguar-**Trashëgimtar mund të jetë vetëm personi i cili është i gjallë në çastin e hapjes së trashëgimit. Fëmija i zënë në çastin e hapjes së trashëgimit do të konsiderohet si i lindur, në qoftë se lind i gjallë. Në qoftë se dy ose më shumë persona humbin jetën në të njëjtin aksident, ose kur nuk dihet rendi kronologjik i vdekjes së tyre, konsiderohet se asnjëri prej tyre nuk ka qenë i gjallë në çastin e hapjes së trashëgimisë së tjetrit.

**4.4 Trashëgimtarët e panjohur-**Në qoftë se nuk dihet nëse ka trashëgimtarë, gjykata me anë të shpalljes do t'i thërrasë personat që pretendojnë se kanë të drejtë për trashëgim që të paraqiten në gjykatë. Në qoftë se me kalimin e një viti nga dita e shpalljes nuk paraqitet asnjë trashëgimtar, pasuria trashëgimore i dorëzohet shtetit, por me këtë trashëgimtari që do të paraqitej më vonë nuk privohet nga e drejta që t'i dorëzohet pasuria trashëgimore ose pjesa që i takon.<sup>2</sup>

**4.5 Heqja dorë nga trashëgimia -Heqja dorë në përgjithësi-**Trashëgimtari mund të heq dorë nga trashëgimi me deklaratë të dhënë pranë noterit gjersa të përfundojë seanca mbi trashëgimin. Heqja dorë vlen edhe për pasardhësit e atij që ka hequr dorë, përveç nëse

<sup>1</sup> Закон за наследувањето пречистен текст, Gazeta zyrtare e RM nr.47/96

<sup>2</sup> .Д-рКирил Чавдар-Коментар закон за наследување со обрасци за преимена, Скопје 1996;

shprehimisht ka deklaruar se hequr dorë vetëm në emër të vet. Në qoftë se pasardhësit janë të mitur për këtë heqje dorë nuk nevojitet leja e organit të kujdestarisë. Trashëgimtari, i cili ka hequr dorë në emër të vet konsiderohet sikur të mos ketë qenë trashëgimtar. Në qoftë se për trashëgim kanë hequr dorë të gjithë pasardhësit të cilët i takojnë radhës me të afërt të trashëgimisë në çastin e vdekjes të trashëgimlënësit, në trashëgim thirren pasardhësit e radhës pasuese të trashëgimit.

**4.6 Personi që nuk mund të heqë dorë nga trashëgimi**- Nuk mund të heqë dorë nga trashëgimi trashëgimtari që ka disponuar tërë pasurinë trashëgimore ose një pjesë të saj. Masat që merr një trashëgimtar vetëm për të ruajtur pasurinë trashëgimore, si dhe masat e administrimit vijues, nuk e privojnë nga e drejta që të heqë dorë nga trashëgimi.

## 5. RADHËT E TRASHËGIMISË

**5.1 Radha e parë e trashëgimisë**- Trashëgimlënësin e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij. Ato trashëgojnë në pjesë të barabarta.<sup>3</sup> Me të drejten e perfaqesimit kuptojmë të drejten e pasardhësve në kuader të një vije të drejte zbritese që të paraqiten si zëvendësim në vend të paraardhësve të vdekur të tyre, dhe ata trashëgojnë atë pjesë të cilën do ta kishte trashëguar paraardhësi i vdekur. Kjo e drejte vazhdon edhe deri tek i fundit në kuader të vijes.

Kur nuk mund të zbatohet kjo e drejte zbatohet e drejta e shtimit që dote thote se kur e drejta e perfaqesimit nuk mund të zbatohet në kuadertë një vije të radhës trashëgimore atëherë pjesa trashëgimore u shtohet trashëgimtareve të tjere që janë në radhë. E drejta e shtimit zbatohet edhe trashëgimia ligjore e edhe trashëgimia e testamentare (për dallim e drejta e perfaqesimit zbatohet vetëm të trashëgimia ligjore).<sup>4</sup>

**5.2 Radha e dytë e trashëgimisë**- Pasurinë e trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti i tij. Prindërit e trashëgimlënësit trashëgojnë gjysmën e pasurisë në pjesë të barabarta, kurse gjysmën tjetër të pasurisë e

<sup>3</sup> Закон за наследувањето пречистен текст, Gazeta zyrtare e RM nr.13/96

<sup>4</sup> E drejta familjare dhe trashëgimore (Permbledhje) – Ajdin Nuhiu fq.26

trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit. Në qoftë se trashëgimlënësi nuk ka lënë bashkëshort, prindërit e trashëgimlënësit e trashëgojnë tërë pasurinë në pjesë të barabarta.<sup>5</sup>

Në qoftë se njëri nga prindët e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë fëmijët e tij (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit), nipat e stërnipat e tij dhe pasardhësit e largët të tij, sipas dispozitave të këtij Ligji që vlejnë për rastin kur trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët dhe pasardhësit e tjerë të tij.<sup>6</sup>

**5.3 Radha e tretë e trashëgimisë**- radha e trete e trashëgimisë janë gjysherit edhe gjyshete trashëgimlënësit (kur trashëgimlënësi nuk ka lënë pasardhës as bashkëshort dhe prindërit e tij nuk kanë pasardhës të tjerë). Pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës, bashkëshort prindër dhe prindërit e tij nuk kanë lënë pasardhës të tjerë, e trashëgojnë gjysherit dhe gjyshet e tij.

Gjysmën e pasurisë trashëgimore e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja nga ana e atit, kurse gjysmën tjetër gjyshi dhe gjyshja nga ana e nënës.<sup>7</sup>

Gjyshi dhe gjyshja të të njëjtit trung trashëgojnë në pjesë të barabarta. Në qoftë se ndonjë nga pasardhësit e të njëjtit trung ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'i takonte sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë fëmijët e tij sipas rregullave që aplikohen për rastin kur trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët e tij.

Për çdo gjë tjetër lidhur me të drejtën trashëgimore të gjyshit dhe të gjyshes të të njëjtit trung dhe të pasardhësve të tyre zbatohen dispozitat sipas të cilave trashëgimlënësin e trashëgojnë prindërit e dhe vëllezërit e motrat e tij.<sup>8</sup>

Në qoftë se gjyshi dhe gjyshja e të njëjtit trung kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe nuk kanë lënë pasardhës, pjesën e pasurisë trashëgimore që do t'u takonte sikur të kishin jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja e trungut tjetër.

<sup>5</sup> Закон за наследувањето пречистен текст, Gazeta zyrtare e RM nr.16/96

<sup>6</sup> Закон за наследувањето пречистен текст, Gazeta zyrtare e RM nr.17/96

<sup>7</sup> Закон за наследувањето пречистен текст, Gazeta zyrtare e RM nr.20/96

<sup>8</sup> Закон за наследувањето пречистен текст, Gazeta zyrtare e RM nr.21/96

## 6. NOTERËT SI PËRFAQËSUES TË GJYKATËS

Autorizimet e noterëve në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë rregullohen me Ligjin për procedurë jashtëkontestimore. Gjatë shqyrtimit të trashëgimisë në mënyrë të detyrueshme është i pranishëm avokati në cilësinë e të autorizuarit për secilin pjesëmarrës.<sup>9</sup>

Noterët, si përfaqësues gjyqësor, ndërmarrin veprime dhe marrin vendime në procedurën trashëgimore në pajtim me dispozitat ligjore. Në procedurën që mbahet para noterit, pjesëmarrësi mund të përfaqësohet në bazë të dispozitave të cilat zbatohen për përfaqësim në procedurën kontestimore.

**6.1 Aktvdekja** - Kur ndonjë person do të vdesë ose është shpallë i vdekur, ofiqari kompetent të bëjë regjistrimin e vdekjes në librat amzës së të vdekurve është i detyruar që, në afat prej tridhjetë ditësh nga dita e vdekjes, t'ia dorëzojë aktvdekjen gjykatës për trashëgimi. Nëse ofiqari nuk mund t'i grumbullojë të gjitha të dhënat për përpilimin e aktvdekjes, do t'ia dorëzojë gjykatës aktvdekjeje vetëm me të dhënat me të cilat disponon dhe do t'i nxjerrë shkaqet pse nuk mund ta dorëzojë aktvdekjen, duke theksuar edhe të dhënat të cilat do të mund t'i hyjnë në përdorim gjykatës për gjetjen e trashëgimtarëve dhe pronën e të vdekurit. Nëse ndonjë person ka vdekur jashtë rajonit të komunës në të cilën ka vendbanim, përkatësisht vendqëndrim, ofiqari do të mund t'ia dorëzojë gjykatës për trashëgimi vetëm aktvdekjen nga libri amzë i të vdekurve, si dhe të dhënat me të cilat disponon, e që mund të shërbejnë për përpilimin e aktvdekjes.

Aktvdekja përpilohet çdoherë kur ndonjë person do të vdesë ose është shpallur si i vdekur, pa marrë parasysh nëse ka ose nuk ka pronë. Aktvdekja përpilohet në bazë të të dhënave të marra nga familjarët e të vdekurit, nga personat me të cilat i vdekuri ka jetuar, si dhe nga persona tjerë të cilët mund të japin të dhëna që do të futen në aktvdekje.

Aktvdekja i përmban këto të dhëna:

1) mbiemrin, emrin e babës dhe emrin e të vdekurit, ndërsa për të vdekurit persona të gjinisë femërore edhe mbiemrin e vajzërisë, profesionin e të vdekurit, datëlindjen e tij, shtetësinë dhe NUAQ;

<sup>9</sup> Gazeta zyrtare e RM-së nr.72/16 - Ligji për noterijatin

2) ditën, muajin dhe vitin, dhe sipas mundësisë dhe orën e vdekjes dhe vendin e vdekjes;

3) vendin në të cilin i vdekuri ka jetuar, përkatësisht vendqëndrimin;

4) mbiemrin dhe emrin, datëlindjen, profesionin, vendbanimin, përkatësisht vendqëndrimin e bashkëshortit të të vdekurit dhe të fëmijëve të tij;

5) mbiemrin dhe emrin, datëlindjen dhe vendbanimin, përkatësisht vendqëndrimin e familjarëve tjerë dhe personave të cilët do të mund të thirren në trashëgimi në bazë të ligjit, si dhe të personave të cilat janë thirrur në trashëgimi në bazë të testamentit; dhe

6) vlefshmërinë e përafërt të pronës së patundshme dhe të tundshme të të vdekurit.

**6.2 Regjistrimi dhe vlerësimi I trashëgimisë** - Regjistrimi i përfshin: gjithë pronën e të vdekurit që e ka pasur në pronësi në momentin e vdekjes së tij, pronën që i ka takuar të vdekurit, ndërsa gjendet te personi tjetër, me rast theksohet se cila pronë te cili është gjendur dhe në çfarë baze, si dhe pronën që në momentin e vdekjes e ka pasur i vdekuri dhe për të cilën vërtetohet se është pronë e tij. Në regjistrimin shënohen kërkesat dhe borxhet e të vdekurit, ndërsa në veçanti tatimet e papaguara dhe dhënit tjera.

Sendet lëvizëse regjistrohen në bazë të llojit, gjinisë, numrit, matjes dhe rëndësisë ose veç e veç. Patundshmëritë regjistrohen veç e veç me shënimin e vendit ku ndodhen, kulturën e tokës, të dhënat nga librat zyrtarë në të cilën regjistrohen të drejtat mbi patundshmëritë dhe të dhënat tjera kadastrale.<sup>10</sup>

Trashëgimtari me deklaratën për trashëgimi mund ta pranojë trashëgiminë ose të heqë dorë nga trashëgimia. Akti noterial konsiderohet se është përpiluar pasi do ta nënshkruajnë të gjithë pjesëmarrësit, avokatët si të autorizuar, palët dhe noteri.

---

<sup>10</sup> Gazeta zyrtare e RM-së nr.09/08 - Ligji për procedure jashtëkontestimore

## KONKLUZION

Nga punimi i lartependur konkludojme se rregullat e procedurës trashëgimore sipas të cilave, gjykata, noteret, organet tjera - personat e autorizuar veprojnë në çështjet e trashëgimisë përcaktohen me dispozitat për procedurën jashtëkontestimore.

Zbatimi i ligjit të trashëgimisë i Republikës Maqedonise dispozitat e Ligjit vlejnë për trashëgiminë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Në seancën për shqyrtimin e trashëgimisë noteri debaton për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë, ndërsa veçanërisht për të drejtën e trashëgimisë, për madhësinë e pjesës trashëgimore të çdo trashëguesi dhe të drejtën për trashëgimtarët.

Për të drejtën e personave të cilët nuk kanë ardhur në seancë, ndërsa në mënyrë të rregullt janë thirrur, noteri do të shqyrtojë në bazë të të dhënave me të cilat disponon, duke marrë parasysh deklaratat e tyre me shkrim që do të arrijnë deri në marrjen e vendimit. Deklarata për trashëgimi për pranimin e trashëgimisë ose për heqje dorë nga trashëgimia.

### Referenca:

1. Д-р Кирил Чавдар - *Коментар закон за наследување со образци за преимена*, Скопје 1996;
2. Ajdin Nuhiu - *E drejta familjare dhe trashëgimore (Përmbledhje)*;
3. Закон за наследувањето (пречистен текст) Службен весник на РМ бр.47/96;
4. Gazeta zyrtare e RM-së nr.72/16 - Ligji për noterijatin;
5. Gazeta zyrtare e RM-së nr.09/08 - Ligji për procedure jashtëkontestimore.



**MARRËVESHJE JASHTËGJYQËSORE- PROCEDURA DHE PASOJAT JURIDIKE****Msc. Liridon ZENKU**

Mehmed Mehmedi Nr. 31 Kërçovë R. Maqedonisë

zenku78@hotmail.com

**Abstrakt**

Sipas kësaj marrëveshje rregullohen kushtet për hapjen e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore, mënyra dhe pasojat juridike për hapjen dhe zbatimin e saj. Nëse me masat e ndërmarra për ristrukturim financiar jashtë procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore debitori nuk mund të vendosë gjendje të likuiditetit, detyrohet që në afat prej 30 ditëve nga krijimi i jolikuiditetit, të ngrejë procedurë për marrëveshje jashtëgjyqësore.

Procedura e marrëveshjes jashtëgjyqësore zbatohet me qëllim që: debitorit që është bërë jolikuid dhe/ose insolvent i mundësohet ristrukturim financiar në bazë të të cilit, do të bëhet likuid dhe solvent dhe kreditorëve t'u mundësohen mundësi më të volitshme për përmbushjen e kërkesave të tyre nga mundësitë që do t'i merrnin me hapjen e procedurës falimentuese ndaj debitorit.

Procedura për marrëveshje jashtëgjyqësore mund të zbatohet mbi: shoqëri tregtare ose tregtar individ, të themeluar në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare dhe personat tjerë juridikë dhe fizikë që janë të themeluar në pajtim me ligj dhe kryejnë veprimtari profitabile, procedura e marrëveshjes jashtëgjyqësore nuk mund të zbatohet mbi institucion financiar, shoqëri investuese dhe shoqëri për menaxhim me fonde investuese, institucion kreditor, shoqëri për sigurim, shoqëri për lizing, institucione për pagesë dhe para elektronike.

Gjatë kohëzgjatjes së procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore nuk mundet kundër debitorit të lejohet përbarim për shkak të sigurimit, as përbarim për shkak të përmbushjes së kërkesave në bazë të dokumentit të miratuar përbarues paraprak. Dokumentet përbaruese të cilat kanë të bëjnë me kërkesat nga marrëveshja jashtëgjyqësore, për pjesën për të cilën janë përmbushur, e humbin fuqinë juridike në lidhje me debitorin.

Vizioni për të ardhmen është që kjo marrëveshje të respektohet dhe zbatohet në përpikshmëri si dhe të sofistikohet edhe më tej, gjithmon me qëllim drejt një marrëveshje më efikase dhe më e sukseshme ku personat fizik, juridik, dhe të gjithë institucionet nuk do të kenë probleme në realizimin e marrëveshjes jashtëgjyqësore.

**Fjalët kyçe:** *Marrëveshje jashtëgjyqësor, kushtet, procedura, pasojat juridike.*

## **HYRJE**

Në këtë punim është bërë studimi i rolit të marrëveshjeve jashtëgjyqësore me çka rregullohen kushtet për hapjen e procedurës, mënyra dhe pasojat juridike për hapjen dhe zbatimin e saj.

Qëllimi i këtij punimi është vënia në pah e rëndësisë së marrëveshjes në zhvillimin e bizneseve, me saktësisht analizimi i bizneseve që marrëveshja të jetë e pranueshme për një sukses më të madhë në shoqërinë bashkohore. Gjatë zbatimit të procedurës së marrëveshjes jashtëgjyqësore do të zbatohen edhe dispozitat e Ligjit për marrëveshje jashtëgjyqësore për rregullimin e afateve për përmbushjen e detyrimeve në para të shkaktuara gjatë transaksioneve afariste.

Gjatë kohëzgjatjes së procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore nuk mundet kundër debitorit të lejohet përbarim për shkak të sigurimit, as përbarim për shkak të përmbushjes së kërkesave në bazë të dokumentit të miratuar përbarues paraprak. Nga dita e shpalljes së aktvendimit për hapjen e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore, bartësi i qarkullimit

pagesor ndërpret të kryejë pagesa në bazë të dokumenteve përmbarese të arritura për arkëtim në ngarkim të debitorit.

Shumë kompani në vendet tona ende nuk i kushtojnë rëndësi të mjaftueshme marrëveshjeve jashtëgjyqësore e cila ka rëndësi të madhe në shoqërin tonë. Në këtë punim fokusi bie te profesionalizmi dhe rëndësia e trajnimeve në kompanit, shoqatat tregtare, presonat fizik e juridik dhe ndikimi i tyre në performancën e të punësuarve dhe performancën e tërë kompanisë. Pasi profesionalizmi është njëri ndër faktorët për sukseset e Ndërmarrjeve dhe Bizniseve të tjera, atëherë ky punim vë në pah sa nga ndërmarrjet në vendet tona duhet të kenë të punësuar profesionistë.

## **1. PROCEDURA E MARRËVESHJES JASHTËGJYQËSORE**

Kjo procedurë zbatohet me qëllim që: debitorit që është bërë jolikuid dhe/ose insolvent i mundësohet ristrukturim financiar në bazë të të cilit, do të bëhet likuid dhe solvent dhe kreditorëve t'u mundësohen mundësi më të volitshme për përmbushjen e kërkesave të tyre nga mundësitë që do t'i merrnin me hapjen e procedurës falimentuese ndaj debitorit.

Gjatë zbatimit të procedurës së marrëveshjes jashtëgjyqësore do të zbatohen edhe dispozitat e Ligjit për rregullimin e afateve për përmbushjen e detyrimeve në para të shkaktuara gjatë transaksioneve afariste. Nëse me masat e ndërmarra për ristrukturim financiar jashtë procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore debitori nuk mund të vendosë gjendje të likuiditetit, detyrohet që në afat prej 30 ditëve nga krijimi I jolikuiditetit, të ngrejë procedurë për marrëveshje jashtëgjyqësore. Nëse debitori është i paaftë për pagesë ose i stërngarkuar me borxh, detyrohet që pa prolongim, më së voni në afat prej 21 ditëve nga krijimi i insolvensës, të ngrejë procedurë për marrëveshje jashtëgjyqësore.

## **2.KUPTIMI I NOCIONEVE TË CAKTUARA**

Për qëllimet e njohjes e të gjithave pjesëmarsve në marrëveshjen jashtëgjyqësore, nocione të veçanta e kanë kuptimin si në vijim:

1. "Likuiditet" është aftësia që në kohë të përmbushen detyrimet e maturuara në para;
2. "Solvencë" është aftësia e përhershme për përmbushjen e të gjitha detyrimeve në para;
3. "Përshtatshmëria e kapitalit" është raporti midis burimeve afatgjate të financimit dhe vëllimit dhe llojit të punëve që operatori ekonomik i kryen edhe rreziqeve të cilave u ekspozohet në punë;
4. Operatorë ekonomikë janë:
  - shoqëria tregtare apo tregtari individ, të themeluar në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare dhe
  - personat tjerë juridikë dhe fizikë që janë të themeluar në pajtim me ligj dhe kryejnë veprimtari profitabile;
5. "Ristrukturim financiar" është procedura që zbatohet në bazë të planit të pranuar për restrukturim financiar me qëllim që të arrihet gjendja e likuiditetit dhe solvencës;
6. "Procedurë e marrëveshjes jashtëgjyqësore" është procedura që zbatohet me qëllim që të arrihet likuiditeti dhe solvenca e debitorit;
7. "Kreditorë" në procesin e marrëveshjes jashtëgjyqësore janë kreditorët personalë të debitorit që në kohën e hapjes së procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore kanë kërkesë pronësore-juridike ndaj debitorit dhe
8. "Kërkesa prioritare" janë kërkesat me rend më të lartë të pagesës ku bëjnë pjesë rrogat, kontributet e rrogës së SPI, sigurimi shëndetësor dhe sigurimi në rast të papunësisë dhe kompensimet për periudhën prej tre muajve të fundit para hapjes së marrëveshjes jashtëgjyqësore.

Operatori ekonomik në gjendje të joliquiditetit nuk guxon që të kryejë kurrfarë pagesash përveç atyre që janë të domosdoshme për punë të rregullt.

Konsiderohet se për punë të rregullt janë të domosdoshme pagesat për:

- kërkesa prioritare;
- rroga bruto për punëtorët nga dita e hapjes së procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore;
- shpenzime operative për punë (energji elektrike, ujë etj.);
- furnizim me mall dhe shërbime të nevojshme për punë të rregullt;
- tatim mbi vlerë të shtuar, kontribute dhe tatime të tjera që nga ana e debitorit doemos duhet të përlllogariten dhe të paguhen në pajtim me rregullat dhe

- shpenzime për procedurat para organeve shtetërore.

Operatori ekonomik në gjendje të jolikuiditetit nuk guxon që të ndërmarrë aktivitete me të cilat do të shkaktonte dëm të sjelljes ose të njëjtat do t'i sjellë në pozitë të pabarabartë.

### **3.QËLLIMI I MARRËVESHJES JASHTËGJYQËSORE**

Procedura e marrëveshjes jashtëgjyqësore zbatohet me qëllim që:

Debitorit që është bërë jolikuid dhe/ose insolvent i mundësohet ristrukturim financiar në bazë të të cilit, do të bëhet likuid dhe solvent dhe Kreditorëve t'u mundësohen mundësi më të volitshme për përmbushjen e kërkesave të tyre nga mundësitë që do t'i merrnin me hapjen e procedurës falimentuese ndaj debitorit.

Marrëveshja jashtëgjyqësore konsiderohet si e lidhur nëse atë e pranojnë vullnetarisht debitori dhe kreditorët, kërkesat e të cilëve kanë shumicë sipas Planit për ristrukturim financiar konsiderohet i pranueshëm nëse për të votojnë shumica e kreditorëve me kërkesa prej më shumë se gjysma e vlerës së të gjithë kërkesave të përcaktuara. Do të konsiderohet se kundër planit për rikonstruktim financiar kanë votuar ata kreditorë të cilët kanë të drejtë vote, e që nuk kanë votuar. Kreditori dhe debitori gjatë procedurës së marrëveshjeve jashtëgjyqësore nuk guxojnë që të ndërmarrin aktivitete me të cilat mund të shkaktohet dëm. Për vlerësim të drejtë të gjendjes financiare dhe mundësive për ristrukturim financiar, debitori detyrohet që t'i sigurojë këshillit për marrëveshje, të autorizuarit për marrëveshje jashtëgjyqësore dhe kreditorëve, qasje të papenguar dhe në kohë në të dhënat dhe dokumentacionin që kanë të bëjnë me pronën e tij, kapitalin, detyrimet, punën dhe planet afariste.

Procedura për marrëveshje jashtëgjyqësore mund të zbatohet mbi:

- Shoqëri tregtare ose tregtar individ, të themeluar në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare dhe
- Personat tjerë juridikë dhe fizikë që janë të themeluar në pajtim me ligj dhe kryejnë veprimtari profitabile.

Procedura e marrëveshjes jashtëgjyqësore nuk mund të zbatohet mbi institucion financiar, shoqëri investuese dhe shoqëri për menaxhim me fonde investuese, institucion

kreditor, shoqëri për sigurim dhe risigurim, shoqëri për lizing, institucione për pagesë dhe para elektronike. Procedura për marrëveshje jashtëgjyqësore nuk mund të zbatohet mbi Shtetin, mbi fondet që financohen nga Buxheti i Shtetit, Fondin për sigurim pensional dhe invalidor, Fondin për sigurim shëndetësor, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe mbi organet e administratës shtetërore. Procedura e marrëveshjes jashtëgjyqësore është urgjente dhe doemos duhet të përfundohet para këshillit për marrëveshje më së voni në afat prej 120 ditësh nga dita e hapjes së saj. Procedura e marrëveshjes jashtëgjyqësore hapet vetëm me propozim të debitorit.

#### **4.NJOFTIMI PUBLIK**

Dokumentet (vendime, ftesa, njoftime dhe të ngjashëm) në procedurën e marrëveshjes jashtëgjyqësore që duhet të shpallen, dorëzohen te Regjistri qendror që i publikon në ueb faqen e vet. Në dokumentin e shpallur theksohet firma, përkatësisht emri dhe mbiemri i debitorit, selia e tij, adresa dhe numri unik i amzës i subjektit. Shpallja publike prodhon veprim pas kalimit të tetë ditëve nga dita e shpalljes. Shpallja publike e dokumenteve është dëshmi se është bërë dorëzimi i tyre tek të gjithë pjesëmarrësit. Të dhënat që publikohen gjatë procedurës së marrëveshjes jashtëgjyqësore në ueb-faqen e Regjistrimit qendror janë:

- firma, përkatësisht emri dhe mbiemri i debitorit, selia e tij, adresa dhe numri unik i amzës i subjektit,
- emri dhe mbiemri, selia, adresa, telefoni i të autorizuarit të marrëveshjes jashtëgjyqësore,
- aktvendimi për hapjen e procedurës së marrëveshjes jashtëgjyqësore,
- shpallja me të cilën thirren kreditorët që t'i paraqesin kërkesat e tyre,
- të gjitha aktvendimet dhe konkluzionet e miratuara në procedurën e marrëveshjes jashtëgjyqësore etj.

Vendimet në procedurën për marrëveshje jashtëgjyqësore miratohen në formë të aktvendimit dhe konkluzionit, dhe me konkluzion vendoset për çështjet procesuale.

#### **5.MJETE JURIDIKE**

Kundër aktvendimit mund të parashtrohet ankesë, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Afati për ankesë është tetë ditë. Nëse me ligj është përcaktuar që aktvendimi t'u dorëzohet personave të caktuar, afati i parashtrimit të ankesës rrjedh nga dita e dorëzimit të

aktvendimit, kurse për aktvendimet tjera, në ditën e tetë nga dita e publikimit në ueb faqen e Regjistrimit qendror. Ankesa parashtrohet te Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë, përmes organit të shkallës së parë. Organi i shkallës së parë detyrohet që ankesën ta dorëzojë te organi i shkallës së dytë në afat prej tre ditëve nga pranimi. Organi i shkallës së dytë detyrohet që të vendos për ankesën në afat prej tetë ditëve nga pranimi i ankesës. Ankesa kundër aktvendimit nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit. Kundër konkluzionit nuk lejohet ankesë. Në procedurë të marrëveshjes jashtëgjyqësore nuk mund të kërkohet kthim në gjendjen e mëparshme, as të parashtrohet propozim për përsëritjen e procedurës. Organe në procedurë për marrëveshje jashtëgjyqësore janë këshilli për marrëveshje dhe i autorizuari.

Procedurën për marrëveshje jashtëgjyqësore e udhëheq këshilli për marrëveshje i përbërë prej tre anëtarëve (këshilli për marrëveshje) prej të cilëve njëri është kryetar i këshillit. Kryetarin dhe anëtarët e këshillit për marrëveshje i emëron ministri i Ekonomisë. Për kryetar dhe anëtar të këshillit për marrëveshje mund të emërohet personi me arsim të lartë të kryer në drejtimin juridik ose ekonomik.

Kur këshilli për marrëveshje përcakton se janë plotësuar kushtet për hapjen e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore, me konkluzion do të emërojë të autorizuar të marrëveshjes jashtëgjyqësore. Të autorizuarin e marrëveshjes jashtëgjyqësore e emëron këshilli për marrëveshje nga lista e drejtorëve të autorizuar të falimentimit.

### **Propozim për hapjen e procedurës**

Debitori i cilin gjendet në gjendje të jolikuiditetit ose insolvencës detyrohet që të propozojë hapjen e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore, në pajtim me dispozitat e ligjit për marrëveshje jashtëgjyqësore. Deri në përfundimin e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore nuk lejohet të hapet procedurë për falimentim. Procedura për marrëveshje jashtëgjyqësore nuk mund të zbatohet nëse ndaj debitorit është hapur procedurë për falimentim. Propozimi për hapjen e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore dorëzohet te Ministria e Ekonomisë.

### **Raport për gjendjen financiare dhe punën e debitorit**

Raporti për gjendjen financiare dhe punën e debitorit përmban:

- 1) raporte financiare në pajtim me Ligjin për kontabilitet të cilat nuk janë më të vjetra se tre muaj nga dita e parashtrimit të kërkesës për zbatimin e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore;
- 2) raport të revizorit (për operatorët ekonomikë të cilët kanë detyrim për kryerjen e revizionit) për raportet financiare të bashkangjitura ndaj kërkesës për zbatimin e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore;
- 3) Regjistrim të detyrimeve ndaj kreditorëve i cili i përmban elementet në vijim:
  - firmën, përkatësisht emrin dhe mbiemrin e kreditorit, selinë e tij, adresën dhe numrin unik të amzës të subjektit për çdo detyrim të veçantë,
  - shumën e përgjithshme të detyrimeve në ditën e raporteve të dorëzuara financiare dhe shumën e përgjithshme të detyrimeve dhe
  - shenjën për të drejtën e përmbushjeve të përjashtuara dhe të veçuara për çdo detyrim individual ndaj kreditorit me të dhëna për sendet mbi të cilat ekzistojnë ato të drejta.

### **Ofertat e kreditorëve**

Me propozimin për marrëveshje jashtëgjyqësore debitori mund t'u ofrojë kreditorëve mënyrë dhe afat për përmbushjen e kërkesave. Propozimi për marrëveshje jashtëgjyqësore përmban:

- 1) shumën e përgjithshme të kërkesave të pasiguruara sipas raporteve të dorëzuara financiare.
- 2) propozim për zvogëlimin e atyre kërkesave dhe afateve për pagimin e tyre.
- 3) Nëse propozohet pagesë e kërkesave në shumë të zvogëluar, përqindja të cilën debitori ua propozon kreditorëve për pagimin e kërkesave të tyre nuk mund të jetë më e vogël se 30% - nëse pagesa propozohet të kryhet në afat prej katër viteve, as më e vogël se 40% - nëse pagesa propozohet të kryhet në afat prej tetë viteve. Nëse debitori është i organizuar si shoqëri kapitale, mundet në propozimin për marrëveshje jashtëgjyqësore t'u ofrojë kreditorëve, sipas zgjedhjes së vet:
  - 1) të pranojnë zvogëlimin e kërkesave dhe prolongimin e afateve për pagesën e kërkesave dhe



2) kërkesat e tyre t'i fusin si depozitë në procedurën e rritjes së kryegjësë themelore të debitorit.

3) lidhur me mënyrën e rritjes së kryegjësë themelore:

- shumën më të vogël të përgjithshme të kërkesave të pasiguruara ose të siguruara, të cilat kreditorët doemos duhet t'ia bartin debitorit, që të jetë i mundur realizimi i suksesshëm i ristrukturimi financiar të debitorit dhe

- nëse debitori njëkohësisht me rritjen zbaton edhe zvogëlim më të thjeshtësuar të kryegjësë themelore, shumën nominale të zvogëlimit të kryegjësë themelore. Në procedurën e rritjes së kryegjësë themelore të debitorit për qëllimet e strukturimit financiar zbatohen dispozitat adekuate të Ligjit për shoqëri tregtare.

Këshilli për marrëveshje detyrohet të vendosë me aktvendim nëse do të hapë procedurë për marrëveshje jashtëgjyqësore ose jo, në afat prej tetë ditëve, nga dita e marrjes së propozimit.

### **Pengesa procedurale për zbatimin e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore**

Këshilli për marrëveshje do ta hedh poshtë propozimin për marrëveshje jashtëgjyqësore nëse:

- 1) propozimi është parashtruar gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes jashtëgjyqësore të lidhur paraprakisht;
- 2) nuk ka kaluar afati prej dy viteve nga plotësimi e detyrimeve nga marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur paraprakisht;
- 3) propozimi nuk është parashtruar nga propozuesi i autorizuar;
- 4) përmbajtja e propozimit nuk është përpiluar sipas dispozitave të ligjit për marrëveshje jashtëgjyqësore dhe
- 5) Ndaj debitorit është ngritur procedurë për falimentim.

### **Dorëzimi dhe shpallja e aktvendimit për hapjen e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore**

Aktvendimi për hapjen e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore i dorëzohet debitorit dhe bankave të cilat për debitorin e kryejnë qarkullimin pagesor. Këshilli për marrëveshje mund t'i urdhërojë të autorizuarit në marrëveshjen jashtëgjyqësore, që aktvendimin për hapjen e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore ta dorëzojë te kreditorët dhe te debitorët e debitorit adresa e të cilëve është e njohur.

### **Procedura hetuese**

Në seancën e parë përcaktohen kërkesat ndaj fletëparaqitjeve të kreditorëve dhe dokumenteve të dorëzuara nga ana e debitorit. Kërkesat për të cilat ekziston pëlqim ndërmjet debitorit dhe kreditorit për ekzistimin e lartësisë së asaj kërkesë për të cilën ekziston dokument për përmbarim, konsiderohen si kërkesa të përcaktuara, përveç nëse debitori disponon me dëshmi se kërkesa është ndërprerë. Këshilli për marrëveshje përpilon tabelë të kërkesave të paraqitura në të cilën për çdo kërkesë individuale fut të dhëna për lartësinë e përcaktimit, përkatësisht kontestimit. Nëse vlera e kërkesave të kontestuara është më shumë se 25% të vlerës së kërkesave të paraqitura, procedura për marrëveshje jashtëgjyqësore ndërpritet. Debitori e arsyeton propozimin për marrëveshje jashtëgjyqësore dhe parashtron deklaratë se të dhënat për gjendjen financiare dhe punën e debitorit që janë dorëzuar me propozimin për marrëveshje jashtëgjyqësore në tërësi i përgjigjen gjendjes reale. Pas prononcimit të debitorit, për propozimin prononcohet i autorizuari i marrëveshjes jashtëgjyqësore.

### **Ndërprerja e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore**

Këshilli për marrëveshje do ta ndërpresë procedurën për marrëveshje jashtëgjyqësore në raste nëse:

- 1) plani për ristrukturim financiar nuk pranohet, procedura për marrëveshje jashtëgjyqësore ndërpritet,
- 2) debitori i plotëson të gjitha detyrimet ndaj kreditorëve deri në seancën për votim,

3) pas skadimit të afatit prej 120 ditëve nga dita e hapjes së procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore para këshillit për marrëveshje nuk zbatohet procedurë për marrëveshje jashtëgjyqësore dhe

4) pas skadimit të 60 ditëve nga dita e hapjes së procedurës së shkurtuar për marrëveshje jashtëgjyqësore nuk zbatohet procedurë për marrëveshje jashtëgjyqësore.

## **6.PASOJAT JURIDIKE NGA HAPJA E PROCEDURES PËR MARRËVESHJE JASHTËGJYQËSORE**

Pasojat juridike nga hapja e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore krijohen në ditën e ardhshme kur shpallja për hapjen e procedurës është publikuar në ueb faqen e Regjistrisë qendror.

Procedurat e përmbarimit dhe sigurimit të cilat kanë filluar para hapjes së procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore, ndërpriten. Gjatë kohëzgjatjes së procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore nuk mundet kundër debitorit të lejohet përmbarim për shkak të sigurimit, as përmbarim për shkak të përmbushjes së kërkesave në bazë të dokumentit të miratuar përmbartues paraprak. Nga dita e shpalljes së aktvendimit për hapjen e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore, bartësi i qarkullimit pagesor ndërpret të kryejë pagesa në bazë të dokumenteve përmbartuese të arritura për arkëtim në ngarkim të debitorit.

Nëse bartësi i qarkullimit pagesor merr dokument përmbartues për pagim në ngarkim të debitorit pas hapjes së procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore, të njëjtën nuk do ta përmbartojë dhe do t'ia kthejë parashtruesit me arsytim. Procedura për marrëveshje jashtëgjyqësore nuk ka ndikim mbi të drejtën për përmbushje të ndarë të kreditorëve të përjashtuar dhe të veçuar. Kërkesat jomonetare ose kërkesat shuma në para e të cilave nuk është caktuar, përlllogariten në vlerë me para në të cilën mund të vlerësohen në ditën e hapjes së procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore.

Kërkesa monetare dhe jomonetare të kreditorit ndaj debitorit të cilat janë lëndë të kërkesave të përkohshme të kostos ose dhënies, me hapjen e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore shndërrohen në kërkesa të njëhershme në para. Me hapjen e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore do të bëhet sheshimi i kërkesave të përcaktuara të kreditorëve me kërkesat e maturuara të debitorit, në bazë të Ligjit për marrëdhënie obligative.

Me paraqitjen e kërkesës në procedurën për marrëveshje jashtëgjyqësore ndërpritet parashkrimi nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes deri në kalim të afatit për pagim i cili është caktuar në marrëveshje jashtëgjyqësore, e nëse marrëveshja jashtëgjyqësore nuk lidhet, deri në plotfuqishmërinë e vendimit për ndërprerje të procedurës.

### **Përgjegjësia për menaxhim gjatë dhe pas lidhjes së marrëveshjes jashtëgjyqësore**

Debitori është i detyruar të sigurojë që masat për ristrukturim financiar të përcaktuara në marrëveshjen jashtëgjyqësore të zbatohen në afatet e caktuara për zbatimin e tyre. Debitori është i detyruar, në çdo tre muaj të përpilojë raport për zbatimin e ristrukturimit financiar, duke përfshirë:

- 1) përshkrimin e masave për ristrukturim financiar të cilat janë zbatuar dhe ndikimin e tyre të debitorit në aspekt të likuiditetit dhe solvencës;
- 2) shumën e përgjithshme të pagesave të kërkesave të kreditorëve;
- 3) bilancet tremujore dhe raport për qarkullimin e parave të gatshme dhe
- 4) deklaratën e debitorit se nuk ka ndërmarrë asnjë punë e cila si pasojë do të kishte sjellje të kreditorëve në pozitë të pabarabartë.

Në bazë të marrëveshjes jashtëgjyqësore, debitori lirohet nga detyrimi që kreditorit t'i paguajë përqindje më të madhe nga e përcaktuara në marrëveshjen jashtëgjyqësore, ndërsa afatet për pagim prolongohen sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore. Në ato korniza debitori lirohet nga detyrimet ndaj personave të cilëve u takon e drejta e regresit (garantëve). Nëse debitori pas lidhjes së marrëveshjes jashtëgjyqësore kreditorëve u paguan shumë mbi përqindjen e përcaktuar në marrëveshjen jashtëgjyqësore, nuk ka të drejtë të kthimit të asaj shume.

Dokumentet përmbarese të cilat kanë të bëjnë me kërkesat nga marrëveshja jashtëgjyqësore, për pjesën për të cilën janë përmbushur, e humbin fuqinë juridike në lidhje me debitorin.

Nëse marrëveshja jashtëgjyqësore nuk realizohet plotësisht, kreditorët të cilët janë plotësuar në marrëveshje jashtëgjyqësore, nuk janë të detyruar ta kthejnë atë që e kanë pranuar. Kreditorët të cilët janë plotësuar pjesërisht sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore, në

procedurë për falimentim e paraqesin kërkesën e përgjithshme të zvogëluar për shumën për të cilën konsiderohet se sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore janë përmbushur. Kreditoret të cilët as pjesërisht nuk janë përmbushur sipas marrëveshjes jashtëgjyqësore, në procedurë për falimentim e paraqesin kërkesën në shumë të përgjithshme në të cilën do të kishin të drejtë pa lidhje të marrëveshjes jashtëgjyqësore.

### **SHFUQIZIMI I MARRËVESHJES JASHTËGJYQËSORE**

Marrëveshja jashtëgjyqësore mund të kundërshtohet me padi nën kushtet e njëjta të cilat janë përcaktuar për kundërshtimin e marrëveshjes gjyqësore. Në bilancin e suksesit të debitorit si të hyra nuk paraqiten zvogëlimi ose ndërprerja e detyrimeve të debitorit në bazë të:

- 1) ndërprerjes së kërkesës së kreditorit, me futjen e kërkesës në kryegjënë themelore të shoqërisë në procedurë të rritjes së kryegjësë themelore në bazë të marrëveshjes së miratuar jashtëgjyqësore dhe
- 2) zvogëlimit të kërkesës së kreditorit në bazë të marrëveshjes së miratuar jashtëgjyqësore.

Debitori i cili ka krijuar rezerva kapitale nuk guxon të bëjë zvogëlimin e kryegjësë themelore para kalimit të afatit prej dhjetë viteve nga miratimi i marrëveshjes jashtëgjyqësore dhe para kalimit të afatit për plotësimin e të gjitha detyrimeve të cilat rezultojnë nga marrëveshja e miratuar jashtëgjyqësore.

Mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të ligjit për marrëveshje jashtëgjyqësore kryen Ministria e Ekonomisë.

### **KONKLuzion**

Si që u tha edhe më lartë, sjellim përfundim se marrëveshjet jashtëgjyqësore të pronsisë të kompanive dhe personave fizik e juridik, respektivisht marrëveshja ka për qëllim zbatimin, rregullimin, kushtet dhe mënyra e procedurës jashtëgjyqësore, heqja dhe kufizimi i të drejtës së pronsisë, pastaj për realizimin e interes publik të përcaktuar me ligj për marrëveshje jashtëgjyqësore. Me hapjen e procedurës për marrëveshje jashtëgjyqësore do të

bëhet sheshimi i kërkesave të përcaktuara të kreditorëve me kërkesat e maturuara të debitorit, në bazë të Ligjit për marrëdhënie obligative. Procedura për marrëveshje jashtëgjyqësore nuk mund të zbatohet nëse ndaj debitorit është hapur procedurë për falimentim. Mjete juridike

Vizioni për të ardhmen është që ligji për marrëveshje jashtëgjyqësore të respektohet dhe zbatohet në përpikshmëri dhe të bëhet një avangard edhe më tej, gjithmon me qëllim drejt një marrëveshje më efikase, më e sukseshme ku pronarët e pronsisë do të ndihen më të sigurt gjatë zbatimit, respektivisht gjatë kompensimit të borxhit - detyrimeve.

### **Referenca:**

- Ligjit për marrëdhënie obligative;
- Ligji për procedur administrative;
- Ligji për marrëdhënie pune në R. Maqedonisë;
- Ligji për kontabilitet;
- Ligjit për shoqëri tregtare;
- Ligji për marrëdhënie jashtëgjyqësore G. Z. e R. M. Nr. 12/2014;
- Ligji për Përmbarim i vitit 2008;
- Kniga Zakon za izvrshvanje 2011 od prof. Dr. Kiril Çavdar ;
- Ligji për procedurë falimentim;
- Ligji për kundërvatje i R.Maqedonisë;
- Ligji për Procedur Penale G. Z. e R. m. Nr. 115/2010;
- Ligji për Vlersim G. Z. e R. M. Nr. 150/2010;
- Ligji për Procedurën Kontestimore G. z. e R. M. Nr. 79/2005;
- Shembuj nga provoja e shumë Kompanive në Ballkan;
- Burime të ndryshme nga Interneti.

## NJË HISTORI E SHKURTËR E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PAS VITEVE 90

**Albana MENGA**

International University of Struga

a.menga@eust.edu.mk

### Abstrakt

Republika e Maqedonisë (sllavomaqedonisht: Република Македонија) është shtet që shtrihet në pjesën juglindore të Evropës(koordinatat gjeografike 41°50' V, 22°00' L) e që kufizohet në lindje me Bullgarinë në një vi kufitare të gjatë 148 km, në jug me Greqinë në një vi kufitare prej 246 km, në perëndim me Shqipërinë në një vi kufitare prej 151 km dhe në veri me Kosovën dhe Serbinë.

Në OKB ky shtet njihet me emrin Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë për shkak të konfliktit rreth emrit me Greqinë e cila pretendon territorin e Maqedonisë antike. Njohja ndërkombëtare e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë nga Jugosllavia në vitin 1991 është kundërshtuar nga Greqiapër shkak të flamurit dhe emrit Maqedoni (të konsideruara si simbole të Helenëve). Marrëdhëniet me Greqinë përfundimisht u normalizuan në vitin 1995, por problemet me emrin e Republikës së Maqedonisë akoma ekzistojnë. Ndryshimi i statusit politik të Kosovës, implementimi i Marrëveshjes së Ohrit, që shënoi fundin e luftës së shqiptarëve në vitin 2001, si dhe zhvillimi i ulët ekonomik vazhdojnë të jenë çështje diskutimi për këtë shtet. Sipas regjistrimit të vitit 2002 në Maqedoni jetojnë: Maqedonë 1.297.981 (64,18 %) Shqiptarë 509.083 (25,17 %) Turq 77.959 (3,85 %) Romë 53.879 (2,66 %) Serbë 35.939 (1,78 %) Boshnjakë 17.018 (0,84 %) Rumunë 9.695 (0,48 %) Të tjerë 20.993 (1,04 %).

**Fjalët Kyçe** :Kordinatat e R.M , pozita gjeografike dhe popullsia , Ekonomia e R.M , Histori e shkurtë pas viteve të 90-ta , Antarsimi.

## **HYRJE**

Në vitin 1990 u mbajtën zgjedhjet e para shumpartiake dhe shënuan një faqe të re në historinë e maqedonis qytetare e r.m për herë të parë dalin në zgjedhje të lira dhe demokratike me vota të fshehta , ata zgjedhin 120 deputet në parlamentin njëdhomësh të maqedonisë .Në zgjedhje marin pjesë 18 parti politike disa të sa po regjistruara dhe 43 kandidat te pamvarur , me 8 janar 1991 u be konstituimi I parlamentit te R.M i pari në sistemin pluralist . Evropian i cili i respekton parimet e BE-së mund të aplikoj për antarësim. Kjo dispozitë parasheh dy kushte kryesore- gjeografik dhe parimor. Në relacionin e kriterëve gjeografike, duhet të nënvizohet se, BE ashtu edhe shteti kandidat nuk kanë mundësi që ta ndryshojnë këtë realitet gjeografik. Domosdoshmëria e harmonizimit me këtë parim është vërtetuar shumë më herët në rrjedha të procesit të zgjerimit - që në fillim, me aprovimin e mendimit të parë për aplikimin e vendit të caktuar, kështu që ky parim asnjëherë nuk ka qenë lëndë e elaborimit.Parimet e Bashkimit Evropian formalisht janë të përshkruar si kriteriume për antarësim në BE dhe më së shumti kanë të bëjnë me kriteret e Kopenhagës, për arsye se këto kriteriume politike dhe ekonomike për herë të parë u vendosën në samitin e Këshillit Evropian në Kopnhagë. Baza e kriterëve politike ka të bëjë me obligimin e shteteteve kandidate që të sigurojnë: Stabilitetin e institucioneve të cilat do të garantojnë demokracinë, qeverisjen e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin e të drejtave të pakicave nacionale. Pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Amstredamit (maj 1999), këto kërkesa u inkorporuan si parime kushtetuese në Marrëveshje për bashkimin Evropian, dhe ishin të potencuara në Kartën e të drejtave fundamentale të BE-së, të proklamuar nga Këshilli Evropian i Samitit të Nice në dhjetor të vitit 2000. <sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Kushtetuta e R.M.



## 2. EKONOMIA E R.M

BVP(Bruto Prodhimi Vendor ) : \$17.26 miliard ( 2007); BVP - shkalla reale e rritjes: 6.6% (2007); BVP për banorë: \$8,400 (2007); BVP - i ndarë sipas sektorëve: bujqësia: 21.7%; industria: 32.6%, shërbime: 45.7% (Shtator 2006) Fuqia punëtore: 890,000 (2007) Niveli i papunësisë: 35% (2007); **Popullsia nën moshën për punë**: 30% (2005 ); **Niveli i inflacionit** (çmimi konsumatorë): 2% (2007); Investime (ritja fikse): 18% e BVP (2007) Buxheti:të ardhura : \$2.381 miliard, shpenzime: \$2.456 miliard,(2007); Borxhi publik: 26.1% nga BVP; **Elektriciteti** - prodhim: 5.935 miliard kwh (2006), harxhim: 8.929 miliard kwh (2006), eksport: 0 kwh (2003), import: 2.994 miliard kwh (2006); Nafta - prodhimi: 0 fuçi/ditë (2005), konsumi: 20,000 fuçi/ditë (2005); Bilanci i tanishëm kontabël: \$ 5 milion (2007). Exporti: \$2.844 miliard (2007), Eksporton: ushqim, cigare, hekur, çelik ... , Eksporton : Serbi dhe Maltë Zi 23.2% , Gjermani 15.6%, Greqi15.1%, Itali 9.9%, Bullgari 5.4%, Kroaci 5.2% (2006) Importi: \$4.079 miliard (2007), Importon: makineri dhe pajisje, automobilë, kemikale, derivate, produkte ushqimore .... , Importon nga: Rusia15.1%, Gjermania 9.8%, Sërbia dhe Mali i Zi 7.5%, Bullgaria 6.7%, Italia 6% (2006)<sup>2</sup>

## 3. ANTARSIMI , CESHTJET DHE PROBLEMET E ANTARSIMIT

Më 22 mars të vitit 2004 Republika Maqedonisë aplikoi për anëtarësim në BE. Më 17 maj 2004, Këshilli i ministrave mandej kërkoi nga Komisioni Evropian të përgadis mendimin që kishte të bëjë me aplikimin. Në mes burimeve të informacionit të cilat Komisioni i shfrytëzonte gjat përgaditjes të mendimit ishin edhe përgjigjet nga pyetëtori. Çka paraqet në esencë pyetëtori? Pyetëtori është mjet punues e cila duhet të lehtësoj dialogun të cilin Komisioni e zbaton me pushtetet me qëllim që të vlerësoj se a është shteti i përgaditur që të ndërmer të drejtat dhe obligimet të cilat burojnë nga anëtarësimi në BE.

Përgjigjet duhet të jenë sa është e mundur më konkret me qëllim që Komisionit të i mundësohet një shqyrtim i drejt për gjendjen aktuale si dhe për implementimin e reformave. Shumë është thënë dhe bërë në katër vitet e fundit që kur Maqedonia u bë vend kandidat për në BE. Me afrimin e datës së publikimit të raportit vjetor të KE, pyetjet nëse ky vit do të jetë

<sup>2</sup> [www.wikipedia.com](http://www.wikipedia.com)

vit për marrjen e datës për fillimin e negociatave për anëtarësimin e plotë po okupojnë diskutimet publike. Për të gjetur një përgjigje të shpejtë ndaj kësaj pyetje duket detyrë mjaft e vështirë. Problemet nuk rrjedhin vetëm nga shqetësimet e brendshme - të ndërlikuara dhe sfiduese, por edhe nga konfuzioni mbi të ardhmen e Evropës brenda kryeqyteteve të Evropës dhe Brukselit.

Rruga e Maqedonisë nëpër të cilën duhet të ecë për të arritur destinacione shumëkërkuar –Brukselin, është veçanërisht e vështirë dhe plot me pengesa. Përveç çështjeve të brendshme dhe mosmarrëveshjeve me fqinjët e saj, Maqedonia gjithashtu duhet të gjejë një mënyrë për të "fituar" Evropën, krahas krizës globale ekonomike dhe ratifikimit të pambaruar të Traktatit të Lisbonës. Duket si mision i pamundur kur kombinohen gjithë këto, megjithëse kjo mund të realizohet. Politika e BE-së “carrot and stick” është e njohur gjerësisht, veçanërisht në mesin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Pas negociatave me vite, reformave të dhimbshme dhe konflikteve, BE-ja në Samitin Evropian në Britani të Madhe, të mbajtur në dhjetor të vitit 2005, vendosi për t'i dhënë Maqedonisë, Kroacisë dhe Turqisë statusin e kandidatit.

Kjo Politikë e BE-së është hartuar për të shtyrë rajonin përpara dhe t'u japë stimuj të gjitha vendeve të BP-së për të vazhduar me reformat pavarësisht çështjeve të brendshme të BE-së dhe lodhjes nga zgjerimi. Përparimi i Maqedonisë që nga kjo datë ka pasur disa ngritje dhe për fat të keq, shumë rënie. Ndryshimi i parë i madh ka ndodhur në vitin 2006 në zgjedhjet parlamentare, në të cilat VMRO-DPMNE e udhëhequr nga koalicioni fitoi shumicën e vendeve në parlament (45 nga 120) dhe mori pushtetin nga SDSM. Ndërsa nga ana tjetër, partia etnike shqiptare BDI (Bashkimi Demokratik për Integrim) fitoi 60% të votave të komunitetit etnik shqiptar, por u la jashtë qeverisë sepse PDSH (Partia Demokratike e Shqiptarëve), ishte zgjedhja e VMRO-së për partner të koalicionit. Kjo rezultoi në bojkot të parlamentit nga ana e BDI-së si shenjë proteste që nuk qenë të ftuar të jenë pjesë e qeverisë së re. Në shtator të vitit 2007 gjatë votimit për kodin zgjedhor u shënua një ballafaqim në parlament, e cila u shkallëzua në dhunë fizike mes partive etnike shqiptare. Njerëz të tjerë u plagosën gjithashtu, duke përfshirë edhe gazetarët. Ky incident ishte rezultat i raporteve të nxehura mes dy partive më të mëdha shqiptare që nga zgjedhjet parlamentare në 2006 kryesisht lidhur me zgjedhjen e partnerit shqiptar në qeveri. Fakti që shumë pak përpjekje

qenë bërë në procesin e ndërmjetësimit për të zgjidhur grindjet ndër-partiake, të cilat bllokuan procesin e reformave të rëndësishme, rezultoi në kritika nga ana e Brukselit.

I pritur në një vizitë nga Presidenti I atëhershëm Z. Branko Crvenkovski, Oli Rehn pyetjes së një gazetari I qe përgjigjur: "Si mund të prisni vendime të mëdha nga ne kur ndodhin gjëra të tilla."

Para se të diskutohen incidentet zgjedhore, ky raport do të fokusohet paraprakisht në një praktikë që ishte prezantuar nga Komisioni pas ngjarjeve elektorale të vitit 2007.

Ku vendosi kushte të reja dhe vetëm me plotësimin e tyre mund që Maqedonia të shpresojë për të marrë datë për fillimin e bisedimeve.

Këto kushte janë të njohura edhe si tetë standarde të BE-së dhe ato janë:

1. Dialog konstruktiv politik.
2. Zbatimi efektiv i ligjit të ri mbi policinë.
3. Depolitizimi I administratës publike.
4. Përmirësimi i klimës së biznesit.
5. Përshpejtimin e legjislacionit të pronës.
6. Forcimi i pavarësisë së gjyqësorit.
7. Zbatimi në mënyrë të qëndrueshme të legjislacionit anti-korrupsion.
8. Krijimi i kushteve për punësimin e të rinjve.

Pas incidenteve në Kuvend në shtator të 2007 dhe raportit negativ mbi përparimin, në fillim të vitit 2008 Komisioni Evropian dha shpresa për të përcaktuar një datë fillimi për bisedimet e pranimit të Maqedonisë në atë vite. Oli Rehn (Komisioneri i BE-së për Zgjerimin) për stacionin televiziv Kanal 5 deklaroi: "Shpresoj se do të jemi në gjendje të bëjmë këtë sa më shpejt gjatë vitit 2008 i cili është një vit me rëndësi kyçe për Ballkanin Perëndimor".

Rëndësia kryesore ishte Samiti i ardhshëm i NATO-s në të cilën vendet e Kartës së Adriatikut (Kroacia, Maqedonia dhe Shqipëria, e krijuar në 2003) priteshte të marrin ftesë për anëtarësim të plotë në NATO.

Megjithatë, mosmarrëveshja e emrit me Greqinë gjithmonë e më shumë filloi të kërcënojë tërë marrëveshje disa muaj para Samitit. Në mënyrë dinake dhe të vendosur, Greqia

filloi të dërgojë sinjale se pa një kompromis rreth emrit zyrtar të Maqedonisë, veto-ja për hyrjen e saj në NATO do të jetë më se reale. Negociatat filluan të intensifikohen, më shumë për shkak të faktit se ai ishte një vit i zgjedhjeve në SHBA dhe Xhorxh Bush po përfundonte mandatin e tij të dytë dhe të fundit.

Të gjitha palët e interesuara, BE, NATO, OKB, Shtetet e Bashkuara dhe ndërmjetësi, Methju Nimitz e këshillonin Maqedoninë se do të duhet të pranojë një kompromis lidhur me emrin e saj para Samitit të Bukureshtit, pasi koha po kalonte dhe të mirat ngadalë te përgatitura që të heqin dorë nga qëndrimet fillestare dhe nuk kishte asnjë zgjidhje kompromisi në prag të Samitit.

Me fillimin e Samitit të Bukureshtit, Greqia vazhdimisht intensifikonte thirrjet për vënien e vetos mbi hyrjen e Maqedonisë në NATO, ndërsa diplomatët punonin me zell mbi arritjen e një marrëveshjeje të mundshme në minutën e fundit midis dy vendeve. "...

Pasi vendimet e NATO-s që nga themelimi kanë qenë gjithmonë të sjella në mënyrë unanime, Greqia gjithashtu ka të drejtën e vetos ..."

Megjithatë, zgjidhje të minutës së fundit për çështjen e emrit nuk pati dhe Maqedonia nuk u bë shtet anëtar i NATO-s. Këtu është e rëndësishme të theksohet se qëndrimi zyrtar nuk ishte se hyrja e Maqedonisë ishte bllokuar përmes vënies së vetos, paraqit në media.

Aleanca iu qas ndryshe kësaj çështjeje dhe në Deklaratën e Samitit të përbashkët u shpreh se: ne e çmojmë punën e mundimshme dhe angazhimin e treguar nga ana e Maqedonisë ndaj vlerave të NATO-s dhe operacioneve të Aleancës Brenda kuadrit të Kombeve të Bashkuara, shumë aktorë kanë punuar me përkushtim për të zgjidhur çështjen e emrit, por Aleanca ka vërejtur me keqardhje se këto bisedime nuk kanë prodhuar një rezultat të pritur.

Prandaj ne ramë dakord që ftesa për Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë do të jepet me sa kohë që të gjindet një zgjidhje reciprokisht e pranueshme për çështjen e emrit. Ne inkurajojmë që negociatat të rifillojnë pa vonesë dhe presim që ato të jenë të përfunduara sa më shpejt të jetë e mundur.

Qeveria e Maqedonisë ishte këshilluar nga të gjithë diplomatët e huaj për rreziqet që vë përpara kjo mosmarrëveshje nëse zgjatet më tej dhe se momenti vendimtar është të përpilohet një marrëveshje menjëherë pas Samitit (në veçanti për shkak se zgjedhjet në SHBA

dhe për Parlamentin e BE ishin të planifikuara në të ardhmen e afërt). Megjithatë, vendimi për zgjedhje të parakohshme surprizoi shumicën e ekspertëve dhe diplomatëve. Arsyet pse qeveria vendosi të shkojë në zgjedhje dy vjet pasi u zgjodh nuk kanë qenë krejtësisht të qarta. Një nga opsionet e paraqitura ishte se pas Samitit të Bukureshtit, një bashkim kombëtar ishte i nevojshëm dhe qeveria, pas dështimit lidhur me anëtarësimin në NATO, donte të vërtetojë nëse ende gëzon besimin e popullit.

Pa marrë parasysh arsyet, vendimi që bërë përfundimtar Parlamenti u shpërbë vetë dhe zgjedhjet u caktuan për 1 Qershorin e vitit 2008. Në periudhën paraelektorale, incidentet ishin të shumta por më së shumti u shkallëzuan më 1 qershor. Sulme të shumta në zyrat e partisë dhe incidente të tjera të dhunshme kanë ndodhur që kur u bë thirrja për zgjedhje të parakohshme. Incidentet kanë qenë kryesisht në zonat etnike shqiptare në veri-perëndim të vendit. Tensionet mbeten të larta në disa rajone. Incidenti më i rëndësishëm ka ndodhur më 12 maj, kur në një sulm jashtë Tetovës në shënjestër ishte lideri i BDI-së, partisë më të madhe etnike shqiptare e përfaqësuar në Parlament.

Zgjedhjet në këtë ditë mund të përshkruhen me fjalën e vetme: dështim. Atmosfera e elektrizuar para dhe Samiti i NATO-s bënte që të regjistrohen zgjedhjet më të parregullta që nga pavarësimi i Maqedonisë. Rezultati ishte: "një i vrarë në fshatin Haraçinë, pranë Shkupit, disa të plagosur në incidente në Çair dhe në disa vendvotime në Tetovë, Gostivar dhe Kumanovë".<sup>3</sup>

Me këto ngjarje të turbullta Maqedonia kaloi nga 2008 në vitin 2009.

## **2. Zhvillimet më të reja 2008-2009.**

### **1.2 2009 zgjedhjet lokale dhe presidenciale,**

### **2.2 vazhdim me reformat dhe negociatat për çështjen e emrit.**

### **3.2 Negociatat me Greqinë për emrin dhe ndikimin e tyre në Maqedoni duke u përgatitur dhe marrjen e datës për fillimin e negociatave**

Siç u përmend në kapitujt e mëparshëm, mosmarrëveshja e emrit të Maqedonisë u shëndërrua në temë tepër dramatike në dy vitet e fundit. Mosmarrja e ftesës për anëtarësim në

---

<sup>3</sup> Demokracia Parlamentare ,Arsim Bajrami , Prishtine,2005

NATO vendosi Maqedoninë në një situatë relativisht të pakëndshme. Greqia, duke kundërshtuar haptas anëtarësimin e fqinjit të saj ka demonstruar qëndrueshmëri mbi mosmarrëveshjen rreth emrit. Nuk ka asnjë diskutim në lidhje me atë se kompromisi lidhur me emrin duhet të arrihet para se Maqedonia të hyjë në NATO dhe BE, të paktën derisa votimet bëhen në mënyrë të njëzëshme.

Me gjithë përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare dhe ndërmjetësit të emëruar nga ana e OKBsë, z. Methju Nimitz, të dyja palët qëndrojnë fuqishëm në pozicionet e tyre të kundërta duke mos arritur ende kurfarë marrëveshje. Disa bisedime, megjithatë të paverifikuara, nga zyrtarë të të dyja anëve ose BE-së, shprehen që me liberalizimin e vizave dhe rekomandimet e mundshme për hapjen e negociatave, Maqedonia do të fitojë nxitjen e duhur për të bërë një kompromis lidhur me emrin e saj në periudhën që vjen.

#### **4. SISTEMI POLITIK I MAQEDONISË**

Maqedonia është një demokraci parlamentare. Pushteti ndahet ndërmjet legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Kushtetuta është më i lartë i vendit.

Presidenti zgjidhet me votim popullor për një mandat pesë-vjeçar. Presidenti emëron kryeministrin. Qeveria apo këshilli i ministrave zgjidhet me shumicë votash në parlament.

##### **Presidenti i R.M**

Presidenti është kreu i shtetit, ai përfaqëson Republikën, është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Maqedonisë dhe kryeson Këshillin e Sigurisë kombëtare. Presidenti zgjidhet me shumicë votash në zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta, me vota të fshehta, për një mandat prej pesë vjetësh dhe asnjë person nuk mund të ushtrojë më shumë se dy mandate si president. Disa prej funksioneve të presidentit përfshijnë: dhënia e mandatit për formimin e qeverisë; dekretimi i emërimit apo shkarkimit të ambasadorëve dhe përfaqësuesve të tjerë diplomatikë jashtë vendit; propozimi i gjyqtarëve për

në Gjykatën Kushtetuese dhe Këshillin Gjyqësor Republikan; emërimi i anëtarëve të Këshillit të Sigurimit, etj.<sup>4</sup>

### **Ekzekutivi**

Pushtetit ekzekutiv i është dhënë qeverisë, e formuar prej kryeministrit dhe ministrave. Presidenti emëron kryeministrin, emërim që i nënshtrohet miratimit nga asambleja. Qeveria zgjidhet me shumicë votash të të gjithë deputetëve në asamble. Ajo trajton veprimtaritë qeveritare të përditshme dhe mban përgjegjësi përpara asamblesë. Qeveria paraqet ligje në asamble dhe vendos në lidhje me politikat për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve të miratuara nga legjislatura. Ajo gjithashtu ka pushtet për të miratuar rregullore, si dhe akte të tjerë rregullues, që i përkasin zbatimit të ligjeve. Ajo emëron dhe shkarkon mbajtësit e funksioneve publike dhe funksioneve të tjera të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligjet. Administrata shtetërore përbëhet prej ministrave dhe organeve e organizatave administrative të tjera të përcaktuara me ligj.

### **Pushteti Legjislativ**

Pushteti legjislativ i është dhënë Asamblesë me një dhomë ose parlament e cila ka 120 anëtarë. Anëtarët zgjidhen me një votim nga populli prej listave të partive, duke u mbështetur në përqindjen e votave të përgjithshme që partitë marrin në secilin nga gjashtë qarqet zgjedhore; anëtarët shërbejnë për mandate katër vjeçarë.

Zgjedhjet legjislative të fundit u zhvilluan më 1 qershor dhe 15 qershor 2008. Asambleja mbledhet në Shkup dhe është në pushtetin e saj që të ndryshojë kushtetutën dhe të miratojë ligje e rezoluta, të ratifikojë marrëveshje ndërkombëtare, etj<sup>5</sup>

### **Pozita dhe organizimi i sistemit gjyqësor në Republikën Maqedonisë**

---

<sup>4</sup> Demokracia Parlamentare ,Arsim Bajrami , Prishtine,2005

<sup>5</sup> Demokracia Parlamentare ,Arsim Bajrami , Prishtine,2005

Në kuadër të ndarjes së funksioneve shtetërore, funksioni gjyqësor është lënë në kompetencë të gjykatave. Pushteti gjyqësor është kompetent për zgjidhjen e kontesteve juridike, të tregojë se çfarë është në pajtim më të drejtën në rastin konkret.<sup>16</sup>

Funksioni gjyqësor, si funksion gjyqësor i zgjidhjes së kontesteve të cilat paraqiten ndërmjet pjesëtarëve të një shteti, është i vjetër. Por, pushteti gjyqësor si institucion shtetëror daton më vonë. Në teori ekzistojnë dilema se a mund të flitet për pushtet gjyqësor, përkatësisht a mund të flitet për gjykatat si pushtet i tretë. Organizimi i gjyqësisë në Republikën e Maqedonisë është unitar. Gjykatat e jashtëzakonshme janë të ndaluara. Llojet, kompetencat, themelimi, anulimin?, organizimi dhe përbërja e gjykatave është rregulluar me Ligjin për gjykatat . Ky është ligj organik, ligj që sillet me shumicë të cilësuar prej dy të tretave të votave nga i gjithë numri i deputetëve. Në sistemin unitar gjyqësor, pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat themelore, gjykatat e apelit dhe Gjykata e lartë e RM-së.

**Gjykatat themelore:** krijohen për territore të caktuara. Në RM ekzistojnë 72 gjykata themelore. Gjykatat themelore mund të gjykojnë edhe jashtë selisë së gjykatës në ditët gjyqësore. Gjykatat themelore janë kompetente të vendosin në shkallë të parë për çështje në kompetencë gjyqësore, për veç çështjeve të cilat me ligj i janë lënë një gjykate tjetër. Gjykatat themelore janë kompetente të vendosin në shkallë të parë edhe për kundravajtjet, përderisa me ligj nuk është caktuar që për lloje të caktuara të kundravajtjeve të vendosin organe të tjera ( doganore, devizore, të tregtisë me jashtë dhe tatimet ).

**Gjykatat e apelit :** krijohen për territoret e më shumë gjykatave themelore. Në RM ekzistojnë 4 Gjykata apeli: në Manastir, Shkup në Shtip dhe ne Gostivar. Gjykatat e apelit janë kompetente të vendosin mbi ankesat kundër vendimeve të gjykatave themelore, të vendosin për mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet gjykatave themelore në territorin e tyre dhe të kryejnë veprime të tjera të përcaktuara me ligj.

**Gjykata e lartë RM-së** ushtron pushtetin gjyqësor në të gjithë territorin e Republikës. Ajo është gjykata më e lartë në Republikë dhe e siguron unitetin në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave. Selia e saj është në Shkup. Gjykata e lartë është kompetente të vendosë në shkallë



të dytë kundër vendimeve të këshillave të saja kur kjo është e përcaktuar me ligj; vendos në shkallë të tretë dhe përfundimisht mbi ankesat kundër vendimeve të gjykatave të apelit dhe kundër vendimeve të këshillave të saja të sjella në shkallë të dytë kur kjo është e përcaktuar me ligj; vendos në shkallë të parë dhe shkallë të dytë në kontestet administrative kur kjo është përcaktuar me ligj dhe vendos për vendimet përfundimtare të sjella në procedurën e kundravajtjeve; vendos për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotëfuqishme të gjykatave dhe vendimeve të këshillave të saja kur kjo është përcaktuar me ligj; vendos për mosmarrëveshjen e kompetencës ndërmjet gjykatave themelore të territoreve të ndryshme të gjykatave të apelit, ndërmjet gjykatave të apelit dhe vendos për delegimin e kompetencës vendore te këto gjykata. Gjykata e lartë për mjetet juridike vendos në këshill të përbërë nga 5 gjyqtarë, në qoftë se me ligj tjetër nuk është përcaktuar ndryshe. Gjykata e lartë në seancë të përgjithshme; përcakton qëndrime parimore dhe mendime parimore juridike për çështjet me rëndësi për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave; jep mendim për propozimet e ligjeve dhe rregullave të tjera kur me to rregullohen çështje me rëndësi për veprimtarinë e gjykatave; shqyrton çështje në lidhje me veprimtarinë e gjykatave, zbatimin e ligjeve dhe praktikën gjyqësore.

## KONKLuzion

**Republika e Maqedonisë** (sllavomaqedonisht: Република Македонија) është shtet që shtrihet në pjesën juglindore të Evropës (koordinatat gjeografike 41°50' V, 22°00' L) e që kufizohet në lindje me Bullgarinë në një vi kufitare të gjatë 148 km, në jug me Greqinë në një vi kufitare prej 246 km, në perëndim me Shqipërinë në një vi kufitare prej 151 km dhe në veri me Kosovën dhe Serbinë. Në OKB ky shtet njihet me emrin **Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë** për shkak të konfliktit rreth emrit me Greqinë e cila pretendon territorin e Maqedonisë antike.

Njohja ndërkombëtare e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë nga Jugosllavia në vitin 1991 është kundërshtuar nga Greqia për shkak të flamurit dhe emrit Maqedoni (të konsideruara si simbole të Helenëve). Marrëdhëniet me Greqinë përfundimisht u normalizuan në vitin 1995, por problemet me emrin e Republikës së Maqedonisë akoma ekzistojnë. Ndryshimi i statusit politik të Kosovës, implementimi i Marrëveshjes së Ohrit, që shënoi

fundin e luftës së shqiptarëve në vitin 2001, si dhe zhvillimi i ulët ekonomik vazhdojnë të jenë çështje diskutimi për këtë shtet.

Sipërfaqja e përgjithshme e Republikës së Maqedonisë është 25,333 km<sup>2</sup>. Vendi shtrihet në koordinatat gjeografike 41 50 V, 22 00 L ku 24,856 km<sup>2</sup> të kësaj sipërfaqeje janë tokë ndërsa 477 km<sup>2</sup> ujë. Vija kufitare e Republikës së Maqedonisë është 25,333 km ndërsa vijë bregdeare nuk ka. Klima e Republikës së Maqedonisë është ngjashme me të Mesdheut e nxehtë me vera të thata e dimra të ftohta me reshje dëbore të mëdha.

Pjesa më e madhe e relievit është terren i vrazhdë, përpos luginës së Vardarit këtë e zbusin edhe rrethina e liqeneve të mëdha. Pika më e ultë e relievit gjendet përgjatë bregut të lumit Vardar (50m) dhe ajo më e larta në lartësi mbidetare prej 2,764 metra. Sipas regjistrimit të vitit 2002 në Maqedoni jetojnë:

- Maqedonë 1.297.981 (64,18 %)
- Shqiptarë 509.083 (25,17 %)
- Turq 77.959 (3,85 %)
- Romë 53.879 (2,66 %)
- Serbë 35.939 (1,78 %)
- Boshnjakë 17.018 (0,84 %)
- Arumunë 9.695 (0,48 %)
- Të tjerë 20.993 (1,04 %).

### **Referenca:**

1. Demokracia Parlamentare ,Arsim Bajrami , Prishtine,2005;
2. [www.wikipedia.com](http://www.wikipedia.com);
3. Kushtetuta e R.M.

**NDIKIMI I SHËRBIMIT TË PROVËS NË ZBATIMIN E MASAVE ALTERNATIVE****Abidin TRENA**

International University of Struga

a.trena@eust.edu.mk

**Abstrakt**

Sistemi i sanksioneve penale në Republikën e Maqedonisë përfshin edhe masat alternative si formë të sanksionimit të kryerësve të veprave penale të cilat ekzekutohen në liri. Qëllimi i masave alternative është zvogëlimi i pasojave negative të cilat mund të mund ti shkaktojë vuajtja e dënimit në institucionet penitenciare dhe nga ana tjetër llogaritet që këto dënime e kryejnë qëllimin e dënimit edhe pas vuajtjes në liri.

Disa nga këto masa shqiptohen shumë rrallë nga ana e gjykatave në Republikën e Maqedonisë si pasojë e mungesës së kushteve për zbatimin e tyre. Një ndër faktorët të pamundësojnë ekzekutimin e tyre është shërbimi i provës. Shërbimi i provës do të fillojë të zbatohet në RM që nga nëntori i vitit 2016 dhe ka për qëllim që të mundësojë aplikimin praktik të masave alternative si: burgu shtëpiak, dënimi me kusht me mbikqyrje mbrojtëse dhe puna në dobi të përgjithshme.

**Fjalë kyçe:** *Sanksion, alternativë, ekzekutim, penale, penitenciare, shqiptim.*

**HYRJE**

Masat alternative e tregojnë idenë themelore mbi të cilën është koncentruar reforma bashkëkohore dhe sistemi i sanksioneve. Të gjitha inovacionet në këtë fushë në të cilën janë të

mbërthyerë dënime klasike dhe masat e sigurisë, ndodhin kryesisht si shprehje e tendencave bashkëkohore për zbatim restriktiv të burgut dhe trajtim të autorit jashtë burgut. Kjo tendencë gjen mbështetje dhe arsyetim si në aspektin teorik po ashtu edhe në atë praktik: ajo është më shumë se përgjigje gjatë krizave të shpeshta nëpër burgje, hyrje në shfrytëzimin e metodave dhe teknikave të reja të kontrollit social të kriminalitetit që janë në hap me erën e re teknologjike-informatike. Zbatimi i alternativave tradicionale të burgut në dekadat e fundit të shekullit të kaluar nuk ndihmoi shumë në reduktimin e tij. Për këtë sot në shumë legjislatura përëndimore ka filluar trendi në gjetjen e masave të reja alternative.

Skepticizmi për dënimin me burg është i shprehur në politikën kriminale të shteteve Evropiane. Këshilli i Evropës është bashkangjitur kah kjo tendencë me rekomandim<sup>3</sup> për rregullat Evropiane për sanksionet alternative dhe masat e zbatuara në bashkësi<sup>4</sup> e miratuar më vitin 1992 nga ana e komitetit Ministror.

Me Rregullat përcaktohen parimet themelore, korniza juridike e sanksioneve juridike, garancitë gjyqësore dhe procedura pas ankesës, sigurimi i të drejtave themelore, bashkëpunimi dhe pëlqimi i kryerësit, standardet për personelin që duhet të aplikohen, burimet financiare, roli i publikut, kushtet për aplikim, metodat e punës, kryerjen e masave dhe pasojave për shkak të mosrespektimit dhe evoluimi i efekteve. Nën community sanctions and measures nënkuptohet masa dhe sanksione që do të thonë mbetja e kryerësit në shoqëri dhe zbatimi i disa restriksioneve të lirisë së tij me imponimin e kushteve dhe detyrimeve të aplikuara nga organe të caktuar me ligj, por mund të bëhet fjalë për sanksione të caktuara nga gjyqi, ose për masa tjera të shqiptuara para ose në vend të vendimit për sanksion, si dhe për vuajtjen e dënimit me burg jashtë institucionit të burgut, edhe pse sanksionet e pasurisë nuk hyjnë në këtë definim, rregullat kanë të bëjnë edhe me aktet e mbikëqyrjes të ndërmarra për sigurimin e zbatimit të tyre.

Me ndryshimet në sistemin penal në dekadat e fundit padyshim ka filluar transformim i madh i dënimit, që do të thotë deinstitutionalizim, largim nga sistemi i burgut dhe zbatim i formave tjera të kontrollit social mbi kriminelët. Më shumë si vërejtje serioze se sa si kundërshtim të ndryshimeve të tilla meriton kujdes edhe teza e disa autorëve për dispersion të disiplinës, sipas së cilës shoqëria bashkëkohore ngadalë shndërrohet në sistem degëzimi të kontrollit social që e bëjnë institucione të ndryshme, i inspiruar me projektin bazik të disiplinës të shoqërisë moderne. Ndryshimet në sistemin penal (transformimi i dytë pas

dominimit të burgut) tregojnë se aparati i kontrollit social zgjerohet jashtë institucionit me synim që të përfshijë shtresa më të gjëra të cilët nuk kanë qenë në rrezik të jenë të dënuar. Rezultati në fund është mbetet i pandryshuar, zbatimi i burgut, por njëkohësisht rritet numri i të dënuarve. Gjatë kësaj, ndryshimi konstant i ekspansionit të burgut arsyetohet me rritjen e formave më të rënda të kriminalitetit, ndërsa zbatimi i masave alternative me nevojën e trajtimit më të butë të kriminelit të thjeshtë, gjegjësisht kryesve që nuk janë të rrezikshëm. Theksohet se nga ana tjetër paraqitja e masave alternative ndihmon në ngritjen e ashpërsisë dhe ngurtësinë e burgut, sepse në të mbeten të selektuar kriminel të cilët nuk meritojnë trajtim joburgu, ndërsa te masat alternative rreptësohet elementi punitiv, gjegjësisht disiplinor. Kundërshtimi i fundit ka të bëjë me jokonzentimet e masave alternative me parimet e ligjshmërisë, përcaktimin e dënimit, dhe barazimin gjatë dënimit, për çka edhe zbatimi i tyre mbështetet në vlerësimin e matur me vështirësi shkencore për rrezikun e kryerësit dhe mundësitë e risocializimit të tij. Prej këtu pranimi i këtyre masave duhet të jetë i ndjekur edhe me forcimin e garancive juridike për të drejtat e të dënuarit, sepse ata janë megjithatë punitive dhe pa kriteret e sigurta për zbatimin e tyre që mund të rezultojnë me arbitraritet dhe cenim i të drejtave të njeriut. Dhe në fund mund të ndodh që të ndara nga ta të jenë më shumë represive se sa dënimi me burg, si për shembull në rastin kur një dënim afatshkurtër me burgim do të zëvendësohej me trajtim afatgjatë disa vjetësh nën mbikëqyrje në liri. Dhe derisa bëhen diskutime të tilla akademike në legjislacionet penale masat alternative fitojnë kuptim gjithnjë më të madh, dhe prioritet mbetet pyetja jo për ose kundër, por si të organizohet zbatimi i tyre, posaçërisht me faktin se ajo paraqet pëlqim të vet autorit që të merr pjesë në procedurën e risocializimit. Zbatimi më i gjerë i këtyre sanksioneve duhet t'i tejkalojë edhe disa probleme praktike. I pari është imponuar me nevojën e përcaktimit të kriterëve precize për zgjidhje të masave alternative! Duke pasur parasysh se gjyqi zakonisht nuk ka shumë kohë të hulumtoj (eventualisht me ndihmën e ekspertëve), cili sanksion do të ishte më adekuat, më shpesh vendos për më të kapshmen dhe më të shpejtën që mund të sjell deri te reduktimi i llojit të vet, gjegjësisht shmangie të sanksioneve që përbëhen në trajtimin intensiv në liri! Problemi i dytë ka të bëjë me besimin dhe bashkëpunimin e gjyqit me shërbimet që duhet ta organizojnë realizimin e sanksionit. Por edhe në rrafshin e legjislaturës dhe më shumë në praktikën gjyqësore duhet të zhvillohen kriteret, sipas të cilëve këto sanksione do të jenë

alternativa të burgut, dhe nuk do të zbatohen si alternativa të ndërsjella (zëvendësim) të alternativave.

## 1. MBI MASAT ALTERNATIVE

Definicioni i nocionit të masave alternative në rrethin juridik evropian është shumë i gjerë dhe përfshinë sanksione të ndryshme dhe procedura që mund të zbatohen në cilëndo fazë të procedurës: alternativat e procedurës penale, alternativat e gjykimit, alternativat e burgut. Disa autor flasin për alternativa joburgosëse në vend të sanksioneve alternative, sepse nocioni i fundit e implikon qëndrimin se dënimi me burg është rregull, ndërsa të gjithë masat tjera janë sekondare, por më pas pranohet se në shumë legjislatura ky është rasti me vepra më serioze! Përveç kësaj, konfuzioni rreth këtij nocioni e rrit faktin se në disa legjislacione disa nga këta sanksione (me rregull dënimi me të holla) janë përfshirë në repertorin e dënimeve në të cilat gjendet dënimi me burg. Prej këtu, nuk ekziston as edhe një qasje kah ajo se, cilat masa preventive, dënim ose kontroll jashtë burgut mund të llogariten si alternativ e saj. Sipas disa autorëve, të tilla janë ato dënime që i mundësojnë kryerësit që një pjesë ose gjithë dënimin ta vuan në bashkësi, jashtë institucioneve të burgut. Konfuzionin e nxit vet nocioni alternativ-sanksion që vjen në vend të ndonjë dënimi. Supozohet d.m.th. zbatimi i burgut por megjithatë në kushte të caktuara, burgut mund t'i gjendet zëvendësim me ndonjë masë tjetër. Nocioni i këtillë përmban një defekt logjik sepse nisët nga supozimi i gabuar – se për atë vepër kryerësit konkret duhet t'i shqiptohet dënim me burg. Sipas kësaj, kur me këtë nocion vihen edhe sanksionet që çojnë kah reduktimi i burgut duhet të kemi parasysh se ajo është vetëm dispozitë parimore sepse mes masave alternative gjenden edhe të tilla që nuk janë zëvendësim për burgun, por kanë natyrë vetjake dhe kapacitet të plotë në sferën e veprave më të lehta të kryera nga shkelësit për herë të parë dhe ta realizojnë qëllimin themelor të sistemit të sanksioneve – mbrojtjen e të mirave materiale dhe pengimin e kryerjes së veprave penale.

Dënim më i vjetër dhe më i zbatuar jo i burgut është dënimi me të holla. Zbatimi i tij është i limituar sepse varet nga gjendja pasurore e kryerësit. Në vijim është kompensimi dhe riparimi i pasojave të dëmshme të veprës e cila bëhet gjithnjë e më shumë pjesëmarrëse në legjislaturën bashkëkohore, por e ka të njëjtën mungesë si edhe dënimi me të holla-varet prej gjendjes pasurore të kryerësit. Shumë legjislatura sot kthehen përsëri kah konfiskimi i pasurisë si sanksion i vetëm, trend që u forcua më shumë pas miratimit të disa konventave

ndërkombëtare për ndërprerjen e pastrimit të parave. Si dënim sekondar është paraparë edhe marrja e disa të drejtave, ose leje (leje e vozitjes, licenca), të cilat posaçërisht në kombinim me dënimin me të holla ose si përforcim i dënimit me kusht paraqesin instrument të mirë për ikje prej dënimit me burg.

Shkallë e dytë e sanksioneve janë sanksionet në bashkësi. Udhëheqës në reformat legjislativë në planin e masave të tilla është legjislatura angleze, e cila (pas reformave të vitit 1991) njih gjatë masa: probacion, burg shtëpiak, punë në dobi të përgjithshme (punë në dobi të bashkësisë), urdhëresa të kombinuara, qendrat mbledhëse dhe mbikëqyrje e rëndomtë. Ideja themelore e këtyre masave përbëhet në trajtimin në liri, përmbajtjen e të cilit në rast konkret e cakton gjyqi. Disa nga ta (puna mbarëshoqërore) janë të pranueshme në shumë legjislatura, përkundër kundërshtimeve se paraqesin kufizim të tepërt të të drejtave individuale dhe për këtë janë jodemokratike, posaçërisht nuk është e përjashtuar zbatimi i tyre ndaj kryesve për të cilët do të ishte më adekuate ndonjë sanksion tjetër jo i burgu.

Në shkallë e tretë bëjnë pjesë modalitetet e ndryshme të burgut, me të cilat i largohen tërësisht zbatimit të saj, ose zbutet regjimi i burgut me kombinimin e burgut me trajtim në liri. Përveç dënimit me kusht me të cilën pezullohet mbajtja e dënimit me kusht që kryerësi në kohën e kontrollimit të mos kryejë veprë të re penale; në këtë rreth hyjnë edhe modalitetet e ndryshme të vuajtjes së dënimit me burg: burg gjysmë ditor, dënime vikendi dhe lirim me kusht, në disa legjislatura e kombinuar me masa mbikëqyrëse.

## **2. QËLLIMI I MASAVE ALTERNATIVE NË KODIN PENAL TË RM-SË**

Alternativë për dënimin në të drejtën tonë penale të mëhershme paraqesin dënimi me burg dhe vërejtja gjyqësore të pozicionuara si sanksione adominante. Me ndryshimet në kodin penal të RM-së të vitit 2004 është vendosur sistem i rumbullakuar i masave alternative i cili përmban: dënim me kusht, dënim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, ndërprerje me kusht të procedurës penale, punë me interes publik, vërejtje gjyqësore dhe burg shtëpiak<sup>10</sup>. Përvojat e mira në zbatimin e sanksioneve të deritanishme dominuese si dhe ata me moszbatimin e dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse-variant e dënimit me kusht e panjohur për praktikën tonë gjyqësore janë shkaku themelor për qasje të kujdesshëm dhe të rezervuar të

ligjvënësit në zgjidhjen e masave alternative! Parashikimi i llojeve të masave alternative duhet të jetë i ndjekur me krijimin e prezumimeve organizative përkatëse për kryerjen e tyre! Si sanksione "në bashkësi", shumica prej tyre nënkuptojnë përgatitjen e bashkësisë (shërbimeve të posaçme) për pjesëmarrje aktive në trajtimin e kryerësit. Për këtë, për zbatimin e punës me interes publik është përcaktuar afat më i gjatë vacatio legis për shkak të ndryshimeve në LPS dhe krijimit të kornizës përkatëse juridike për organizim të realizimit të saj. Kodi Penal përcakton qëllim të veçantë të masave alternative: sipas përgjegjësisë penale ndaj kryerësit të mos zbatohet dënim për vepra të lehta kur ajo nuk është e patjetërsueshme për mbrojtjen penalo-juridike dhe kur mund të pritët se qëllimi i dënimit mund të realizohet me paralajmërim, me kërcënim për dënim, vetëm paralajmërim ose me masa të ndihmës dhe mbikëqyrjes. Qëllimi i këtillë qartë i distancon masat alternative prej dënimeve. Për dallim nga dënimi, i cili është sanksion retributivo-preventiv, masat alternative janë sanksione preventive të cilat elementi retributiv është i nxitur dhe i vendosur në funksion të kërcënimit me dënim që e forcon veprimin special-preventiv të tyre. Me zbatimin e tyre për veprë më të lehtë shmanget zbatimi i dënimit, kur e njëjta nuk është e patjetërsueshme, dhe njëkohësisht arrihet qëllimi i dënimit. Qëllimi i këtillë, mund të arrihet vetëm me sanksione me potencial edukativ, ndonjëherë i përmbajtur edhe me trajtim plotësues të lirisë që nënkupton involvimin e vet kryerësit në risocializimin e tij, dhe kjo çon në vlerësimin për personalitetin si prezumim kyç për shqiptimin e tyre.

### 3. SHËRBIMI I PROVËS

1. Sherbimi i Proves mbikeqyr dhe mbeshtet zbatimin e denimeve alternative me qëllim mbrojtjen e interesave publike dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale, asistimin e personit të denuar gjatë kryerjes së dënimit alternativ nepermbushjen e detyrimeve dhe kushteve që rrjedhin nga ky dënim, si dhe në kapercimin e vështiresive për riintegrimin e tij shoqëror.

2. Sherbimi i Proves bashkepunon dhe paraqet informacion dhe raporte para prokurorisë dhe gjykatës sipas parashikimeve ligjore.

3. Sherbimi i Proves përcakton metodat e zbatimit të dënimit alternativ në përputhje me parashikimet ligjore. Kur është e nevojshme, Sherbimi i Proves bashkepunon me



institucione shtetërore, qendrore apo lokale, me komunitetin lokal, si dhe me institucione të tjera dhe organizata jofitimprurese për zbatimin e denimeve alternative”.

RM është vendi i vetëm në rajon i cili nuk përfshin në legjislacionin e vetë Shërbimin e provës. Ekziston projekt nga Ministria e Drejtësisë – Zyra për zbatimin e sanksioneve penale, për inkuadrimitin e Shërbimit të provës në legjislacionin e cila parashikon të hyjë në zbatim në fund të këtij viti.

Një ndër kushtet bazë për zbatimin e sanksioneve është ekzistenca e institucioneve përkatëse, përkatësisht stafit të institucioneve. Drejtoria për zbatimin e sanksioneve penale në projektin për zhvillimin e Shërbimit të provës 2013 – 2016 parashikon hapjen e 12 zyrave të reja në qytetet kryesore të Maqedonisë dhe rritjen e numrit të të punësuarve për 90 deri në fund të projektit tre vjeçar.

Zgjerimi i projektit për zhvillimin e Shërbimit të provës detyrimisht rrit nevojën për mjete financiare. Sipas Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve deri në vitin 2016 do të sigurohen 47 milionë denarë për pagat e të punësuarve dhe mjete bazë për punën e tyre.

Mes ndryshimeve ligjore të cilat paraqiten si nevojë për vënien në funksion të shërbimit të provës është edhe Ligji për Shërbimin e provës. Ky ligj ishte planifikuar të zbatohet në nëntor 2016, ndërsa deri në këto momente nuk është vënë në zbatim. Qëllimi është që të krijohet një kuadër dhe një sistem efektiv të sanksioneve dhe masave mbrojtëse që do të pranohet nga komuniteti për të siguruar përfitime afatshkurtra dhe afatgjata për shoqërinë që do të jetë në përputhje me normën e krimit dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në forcimin e sigurisë në shoqëri.

Parimi bazë i këtij ligji është ndërtimi i një koncepti të ri dhe një qasje realiste ndaj politikës penale, që është baza e luftës kundër krimit, kontribuese në zhvillimin e kriterëve të verifikueshme për përcaktimin e sanksioneve individuale mbi të burgosurit që nisen nga natyra e deliktit si bazë për aplikimin e sanksioneve, lloji dhe forma e përgjegjësisë penale, personaliteti i dënuari dhe nevojat / interesat e komunitetit. Këto kriterë të përgjithshme dhe globale të ndërlydhura duhet të sigurojnë realizimin e politikës penale efektive dhe të qëllimshme.

Shërbimi i provës duhet të kontribuojë për të reduktuar represionin kundër kryerësve të veprave penale përmes aplikimit të dënimeve shtrënguese, duke e lënë të burgosurin në liri, duke transferuar një pjesë të përgjegjësisë shoqërisë dhe institucioneve të saj, shërbimeve dhe

institucioneve të probacionit, agjencive dhe shërbimeve sociale, rritjen e pjesëmarrjes së publikut dhe rritjen e përgjegjësisë personale të personit të dënuar për sjelljen e tij ndaj shoqërisë dhe qytetarëve të tjerë.

## **KONKLuzion**

Efektet pozitive që sjell zbatimi i masave alternative janë të shumta dhe të sferave të ndryshme, nga aspekti objektiv ato shmangin harxhime të mjeteve financiare nga arka e shtetit, paraqesin mbrojtje për të mirat shoqërore, paraqesin mundësi për zhdëmtimin e dëmit dhe luajnë rol të rëndësishëm si parandalues gjeneral. Shikuar nga aspekti subjektiv kanë efekt në ruajtjen e kryerësit nga përfshirja në ambientet kriminale dhe ndikimit negativ që mund të ketë burgu në psiqikën e personit, shmangia nga përvetësimi i veseve negative që mund të merren në burg, vazhdimi i aktiviteteve jetësore, mos shkëputja nga rrethi shoqëror etj.

Me gjithë përparësitë që sjell implementimi i masave alternative, përsëri në Republikën e Maqedonisë ka barriera të shumta për zbatimin e plotë të tyre. Mangësia parësore qëndron në mungesën e kornizës jo të plotë ligjore për zbatimin e masave alternative, në të cilën nuk janë 74 qartësuar kompetencat dhe udhëzimet mbi zbatimin e tyre. Kjo paraqet pikën kyçe të zbatimit dhe njëkohësisht pikën në të cilën në realitet stagnon procesi i zbatimit të masave alternative. Nga kjo del nevoja për plotësimin e legjislacionit i cili do të qartësonte kompetencat dhe udhëzimet për zbatimin e alternativave të burgimit.

Për ndryshim nga shtetet fqinje në RM nuk ekziston një strukturë e organizuar përkatëse e cila do të merrej me zbatimin e masave alternative. Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim është bërë në vitin 2013 me nisjen e projektit për zhvillimin e Shërbimit të provës i cili paraqet organin me anë të së cilit do të mundësohet zbatim i plotë i këtyre llojeve të sanksioneve penale.

Rekomandim parësor në këtë punim radhitet ngritja e një sistemi të veçantë organesh dhe ndryshimesh ligjore përkatëse për zbatimin e masave alternative. Shërbimi i provës do të ishte një zgjidhje adekuate për këtë problematikë.

Niveli i profesionalizmit paraqitet i ulët tek organet aktuale përkatëse për zbatimin e sanksioneve alternative si rezultat i informimit të dobët dhe mos ballafaqimit me zbatimin e këtyre masave në praktikë. Përgatitja profesionale e individëve që do të zbatojnë këto masa duhet të jetë maksimale për të kryer me efikasitet implementimin dhe arritjen e beneficioneve

që sjell në shoqëri zbatimin e masave alternative. Një ndër përfitimet që synohet të arrihet vitin e parë të fillimit të praktikimit të Shërbimit të provës është zvogëlimi për 10% - 20% i numrit të të burgosurve.

## **Referenca:**

### **I Tekste universitare, Publikime, Strategji, Plane dhe Raporte**

1. Arnaudovski, Dr. Lupço; Buzharovska, Dr. Gordana; Celevski, Dragi; Nanev, M-sc. Lazar;, Strategjia për implementimin e masave alternative, Shkup, 2004
2. Buzharovska, Dr. Gordana, Alternativat e burgimit, Shkup, 2003
3. Halili, Dr. Ragip, Penologjia – shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, Prishtinë, 2002
4. Herring, Jonathan, E drejta penale – Teori, kazuse dhe materiale, Tiranë, 2013
5. Kambovski, Dr. Vllado, E drejta penale – Pjesa e përgjithshme, Shkup, 2010
6. Kovaçiq, Marina, Vlerësimi i gjendjes së masave alternative në Republikën e Maqedonisë, Shkup, 2007
7. Leka, Adrian, Alternativat e dënimit në Shqipëri, vështrim krahasues me Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Kosovës, Tiranë, 2015
8. Nanev, Dr. Lazar, Uslovna osuda so zastiten nadzor, 2009
9. Osmani, Dr. Afrim, Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, Shkup, 2013
10. Osmani, Dr. Afrim, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë – Tekst integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Shkup, 2015
11. Separovic, Dr. Zvonimir, Alternativat e dënimit me burgim, Sarajevë, 1988

### **II Burime juridike kombëtare**

1. Kodi Penal i Maqedonisë me ndryshimet e vitit, 1999, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, 2008, 2009, 2011, 2012, 2013, 2014

2. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, e ndryshuar me amandamentet e vitit 1992, 1998, 2001 dhe 2005
3. Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale
4. Ligji për mbrojtje sociale
5. Ligji për procedurë penale
6. Ligji për të drejtat e të miturve

# EDUCATION

**THE CHALLENGE OF ADAPTING TEACHING TO NEW GENERATIONS IN  
MACEDONIA**

**Lindita SKENDERI**

University of Tetovo

[lindita.skenderi@unite.edu.mk](mailto:lindita.skenderi@unite.edu.mk)

**Abstract**

New generations of learners come to the learning environments with their requirements regarding teaching methods. One of the reasons for these changes is learners' dependency on technology. It is also the impact of having access to a lot of information online at any time and any place. This has brought teachers in front of new challenges in doing their job. The paper aims to give a broader picture of the requirements of new teaching methods by the new generations of students in Macedonia. Its general purpose is to show what kind of expectations students have when it comes to the way how knowledge is delivered to them. The answers of the research questions expected are found in the results of the questionnaires. The last ones have been given to 50 college students of higher education in Macedonia. The questionnaire consisted of 10 questions has been conducted online. The outcomes of students' opinions help us see what their standings are on this matter. Even though it cannot give the opinions of the majority of the students in Macedonia, it still helps in giving a helpful start regarding this issue.

**Keywords:** *Methods, requirements, students, teaching.*

## **INTRODUCTION**

The educational system is going through constant changes and undoubtedly there should be included the change in the teaching methodology. The teachers are witnessing the presence of new types of learners who have different learning styles and expectations because of few external factors. The recent years have made technology an important and needed part of the learning environments. This may lead to the need of changing the approaches and methods in the classroom in order the learners to accept it. Through changing the methodology the role of the teacher will be changed too. This paper only gives a general overview of students' perceptions on whether they should be taught differently or the styles used in teaching are helpful in life-long learning. There are no details provided on which things should be changed but rather overall opinions are given which give us a hand in researching more in this field. It could be helpful to further studies regarding the need of changes in the classroom, in order to build more successful learning environments that will produce life-long learners.

### **Literature review**

Teaching methodology includes different methods, techniques and styles which have been used through decades in the classroom. Needless to be mentioned, every teacher is surely prepared to use the already known techniques in the classroom. Through experience, teachers choose their most effective methods which show better results. The main goal of the teachers indeed is to achieve teaching effectiveness with the new generations. According to Schaeffer, et al., the top ranked factors in achieving teaching effectiveness are being caring and open minded, creative, encouragement, flexible and having good public speaking skills. However, the needs of the students as receivers of the knowledge have changed through years. When new generations of learners are mentioned, the idea is about the generation of "millenials" which was introduced by Strauss and Howe (2000) in "The Next Great Generation". They talk about this generation which rises very differently from their predecessors and has different expectations when it comes to education. Related to this, Keeling (2003) says about the millenials that "These students will leave their mark on higher education and academic advising" (30). According to her, their effect will be positive but the teachers will need to be more innovative and prepared for changes. Few years ago, in 2007 Monaco and Martin (42)

wrote that the learners of the new generations "... are determined, driven achievers who depend on technology and their support system". According to them, the methods that were helpful ten years ago are not the ones which could lead to achieving effective learning today. Furthermore, the study talks about the millennials and describes them as a generation which has unrealistic expectations. Besides that, they state that this generation spends less time on tasks but expects to achieve success with little effort. However, this is far truer today, in 2017, when we are surrounded by a generation that is highly dependent on technology. When learners have different expectations regarding their classroom and the way how knowledge is transmitted to them, they might struggle to accept other methods which do not include technology. Kraus and Sears (2008) state that: "Text and instant messaging, cell phones, beepers, blogs and social networking are a normal part of their everyday life and allow connection anytime and anywhere". In addition to technology, social media and networking are also a part of everyday life of young people. This is because, as of 2015, around 40% of the world population is connected to the Internet (Internet News Stats, 2015). The teaching profession is working continuously to find better and more effective ways of delivering the knowledge to the students and learners.

Nowadays, the presence of technology in the everyday life of young people affects everything they acquire, including knowledge. That causes the interest and need of the students to be part of classrooms where technology is used. Some scholars believe that social networking is an important tool of making learning more attractive to learners. It is believed that there should be changes in the learning styles and strategies, but there is still so much work to do in order to achieve what is expected. The focus of the teachers according to Kember and Grow (1994), should stop falling only on knowledge transmission via lecture. Instead of it, they suggest that teachers should pay attention to students' interaction with knowledge. Moreover, teachers need to motivate students to focus on problem solving. These kind of approaches would mean attractive changes in the learning environment. Maybe we need new techniques, or maybe "*we are in need of knowing how to apply what we already know*" (Dorestani, 2005).



## Methods

The questionnaire included ten simple and clear questions. It was sent online to the students and the answers were collected in three days.

## Participants

The participants are students attending studies at universities in Republic of Macedonia. The vast majority of them are students of University of Tetovo, followed by students of South East European University, Cyril and Methodius, University American College Skopje and International Balkan University. Their age varies from eighteen to twenty one years old.

## Procedure

They were chosen randomly through a snow ball technique, via a Facebook group which is used for communication with students.

## Results

The answers given by students are believed to be honest because of the anonymous nature of the questionnaire. It cannot be said that the results will solve the issue presented in this paper, but of course it gives an initial picture of where the opinions of the students stand.

Most of the students who participated are students of UT (45 %), followed by SEEU students (31%), Cyril and Methodius (14 %), UACS (8%) and only 2 % students of other Universities.

In the initial question “*Can you make the difference between new methods and old methods of teaching*” 90 % of them said they can while 10 %, meaning only 5 of the participants said they can't make the difference between old and new methods of teaching.

In the question “*Is the overall way of teaching effective for you*” 80 % of the participants chose yes for an answer contrary to a much lower number of only 20 % of them who said they don't find effective the overall way of teaching.

Another question of the survey was “*What kind of methods do your professors use while lecturing?*”, where most of the students, 48 % of them chose old and traditional methods as an

answer, followed by 40 % who think the methods used in their classroom are new methods, while 10 % said their teachers use both old and new methods.

One of the questions in the survey was whether elder teachers try to use new teaching methods and 70 % of them said yes and 30 % chose no for an answer. The following question was whether new generations (where the participants also belong) need new teaching methods and 94 % of them think they do, while only 6 % of them said no.

When it comes to the role of technology in the classroom, 60 % of the students said that they find technology helpful in learning better, 30 % said no and 10 % chose maybe as an answer.

When it comes to effective teaching teachers tend to offer life-long teaching which means students will remember what they have been taught. In the question “*Do you remember the material that you have learned last semester*”, 48% of them chose yes as an answer contrary to 32 % who chose no, and 20 % who are not sure of the answer and chose maybe.

Last, but not least, they were asked whether they have ever thought of any method that would help them learn better and 62 % said yes, 34 % chose no as an answer.

## **Discussions**

The ten questions of the survey are related to each other and below there are some brief analyses related to the correlation values between some of the answers provided by the students.

Initially, the paper introduced the idea that the new generations are somehow specially dependant on technology, and according to different studies in the world, they expect to have technology included in the classroom. This is also true for students in Macedonia, since 60% of the students who participated in the survey said they find technology helpful in the classroom.

For example, if we analyze the third question, “*Is the overall teaching process effective for you*” and question number 9, “*Do you remember the material that you have you learned last semester*”, the correlation values appears to be 1, which shows that these two are

positively correlated. It would be acceptable to say that students are satisfied with the effectiveness of the process which is also proved by the fact that the materials that have been presented to them are still remembered by them.

Similarly, the same question about the effectiveness of the overall teaching process and the question “*Do you think new methods will help you learn better*” appear to have a correlation value of 0.84.

There is also a high positive correlation value of 0.92 between the question “*Do you think new methods will help you learn better?*” and “*Does technology in the classroom help you learn better?*”, which would mean that the more technology involvement and new methods use the better for them.

Students are aware of their dependency on technology and their need to use it everywhere including the classroom, however they are still in need of finding what kind of methods they really prefer to be taught through. These young people, part of a generation in transition most probably has difficulties in getting to know their own preferred styles and techniques. Maybe they want new methods and different learning approaches as part of their teaching, but maybe they also find it successful the way how traditional methods work. Since all of the changes are happening so quick, maybe they will need some time to express themselves and see what in fact helps them in getting effective learning. These answers in the survey just show that the students who participated in the survey are eager to be introduced new methods of teaching. However, it is a long road ahead to be taken by teachers and learners together. That road will help finding ways which would not be destructive of the educational system but would build successful learners in the future. Those students who would grow up to be prepared for their careers and challenges in the job they choose to work after having received qualitative and effective education.

## **CONCLUSION**

There is no doubt that being a teacher in this digitalized and technology oriented era is very challenging. This does not mean it is hard or impossible mission but it requires a lot of work in order to adapt to the needs of the new generations of learners. This paper doesn't find a solution for this kind of challenge but it brings out students opinions on the issue of

implementing and creating new methods of teaching in the classroom. According to their answers, they do believe that they need new methods of teaching and learning. However, because of few time limitations and type of research we can't exactly say which the new styles that would fulfill their needs of acquiring knowledge are. The answers show that students believe that they need new methods to learn better, but on the other hand are satisfied with the effectiveness of the teaching process. They also say that involving technology in the classroom is helpful. Maybe all these mixed answers are a result of the misconceptions of students related to new and old traditional methods of teaching. They may not necessarily know what and how exactly these methods are divided. Nevertheless, maybe we as teachers have the possibility to combine traditional methods with some new learning styles and strategies, in order to remove the boredom of the classroom environment and offer stable but attractive teaching. There is still room for using the all time methods for achieving stability and effective learning, and sometimes include technology and modern styles.

### References:

1. Monaco, Michele, and Malissa Martin. "The Millennial Student: A New Generation of Learners." *Athletic Training Education Journal* 2 (2007): 42-46. Web. 27 Feb. 2017.
2. Dorestani, A. (2005). Is interactive learning superior to traditional lecturing in economics courses? *Humanomics*, 21, 1–20.
3. Strauss, William , and Nail Howe. "Millenials rising: The next great generation." *Vintage Books* (2000): n. pag. Web.
4. Kraus, S. & Sears, S. (2008). Teaching for the Millennial Generation: Student and Teacher Perceptions of Community Building and Individual Pedagogical Techniques. *The Journal of Effective Teaching*, 8(2), 32-39
5. "Number of Mobile Monthly Active FB Users Worldwide from 1st Quarter 2009 to 2nd Quarter 2015 (in Millions).”*Statista*. 2015. Web.

6. Kember, D. & Grow, L. (1994). Orientations to teaching and their effect on the quality of student learning. *Journal of Higher Education*, 65, 58-74.
7. Schaeffer, G., Epting, K., Zinn, T., & Buskit, W. (2003). Student and faculty perceptions of effective teaching: A successful replication. *Teaching of Psychology*, 30(2), 133-136.
8. Keeling, Sarah. "Advising the Millennial Generation." *NACADA Journal* 23.1-2 (2003): 30-36. Web. 01 Mar. 2017.

**TEACHING ENGLISH THOROUGH AUTHENTIC MATERIALS****Msc. Eriona ÇELA**

AleksanderXhuvani University, Elbasan Albania

eriona.cela@gmail.com

**Msc. Algerta PLAKAXHIU**

Elbasan, Albania

plakaxhiu.algerta@yahoo.com

**Abstract**

The aim of learning a foreign language means to be able to use the respective language similarly to the way in which a native speaker uses his language, which is why I believe that exposing the students to authentic materials throughout the teaching process is crucial. The use of authentic materials in an EFL classroom is what many teachers involved in foreign language teaching have been discussing in years. I was really interested in the new teaching methods and therefore I decided to look carefully into this way of teaching. In this paper, I am going to explore where these authentic materials started to get used and some other important components that should be involved in teaching language which are somehow connected with authenticity. I am also going to describe my teaching experience in using these authentic materials and come up with some useful results for every professor.

**Keywords:** *Foreign language, methods, teaching, authenticity.*

## INTRODUCTION

In the last decades English language has considerably gained on importance in Albania. Whether as a university student in need of relevant, up-to date resources, or as a job applicant interested in basically any position in any average, good communicative English knowledge has become a basic prerequisite and a necessity as well. Of course, such a development also had to be mirrored in the practice of teaching English language in schools, and in the curricular documents that define it. New methods and approaches have come up, new theories and philosophies have been developed, all focused on how best to accommodate this current urgent requirement of nowadays society – mastery of communicative English skills.

Among other trends, the use of authentic language and so-called authentic materials in ELT has been discussed and paid attention in greater detail in recent years. As English teachers it is always in interest to use alternative and untraditional ways of teaching, since they have not been used for long time in current educational systems at primary and secondary schools. Therefore, in this paper is looked closely at one of the alternative ways, use of authentic materials. Based on the conclusions of this material, they are considered to be underestimated. If they were used more, English teaching would be not only more effective, but also more interesting. Since that time, I am trying to get proficient in using at least some of the methods in my teaching process.

The method used in this research is qualitative and quantitative as well. There were observed two classes of age 10-12 years old, two classes 15- 17 years old and students. Each authentic material provides a different result and each method is interpreted and welcomed differently by different target groups. Teachers were part of the study by asking them how easy is it to use these materials in school. Is there any necessity of a special environment? What kind of equipment is needed? Does it take to much time to imply these methods in the teaching and learning process?

## AUTHENTICITY

Authenticity has been viewed diversely by different scholars. According to Rost authenticity is one of the terms which researchers talk about questionably<sup>1</sup>. Kilickaya states that authenticity has been put under deep discussion by many researchers<sup>2</sup>. As a result, they came up with different definitions for this problematic term. Defining 'authenticity' is a vital element for both materials designers and language teachers, who are willing to employ authenticity in language teaching in EFL classrooms. There were a number of studies engaged with studying authenticity and the use of authentic materials in EFL classes. For many researchers, authenticity is very significant, because it prepares learners for the real world situations in terms of using the target language. On the other hand, using less authentic materials with our learners, may lead to less practice in the real world. According to Hedge the notion of authenticity, came to the surface in association with communicative approach in language teaching in the 1970-s<sup>3</sup>. Defining authenticity is not an easy matter. Therefore, there are various differences among writers, regarding the definition of this term.

Mishan states that there are three approaches which are regarded as the basis for the term authenticity in language teaching<sup>4</sup>. These are communicative, materials-focused and humanistic approaches.

-*Communicative approach*: in this approach, the focus is on communication from both sides - the learning process and the teaching methods.

-*Materials-focused approach*: the learning in this approach is text-centered.

-*Humanistic approach*: this approach emphasizes the unity of learners' feelings and the learning process.

---

<sup>1</sup> Rost, M. (2002). Teaching and researching listening. London: Longman.

<sup>2</sup> Kilickaya, F. (2004). Authentic materials and culture content in EFL classrooms. The Internet ELT Journal, 10(7).

<sup>3</sup> Hedge, T. (2000). Teaching and Learning in the Language Classroom. Oxford: Oxford University Press.

<sup>4</sup> Mishan, F. (2005). Designing authenticity into language learning materials. Bristol



## TYPES OF AUTHENTICITY

Hulumtime të shumta paraqesin rëndësinë e edukimit parashkollor, si dhe nevojën e parapërgatitjes së fëmijëve për në shkollë, duke e fuqizuar moshën e fëmijëve 5-6 vjeç, si pjesë e SNKA 0, në rastin e Kosovës, e ndërlidhur me SNKA I.

Ky nivel i edukimit është i rregulluar me Ligjin për Edukimin Parashkollor, Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe Ligjin për Arsimin në Komuna, e po ashtu edhe me Planet Strategjike të Arsimit në Kosovë, ku kanë vënë objektivë realizimin e edukimit parafillor, si edukim i obliguar.



Është realizuar një hulumtim, për të identifikuar gjendjen në përgjithësi në edukimin parafillor në Kosovë, dhe nivelin e përfshirjes së fëmijëve të moshës 5-6vjeç, në edukim. Rezultatet janë krahasuar me objektiven që është vënë prioritetet nga niveli qendror.

Sipas gjetjeve, përfshirja e fëmijëve në edukim parafillor në Kosovë, është 80.2%. Vetëm 10% e komunave kanë të përfshirë të gjithë fëmijët në edukim parafillor. Ende ka komuna që në shkollat e tyre nuk kanë klasë parafillore. Jo në të gjitha shkollat, klasat parafillor ofrojnë standarde infrastrukturore të përshtatshme për moshën përkatëse.

Rekomandimet e dala nga hulumtimi janë: mungesa e buxhetit për nivelin lokal për të përmirësuar kushtet për përfshirje më të lartë të fëmijëve 5-6 vjeç në edukim, pamundësia për të rritur numrin e edukatoreve, mungesa e hapësirave, objekteve, etj,

Përfshirja e të gjithë fëmijëve në edukim parafillor, tejkalimi i sfidave të dala nga hulumtimi dhe përkushtimi më i madh i nivelit qendror dhe lokal, janë parakusht, që edukimi parafillor të bëhet i obliguar në Kosovë.

**Fjalët kyçe:** *Fëmijë, edukim, parashkollor, parafillor, edukatore.*

## SHKURTESAT

<b>ARC</b>	Agjencioni për Regjistrim Civil
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale për Arsim
<b>SNKA</b>	Standardi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit
<b>MAShT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë
<b>PSAK</b>	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
<b>QBK</b>	Qendra me bazë në komunitet
<b>UA</b>	Udhëzim administrativ

## PËRKUFIZIMI I TERMAVE

**Edukim parashkollor:** i referohet edukimit të hershëm të fëmijëve i cili organizohet në institucionet parashkollore.

**Edukim parafillor:** i referohet nivelit të edukimit të fëmijëve të moshës 5-6 vjet i cili organizohet në klasat parafillor (përgatitore), në institucionet parashkollore dhe në qendrat me bazë në komunitet.

**Qendra me bazë në Komunitet:** objekt në të cilin organizohet edukimi parashkollor/parafillor, por që financohen nga komuniteti (prindërit, OJQ-të, etj), me qëndrim gjysmë ditor.

**Edukator/Mësimdhënës:** personi i kualifikuar sipas dispozitave të ligjit mbi arsimin parauniversitar me përgatitje akademike dhe profesionale, i punësuar për ofrimin e shërbimeve arsimore për fëmijët/nxënësit.

**Institucione parashkollore:** mund të definojnë objektet apo shtëpitë e konvertuara të cilat janë të ndërtuara në mënyrë speciale për të ofruar programe parashkollore dhe të cilat plotësojnë nevojat edukative dhe ndihmojnë zhvillimin e fëmijëve deri në regjistrimin e tyre në shkollë fillore. Këto institucione ofrojnë shërbime të cilat janë me orar të plotë apo gjysmë orari.

## **HYRJE**

Duke u bazuar në përpjekjet për reformimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë dhe në të gjithë dokumentacionin përmes të cilit realizohet arsimi e reformat e tij, shohim që i është kushtuar shumë kujdes faktit që, vitet e hershme të të nxënës, janë vendimtare për zhvillimin e fëmijës. Nga ky fakt, kushtëzohet rëndësia e zhvillimit të edukimit parashkollor te ne dhe kudo në botë. Kurse nevoja e parapërgatitjes së fëmijëve për shkollë, ka rezultuar me funksionimin e nivelit të veçantë, në kuadër të edukimit parashkollor, pra nivelit të edukimit parafillor, me fëmijët e moshës 5-6 vjeç.

Pastaj, një prej dy objektivave të përgjithshme të PSAK-ut 2011-2016, lidhur me Edukimin Parashkollor ishte që: „Deri në vitin 2016, parashihet që të gjithë fëmijët e moshës 5-6 vjeçare të përfshihen në arsimin parafillor” (fq.58) Kjo, natyrisht që mund të arrihet vetëm nëpërmes sigurimit të hapësirës fizike, krijimit të kushteve, avancimit të Kurrikulës për këtë nivel edukimi, përmes avancimit të materialeve mësimore-mjeteve didaktike dhe lojës,

përmes avancimit të programeve për zhvillimin profesional të edukatoreve, përmes ngritjes së vetëdijes së komunitetit dhe të prindërve për këtë nivel edukimi, nëpërmes fushatave vetëdijësuese, seminareve e trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera dedikuar prindërve dhe edukatoreve, etj. Përgjegjësitë për realizimin e të gjitha këtyre aktiviteteve me të gjitha ligjet në fuqi të cilat rregullojnë këtë nivel edukimi, i takojnë MASHT-it dhe DKA-ve.

Në kuadër të kësaj çështjeje zhvillimore të edukimit parafillor, është imponuar nevoja, që të realizohet ky hulumtim, i cili i paraqet të dhënat reale në shumë aspekte si: në aspektin e sigurimit të resurseve profesionale (edukatoreve), të infrastrukturës fizike, shkollore të përshtatshme për moshën 5-6 vjeç, si dhe sigurimin e buxhetit të nevojshëm, për përfshirjen e tërësishme(100%), të fëmijëve të kësaj moshe, në edukimin parafillor. Këto të dhëna, pastaj mund të merren parasysh nga kompetentët dhe të orientojnë aktivitetet e tyre, aty ku ka nevojë dhe ngecje eventuale, për ta realizuar këtë objektivë.

## 1. QASJA TEORIKE

Edukimi parafillor në kuadër të edukimit parashkollor në Kosovë, ka përfshirje jo të kënaqshme. MASHT është duke i kushtuar më shumë rëndësi këtij niveli të edukimit, për arsye se kjo e mundëson ngritjen e cilësisë së edukimit dhe arsimit, në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë.

Në Kornizën e re të Kurrikulës, edukimi parafillor (mosha 5-6vjet) është pjesë e shkallës së Kurrikulës Bërthamë për nivelin e I -rë, natyrshëm e ndërlidhur me nivelin 0 të SNKA. Kjo do të thotë që fëmijët të shkojnë në klasë të parë me përgatitje paraprake edukative-arsimore dhe kjo përgatitje të ketë koherencë me përmbajtjet programore që do të marrin fëmijët në klasë të parë, e tutje.

Bazuar në Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës 39/L-068, neni 4, pika 4.1 dhe neni 5 pikat a, b, c; komuna i bartë këto përgjegjësi: krijimin e kushteve, ndërtimin e objekteve edukative/shkollore, punësimin e stafit profesional, regjistrimin e fëmijëve/nxënësve, etj, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar nga niveli 0 (parashkollor), 1 (fillor), 2 (të mesëm të ulët) dhe 3 (të mesëm të lartë).

Ndërsa, sipas këtij ligji, në nenin 3 dhe në të gjitha nënpikat e këtij neni, MASHT bartë përgjegjësitë për cilësinë në të gjitha nivelet e arsimit përmes: hartimit të politikave, hartimit të dokumenteve, promovimin e sistemit gjithpërfshirës, promovimin e bashkëpunimit shkollë-familje, etj.

Të gjithë faktorët që ndikojnë në edukimin parafillor janë duke bërë përpjekje që korniza ligjore të zbatohet dhe të arrihen synimet e parapara për ta rritur cilësinë në arsim. Ky hulumtim u mundëson faktorëve relevant, që të kenë rezultate të sakta nga terreni për të zhvilluar proceset e mëtutjeshme të kësaj fushe.

Duke mos e lënë anash rëndësinë e madhe të edukimit të fëmijëve në familje, në moshat më të hershme siq është mosha 0-3 vjeç, rëndësia e edukimit institucional është e pakontestueshme edhe për këtë moshë edhe për moshat më të rritura dhe realizohet përmes profesionistëve të edukimit parashkollor, ku fëmijët zhvillojnë personalitetin e tyre, krijojnë shprehje dhe shkathtësi për jetë dhe për shkollë.

Në këtë moshë fëmijët merren me lloje të ndryshme të aktiviteteve të cilat ndikojnë në personalitetin e tij. „Fëmija aftësohet për punë në kopsht, për vetëshërbim, për veprimtari figurative me letër, plastelinë, baltë, etj”( Deva-Zuna,2003, f.48)

Edukimi në institucionet parashkollore/parafillore, duhet të realizojë motivimin e fëmijëve për të mësuar, të nxitë kuriozitetin për dije. Institucionet parashkollore/parafillor, duhet të realizojnë një nivel të caktuar kërkesash që t'i përgjigjen rritjes së aftësive të fëmijës dhe përmbushjes së nevojave dhe interesave të fëmijëve.

E rëndësishme për fëmijën që do të shkojë në shkollë, është formimi jo vetëm i shprehjeve të sjelljes së kulturuar, por kthimi i tyre në zakone, që këto rregulla të bëhen normë e sjelljes së tyre. Fëmijët parashkollor duhet të përvetësojnë shprehitë e higjienës personale, shprehje në komunikim, shprehitë e punës intelektuale, t'u bëhen zakonet rregullat e para të mardhënjeve me fëmijët, t'u edukohet dashuria për moshatarët, prindërit dhe mësuesit ( Vadahi, 2002, f. 125)

Roli i edukimit parafillor, është i pazëvendësueshëm për zhvillimin e dhe përgatitjen e fëmijëve për klasë të parë, për këtë arsye është i nevojshëm që kjo klasë të bëhet e obliguar.

### 3. ORGANIZIMI I EDUKIMIT PARASHKOLLOR NË KOSOVË

Edukimi Parashkollor në Kosovë organizohet:

- Në institucione parashkollore publike (grup-mosha);
- Në institucione parashkollore private;
- Në qendrat me bazë në komunitet.

Ndërsa edukimi parafillor (mosha e fëmijëve 5-6 vjeç) përveç në institucionet e lartëcekuaara, organizohet edhe në klasa parafillore në kuadër të shkollave fillore.

*Edukimi Parafillor në Kosovë ende nuk është edukim i obliguar.*

### 4. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Identifikimi i prioriteteve dhe sfidave për funksionimin e edukimit parafillor, si edukim i obliguar.

#### 3.1. Pyetjet e hulumtimit

- A janë krijuar kushtet që edukimi parafillor të bëhet i obliguar?
- Cilat janë sfidat që duhet tejkaluar, për përfshirjen e të gjithë fëmijëve të moshës 5-6vjeç në edukim parafillor?

### 4. METODOLOGJIA

#### 4.1 Modeli i hulumtimit

Hulumtimi është vlerësues dhe karakterizohet nga qasja kuantitative.

#### 4.2. Respondentët

Në hulumtim janë përfshirë:

Zyrtarë të drejtorive komunale të arsimit, në 30 komuna, të cilët u janë përgjigjur pozitivisht kërkesave tona për bashkëpunim për marrjen e të dhënave lidhur me hulumtimin.

Udhëheqësit e institucioneve parashkollore private

Për të siguruar të dhënat për fëmijët e moshës 5-6 vjet, në institucionet parashkollore private të licencuara, kemi realizuar hulumtimin në 48 institucione parashkollore private dhe nga këto 15 institucione, nuk kanë fëmijë të moshës 5-6 vjet, kanë vetëm të moshave tjera.

**Udhëheqësi e sektorit për administrim në bazë të të dhënave në Agjencionin e Regjistrimit Civil të Kosovës**

Nga Agjencioni janë marrë të dhënat për numrin e fëmijëve në të gjitha komunat e Kosovës. Por, për hulumtim për ta krahasuar me numrin e fëmijëve të përfshirë në edukimin parafillor, janë marrë vetëm numri i fëmijëve të lindur në ato 30 komuna që kanë qenë të përfshira në hulumtim (duke zbritur numrin e fëmijëve që kanë lindur në komunat që nuk janë përfshirë në hulumtim).

### **4.3 Instrumentet**

Si instrumente për realizimin e hulumtimit u përdorën pyetësorët, të cilët janë përpiluar në mënyrë adekuate, për secilin resor që plotësonte objektivat tona të hulumtimit.

### **4.4 Procedurat e hulumtimit**

Hulumtimi në terren është realizuar në periudhën prill-maj 2016, dhe të dhënat pasqyrojnë përfshirjen e fëmijëve të moshës 5-6 vjeç, për këtë vit kalendarik, si dhe gatishmërinë e komunave për përfshirje më të lartë të fëmijëve në edukimin parafillor në vitin 2016/2017.

Gjatë realizimit të hulumtimit kemi hasur në gatishmërinë e pakursyer të zyrtarëve të drejtorive komunale të arsimit, për të na ofruar të dhënat më të fundit nga shkollat dhe institucionet parashkollore, për numrin e fëmijëve në edukim parafillor dhe për kuadrin profesional që punojnë me fëmijë e kësaj moshe, e po ashtu edhe për të gjitha detajet e kërkuara në pyetësor.

Institucionet parashkollore private i janë përgjigjur pozitivisht bashkëpunimit për realizimin e hulumtimit duke ofruar të dhënat e kërkuara në pyetësor.

Agjencioni për Regjistrim Civil, po ashtu ka ndihmuar në realizimin e këtij hulumtimi duke na ofruar të dhëna për fëmijët e lindur dhe të regjistruar në Kosovë, në vitin 2010. Këto

të dhëna na kanë shërbyer për të siguruar përqindjen e përfshirjes së fëmijëve në edukim parafillor.

## 5. REZULTATET DHE INTERPERTIMI I TYRE

- Numri i grupeve të fëmijëve të përfshirë në edukim parafillor është 1089 grupe.
- Numri i përgjithshëm i fëmijëve të përfshirë në edukimin parafillor është 23698 fëmijë, ndërsa numri i fëmijëve që kanë lindur në vitin 2010 (sipas ARC, në këto 30 komuna që janë të përfshira në hulumtim) është 29538 fëmijë. Krahasimi i këtyre shifrave paraqet numrin e fëmijëve të pa përfshirë në edukim parafillor e që është 5840 fëmijë.
- Paraqitur në përqindje, janë 80.2% të fëmijëve të moshës 5-6vjeç, të përfshirë në edukim parafillor dhe 19.8 % të papërfshirë në edukim parafillor.
- Vetëm 10% e komunave i kanë të përfshirë të gjithë fëmijët në edukim parafillor.
- Nga gjithsej 963 shkolla fillore të mesme të ulëta, 836 shkolla kanë klasë parafillore dhe 127 shkolla nuk kanë klasë parafillore.
- Ka klasa parafillore që nuk ofrojnë standarde të infrastrukturës së përshtatshme për moshën përkatëse.
- Rezultatet tregojnë se 11% e edukatoreve nuk kanë kualifikim përkatës për të punuar me këtë grup-moshë të fëmijëve.
- Lidhur me gatishmërinë e komunave për të përfshirë të gjithë fëmijët në edukimin parafillor, kemi këto rezultate: 3% e komunave kanë në plan të ndërtojnë institucione publike parashkollore, ku do të përfshihen edhe fëmijët parafillor; 57% e komunave do të formojnë klasë të reja në kuadër të shkollave fillore të mesme të ulta; 20% e komunave do të zbatojnë Udhëzimin administrativ 19/2016<sup>1</sup>, 7% e komunave nuk kanë

---

<sup>1</sup> Udhëzimi Administrativ 19/2016 për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë.

Sipas këtij udhëzimi, neni 5, pika 14: Për moshën 5-6vjeç, edukatorët që punojnë në paralelet parafillore në kuadër të shkollave fillore, duhet të punojnë nga 5 orë punë të drejtpërdrejt me fëmijët dhe 1 orë përgatitje për punë edukative, duke përcjellë 2 grupe. Raporti edukatore-fëmijë për këtë grupmoshë është 1:18 maksimumi i lejuar është 20 fëmijë në grup. Njëri grup 2 orë e 30 minuta, grupi tjetër 2 orë e 30 minuta, në total norma 5+1.

buxhet për të zgjeruar hapësira për të përfshirë më shumë fëmijë në parafillor dhe 3% kanë pak fëmijë për të formuar grupe për edukim parafillor.

Kur të arrihet që të përfshihen të gjithë fëmijët, atëherë, kjo tregon se janë krijuar kushtet që të marrin shërbimet edukative të gjithë fëmijët, pavarësisht nga ajo a i marrin ato shërbime në shkollë, a në institucion parashkollor publik, a në institucion parashkollor privat, apo në qendra me bazë në komunitet, vetëm që ky edukim të jetë i qëndrueshëm, cilësor dhe të bëhet i obliguar.

## **5. SFIDAT E PARAQITURA, QË NDIKOJNË NË REALIZIMIN E EDUKIMIT PARAFILLOR TË OBLIGUAR**

- Mungesa e buxhetit për krijimin e vendeve të reja të punës për edukatore.
- Mungesa e hapësirave fizike për klasa parafillore.
- Sigurimi i transportit për përfshirjen e fëmijëve nga zonat e thella rurale në edukim parafillor (aty ku nuk mund të formohen grupe për shkak të numrit të vogël të fëmijëve).
- Angazhimi jo i mjaftueshëm i nivelit lokal (komunave) për të përmirësuar kushtet dhe për të rritur përfshirjen më të lartë të fëmijëve në këtë nivel të edukimit, që është parakusht për Edukimin Parafillor të obliguar.

## **KONKLuzion**

Nga ky hulumtim mund të konkludojmë se:

- Niveli qendror ka hartuar politika arsimore, ligje, dokumente zyrtare e profesionale që mbështesin dhe avancojnë edukimin parashkollor dhe i japin prioritet edukimit parafillor të obliguar.
- Niveli lokal ende nuk është i gatshëm të krijojë kushte dhe mundësi që të gjithë fëmijët të vijnë në edukimin parafillor. Krijimi i këtyre kushteve do të ishte parakusht që edukimi parashkollor të bëhet edukim i obliguar.
- Vetëm 10% e komunave kanë arritur të krijojnë kushte që të përfshijnë të gjithë fëmijët në edukim parafillor. Bazuar në reflektimin nga terreni, komunat ende nuk kanë arritur



këtë dhe sipas planifikimeve që i kanë bërë, nuk do të ndodh shpejtë krijimi i kushteve dhe përfshirja 100% e fëmijëve, për arsye se 37% e komunave, edhe në planifikimin 2016/2017, nuk kanë paraparë që kjo gjendje të ndryshojë.

- Sfidat e paraqitura, nuk janë të patejkalueshme, por mungon planifikimi dhe prioritetizimi në nivelin komunal për të realizuar obligimet që i caktohen në Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës; në dispozitat ligjore të Ligjit për Arsim Parauniversitar (2011); në UA 19/2016, në Ligjin për Edukimin Parashkollor, si dhe në koordinimin me nivelin qendror.
- Këto rezultate tregojnë janë 127 shkolla, që ende nuk kanë klasë parafillore.

Mosrealizimi i edukimit parafillor si i obliguar, ndikon edhe në cilësinë e edukimit në nivelet tjera formale të arsimit, kur fëmijët nuk marrin asnjë shërbim edukativ institucional deri në fillimin e klasës së parë.

### **Rekomandimet**

- Të planifikohet me kohë rritja e buxhetit për të punësuar më shumë edukatore;
- Të krijohen mundësi infrastrukturore për klasë parafillore;
- Të monitorohet realizimi i UA 19/2016, që rregullon orarin e punës së edukatores, e që ndikon në përfshirje më të lartë të fëmijëve 5-6 vjeç në edukim parafillor;
- Të realizohen fushata vetëdijësuese për rëndësinë e edukimit parafillor, në nivelin lokal dhe në komunitet;
- Të fuqizohet edukimi parafillor në nivelin lokal;
- Të sigurohet transport për fëmijët e zonave rurale;
- Të bashkëpunohet me donatorë për të mbështetur këtë nivel të edukimit.

### **Referenca:**

1. Britto, P.R., Ravens, V.J., Ponguta, A.L. (2011). Joined Hands Better Childhood. [[http://www.unicef.org/kosovoprogramme/Joined\\_Hands\\_ENG\\_web.pdf](http://www.unicef.org/kosovoprogramme/Joined_Hands_ENG_web.pdf)];
2. Deva-Zuna, Afërdita (2003) Edukimi i parashkollorit në familje, Prishtinë, f 48;

3. HMO Solution, (2007). Budget and legal analysis of early childhood education in Kosovo. Commissioned by Save the Children Alliance in Kosovo;
4. MASHT, (2006). Kurrikula e edukimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç;
5. MASHT, (2006). Ligji mbi edukimin parashkollor;
6. MASHT, (2006). Standarde të përgjithshme të edukimit dhe arsimit parashkollor në Kosovë 3-6 vjeç;
7. MASHT, (2008). Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës;
8. MASHT, (2016). Draft - Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2017-2021 (PSAK);
9. MASHT, (2011). Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës;
10. MASHT, (2011). Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6vjet;
11. MASHT - IPK, (2013) . Raport mbi përfshirjen e fëmijëve 5-6 vjeç në arsimin parafillor;
12. Udhëzimi Administrativ 19/2016 - Për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë;
13. Vadahi, Fatmir, (2002)Pedagogjia Parashkollore, Shkodër, f 125.

**EDUKIMI ESTETIK DHE LETËRSIA PËR FËMIJË****Zehrie PLAKOLLI**

Hulumtuese në Institutin Pedagogjik të Kosovës

Adresa: Kompleksi i Rilindjes

Tel: 038/213 834 &amp; 044/162 429

Zehrie.Plakolli@rks-gov.net

**Abstrakt**

Çështje esenciale e këtij studimi është, ndikimi i letërsisë në edukimin estetik, me theks të veçantë tek edukimi estetik i nxënësve, përmes letërsisë në shkollë. Në kuadër të kësaj çështjeje, përveç universalitetit të edukimit estetik dhe edukimit estetik të nxënësve përmes letërsisë. Punimi përmban, një shqyrtim të përgjithshëm të historikut të edukimit estetik, i cili është universal dhe paksa është i lindur bashkë me njeriun, por i cili duhet të kultivohet, sepse nuk krijohet vetvetiu.

Në këtë studim, potencohet rëndësia dhe roli i pazëvendësueshëm i edukimit estetik, në formimin e një fëmije-njeriu më të qytetëruar, më humanist, më etik dhe më njerëzor. Si i tillë, edukimi estetik, është një proces mjaft i ndërlikuar i edukimit, që në mënyrë spontane bëhet gjatë jetës, në familje dhe aty ku e ofron rrethi shoqëror, për të vazhduar në mënyrë të planifikuar e të organizuar nëpër institucione arsimore.

Përveç këtyre, studimi reflekton edhe mbi disa nga veçori të letërsisë për fëmijë, e cila nuk është art i pastër letrar, por është edhe pedagogji e ndonjëherë edhe didaktikë. Është e tillë, sepse është e dedikuar për një qenie delikate, të vogël dhe ende të paformuar, që në formim e

sipër e ka personalitetin e tij psiko-fizik, shpirtëror e emocional dhe për këtë, ka nevojë, t'i ofrohen njohuri për jetën e botën, këshilla e moralizime edhe nëpërmjet artit letrar .

Punimi reflekton poashtu edhe lidhur me disa lëshime profesionale, në përpilimin e teksteve shkollore të letërsisë, në për zgjedhjen e lekturës shkollore dhe në mësimdhënien e letërsisë.

**Fjalët kyçe:** *Edukimi, estetika, artistikja, shija, letërsia , shkolla, nxënësi.*

## **HYRJE**

Ky studim, është në funksion të paraqitjes së informacioneve analitike dhe empirike, për rëndësinë e edukimit estetik, në aspekt të përgjithshëm, por me theks të veçantë, për edukimin estetik në shkollë. Punimi reflekton lidhur me faktin (e bazuar në terren), se sa nxënësit tanë kanë kureshtje për të lexuar letërsi, çka i pengon dhe çka i motivon ata për të lexuar, a reflekton leximi në suksesin e përgjithshëm të tyre në shkollë, në kulturë komunikimi, në kulturë shkrimi, në raporte shoqërore e në çdo aspekt, të jetës së përditshme. Arsyeja e përcaktimit për këtë çështje studimi, është fakti se edukimi estetik, si edukim universal, është i nevojshëm në çdo aspekt të jetës njerëzore dhe është një proces i ndërlikuar i edukimit, që në mënyrë spontane, bëhet gjatë jetës në familje, në atë që i ofron rrethi shoqëror, për të vazhduar në mënyrë të planifikuar e të organizuar, nëpër institucione arsimore. Prandaj, pjesë thelbësore e edukimit të përgjithshëm dhe synim i çdo sistemi arsimor, duhet të jetë edhe edukimi estetik, i cili realizohet si komponentë e veçantë e edukimit të përgjithshëm në shkollë dhe i cili, në vete përmban si objektivë, krijimin e idesë, shijes së nxënësit për të bukurën në art, në punë e në jetë, pastaj aftësimin e nxënësit për ta vërejtur, për ta përjetuar, vlerësuar, kultivuar dhe krahas këtyre edhe për ta krijuar ai vet të bukurën. Në kuadër të kësaj çështjeje, në këtë punim, përveç universalitetit të edukimit estetik dhe veçantive të përgjithshme të letërsisë për fëmijë, në mënyrë specifike, janë prekur edhe mësimdhënia e letërsisë, teksti shkollor i letërsisë dhe lektura shkollore.

### **1.ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME TË EDUKIMIT ESTETIK**

Fjala estetikë, nga greqishtja është përkthyer si ndijim, përceptim dhe përjetim i së bukurës. Për dallim nga të njohurit racional (gnoseologjik), estetika është shkencë për të

njohurit sensual, emocional. Kurse Imanuel Kanti, thotë që estetika është kritika për shijen artistike. Estetika është degë e filozofisë, që merret me të bukurën në natyrë, në art dhe me shijen e qenies njerëzore për artin dhe të bukurën. Teoria më specifike e estetikës, ka të bëjë me degë të caktuara të artit dhe ndahet në fusha të ndryshme të estetikës; estetika e muzikës, estetika e pikturës,estetika e arkitekturës, estetika e letërsisë, etj. E bukura e përgjithshme dhe veçanërisht arti me shumëllojshmërinë e tij, gjithnjë e ka preokupuar mendjen njerëzore. Çështja e asaj që është e bukur dhe që nuk është e bukur, (e madhërishmja,tragjikja, komikja, simpatikja, etj. si kategori të estetikës,) dhe relativizmi ose subjektivizimi i vlerësimeve estetike, ishte një çështje filozofike e trajtuar, që nga filozofët e vjetër e tutje. Lidhur me këtë problematikë studimi, kanë reflektuar shumë filozofët, që nga Platoni e Aristoteli, për të vazhduar deri te Kanti,Hegeli, Frojdi, Shileri, Lalo, Uçi, etj., kështu që ne nuk mund të themi diçka të re për rëndësinë e edukimit estetik (në aspektin shkollor as jetësor), por e rikonfirmojmë rëndësinë e pakontestueshme, të edukimit estetik, në kuadër të sistemit edukativo-arsimor.

## **2.UNIVERSALITETI I EDUKIMIT ESTETIK**

*Edukimi i mendjes pa edukimin e zemrës, nuk është edukim -Aristoteli*

Edukimi estetik, është i lindur bashkë me njeriun, por nuk krijohet vetvetiu. Ai duhet të zhvillohet si një nevojë e domosdoshme e jetës, punës dhe shpirtit të njeriut. Ndërsa, e bukura, është një fenomenologji e shpirtit, e cila është brenda natyrës së njeriut, në komunikimin e tij me të tjerët, në punë, në ambientin që e rrethon dhe përgjithësisht në jetë. Përveç fenomeneve artistike-estetike, që i ka krijuar natyra, si: tingujt, aromat, ngjyrat, peizazhet, detin, diellin, agimin, muzgun, edhe artet e krijuara nga njeriu, janë një botë e tërë veprimtarish estetike, në të cilën përfshihen: letërsia, muzika, teatri, arkitektura, piktura, skulptura, filmi, teatri etj. Dhe ndër veprimtaritë kryesore kulturore individuale dhe shoqërore, është arti, i cili i rrit vlerat njerëzore të një shoqërie. Emocionet, ndjenjat që shkakton e bukura, estetikja, janë reflektim i artit, pra janë si një “pasojë” e artit, e cila mund të jetë : ndjenjë e mirë, e keqe, e gëzimit, e ngazëllimit, e dëshpërimit apo e trishtimit, varësisht nga përmbajtja e vlerës estetike. Përjetimi i këtyre ndijimeve, u ndodhë vetëm atyre që e kanë të kultivuar shijen estetike, për të përjetuar të bukurën. Sipas Shilerit,“Çelësi i edukimit në përgjithësi është edukimi për të bukurën” ( Shiler Fridrih, “Mbi edukimin estetik të njeriut”,

Tiranë, 2004, f. 86). Prandaj, edukimi estetik në shkollë, është një objektivë specifike e plan-programeve shkollore, e cila realizohet përmes lëndëve të ndryshme, e veçanërisht përmes letërsisë, e cila është objektivë e këtij studimi. Duke ua zhvilluar nxënësve ndjenjën për të vërejtur e për ta përjetuar të bukurën që është në natyrë, në art e në jetë, edukimi estetik, së bashku me fushat e tjera edukative arsimore, intelektuale e morale, përbën një tërësi unike të edukimit, që ka për qëllim formimin e gjithanshëm të njeriut të ri-nxënësit. Edukimi estetik, përshkon tërësinë e personalitetit të nxënësit dhe reflekton në të gjitha performancat e tij shkollore e jetësore. Ai ndikon në mënyrën e përgjithshme të jetesës, në raportin me të tjerët (në familje e shoqëri), në qëndrimin ndaj të bukurës, kudo që është e shfaqur dhe në zhvillimin intelektual të nxënësit, duke ndikuar në thellimin e njohjes së realitetit, në begatimin e përjetimeve, pra, ndikon në plotësimin e personalitetit të tij. Kështu që edukimi estetik, është i lidhur ngushtë me zhvillimin intelektual të nxënësve, sepse në procesin e edukimit estetik, aktivizohet një numër i madh funksionesh intelektuale, të cilat zhvillohen fuqimisht në këtë proces, ku përsosen aftësitë e të analizuarit, të të vërejturit, të kujtesës, të riprodhimit të imazheve, të fantazisë krijuese, që d.th. krijohen aftësi të të menduarit. “Njohuritë me karakter estetik, janë të pazëvendësueshme me njohuri të natyrave të tjera, si shkencore, filozofike apo sociale. Njohja jonë e jetës, e plotësuar me përjetime estetike, bëhet më e shumëllojshme dhe më e begatshme” ( Grup autorësh, “Pedagogjia”, Zagreb, 1978, f. 195). P.sh. njohja e momenteve historike përmes veprave estetiko-letrare, është shumë më e thellë dhe më e ngulitur, se sa përmes librave ose shkrimeve të historisë, gjeografisë, sociologjisë, filozofisë apo shkencave tjera të njohjes. P.sh., në asnjë shkrim të një natyre tjetër, nuk është e përshkruar thellësisht e detalisht, lufta me Turqinë, sikurse tek shkrimi letrar „Kështjella, e Kadaresë, apo lufta antifashiste e Shqipërisë sikurse tek „Kronikë në gur,.. Asnjë ligjëratë moralizuese, nuk mund ta ngulisë në kokën e fëmijës, rëndësinë e fuqisë dhe të bashkimit, më mirë se sa përralla „Shtatë thuprat, ose fuqinë simbolike-metaforike që ka, për vlerën e punës, përralla „ Dheu është flori,, etj.

Dikur, edukimi estetik, konsiderohej si një edukim, që ka të bëjë, jo me jetën përgjithësisht, por vetëm me fushën e veprimtarisë artistike dhe nuk konsiderohej e nevojshme që të edukohej e tërë shoqëria, me këtë lloj edukimi. Mirëpo, se shija për të bukurën ka ekzistuar gjithnjë, argumentohet me të bukurat e mbijetuara, që nga antika, e ato janë të natyrave të ndryshme: arkitekturë, pikturë, skulpturë, vlera të trashëguara letrare, vlera

artizanale etj. Pra, edhe për shoqëritë e mëhershme, edhe për ato bashkëkohore, edukimi estetik nuk është edukim plotësues, por një domosdoshmëri shoqërore, nevojë themelore e jetës së njeriut, e sipas pedagogjisë bashkëkohore, është premisë themelore e edukimit. Figura shpirtërore dhe morale e njeriut të ri, nuk mund të kuptohet pa formimin e shijes së tij dhe ndjenjës për të bukurën në jetë dhe në punë. Edukimi estetik, ua formon nxënësve ndërgjegjen artistike dhe e fisnikëron shpirtin e tyre. Për të kuptuar vlerën estetike, ose për të pasur shijen për të bukurën, nevojitet të kultivohet në vazhdimësi, një grup aftësish elementare: aftësinë për ta perceptuar të bukurën, aftësinë për ta përjetuar, aftësinë për ta vlerësuar, si dhe aftësinë për ta krijuar atë. Këto, përmbajnë nocionin e kuptimit të idesë për të bukurën. Pa këto njohuri apo aftësi, njeriu në përgjithësi, e në këtë rast nxënësi, nuk ka as sy, as vesh, as emocion, as ide për të bukurën në natyrë, apo në jetë. “Pa edukim estetik, nuk mund të imagjinohet zhvillimi, formimi e vetëformimi i personalitetit të gjithanshëm të fëmijës, e për këtë edhe duhet të trajtohet si pjesë shumë e rëndësishme e sistemit, procesit edukativo-pedagogjik” ( Emërllahu Dali, “Edukata Estetike”, Prishtinë, 2001, f. 14)

Kjo komponentë edukimi, trajton raportin në mes të jetës dhe së bukurës, sepse, sipas Gjon Djuit, njeriu është një homo-estetikus. Sipas tij, çdo njeri është pakëz artist dhe arti është një dimension i lindur i njeriut dhe vazhdimisht njerëzit, gjatë tërë etapave të tyre të zhvillimit, kanë treguar interesim për të bukurën. Në fakt, nuk njohim dhe nuk ka, shoqëri pa arte. Derisa s’ka shoqëri pa arte, do të thotë gjithnjë ka pasur interesim, përjetim dhe krijim të artit. Sipas Kantit, arti ka karakter edhe etik e moral. Kështu që sa më shumë që t’u injektosh njerëzve, e posaçërisht brezit të ri, artistiken, estetiken, që do të thotë t’u ofrosh atyre qytetërim, aq më shumë, bëhen qytetarë të edukuar, më sublimë, më të ndjeshëm e më njerëzor, në çdo aspekt.

### **3.LETËRSIA PËR FËMIJË**

#### **3.1.Letërsia për fëmijë, si art dhe si mesazh**

Ndër artet më të vjetra e më të rëndësishme dhe më me ndikim, në edukimin e përgjithshëm, e në veçanti atë estetik, pa dyshim që është arti i fjalës. Për këtë arsye, letërsia për fëmijë, është njëra ndër artet me ndikimin më të madh tek fëmija. Letërsia për fëmijë, është letërsi që i ofrohet fëmijës (pa u përjashtuar edhe lexuesi i rritur, i cili përkujdeset për

të, siq janë : prindi, mësuesi apo studiuesi) dhe duke qenë se i ofrohet këtij, ajo zhvillohet duke u realizuar në dy aspekte, në atë letrar dhe në atë pedagogjik-edukativ. Për këtë, prindërit dhe shkolla, duhet ta shfrytëzojnë artin letrar, përveç si faktor që shkakton kënaqësi shpirtërore, edhe si mjet shumë të fuqishëm të edukimit. Të shumtën e rasteve, kjo letërsi, përveç pasionit për estetikën, e ka edhe misionin e saj, të natyrave të ndryshme: misionin patriotik, etik, moral, psikologjik e shpesh edhe didaktik. Pra, letërsia për fëmijë e posaçërisht ajo shqipe, nuk ka mundur të shpëtojë nga molepsjet dhe ngarkesat e shumta, të natyrës jashtë-artistike, moralizuese e edukative, e shpesh edhe ideologjike, për të dhënë vetëm kënaqësinë e nevojshme artistike dhe përjetime estetike. Fenomeni i intencës, në letërsinë për fëmijë dhe në atë shqipe në veçanti, në situata e rrethana të caktuara sociale, ndoshta është edhe domosdoshmëri, në mënyrë që ajo të ketë efekt më të gjithanshëm dhe të ndikojë në formimin e përgjithshëm, të tyre.

Arti në shkencën e pedagogjisë, zë një vend me rëndësi, si një mënyrë shumë efektive për edukimin e brezave, në mënyrë më esenciale dhe më spontane. Kurse edukimi estetik, vlerësohet shumë, që nga Aristoteli, i cili si gjeni i gjithanshëm, edukimin estetiko-artistik, e konsideron, si faktor qenësor, të zhvillimit dhe formimit të personalitetit të njeriut. Po ashtu, Aristoteli (tek "Poetika,") thotë që, arti është i dobishëm, është si terapi mjekësore dhe e pastron njeriun nga emocionet negative.

Kështu që, ndër çështjet themelore të shkencës së pedagogjisë, si shkencë mbi edukimin, është edukimi estetik, i cili duhet të realizohet, si veprimtari edukative e planifikuar, e sistemuar, e qëllimshme për përfitimin e një sistemi të njohurive, shprehive e shkathtësive dhe zhvillimin e interesimit permanent të fëmijëve-nxënësve, për kategoritë dhe vlerat estetike (e bukura, e shëmtuara e madhërishmja e ulëta, e guximshmja etj), për të gjithë lëmenjtë e artit, për t'i hetuar, gjykuar, vlerësuar e krijuar, në mënyrë që të avancohet personaliteti i gjithanshëm i tyre.

### **3.2. Letërsia për fëmijë si vlerë estetike dhe edukative**

Letërsia, ka funksion të edukimit të karakterit, përmes trajtimit të përmbajtjeve të ndryshme letrare dhe realizimit të tyre, përmes situatave konfliktuozë e personazheve me karaktere nga më të ndryshmet (të ulëta, të forta, guximtare, madhështore, tragjike, komike,



etj). Kështu, përmes këtij arti, dhe kapaciteteve të performancës së tij për jetën në përgjithësi, fëmijës i mundësohet kultivimi i virtyteve humane, si: guximi, bujaria, nikoqirllëku, respekti ndaj njerëzve dhe ndaj ambientit ku jeton, e në mënyrë të veçantë ndaj të bukurës, kudo që e hasin, në natyrë apo krijimtari artistike. Arti, edhe nëse fare nuk ka përmbajtje moralizuese, vetëm si estetikë, si e bukur, ndikon në etikë-moral të njeriut. Pra, arti, sado që është i pavarur nga moralja, ajo ekziston në të. E moralshmja mund të burojë nga estetikja, sepse estetikja avancohet virtytet, fisnikëron shpirtat, ngritë intelektin.

Prandaj është e domosdoshme që, objektivë e trajtuar me seriozitet e çdo plani edukativo arsimor, të jetë edhe edukimi estetik e si veçanti letërsia shkollore. Objektivat e edukimit estetik në shkollë, si pjesë e edukimit të përgjithshëm të nxënësit, realizohen përmes mjeteve e përmbajtjeve të ndryshme, në kuadër të lëndëve të fushave të artit: Edukatë Fizike, Edukatë muzikore, Art figurativ, dhe përmes lëndës Gjuhë e Letërsi Shqipe, përmes së cilave, nxënësve, duhet t'u ofrohen vlera të theksuara estetike, në mënyrë që atyre t'u bëjnë përshtypje dhe të ndiejnë nevojë për to. Interesimi i nxënësit për artin e për estetikën, nuk është trashëgim, ai kultivohet, zhvillohet gradualisht dhe sistematikisht nga familja, mjedisi ku jeton dhe shoqëria, por në mënyrë të veçantë kjo realizohet përmes shkollës, gjatë procesit edukativo-arsimor. ” ( Grup autorësh, „Pedagogjia” – Zagreb, 1978, f. 205)

Për t'u jetësuar edukimi estetik tek nxënësit, ai duhet të jetë në kontakt me vlerën estetike, si dhe të aktivizohet praktikisht në këtë aspekt, në mënyrë që ai ta pranojë, ta përjetojë e t'i bëhet e nevojshme në përditshmëri. Pa iu orientuar fëmijës ana emocionale e psikoshpirtërore, kah vlerat estetike, që në moshë të hershme, vështirë do t'i vërejë, t'i dojë e t'i përjetojë ato më vonë. Fëmija-nxënësi, që përjeton impakt estetik, bëhet më i butë në karakter, më i ndjeshëm, më solidar me të tjerët, më etik dhe shpirtërisht e fizikisht, qëndron më i distancuar nga vrazhdësia, brutaliteti, e devijimet e ndryshme sociale, që tashmë janë shumë evidente. Alternativë efikase për edukimin emocional, shpirtëror e estetik të fëmijës, është letërsia, si lloj specifik i artit mbi jetën. “Leximi i librave të ndryshëm letrarë (prej nga rrjedhin filma e drama që përmbajnë copëza e përvoja jete) edukon imagjinatën, zbulon përfytyrimin e fëmijës për të mundshmen në jetë” ( Fraj Northrop, „Anatomia e kritikës”, ‘Rilindja’, Prishtinë, 1990 f.27) Përmes letërsisë, fëmijët-nxënësit, kontaktojnë me situata të ndryshme, të mundshme për jetën individuale e shoqërore, prandaj leximi, nuk mund të

nënkuptohet vetëm si shkathtësi, apo si formë e dëfrimit dhe argëtimit, por edhe si një nevojë e përgatitjes dhe të zhvillimit të personalitetit të njeriut për një jetë më cilësore në çdo aspekt të saj. Në funksion të kësaj, arti letrar, në mënyrë të veçantë, duhet të përmbajnë vlera të mirëfillta dhe që janë të përshtatura me moshën e fëmijëve-nxënësve por edhe me kohën e aktualitetin.

## **KONKLUZION**

Aspekti i edukimit estetik përmes letërsisë, është një çështje që nuk mund të matet, as të përshkruhet, sepse ndikimi estetik, lind aty për aty, mbi bazën e shkallës së komunikimit në mes të lexuesit (nxënësit në këtë rast) me tekstin letrar, i cili në rrethana normale artistike, ka synim kryesor artistiken. Ky komunikim-përjetim, është shumë individual, saqë asgjë në këtë aspekt, nuk mund të përgjithësohet dhe është i përcaktuar nga para-kultura e lexuesit-nxënësit dhe nga aftësitë e gjenialitetit e origjinalitetit krijues, të autorit, nga talenti ekzibicional imagjativ, semiotik e struktural i tij. Për të parë nga afër, ndikimin e edukimit estetik dhe rëndësinë e artit letrar në shkollë dhe për të marrë në mënyrë konkrete, mendimin e nxënësve e të mësimdhënësve, lidhur me këto çështje hulumtuese:

**1-A** ndikon arti letrar në edukimin estetik të nxënësve?

**2-Sa** ndikon leximi i letërsisë dhe edukimi estetik, në formimin e përgjithshëm të nxënësve?

**3-Sa** kanë nxënësit interesim për të lexuar?

**4-Çka** i motivon e çka i demotivon nxënësit për të lexuar vepra letrare.

**5-A** e përjetojnë-ndiejnë nxënësit veprën letrar, apo e lexojnë vetëm si aspekt obligativ mësimor në shkollë?

**6-Sa** ndikon leximi i letërsisë në njohuritë e përgjithshme dhe në formimin e personalitetit të fëmijës?

**7- Cili** është ndikimi i leximit, në suksesin e përgjithshëm dhe në sjelljen e nxënësit?

përgjigjet për këto pyetje esenciale, i kemi marrë nga 12 shkolla të rajoneve të ndryshme të Kosovës, nga 190 nxënës të klasave VI-VII të arsimit të mesëm të ulët dhe nga 21

mësimdhënës të lëndës së Gjuhës e letërsisë shqipe. Si çdo studim edhe ky, i ka objektivat e veta, të cilat janë arritur në mënyrë relative. Thënë më konkretisht, nga ky hulumtim kanë dalë këto rezultate:

**1-**Është evidentuar rëndësia dhe roli i pazëvendësueshëm i edukimit estetik në formimin e një fëmije më të qytetëruar, më human dhe më të gjithanshëm.

**2-**Janë paraqitur disa nga veçoritë e përgjithshme të letërsisë për fëmijë, e që më e veçanta e saj është se kjo letërsi nuk është art i pastër letrar, por është art i prekur me pedagogji e ndonjëherë edhe didaktikë, sepse ka të bëj me një qenie delikate, të vogël dhe akoma të paformuar, që është në formim e sipër të personalitetit të tij psiko-fizik, shpirtëror e emocional e të cilit i është e nevojshme t'i ofrohen njohuri të ndryshme për jetën e botën dhe këshilla e moralizime edhe përmes artit letrar.

**3-**Është vlerësuar se në Kosovë, pak krijohet letërsi për fëmijë e edhe më pak kritikë e mirëfilltë e kësaj letërsie. Si pasojë e kësaj të dytës, pëson ajo e para, d.th. vlera dhe cilësia e letërsisë për fëmijë.

**4-**Punimi reflekton edhe mbi disa lëshime profesionale në përpilimin e teksteve shkollore të letërsisë, e disa nga të cilat janë P.sh; përzgjedhja e njësive letrare a pa harmonizuar me moshën e nxënësit, leksiku i tej ngarkuar me terminologji shumë profesionale jashtë domenit të moshës dhe të pakapshme për fëmijën-nxënësin, (kur dihet që libri është i krijuar për nxënësin e jo për mësimdhënësin), aparaturo didaktike e teksteve shpesh joadekuate në raport me përmbajtjen letrare, etj.

**5-** Në bazë të punës empirike dhe anketave të realizuara në shkolla me nxënës dhe mësimdhënës, janë evidentuar shmangie profesionale të mësimdhënies së letërsisë (ku më shumë i kushtohet rëndësi aspekteve dytësore të njësisë letrare, (si; biografisë së autorit, vlerës sociale-patriotike dhe përmbajtjes semantike letrare, se sa aspektit estetik, stilistik, figurativ, etj).

**6-** Është konstatuar (në bazë të komunikimit me bibliotekat e shkollës dhe me mësimdhënësit), se lista e lekturës shkollore, është pothuajse e pandryshuar me dekada, apo ka ndryshuar pak por ky ndryshim nuk është adekuat dhe kjo lekturë në ndonjë rast edhe nuk

përkon fare me moshën dhe kapacitetet absorbuese të nxënësit, dhe në vend që të ketë efekt pozitiv lidhur me ndjenjës dhe vullnetin e fëmijës për artin letrar, kanë efekt të kundërt e ndodhë edhe imitues.

7-Janë nxjerrë disa rekomandime për kompetentët, gjegjësisht mësimdhënësit dhe përpiluesit e teksteve shkollore.

## **KONKLuzion**

Thënë përfundimisht, ky punim është realizuar mbi dy lloj burimesh të njohurive, mbi të dhënat nga literatura përkatëse e kësaj fushe dhe mbi të dhënat empirike, të dala nga hulumtimi në institucionet arsimore-shkolla. Kombinimi i këtyre dy lloj studimesh, ka mundësuar që përmbajtja dhe konstatimet e punimit të jenë origjinale dhe të reflektojnë, situatën, reale, të objektit tonë të studimit.

## **Referenca**

1. Demiri, Qibrie, “Letërsia për fëmijë”, “Rozafa”, Prishtinë, 2011;
2. Deva, Agim, “Poezia shqipe për fëmijë - 1872-1980”, “Rilindja”, Prishtinë, 1982;
3. Dewey, John, “Shkolla dhe shoqëria”, Plejad, 2003, Tiranë;
4. Eco, Umberto, “Si shkruaj”, AIKD, Prishtinë, 2003;
5. Emërllahu, Dali, “Edukata estetike”, Prishtinë, 2001;
6. Fraj, Northrop, “Anatomia e kritikës”, Rilindja, Prishtinë, 1990;
7. Frojd, Zigmund, “Mbi letërsinë dhe artet”, F. Noli, Tiranë ;
8. Grup autorësh, “Letërsi në shkollë”, Tiranë, 2001;
9. Grup autorësh, “Pedagogjia”, Zagreb, 1978 ;

10. Kant, Imanuel, “Kritika e gjykimit”, Plejad, 2002, Tiranë;
11. Kumnova. M, Hyseni,M., “Leximi letrar 7”, Libri Shkollor, Prishtinë, 2010;
12. Musai, Bardhyl, “Metodologjia e mësimdhënies”, Tiranë, 2003;
13. Musai, Bardhyl, “Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies”, Tiranë, 2008;
14. Petro, Rita & Sylva, Xhevat, “Leximi Letrar 6”, Botime Shkollore, Prishtinë, 2004;
15. Qosja, Rexhep, “Historia e Letërsisë shqipe III, Romantizmi, “Rilindja”, Prishtinë, 1986;
16. Rexhepi, Nuhi, “Letërsia në tekstet shkollore të Kosovës”, Prishtinë, 2002;
17. Rugova, Ibrahim, “Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983”, Prishtinë, 1983;
18. “Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar-Kosovë 2007-2017”, MASHT;
19. Shiler, Fridrih, “Mbi edukimin estetik të njeriut”, Tiranë, 2004;
20. Uçi, Alfred, “Universi Estetik”, Tiranë, 2007;
- Uçi, Alfred, “Estetika I-II-III”, Tiranë, 1986;
21. Zherar, Mari, Fransua & Rozhje Ksavje, “Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore”;  
“Standardet për tekstet shkollore”, MASHT, Prishtinë, 2011.

**ЛИНГВИСТИЧКА ЕМАНЦИПАЦИЈА ВО Р.МАКЕДОНИЈА****Doc.dr.Edi KELA**

International University of Struga

e.kela@eust.edu.mk

**Abstract**

Macedonia is a multilingual and multicultural country. Besides Macedonian language actively are spoken Albanian, Turkish and other languages of the smaller ethnic communities as Vlach, Bosnian, Serbian, Roma and others. Bilingualism and Trilingualism is more dominant in western Macedonia, while in Eastern Macedonia the bilingualism is less present while trilingualism is less common issue. Undoubtedly bilingualism and trilingualism presents a linguistical and cultural wealth but also brings problems and conflicts which should be resolved through meaningful and well prepared language policies.

David Harrison in his research came to the following conclusion: From 7,000 languages now spoken in the world, the half of the population uses only 83, and many of the small languages are threatened with complete extinction. Thus, by the end of this century may disappear even half of the languages. Around 3,500 languages are spoken by only a tenth percent of the world's population.

If a language is not used at the official level language respectively if a language is used only in the circle of the loved ones, family, friends, the danger of its extinction is much higher.

In the R. Macedonia the right to use a language is a constitutional and legal category, respectively everything that is connected with the use of languages shall be governed by the

Constitution of R. Macedonia. Legislation is adopted by the Parliament and the use of language is not allowed to be regulated by secondary legal acts adopted by the Government of R. Macedonia, the bodies of the state administration or local authority. This emphasizes the importance of the right to use the languages. The ratification of the "Framework Convention for the Protection of National Minorities" presents the first step that R. Macedonia took towards extensive use of languages.

The use of language respectively its proper use is not only a right it is also the obligation of all parties. Language twisting poses great danger, the use of foreign words for terms that exist in the official languages or writing of the Macedonian word in Latin characters. It not only has a negative impact on the preservation of the language but also affects the authenticity of certain terms and concepts. To avoid this, there are strict legal sanctions for those who fail to respect the linguistic rules.

**Keywords:** *Macedonia, "Framework Convention for the Protection of National Minorities, official languages.*

## **ВОВЕД**

Во сите закони на уставниот амандман на Р.Македонија во врска со употреба на јазиците се среќава формулацијата „друг службен јазик што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните на Р.Македонија..., никаде експлицитно не се спомнуваат друг јазик и писмо, освен македонскиот јазик и неговото кирилско писмо. Ако за основа се земе последниот попис на населени (2002 година), единствената етничка заедница во Р.Македонија која учествува со најмалку 20% од вкупната популација е албанската. Тоа покажува дека статусот „друг службен јазик“ во моментот во Р.Македонија го има албанската етничка заедница.

Јавната употреба на јазиците на заедниците и нивните писма се однесуваат на следните области и институции: Собранието на Р.Македонија, комуникација на граѓаните со министерствата и органите државната управа, судските постапки,

управната постапка, извршувањето санкции, народниот правобранител, изборниот процес, изјаснувањето на граѓаните, личните документи на граѓаните, матичната евиденција, примената на полициски овластувања, радиодифузната дејност, инфраструктурните објекти, локалната самоуправа, финансиите, економијата, образованието и науката, културата, како и органите кои се значајни за унапредувањето и заштитата на ова право<sup>1</sup>.

После конфликтот во 2001 година дојде до промена на јазичните политики во Р.Македонија. Како и секоја промена тие имаа позитивни и негативни последици врз граѓаните на Р.Македонија. околу позитивните и негативните резултати од новите јазични политики во Р.Македонија ќе се навратиме подоцна пред тоа да разјасниме што всушност претставува јазична политика.

Јазичното политика и планирање пред се треба да се третира како мултидисциплинарна истражувачка област која е во корелација со социо-политичкиот, научниот, културниот контекст во кој истата се реализира и без нив неможе јасно и прецизно да се согледа и утврди. Наведените контексти директно или индиректно влијаат врз планирањето и целите на одредена јазична политика. Со други зборови, исходите ( планирани и очекувани или/и непланирани но реализирани) јазичните политики во различни делови од светот, секогаш се во корелација со социо-политичките, епистемиолошките и стратешките ставови од оние кои ги планираат, без разлика дали тоа го прават свесно или не во текот на креирањето на јазичните политики.

Може да се заклучи дека креирањето на јазичната политика е поврзана со социо-политичките ставови, економијата, културата, науката, моќта, националниот интерес и идентитет итн.

Wald for the parameter P1 is 10,5 which shows that in conditions when other parameters are unchanged, the chance for high performance in females is 0.4 times higher than for males. We also note also the confidence interval for Exp (B) for each of the coefficients. The independent variables, P2, has the significant 0.733, are therefore not statistically important. So it is not statistically important if the students come from private or public schools in performance appraisal in the first semester. Also, P3, therefore, the location of the school again is not statistically important variable, the significance is  $0.490 < 0.05$  and should therefore not be included in the model.

#### Variables in the Equation

	B	S.E.	Wald	df	Sig.	Exp(B)	95% C.I.for EXP(B)	
							Lower	Upper
P1(femra Step /meshkuj 1 <sup>a</sup> )	-.919	.284	10.462	1	.001	.399	.229	.696
P5	-.477	.264	3.257	1	.071	.621	.370	1.042
P6	.626	.210	8.903	1	.003	1.870	1.240	2.821
P7	-.450	.203	4.928	1	.026	.638	.429	.949
Constant	.547	.721	.575	1	.448	1.728		

a. Variable(s) entered on step 1: P1, P5, P6, P7.

The regression equation form would be:

$$\theta = \frac{e^{(0.54-0.91 x_1-0.47 x_5+0.62x_6-0.45x_7)}}{1 + e^{(0.54-0.91 x_1-0.47 x_5+0.62x_6-0.45x_7)}}$$

## Variables in the Equation

	B	S.E.	Wald	df	Sig.	Exp(B)	95% C.I. for EXP(B)	
							Lower	Upper
Step 1 <sup>a</sup> P1(femra /meshkuj )	-.919	.284	10.462	1	.001	.399	.229	.696
P5	-.477	.264	3.257	1	.071	.621	.370	1.042
P6	.626	.210	8.903	1	.003	1.870	1.240	2.821
P7	-.450	.203	4.928	1	.026	.638	.429	.949
Constant	.547	.721	.575	1	.448	1.728		

Variables in the Equation

	B	S.E.	Wald	df	Sig.	Exp(B)
Step 1 <sup>a</sup> P2	.325	.839	.150	1	.699	1.384
P3	.017	.460	.001	1	.970	1.018
P6	1.144	.464	6.086	1	.014	3.140
P7	-.397	.454	.766	1	.381	.672
P8	-.064	.588	.012	1	.913	.938
Constant	-2.022	2.356	.736	1	.391	.132

a. Variable(s) entered on step 1: P2, P3, P6, P7, P8.

The regression equation form would be:

$$\theta = \frac{e^{(-2.022+0.325 x_2-0.017x_3+1.14x_6-0.397x_7-0.064x_8)}}{1+e^{(-2.022+0.325 x_2-0.017x_3+1.14x_6-0.397x_7-0.064x_8)}}$$

Independent variables that are important in the Forwise Stepwise method are P1, P6 and P7, respectively, gender, where you live, and the degree of stress in the social

environment. It is also noted that the performance of girls and boys in schools is 0.669 and 1.979 times better than co-educational schools respectively. Similarly, urban student performances are 1.409 times better than students from rural areas.

Using the Correlation Analysis method, there is no significant correlation between the variables participating in the model.

Independent variables, the location of the school is not important in the model of significance is  $0.733 > 0.05$ , as well as P31 and P5 respectively, the location of the schools and while the gender of the students and the type of schools have influenced in the results of the students in the results Of the first semester. In regard to the type of private or public high schools, it can be seen that the performance of private high schools is not significant in relation to state schools.

This is also indicated by wald 0.116. A similar conclusion is reached in regard of their location independently of the fact that 86% of students come from high school of urban areas, and only 14% of them come from secondary schools in rural areas. Urban student performance is better than rural students with 0.750 times.

## CONCLUSIONS

From the obtained data and the statistical analysis we can conclude that:

- Studying the student performance is a well-known problem that takes on its own relevance of treatment to build such teaching and research policies in order to increase the degree of quality. Evidence of such occurrences is the most advantageous for society.
- From the data we note that the female student performance rate is better than that of male students, otherwise, it would be useful to recommend female students in economics branch considering their rate of performance.
- The environment where their live is far from being suitable for study and research. This requires rooting measures to increase not only economic conditions but also standards for a university study environment.

- From the study, we conclude that the rate of performance of students influences in the results of high school, and perform better those who have more points. Therefore special attention should be paid to increasing the performance rate from high school.
- The continuous improvement of the student's socio-economic conditions and the creation of non-stressful conditions are important factors for increasing student performance.

## References

1. Agresti, A. (1996). *An Introduction to Categorical Data Analysis*, John Wiley and Sons, Inc.
2. Hosmer, D. and Stanley, L. (1989). *Applied Logistic Regression*, John Wiley and Sons, Inc.
3. Menard, S. (1995). *Applied logistic regression analysis* (Sage University Paper Series on Quantitative Applications in the Social Sciences, 07–106), Thousand Oaks, CA: Sage.
4. Menard, S. (1995). *Applied Logistic Regression Analysis*. Sage Publications. Series: Quantitative Applications in the Social Sciences, No. 106.
5. Menard, S. (2000). Coefficients of determination for multiple logistic regression analysis, *The American Statistician*, 54(1), p. 17–24.

## **NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA, SFIDAT E TYRE NË PROCESIN E GJITHËPËRFSHIRJES**

**Nexhmedin Z. BARDHI, PhD Candidate**

Internacional University of Struga

Profesor në Kolegjin Universitar "Humanistica" Ferizaj

nexhbardhi@hotmail.com

### **Abstrakt**

Sfidat në procesin e gjithëpërfshirjes i hasim dhe janë të manifestuara në vazhdimësi, duke filluar nga përgatitja e politikave të gjithëpërfshirjes në shkollat e zakonshme, suksesin e gjithëpërfshirjes, rolin e personelit mësimdhënës, identifikimin e nxënësve me nevoja të veçanta, përgatitjen e mësimdhënësve, planin edukativ individual, kontributin e prindërve në procesin e gjithëpërfshirjes. Me rastin e gjithëpërfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme roli i prindërve duhet të jetë i rëndësishëm në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e strukturave si dhe programeve të edukimit për fëmijët e tyre të përfshirë në sistemin arsimor.

Në institucionet arsimore ku menaxhimi është i mirë, në procesin e gjithëpërfshirjes kemi rezultate inkurajuese dhe anasjelltas në institucionet ku menaxhimi ishte i dobët forma dhe niveli i gjithëpërfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta është alarmant.

**Fjalët kyçe:** *Gjithëpërfshirje, institucion arsimor, nxënës me nevoja të veçanta, plan edukativ individual.*



**HYRJE**

Gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme njih fillime të vonshme në historinë e edukimit special të fëmijëve me nevoja të veçanta. Ajo ka bashkëshoqëruar lëvizjet e kryera në fushën e nevojës së veçantë, nga organizata, rrjetëzime interesi, por kryesisht grupime të prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta, për të garantuar të drejtat e personave me nevoja të veçanta në një shoqëri për të gjithë.

Qasja ishte e rëndësishme pasi u identifikua me një paradigmë të re në trajtimin e çështjeve të nevojës së veçantë, paradigmen sociale, që shërbeu për të nisur shmangien nga modeli mjekësor, mbizotërues deri në atë kohë për trajtimin e çështjeve të nevojës së veçantë. Procesi i gjithëpërfshirjes shoqërohet nga një sërë vështirësish e barrierash, të cilat më së shumti lidhen me faktorë të jashtëm si: financiarë, zhvillimi social-kulturor dhe arsimor i aktorëve të përfshirë në proces, i komuniteteve ku realizohet ai, qëndrimet e tyre, mungesa e infrastrukturës mbështetëse për zbatimin e praktikave gjithëpërfshirëse, niveli i bashkëpunimit që ofrojnë prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta.

**TË DREJTAT E NJERIUT DHE GJITHËPËRFSHIRJA NË ARSIM**

Kur trajtojmë arsimin gjithëpërfshirës duhet të kemi të qartë se është e drejta njerëzore për edukim e përcaktuar në Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut në vitin 1948, e cila thekson se *“çdo njeri ka të drejtë për edukim...Edukimi duhet të drejtohet për nga zhvillimi i plotë i personalitetit njerëzor dhe fuqizimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore...”*<sup>1</sup>

Në kuadër të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve <sup>2</sup>, përcaktohen e drejta e fëmijëve për të mos u diskriminuar, e përcaktuar në nenin 2 dhe në nenin 23 të saj,

Neni 23 specifikon se fëmijët me nevoja të veçanta duhet të kenë: *“akses efektiv dhe të marrin edukim, trainim, shërbime të kujdesit shëndetësor, përgatitje për punësim dhe mundësi për argëtim në mënyrë që të kontribuojnë në arritjen e integritit të plotë social dhe të zhvillimit*

<sup>1</sup> OKB Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.1948, neni 26.

<sup>2</sup> OKB, Konventa për të drejtat e fëmijëve,1989.

*të tij individual, duke përfshirë zhvillimin kulturor dhe shpirtëror.”* <sup>3</sup>  
 Konventa e UNESCO-s Kundër Diskriminimit në Edukim (1960) dhe Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave<sup>4</sup>, janë dokumente shumë të rëndësishme që sanksionojnë të drejtat e njeriut – eliminimin aktiv të diskriminimit.

Arsimi gjithëpërfshirës merr për bazë parimet e respektimit të të drejtave të njeriut ku bazohet:

1. akses në arsimin e detyruar dhe falas,
2. barazi, përfshirje dhe mos-diskriminim,
3. të drejta për edukim cilësor, programe dhe praktika të përshtatura.

Në Deklaratën e Salamankës dhe Plani për Veprim (1994) në zbatim të saj theksojnë se: *“...shkollat duhet të përfshijnë fëmijët pavarësisht aftësive të kufizuara fizike, intelektuale, sociale, emocionale...”*. Po në këtë deklaratë theksohet se: *“...shkollat e zakonshme me orientim përfshirës janë mjetet më efektive për luftimin e diskriminimit, krijimin e komuniteteve mirëpritëse, ndërtimin e shoqërive përfshirëse dhe arritjen e edukimit për të gjithë.”*<sup>5</sup>

OKB në vitin 2006 miratoi Konventën për të Drejtat e Personave me Nevoja të veçanta, ku specifikimin e saj e hasim në nenin 24 ku precizohet : *“...shtetet duhet t’u garantojnë personave me nevoja të veçanta akses në arsimin gjithëpërfshirës, cilësor...ashtu si të gjithë fëmijëve të tjerë në komunitetet ku ata jetojnë”*.<sup>6</sup>

Bazuar në dokumentet ndërkombëtare shohim qartë se kemi një garantim të respektimit dhe të mbrojtës të së drejtës për arsim të fëmijëve me nevoja të veçanta, duke eliminuar diskriminimin dhe duke u siguruar qasje në shkollat e zakonshme si dhe fëmijët e tjerë.

### **SFIDAT E PROCESIT TË GJITHËPËRFSHIRJËS**

Për t’u realizuar procesi i gjithëpërfshirjes në shkollat e zakonshme, fëmijëve me nevoja të veçanta u duhet të ballafaqohen me shumë sfida dhe barriera. Fillimisht është e rëndësishme

<sup>3</sup> OKB, Konventa për të drejtat e fëmijëve, 1989.

<sup>4</sup> OKB , Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, 1979.

<sup>5</sup> Deklarata e Salamankës, 1994

<sup>6</sup> OKB, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, 2006.

të vlerësohen barrierat egzistuese në sistemin arsimor.<sup>7</sup> Varësisht nga vendet e ndryshme edhe barrierat janë të ndryshme, duke u ndikuar nga zhvillimet ekonomiko-sociale dhe kulturore. Në veçanti sfidat e identifikuar lidhen me qëndrimet e mësimdhënësve dhe kurrikulave jo të përshtatshme.<sup>8</sup> Kemi edhe pengesa të ndryshme që janë sfida për kyçjen e lirë të nxënësve me nevoja të veçanta në shkolla të zakonshme.<sup>9</sup>

Bazuar në studimet e ndryshme janë bërë përparime të konsiderueshme dhe janë orientuar në drejtimet e nevojshme për ndërhyrje.<sup>10</sup>

Nëse mësuesit në shkollat e zakonshme nuk janë të ndërgjegjësuar dhe të orientuar për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta atëherë gjithëpërfshirja kthehet në utopi.<sup>11</sup> Një rëndësi të veçantë në realizimin e gjithëpërfshirjes janë faktorët financiar, infrastruktura mbështetëse e shkollave, numri i nxënësve në klasa, mbështetja administrative, koha e nevojshme e mësimdhënësve për t'u përgatitur për punë me nxënësit me nevoja të veçanta.<sup>12</sup> Përkundër trajnimit dhe aftësimin të tyre për të zbatuar arsimin gjithëpërfshirës mësuesit ballafaqohen edhe me faktorë të ndryshëm si : numri i nxënësve në klasa, mungesa e materialeve dhe mjeteve didaktike, programet mësimore, mungesa e infrastrukturës mbështetëse.<sup>13</sup>

---

<sup>7</sup> EADSNE, 2005

<sup>8</sup> Banka Boterore, 2004, f.18

<sup>9</sup> Jonsson, T., Wiman, R., Education, Poverty and Disability in Developing Countries. Poverty Reduction Sourcebook, June 2001.

<sup>10</sup> Institute of Medicine-National Academies, 2007, fq.165

<sup>11</sup> ul Hassan, M.U., Parveen, I., un-Nisa, R. (2010). Exploring Teachers' Perspectives: Qualms and Possibilities

<sup>12</sup> Banka Boterore, 2004, fq.17.

<sup>13</sup> Lei, 2006.

## **POLITIKAT ORGANIZATIVE TË SHKOLLAVE TË ZAKONSHME DHE NXËNËSIT ME NEVOJA TË VEÇANTA**

Shkolla e cila kujdeset për nevojat e të gjithë nxënësve quhet gjithëpërfshirëse, në kuadër të së cilës të gjithë janë të vlerësuar dhe respektuar.<sup>14</sup> Orientimet e shkollës duhet të jenë të atilla që të formojnë bazat e një shoqërie jo diskriminuese. Shkollat bëjnë jo vetëm tolerimin e nevojës së veçantë por edhe e pranojnë atë, arrijnë sukses dhe e shohin si mundësi për të ofruar arsim cilësor.<sup>15</sup> Shkollat u përgjigjen nevojave të gjithë fëmijëve.<sup>16</sup>

Në një institucion arsimor duhet të jenë të përfshirë të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh kushtet e tyre fizike, intelektuale, sociale e gjuhësore, duke nënkuptuar edhe fëmijët me nevoja të veçanta.<sup>17</sup>

Në favorizimin dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, në kuadër të nivelit organizativ identifikohen dhjetë faktorë:<sup>18</sup>

- Akordimi dhe financimi i burimeve financiare;
- Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse dhe kuadri ligjor i përshtatshëm;
- Angazhimi dhe vizioni i duhur, qëndrimet pozitive të drejtuesve të shkollave;
- Të gjitha hallkat në sistemin e shkollës dhe përtej të kenë, bashkëpunim dhe bashkërendim;
- Evaluimi dhe rivlerësimi i rezultateve në të mësuar;
- Strukturimi i një mjedisi të përshtatur social dhe fizik të shkollës;
- Zhvillimi i programeve dhe organizimi i klasave;
- Aftësimi i stafëve pedagogjike i realizuar përmes trajnimeve;

---

<sup>14</sup> Dixon, R. M., Verenikina, I., Towards Inclusive Schools: An Examination of Socio-cultural Theory and Inclusive Practices and Policy in New South Wales DET Schools, Learning and Socio-cultural Theory: Exploring Modern Vygotskian Perspectives International Workshop 2007, 1.

<sup>15</sup> Asian Development Bank, 2010.

<sup>16</sup> Mohan Jha, M., Barriers to Access and Success: Is Inclusive Education an Answer? 2nd Pan-Commonwealth Forum on Open Learning, 29 July 2002 - 2 August 2002, Durban, South Africa., 2002.

<sup>17</sup> UNESCO, The Salamanca Statement and framework for action on special needs education adopted by the world Conference on special needs education: access and quality, 1994.

<sup>18</sup> Berhanu, G., Framgångsfaktorer för delaktighet och jämlikhet. [Favourable factors to enhance participation and equality]. Specialpedagogiska institutet: Sweden (Monograph), 2006.

- Kygja e prindërve në vendimarrje;
- Përkrahja teknike dhe përshtatja e kurrikulave.

Kultura e shkollës llogaritet shumë e rëndësishme në procesin e gjithëpërfshirjes. Kultura përbëhet nga norma, zakone të një mjedisi të caktuar, pritshmëritë. Karakteristikë e shkollës gjithëpërfshirëse është barazia ku të gjithë trajtohen me dinjitet dhe të gjitha kontributet vlerësohen. Karakteristikë tjetër në këto shkolla është bashkëpunimi. Nxënësit janë të lidhur me njëri-tjetrin në mjedisin që i rrethon dhe në komunitetin më gjerë.<sup>19</sup> Udhëheqësi i institucionit arsimor llogaritet të jetë mbështetësi më i madh ose jo i gjithëpërfshirjes arsimore.<sup>20</sup> Përmes nismave që merr udhëheqësi i institucionit krijon mundësin e ndryshimeve të duhura në përkrahjen e arsimit gjithëpërfshirës.<sup>21</sup>

Drejtuesit e institucioneve duhet ta kenë të qartë se realizimi i gjithëpërfshirjes, duhet të shoqërohet me klasë demokratike, mësimdhënës me mendje të hapur, me një nivel të lartë të mbështetjes, programet mësimore të përshtatura.

Institucioni arsimor duhet llogaritur si komunitet i të mësuarit, ku trajnimi i stafit dhe puna kërkimore në grup është shumë qenësore.<sup>22</sup>

Që një shkollë të jetë e suksesshme padyshim se udhëhiqet nga drejtues me vizion gjithëpërfshirës, nga mësimdhënës të kualifikuar të orientuar në zbatimin e programeve me anë të cilave do përmbushin nevojat specifike të nxënësve.<sup>23</sup>

### **Procesi i gjithëpërfshirjes dhe ndikimi i saj në praktikë**

Për të precizuar procesin e gjithëpërfshirjes kemi kategorizimet të veçanta. Rëndësia e veçantë specifikohet edhe atëherë kur duhet të kemi qëndrimet e mësimdhënësit, kualifikimin e tyre, definimin e saktë të nevojave të fëmijëve me nevoja të veçanta, përshtatjet programore, punën individuale me këta nxënës dhe përkrahja nga profesionistët.

<sup>19</sup> Kluth, 2005.

<sup>20</sup> Trump, G., Hange, J., Teacher perceptions of and strategies for inclusion: A regional summary of focus group interview findings. Charleston, WV: Appalachia Education Laboratory (ERIC Document Reproduction Service No. ED 397 576), 1996.

<sup>21</sup> EADSNE, 2003

<sup>22</sup> UNESCO, Guidelines for inclusion: Ensuring Access to education for all, 2005.

<sup>23</sup> UNESCO, Guidelines for inclusion: Ensuring Access to education for all, 2005.

### **Suksesi i gjithëpërfshirjes dhe roli i personelit mësimdhënës**

Qëndrimet e mësimdhënësve janë njëri nga elementët më të rëndësishëm dhe përcaktues për suksesin e gjithëpërfshirjes. Ndërgjegjësimi i mësimdhënësve është primar në arritjen e suksesit në gjithëpërfshirje.<sup>24</sup>

Mësimdhënësit duhet t'a kenë të qartë se rëndësia e ndryshimit të qëndrimeve të tyre ka për synim që gjithëpërfshirja të funksionoj. Mësimdhënësit duke u bazuar edhe në qëndrimet e tyre duhet t'i kushtojnë kujdes shumë bashkëbisedimit me nxënësit e jo të shihen si dëgjues pasiv. Mësimdhënësit duhet të vlerësojnë në vazhdimësi dhe të ri-vlerësojnë efektivitetin e punës së tyre.

Bashkëpunimi i ngushtë me kolegët e tyre, prindërit ose kujdestarët e fëmijëve me synim që të gjenden zgjidhje për sfidat që hasin.<sup>25</sup> Bazuar nga përvojat dhe të menduarit reflektues shiheshin si shumë të rëndësishme për formimin e qëndrimeve pozitive të mësimdhënësve dhe kandidatëve për mësimdhënës. Këto përvoja janë një mundësi e sigurt për zhvillimin dhe ndryshimin e vazhdueshëm të praktikave të mësimdhënies për nxënësit me nevoja të veçanta.<sup>26</sup>

Një rol dhe ndikim shumë të madh kanë mësimdhënësit tek nxënësit me të cilët punojnë. Këta me nxënësit ndajnë njohuritë, si dhe mënyrën formale dhe joformale të vlerave të tyre. Mësimdhënësit duke njohur vlerat e këtyre individëve, bëjnë që të rrisin në mënyrë

---

<sup>24</sup> Alghazo, E. M, Naggar Gaad, E. E., General education teachers in the United Arab Emirates and their acceptance of the inclusion of students with disabilities., British Journal of Special Education Volume 31. No.2,:94-99, 2004.

<sup>25</sup> Le Fanu, G.,The Inclusion of Inclusive Education in Teacher-Training: Issues of Curriculum, Pedagogy and Staffing, 2005 National Curriculum Reform Conference, Australia, 2005.

<sup>26</sup> Kozleski, E. B., Waitoller, F. R., Teacher Learning for Inclusive Education: A Framework for Embracing Diversity. Potchefstroom, South Africa: North West University, 2009.

graduale formësimin e qëndrimeve pozitive dhe të përmbushin misionin e tyre përballë individëve të tillë.<sup>27</sup>

Në fillet e para të punës si mësimdhënës, është e rëndësishme që mësimdhënësit e rinjë të përballen me nxënës të nevojave të veçanta.<sup>28</sup>

Bazuar në studimet paraprake është konstatuar se numri i trajnimeve dhe përvojat e mësuesve me fëmijët me nevoja të veçanta ndikojnë edhe në qëndrimet e tyre ndaj gjithëpërfshirjes. Të gjithë ata mësimdhënës të cilët kanë punuar me fëmijë me nevoja të veçanta kanë qëndrime pozitive ndaj gjithëpërfshirjes dhe anasjelltas ata të cilët nuk kanë patur përvoja të tilla.

Në bazë të studimeve del se një rol dominant në krijimin e qëndrimeve të mësuesve është edhe perceptimi që ata kanë për aftësit dhe efektivitetin e punës së tyre. Pra, mësimdhënësit të cilët kanë një sens të lartë efektiviteti janë më mirëkuptues ndaj qasjeve të reja.<sup>29</sup>

Po në këtë studim del se mësimdhënësit më të vjetër kanë qëndrime më pak pozitive ndaj procesit të gjithëpërfshirjes krahasuar me mësimdhënësi të rinj. Padyshim që mësimdhënësit të cilët reflektojnë pozitivitet me nënësit me nevoja të veçanta ata me lehtësi i pranojnë në klasat e tyre.<sup>30</sup>

## **PËRGATITJA E MËSIMDHËNËSVE DOMOSDOSHMËRI PËR SUKSESE NË GJITHËPËRFSHIRJE**

Në kuadër të përgatitjes së mësimdhënësve për përfshirjen e nxënësve në klasa të zakonshme një rol të rëndësishëm luan edhe morali i mësimdhënësve.<sup>31</sup>

---

<sup>27</sup> Brandes, J. A., Crowson, M. H., Predicting dispositions toward inclusion of students with disabilities: the role of conservative ideology and discomfort with disability, Soc Psychol Educ 12,;271-289, 2009.

<sup>28</sup> Umesh Sharma, Dennis Moore and Sanjeev Sonawane 2009.

<sup>29</sup> Engelbrecht, Forlin, Eloff dhe Swart 2001.

<sup>30</sup> Ajodhia-Andrews, A. D., Inclusive education in Guyana: perspectives of policy makers, teachers, and parents of children with special needs, 2007.

<sup>31</sup> Ajodhia-Andrews, A. D., Inclusive education in Guyana: perspectives of policy makers, teachers, and parents of children with special needs, 2007.

Në klasat gjithëpërfshirëse mësimdhënia me nxënës me nevoja të ndryshme paraqet një sfidë gjatë orës mësimore.<sup>32</sup> Zhvillimet e shpejta të cilat po përcjellin fushën e arsimit, hartimi i programeve akademike do shërbej si një bazament solid për të përgatitur mësimdhënës të rinj me njohuri, aftësi, përvoja, burime dhe mbështetje për të realizuar rolin e tyre si mësimdhënës me nxënës me aftësi të ndryshme në klasat e tyre. Nevoja për përgatitjen e programeve për formimin e mësimdhënësve për sistemet edukative gjithëpërfshirëse duhet bërë që të mbështesë zhvillimin e mësuesve, të cilët kanë aftësi, ndërgjegjësim dhe ndjeshmëri për të mësuar fëmijë të përjashtuar nga shoqëria. Gjatë formësimit akademik të mësimdhënësve një rëndësi të veçantë ka zhvillimi i programeve që nxisin praktika me nxënës me nevoja të veçanta gjatë formimit të tyre akademik. Nga këtu këta mësimdhënës krijojnë marrëdhënie me këta nxënës dhe do krijojnë qëndrimet pozitive ndaj tyre. Universitetet duhet të hartojnë programet mësimore ku gjatë përgatitjes akademike të mësimdhënësve të rinj, të kenë në fokus promovimin e qëndrimeve pozitive kundrejt gjithëpërfshirjes.

Gjatë përgatitjes të kandidatëve për mësues për fëmijët me nevoja të veçanta një element shumë të rëndësishëm luan edhe mësimi terminologjisë të re dhe mospërdorimi i etiketimeve. Shkalla e lartë e arsimit të mësimdhënësve ndikon pozitivisht në krijimin e bindjeve të duhura ndaj gjithëpërfshirjes. Trajnimet të cilat kanë për qëllim të njohin mësimdhënësit për fëmijët me nevoja të veçanta i shtyn ata që të jenë më krijues në kërkimin e formave për një përshtatje më të arsyeshme pedagogjike. Këta mësimdhënës duhet të kenë një bindje që zotërojnë aftësi të duhura për të trajtuar këta fëmijë.

Mësimdhënësit duhet të kenë parasysh dhe të vlerësojnë specifikat e të ndryshmes, ato duhet të njohin të veçantën brenda saj.

Një faktorë i rëndësishëm për cilësinë e shkollës është përgatitja e mësuesve, shkathtësit e tyre në komunikim si dhe pasioni për të mësuarin.<sup>33</sup>

## **PROCESI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA**

---

<sup>32</sup> EADSNE, 2003.

<sup>33</sup> UNESCO 2005, Guidelines for inclusion: Ensuring Access to education for all, 2005.



Procesi i identifikimit është fillesa e parë dhe ndër më kryesoret për të drejtuar më tej çështjen e plotësimit të nevojave të nxënësve me nevoja të veçanta në klasa të zakonshme. Ky identifikim i këtyre nxënësve duhet bërë nga këndvështrimi i pikave të forta dhe jo të forta.

Vlerësimi na bën të mundur që t'i kemi karakteristikat në të mësuar të fëmijës dhe ka për qëllim t'a orientoj suksesin e tij përmes pjesëmarrjes në veprimtari. Nocioni vlerësim shihet si i përshtatshëm për të përkufizuar një proces të përgjithshëm dhe të dallohet nga termi testim që kufizohet vetëm me rezultat.<sup>34</sup> Vlerësimi duhet të përqendrohet në pika në pika te forta tek nxënësit me nevoja të veçanta. Një vlerësim shumë kritik është kur bëhet përmes diagnostifikimit mjekësor, ku në këto raste mundësohet etiketimi i nxënësit. Diagnostifikimi është vetëm hapi për të kuptuar nevojën e tij, kurse një vlerësim i gjithanshëm mundëson të identifikohen dhe të bëhen përshtatjet e nevojshme në programe, mjedise fizike, asistencë në klasë për të cilat fëmija ka nevojë gjatë procesit mësimor. Mbarëvajtja e procesit të vlerësimit do na krijojë një bazë të mirë për të gjykuar progresin e nxënësit. Shumë e rëndësishme në procesin e vlerësimit është edhe pjesëmarrja aktive e prindërve dhe fëmijëve, ata duhet të jenë të njoftuar plotësisht për këtë proces si dhe të japin pajtimin e tyre në përfundim për raportet, rezultatet dhe rekomandimet e vlerësimit.<sup>35</sup>

Në manualin e botuar nga UNESCO drejtuar administratorëve dhe drejtuesve të shkollave për gjithëpërfshirjen, kemi një pjesë të veçantë për vlerësimin në drejtim të planifikimit dhe parashikimit të shërbimeve të vlerësimit, si pjesë të cilësisë të arsimit gjithëpërfshirës.

## **KONCEPTET GJITHËPËRFSHIRËSE NË KURRIKULËN BAZË**

Kurrikula bazë duhet të përfshijë konceptet gjithëpërfshirëse. Dhe është shumë e rëndësishme për të përmbushur nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta të gjithë nxënësve.<sup>36</sup> Kufizimet

<sup>34</sup> Oliver C. and Bowler F. R., Learning to Learn, Simon & Schuster, 1996, fq.158-159.

<sup>35</sup> Oliver C. and Bowler F. R., Learning to Learn, Simon & Schuster, 1996, fq.160.

<sup>36</sup> Le Fanu, G., The Inclusion of Inclusive Education in Teacher-Training: Issues of Curriculum, Pedagogy and Staffing, 2005 National Curriculum Reform Conference, Australia, 2005.

dhe përjashtimet duhet të shmangen nga arsimi i hapur.<sup>37</sup> Kurrikula bazë kombëtare dhe zhvillimi i saj, nxjerr në pah domosdoshmërinë e përgatitjes së mësimitdhënësve përmes trajnimeve të ndryshme si dhe planifikimet e fondeve të nevojshme. Në kuadër të hartimit të programeve gjithëpërfshirëse duhet dhënë përparësi faktit që prej tyre duhet të përfitojnë jo vetëm nxënësit me nevoja të veçanta, por të gjithë nxënësit e një klase të zakonshme.

Plani Individual i Arsimit, është një përcaktues se cili lloj i përshtatjes është i nevojshëm për programin mësimor për të siguruar rezultatin e fëmijës.<sup>38</sup>

Fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin publik duhet të përfshihen që nga arsimin parashkollor. Prandaj është e nevojshme që të zhvillohen dhe të publikohen politikat në mbështetje të barazisë dhe aksesit për arsim.

### **PLANI EDUKATIV INDIVIDUAL**

Një ndihmesë shumë e madhe për nxënësit me nevoja të veçanta është PEI, ku manifestohet si orientues për mësimitdhënësit dhe mësimitdhënësit mbështetës, në asistimin në të mësuar për këta nxënës. Udhëheqës të zbatimit të PEI janë mësimitdhënësit në mjediset e institucioneve arsimore. Zbatimi i PEI bëhet në bashkëpunim të ngushtë me mësimitdhënësit, prindërit duke i udhëzuar që zbatimi të vazhdojë edhe në mjediset familjare të fëmijës. Në hartimin e PEI janë përfshirë një grup ekspertësh të fushës përkatëse duke qenë të përfshirë edhe prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta, por zbatueshmëria e tij bëhet nga mësimitdhënësit dhe prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta. Këta janë vlerësuesit dhe monitoruesit e drejtëpërdrejtë të rezultateve të nxënësit gjatë procesit mësimor dhe jashtë tij.

Në kuadrin e saj PEI përfshinë:

- Përcaktimin e zhvillimit aktual të fëmijës;
- Arsyeshmërinë përse fëmija duhet të vendoset në shkollë të zakonshme;
- Objektivat vjetore dhe të objektivat afatshkurtëra të lidhura me njëra-tjetrën për edukimin e fëmijës;

---

<sup>37</sup> Le Fanu, G., The Inclusion of Inclusive Education in Teacher-Training: Issues of Curriculum, Pedagogy and Staffing, 2005 National Curriculum Reform Conference, Australia, 2005.

<sup>38</sup> Len Barton 2003

- Asistenca e nevojshme e specializuar që fëmija duhet të marrë gjatë procesit të edukimit;
- Kriteret për të vlerësuar progresin e fëmijës në procesin e edukimit përkundrejt objektivave dhe afateve kohore të vendosura paraprakisht.

Që PEI të jetë realizuar me sukses ndikojnë shumë faktorë por kyç janë përfshirja e mësimitdhënësve dhe prindërve në hartimin e tij si dhe e nxënësve të tjerë. Por duhet ta kemi të qartë se ka edhe faktorë që e pengojnë realizimin e PEI siç janë: mospërcaktimi i drejtë i objektivave për këta nxënës, mospërputhja e objektivave të vendosura në PEI etj. Në hartimin e PEI duhet pasur parasysh këta faktorë ndikues.<sup>39</sup>

Hapi i parë gjatë hartimit të PEI duhet të jetë të identifikojmë qartë nivelin e nxënësve me nevoja të veçanta në njohuri dhe aftësi. Një rol substancial për nxënësit me nevoja të veçanta e luan edhe mjedisi social-kulturor gjithëpërfshirës.

### **Bashkëpunimi i ekspertëve dhe realizimi i gjithëpërfshirjes**

Bashkëpunimi i ekspertëve për realizimin e gjithëpërfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme është i domosdoshëm. Një rol të rëndësishë kanë edhe grupet e ekspertëve të fushave multidisiplinare ku mund të jenë të përfshirë: neurologë dhe psikiatër, terapistë të folurit, terapistë okupacionalë dhe fizioterapistë, psikologë, mësues asistent dhe mësues të formimit profesional, mësues të edukimit special, punonjës socialë, si dhe mësues me përvojë në arsimin gjithëpërfshirës.<sup>40</sup>

Një brengë e madhe është se kemi mungesë të profesionistëve në shkolla ku nënkupton edhe mungesën e zhvillimit të veprimtarive në përputhje me nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta.

### **Roli i prindërve në suksesin e fëmijëve me nevoja të veçanta në procesin e gjithëpërfshirjes**

<sup>39</sup> Salend, S.J., *Creating Inclusive Classrooms: Effective and reflective practices* (3rd ed). Upper Saddle River, NJ: Merrill Prentice Hall, 1998, fq.103.

<sup>40</sup> Manor-Binyamini, I., *Special education in the Bedouin community in Israel's Negev region*. *International Journal of Special Education*, Volume 22, No.2.:109-118, 2007.

Rol shumë të rëndësishëm në edukimin e fëmijëve me nevoja të veçanta luajnë prindrit e tyre. Gjatë punës në institucionet arsimore, procesi i gjithëpërfshirjes së këtyre fëmijëve në shkollat e zakonshme është shumë i lidhur edhe me angazhimin prindërv të tyre. Prindërit janë aleatët kryesorë të mësimdhënësve gjatë realizimit të politikave gjithëpërfshirëse.

Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta kanë mendime jo të njëjta lidhur me gjithëpërfshirjen sepse sipas tyre nëse fëmijët përfshihen në shkollat e zakonshme atëherë po i humbin shumë nga shërbimet e specializuara, që i përfitojnë.<sup>41</sup> Disa nga prindërit ngrisin edhe shqetësimet se nëse fëmijët e tyre do të përfshiheshin në shkolla të zakonshme atëherë do bëhen edhe pjesë e etiketimeve dhe talljeve nga nxënësit tjerë.

Nga konkludimet e një studimi i kryer në Irlandë del se 94 % e prindërv të intervistuar i japin prioritet edukimit të fëmijëve të tyre në shkolla speciale duke potencuar edhe arsyet e tyre si:

- Sepse mësuesit kanë më shumë kohë të merren me ta;
- Në shkollë ka edhe të tjerë si ai
- Fëmija i tyre nuk e ndjen veten të veçuar;
- Klasat janë më të pakta në numër;
- I ofrohet kujdes i specializuar;

Sigurisht ndarja e mendimeve lidhur me shkollat e zakonshme dhe atyre të edukimit special bazohet nga praktikat dhe arsyet e ndryshme, por nuk duhet neglizhuar faktin se varësisht nga niveli i nevojës së veçantë atëherë duhet edhe nxjerrë konkluzionet. Por bazuar në studimet e ndryshme nëpër shtete të zhvilluara kjo çështje ka pasur fatin të jetë e zgjidhur konform nevojave të këtyre nxënësve me një përkrahje të vazhdueshme nga shteti.

## **KONKLuzion**

Gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme njeh fillime të vonshme në historinë e edukimit special të fëmijëve me nevoja të veçanta. Ajo ka bashkëshoqëruar lëvizjet e kryera në fushën e nevojës së veçantë, nga organizata, rrjetëzime

---

<sup>41</sup> Green & Shinn 1994, cituar në Salend, S.J., Creating Inclusive Classrooms: Effective and reflective practices

interesi, por kryesisht grupime të prindërve të fëmijëve me nevoja të veçanta, për të garantuar të drejtat e personave me nevoja të veçanta në një shoqëri për të gjithë.

Qasja ishte e rëndësishme pasi u identifikua me një paradigmë të re në trajtimin e çështjeve të nevojës së veçantë, paradigmën sociale, që shërbeu për të nisur shmangien nga modeli mjekësor, mbizotërues deri në atë kohë për trajtimin e çështjeve të nevojës së veçantë. Paradigma sociale e trajtimit të gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme u vlerësua e rëndësishme në identifikimin e faktorëve të jashtëm (jo të varur nga dëmtimi apo sëmundshmëria e fëmijës me nevoja të veçanta), papërshtatshmëria e të cilëve pengonte aksesin e plotë të fëmijës me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme. Si rrjedhojë gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme bëhet proces i pranueshëm për të gjithë.

Procesi i gjithëpërfshirjes shoqërohet nga një sërë vështirësish e barrierash, të cilat më së shumti lidhen me faktorë të jashtëm si: financiarë, zhvillimi social-kulturor dhe arsimor i aktorëve të përfshirë në proces, i komuniteteve ku realizohet ai, qëndrimet e tyre, mungesa e infrastrukturës mbështetëse për zbatimin e praktikave gjithëpërfshirëse, niveli i bashkëpunimit që ofrojnë prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Poashtu, rëndësi ka përgatitja akademike e mësuesve të rinj me njohuri për trajtimin e fëmijëve nevoja të veçanta, aftësi praktike për të punuar me ta si dhe me njohuri për përshtatje të programeve në përputhje me nevojat e nxënësve me nevoja të veçanta. Gjithashtu, në procesin e gjithëpërfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta vlerësohet i domosdoshëm roli i prindërve. Ku ata shihen si aleatë, bashkëpunëtorë në këtë proces, rezultatet janë të ndjeshme tek fëmijët me nevoja të veçanta.

Me rastin e gjithëpërfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme vlerësohet se prindërit duhet të bashkëpunojnë ngushtë dhe në mënyrë të vazhdueshme me shkollën dhe mësuesit në veçanti. Roli i tyre duhet të jetë i rëndësishëm në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e strukturave dhe të programeve të edukimit të fëmijëve të tyre të përfshirë në sistemin arsimor. Për këtë është e domosdoshme rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të tyre për të drejtat e fëmijëve nevoja të veçanta, për të përfituar arsimimin në përputhje me nevojat specifike të tyre.

**Referenca:**

1. Ajodhia-Andrews, A. D., (2007). Inclusive education in Guyana: perspectives of policy makers, teachers, and parents of children with special needs.
2. Alghazo, E. M, Naggar Gaad, E. E., (2004). General education teachers in the United Arab Emirates and their acceptance of the inclusion of students with disabilities., *British Journal of Special Education Volume 31.No.2,:94-99.*
3. Asian Development Bank (2010). Strengthening inclusive education.
4. Brandes, J. A., Crowson, M. H., (2009). Predicting dispositions toward inclusion of students with disabilities: the role of conservative ideology and discomfort with disability, *Soc Psychol Educ 12,:271-289.*
5. Jonsson, T., Wiman, R., (2001). *Education, Poverty and Disability in Developing Countries.* Poverty Reduction Sourcebook, June 2001.
6. Kozleski, E. B., Waitoller, F. R., (2009). *Teacher Learning for Inclusive Education: A Framework for Embracing Diversity.* Potchefstroom, South Africa: North West University.
7. Le Fanu, G. (2005). The Inclusion of Inclusive Education in Teacher-Training: Issues of Curriculum, Pedagogy and Staffing, 2005 National Curriculum Reform Conference, Australia.
8. Mohan Jha, M., (2002), Barriers to Access and Success: Is Inclusive Education an Answer? 2nd Pan-Commonwealth Forum on Open Learning, 29 July 2002 - 2 August 2002, Durban, South Africa.
9. OKB 1948, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.
10. OKB 1979, Konventa për Eleminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas.
11. OKB 1989, Konventa për të drejtat e fëmijëve.
12. OKB 1993, Rezoluta 48/96 “Rregullat standarte mbi barazinë e mundësive për personat me nevoja të veçanta”.
13. OKB 2006, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.
14. Oliver C. and Bowler F. R., 1996, Learning to Learn, Simon & Schuster.
15. Trump, G., Hange, J. (1996). Teacher perceptions of and strategies for inclusion: A regional summary of focus group interview fi

ndings. Charleston, WV: Appalachia Education Laboratory (ERIC  
Document Reproduction Service No. ED 397 576).

16. UNESCO 2005, Guidelines for inclusion: Ensuring Access to education

**WOMEN WRITERS OF THE HARLEM RENAISSANCE****Reis KERIM**

International University of Struga

r.kerim@eust.edu.mk

**Rezarta MERKO**

International University of Struga

rezarta.merko@eust.edu.mk

**Abstract**

The Harlem Renaissance began around 1918 to 1920 and was an era of African-American art. The movement was known as the “New Negro Movement” coined by Alain Leroy Locke in 1925. The Harlem Renaissance also sparked the notion of the “New Negro Woman” relating to women poets, authors and intellectuals, known for their race conscious writing. It played a vital role as the voice for the struggling minority of African American women. The Harlem Renaissance was not just about legislative issues, rather it was a route for authors like Zora Neale Hurston, jazz artists like Louis Armstrong and performers like Josephine Baker to exhibit that the African American culture had a place in American history as well as demonstrated that the thought regarding black inferiority was a social construction. It likewise gave the chance to some black theater performing artists to perform among whites and which thus supported in the dismissal of blackface and minstrel shows. The Harlem Renaissance arrived at an end amid the Great Depression generally in light of the fact that the African American group relied on white benefactors (who were harmed by the recession). Still, the development enlivened new creators, musical artists and black scholarly people amid the social liberties development. Besides, many accept that the development has made



significant contribution towards social fairness in expressions of the human experience and inside the American culture.

**Keywords:** *Harlem Renaissance, The New Negro Movement, American Culture, Women Writers in the Renaissance, Cultural bridges between Africa and America, Art.*

## INTRODUCTION

The Harlem Renaissance was a period in which black intellectuals, writers, poets, performers and musicians explored their cultural identity. In a society where racism was predominant African Americans needed economic opportunities. The creation of art, music and verse was not just an approach to monetarily uplift the race but additionally to demonstrate racial pride. The social development began toward the end of the First World War and finished in the center of the Great Depression in the 1930s. Many argue that the war extended economic opportunity in Northern urban communities on account of industrialization and the reduction of European foreigners impending into the United States. The Great Migration on the start of the twentieth century likewise played a major part in the conception of the social development. African Americans in the South were encountering social, cultural and economic mistreatment so when they discovered chances to escape Jim Crow laws they took their chances. The absence of a political voice and the predominant racial scorn drove numerous African Americans to communicate by means of art. Alain Locke, an African American author, was the first to use the expression "New Negro" discussing a spur of youthful black artists who were going to change the African American culture by showing that their kin was most certainly not subservient. Other educated people, for example, W.E.B. Du Bois and James Weldon Johnson helped in the extension of the development by being representatives for the literary youth (Delgado-Tall 2001). As journalist Sonia Delgado-Tall (2001) notes in "The New Negro Movement and the African Heritage in a Pan-Africanist Perspective", Locke and Du Bois should be recognized as the first to concretize the cultural bridges between Africa and America. An alternate essential on-screen character of the Harlem renaissance is Marcus Garvey who had confidence in the significance of racial pride and the African legacy. This paper will explore what life was like for African

Americans during the Harlem Renaissance. The focus will be on the role of the Negro woman during this time period, as she became an important player during the New Negro Movement.

## **1. WOMEN WRITERS IN THE RENAISSANCE**

The questions of appropriateness in tone and topic gotten to be significantly more pressing when one considers issues of gender. For women writers of the Harlem Renaissance like Jessie Fauset, Nella Larsen, and Zora Neale Hurston, the push to articulate effectively a feeling of self, included an investigation of female sexuality and of sentimental connections. Fundamentally, albeit every one of the three of these creators concentrated on a comparative issue for black women, they exhibited an expansive scope of answers, a range that paralleled and mirrored the class and social strains confronting their male partners. For Fauset and Larsen the issue of passing, or the endeavor to deny one's black character by acting like a white individual, likewise molded the discourses of sex, class, and culture (Hagood 2010, 6).

### **Jessie Fauset**

Of the ladies artists who made a critical commitment to the development, Jessie Fauset is arguably one of the most underestimated. As literary editor of *The Crisis* and teammate with W. E. B. Du Bois, Fauset was, in actuality, a midwife to the Harlem Renaissance (Zhao 2010). It was she who first distributed Langston Hughes' verse and who encouraged Countee Cullen and Jean Toomer to continue writing. In expansion to being an incredible nurturer of writers, Fauset was herself a productive writer, distributed a few crucial articles also four books, the best known of which is *Plum Bun* (1929). The narrative of racially blended Angela Murray's pursuit of sentimental and artistic fulfillment on both sides of the shading line, *Plum Bun* brings up intriguing issues about the ethical quality of passing, the restrictions the black artists must face, and the challenges experienced by ladies who strive for passionate and sexual determination toward oneself in a male-dominated world. Sadly, despite the fact that the issues are brave, Fauset's mode of addressing to them is, eventually, ordinary and

conservative; she brings her story to a pretty much unimaginable happy ending and what's more offers to some degree easy responses to the questions she has raised. It is in all likelihood this that has driven most readers to fail to notice her fiction.

### **Nella Larsen**

On the off chance that Fauset's conservatism is part of what makes hers a lesser voice in the period, Nella Larsen's ability to take savvy and innovative risks, alongside her impressive talent, make her one of the Renaissance's driving lights. Her two books, *Quicksand* (1928) and *Passing* (1929), depict talented tenth light-skinned black women who battle to adjust their individual senses of faithfulness to their race with a developing craving for sexual fulfillment. In *Quicksand*, heroin Helga Crane tries to discover fulfillment in Harlem, then in Denmark, before she at long last settles in a little southern town as the wife of a terrible, yet sexually intense, black minister. The novel closes with a picture of Helga childbearing herself to death, a picture that resounds with the book's title and reminds the reader of the traps into which dark ladies who attempt to assert themselves can fall.

*Passing* is in many ways even braver, as it exhibits Irene Redfield's battle to deal with her irresoluteness about Clare Kendry, a childhood friend who is currently passing for white however chooses to come back to the black community, whatever the cost. Irene seems stressed that the cost may include Clare taking her spouse, Brian. As Deborah E. McDowell has noted, however, the novel unmistakably has a strange subtext, which shows itself in Irene's developing interest with Clare's "un-raced" body. At last, Clare's looming return to Harlem as a liberated individual proves excessively threatening to Irene, who pushes her out an apartment window to her death. As in *Quicksand*, Larsen stresses the perils confronting the black woman who tries to free herself from the strictures of externally characterized race and sexual personality; here, however, she makes deadly consequences that she rather obliquely suggests in her first novel.

Regardless of, or maybe because of, their controversial subject matter, both of Larsen's books were exceptionally received to such an extent that Larsen won a Guggenheim partnership to do research on a novel set in Spain; shockingly, she never created that third

